



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR”
TË USHTRUAR NË BASHKINË SELENICË

Tiranë, janar 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtime	3
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-12
a	Përshkrim i shkurtër i Bashkisë Selenicë	4
b	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij	4
c	Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave	4
d	Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave	5
e	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve	5
f	Paraqitja e gjetjeve kryesore	5-8
g	Paraqitja e rekomandimeve kryesore	8-10
I.1	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	10-12
II	HYRJA	12-
1	Objektivat dhe qëllimi	12
2	Identifikimi i çështjes	12
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12-13
4	Përgjegjësitë e audituesve	13
5	Kriteret e vlerësimit	13-15
6	Standardet e auditimit	15-16
7	Metoda e auditimit	16-17
8	Dokumentimi i auditimit	17-18
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	18-153
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Selenicë	18-19
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	19-153
2.1- 2.5	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	19-35
2.1.6	Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre	35-53
2.2	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2023	53-78
2.3	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM	78-125
2.4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	125-152
2.5	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	152-153
IV	REKOMANDIME	154-180

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave.01
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
OE	Operator Ekonomik
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit të zhvilluar në Bashkinë Selenicë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me Bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me Bashkinë Himarë dhe perëndim me Bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës. Sipas Censurit të vitit 2011, zona e Bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezulton me 35.793 banorë. Kjo bashki përbëhet nga 6 Njësi Administrative, të cilat janë: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Për vitin 2023 planifikimi përfundimtar i shpenzimeve ka qenë 783,099,827 lekë, ndërkohë që realizimi ka qenë 649,625,519 lekë ose në masën 83% me një diferencë mos realizimi në vlerën 133,474,308 mijë lekë. Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ka qenë në vlerën 114,592,854 lekë ndërsa realizimi në vlerën 97,651,182 lekë ose në masën 85% me një diferencë mos realizimi në vlerën 16,941,672 lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij:

Bashkia e Selenicë është njësi vendore e pavarur, ku pas ndarjes së re territoriale është bashkuar ish-Bashkia Selenicë dhe pesë ish-komunat në afërsi të saj, të cilat aktualisht funksionojnë si Njësi Administrative dhe ato janë: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj.

Auditimi i këtij institucioni të vetëqeverisjes vendore bëhet në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 163 dhe 164, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 10, Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, si dhe Programit të Auditimeve për muajin Maj të vitit 2024, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 87/4 prot., datë 10.05.2024.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt. Periudha e auditimit është nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit, janë si vijon:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit;
- Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre;
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi;
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM;
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit;

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku dhe me përzgjedhje periudhash dhe transaksionesh. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të vlerës së transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe autorizimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- ✓ Verifikimi i transaksioneve;
- ✓ Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;
- ✓ Intervistat;
- ✓ Verifikimi në sisteme etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 28 gjetje dhe ka dhënë 44 rekomandime, nga ku masa organizative 23 gjetje me 38 rekomandime, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike 1 gjetje me 1 rekomandim dhe masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) 4 gjetje me 5 rekomandime.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

▪ *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit:*

a) Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2023 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në llogaritë e mësipërme janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar. Për vitin 2023 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën **783,099,827 lekë** dhe realizuar në vlerën **649,625,519 lekë** në masën 83 % ose me një **mos realizim në vlerën 133,474,308 lekë** përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 92,875,507 lekë + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 245,470,200 lekë + nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 80,697,349 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 165,029,362 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për investimet në vlerën 65,553,096 lekë.

▪ *Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre:*

a) Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave nuk janë mbajtur procesverbalet në terren për verifikimin e statusit të subjekteve të përgjithshme në QKB;

-Për vitin 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 103 subjekte “Biznes i vogël” të pa regjistruara në QKB. Këto subjekte në pjesën më të madhe janë dyqane, bar-kafe, ambulant, profesione përziera të cilët ushtrojnë aktivitet shërbimi dhe në disa raste sezonale.

-Për vitin 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 6 subjekte “Biznes i madh” por pa u pajisur me Nipt sekondar ku 3 prej tyre nuk kanë likuiduar taksat vendore për vlerën 198,200 lekë, përkatësisht: OE “A” Shpk në vlerën 28,200 lekë, OE “K” Shpk në vlerën 85,000 lekë dhe OE “A” Shpk 85,000 lekë.

b) Nga verifikimi me zgjedhje i 15 dosjeve subjekteve biznesit madh për vitin 2023, konstatohet se:

-Të gjitha dosjet e biznesit të madh nuk kanë inventar të dokumentacionit dhe nuk janë arkivuar, në kundërshtim me nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor RSH” miratuar nga DP Arkivave, në zbatim nenit 3 dhe 29 Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”;

-Në disa raste, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave (MA);

-Në disa raste janë lëshuar padrejtësisht vërtetime për efekt dokumenti, se subjektet nuk janë debitor, ndërsa në fakt rezultojnë debitor, përkatësisht: për subjektet “BSAD C” Shpk; “M P” Shpk; “M B” Shpk; “S B” Sh.a; “B P” Shpk e tjerë;

-Në 1 rast, në dosjen e subjektit “A G E” Shpk u konstatua se, subjekti debitor për 5,214,327 lekë ka hapur padi gjyqësore, por kjo nuk e pengon DAPPLL për ekzekutimin e detyrimit deri në daljen e vendimit formës prerë të gjykatës;

-Në 1 rast, në dosjen e subjektit “Z” Shpk u konstatua se, subjekti debitor për 2,700,000 lekë, ka bërë marrëveshje nr. 1237/1 prot., datë 19.06.2023, për shtyrjen me këste prej 450,000 lekë/secili deri në fund të vitit 2024 për arsye vështirësie financiare, por nuk ka asnjë këst të derdhur nga subjekti, në kundërshtim me kushtet e aktmarrëveshjes pika 3 dhe nga ana e DAPPLL nuk ka asnjë masë për shkeljen e aktmarrëveshjes.

-Në 1 rast, në dosjen e subjektit “A I” Shpk u konstatua se, subjekti nuk është nxjerrë debitor për vitin 2023, pasi ka pezulluar aktivitetin. Lidhur me pezullimin disponohet akt-konstatimi në terren date 01.03.2023 i komisionit, por mungon nënshkrimi i Policisë Bashkiake dhe pala e interesuar, madje kjo e fundit nuk ka bërë kërkesë për ndërprerje;

-Në 1 rast, në dosjen e subjektit “A I” Shpk u konstatua se, subjekti është njoftuar për vitin 2023 disa herë për shlyerjen e detyrimeve taksave për vlerën 370,000 lekë, por nuk ka njoftuar subjektin për shlyerjen e detyrimeve të vitit 2024;

-Lidhur me rentën minerale, u konstatua se DAPPLL nuk disponon dokumente në dosjet e subjekteve, për zbërthimin dhe përlllogaritjen e kësaj rente si dhe nuk ka rekordim vjetor me agjentin tatimor, për efekt të pagesës saj dhe sa subjekte nuk kanë kryer pagesën ose e kanë kryer të pjesshme.

-Nuk u verifikuan dosjet e biznesit vogël, pasi nuk janë mbajtur nga DAPPLL.

c) Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Selenicë në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, janë në vlerën **455,593,441 lekë**.

Bashkia Selenicë nuk ka ndërmarrë veprime administrative ose ligjore për arkëtimin e tyre, duke i lënë këto debitorë në heshtje dhe të kalojnë në debitorë pa shpresë arkëtimi, duke kaluar afati i kërimit të tyre në rrugë gjyqësore. DAPPLL nuk i ka kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”. Nuk është zbatuar pika 5/3.4 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të paguar”. DAPPLL nuk ka aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim

të nenit 17, pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Kreu XIV, neni 114.

-Nuk është bashkëpunuar me DRT Vlorë për arkëtimin e debitorëve të subjekteve biznesi i madh.
-Për rastet e bizneseve private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë që nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, nuk janë marre masat administrative apo sekuestro, kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

▪ *Auditimi mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi:*

a) Nga komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i ngritur me Urdhrin nr. 155, datë 16.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë janë mbajtur procesverbalet përkatëse të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve në vlerën 93,153 lekë. Në procesverbalet e asgjësimit të aktiveve citohet se, “Gjatë verifikimit të këtyre materialeve u konstatuan se këto materiale nuk janë në gjendje pune për t’u përdorur dhe nuk përshtaten për përdorim. Materialet që dolën jashtë përdorimit u ndryshua forma dhe një pjesë e tyre u gropos dhe pjesa tjetër u dogj”. Nga sa më sipër konstatohet se nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

b) Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 180,033,022 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 236,324,467 lekë me një rritje në vlerën 56,291,445 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 219,268,974 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërpartit llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. 3. Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 75,928,024 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 87,407,780 lekë me një rritje në vlerën 11,479,756 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksat dhe sigurime shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 69,043,253 lekë.

c) Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” u konstatua se, kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 530,578 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjalet Kanalizime Selenicë me Nipt K47127201C është 17,396,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjalet Kanalizime Vlorë me Nipt M37202202E. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Selenicë është 530,578 ose 3.05% ($3.05 \cdot 17,396,000 / 100 = 530,578$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë.

d) Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,401,723,271 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 10,818,675 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 720,498 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 115,350,035 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 1,440,996 lekë.

▪ *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM:*

a) Nga Bashkia Selenicë nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje për 10 subjekte private. Duke u bazuar në raportet tekniko ekonomiko-financiare të kryera nga grupi i punës të bashkisë (trajtuar më sipër në mënyrë të hollësishme) është përllogaritur detyrimi për 15 subjekte (nga të cilat pesë prej tyre kanë lidhur kontratë qiraje) vetëm për sipërfaqen faktike të gërmimit së bashku me tarifën për linjat gjatësore të rrugës vlerën 6,899,072.3 lekë për vitin 2023, ku është arkëtuar vlera 1,523,434.4 lekë si dhe janë krijuar debitorë ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën **52,032,890.3 lekë**. Gjithashtu nga Bashkia Selenicë për vitin 2023 nuk janë përllogaritur detyrimet në vlerën **47,186,572.4 lekë** për pjesën tjetër të sipërfaqes së lejes minerare sipas tipologjisë përkatëse e **cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë**.

b) Përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitetet minerar brenda fondit pyjor kullosor dhe në pasuritë pronë të institucionit **15 subjekte**. Referuar akt-verifikimeve të mbajtura në terren dhe raporteve tekniko-ekonomiko financiare të hartuara nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë, sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është **97.1238 ha** sipas tipologjisë tokë arë, inproduktive, e pa frytshme dhe kullotë (pjesë të fondit pyjor kullosor dhe ato privatë të përfituara në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”) që prej fillimit të lejeve dhe deri në muajin mars të vitit 2024. Nga këto subjekte nuk janë masa për zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit, për rehabilitimin e sipërfaqes prej **136.5686 ha** sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës në rakordim me sipërfaqen e shfrytëzueshme të karrierës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në neni 37, pikat 2-3, dhe Urdhrin nr. 1937, datë 21.10.2014, të Ministrit të Mjedisit me objekt “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullosore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullosor nëpërmejt pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”, pika 1-3.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

▪ *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit:*

a) Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bashkisë, të marrë masa hartojë plane të studiuara mbi realizimin e të ardhurave si bazë për planifikimin e investimeve të qëndrueshme e të sigurta për t’u realizuar, gjithashtu, plani i shpenzimeve të korrigjohet, brenda afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor.

▪ *Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre:*

a) Bashkia Selenicë, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave (sektori i kontrollit në terren), të planifikojë inspektime në terren në lidhje me statusin e subjekteve, në qoftë

se konstatohen subjekte që ushtrojnë aktivitetet pa u regjistruar në QKB t'u përlllogariten taksat dhe tarifat vendore përkatëse.

b) Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për subjektet që ushtrojnë aktivitetet në territorin e Bashkisë Selenicë të pa pajisur me nipt sekondar në shumën **198,200 lekë**.

c) Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune me specialist fushe (duke përjashtuar punonjësit e DAPPLL) për verifikimin dhe rakordimin e gjendjes debitore për subjektet të cilëve është lëshuar vërtetimi për mos pasje detyrimesh për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Selenicë ndërkohë që janë debitorë. Në rast se kjo problematikë evidentohet përgjatë këtij procesi të merren masa për përlllogaritjen e detyrimeve, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit sipas vlerave përkatëse.

ç) Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për plotësimin me dokumentacionin përkatës ligjore të dosjeve të subjekteve të biznesit të madh dhe atij të vogël, duke kryer njëkohësisht edhe inventarizimin e tyre.

d) Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën totale **455,593,441 lekë**.

▪ *Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi:*

a) Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

b) Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kunërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë”. -Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të paraqesë saktë vlerat e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, ku në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 87,407,780 lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

c) Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

ç) Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

▪ *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM:*

a) Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Selenicë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga

fondi pyjorë, t'i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë.

b) Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Selenicë, të vendosen marrëdhënie kontraktuale me subjektet shfrytëzuese të sipërfaqeve pyjore, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 761.8728 ha, dhe aplikuar tarifatat dysHEME minimale për të llogaritur vlerat e qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit për vlerën **52,032,890.70 lekë**.

c) Bashkia Selenicë të marrë masa të menjëhershme që, t'u kërkojë subjekteve që ushtrojnë aktivitetet minerar në fondin pyjor kullor, zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit për rehabilitimin e sipërfaqes sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës në rakordim me sipërfaqen e shfrytëzueshme të karrierës.

3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Selenicë, KLSH ka dhënë **“Opinion të modifikuar/kualifikuar me rezervë”** për Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2023.

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2023:

a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të parashkruara në paragrafin e “Bazës për opinion me rezervë” pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Selenicë më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrin rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 12,992 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, nuk është kryer pakësim i vlerës 93,153 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023.

-Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” është nënvlerësuar në vlerën 9,057,580 lekë për arsye se në këtë llogari nuk janë kontabilizuar aktivet vlerësuar si të dëmtuara nga procesi i inventarizimit sipas procesverbaleve të datës 01.12.2023, 23.12.2023, dhe 28.12.2023.

-Në gjendjen e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba” është përfshirë vlera 29,760,703 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

-Në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar vlera 219,268,974 lekë e cila ka të bëjë me detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore.

-Llogaria 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 87,407,780 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 69,043,253 lekë.

-Për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 58,000 lekë ndërkohë që duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

-Në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është pasqyruar vlera 526,501,279 lekë, e cila i përket asetëve të transferuara në Shoqërinë Ujësjiellës Selenicë.

-Në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 31,079,786 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 15,757,820 lekë; 210 “Tokë, troje, terrene” është përfshirë vlera prej 140,307,952 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 58,000 lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” është përfshirë vlera prej 282,322,171 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 45,581,320 lekë; 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është përfshirë vlera prej 1,570,622,458 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 260,837,855 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” është përfshirë vlera prej 11,853,994 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 5,399,691 lekë; 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera prej 11,678,180 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 10,799,192 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” është përfshirë vlera prej 38,702,608 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 19,379,921 lekë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike. Këto vlere janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Sevaster, Brataj, Kotë, Armen dhe Vllahinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” është nënvlerësuar në vlerën 530,578 lekë. Vlora e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Selenicë me Nipt K47127201C është 17,396,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë me Nipt M37202202E. Vlora e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Selenicë është 530,578 ose 3.05% ($3.05 \cdot 17,396,000 / 100 = 530,578$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë.

-Në gjendjen e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” evidentohen vlora të kontabilizuara me emërtimin “Pa origjinë” apo “Kaluar gabim nga të ardhurat” në vlerën totale prej 764,810

lekë, për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre të cilat mbahen të mbartura dhe të trashëguara vit pas viti në kontabilitet si dhe nuk janë të verifikueshme çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë për shkak të mos përshkrimit të objektit që i përket kthimit të garancisë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” paraqitet në vlerën 35,733,436 lekë, nga të cilat 18,800,834 lekë i përkasin ngurtësimeve për 43 objekte të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Selenicë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve.

-Çelja e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,401,723,271 lekë. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 10,818,675 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 720,498 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 115,350,035 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 1,440,996 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 619/1 prot., datë 09.05.2024, i ndryshuar me shkresën nr. 619/2 prot., datë 03.06.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.05.2024, deri më 14.06.2024, në institucionin Bashkia Selenicë u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. H (Përgjegjës grupi)
2. B. B anëtar

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Identifikimi i çështjes: Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Selenicë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Titullari i institucionit në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe Drejtori i Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në cilësinë e nëpunësit zbatues, janë

përgjegjës përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, dhe aktet nënligjore të tjera.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

-Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.,;

-Interesin publik ose pritshmërinë publike (përshtetull shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.,);

-Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.,;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Selenicë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5. Kriteret e vlerësimit: Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Selenicë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Selenicë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008, “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 35, datë 05.11.2008, “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008, “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 29.03.2012, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 02.06.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 10/1, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimi plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr. 1, datë 17.01.2019, “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014, (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014, (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

6. Standardet e auditimit: Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Selenicë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.,.

7. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

-Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

-Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

4. Kontrolli i vlerësimeve:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,

7. Intervista:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Selenicë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione:

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.

9. Praktikat e ndjekura:

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231).

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit: Është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të aktkonstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 619/5, datë 30.07.2024. Nga ana e Bashkisë Selenicë janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr. 1612/2 prot., datë 04.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 619/6 prot., datë 09.09.2024. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Selenicë.

Auditimi në subjektin “Bashkia Selenicë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Selenicë është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

Profili i Bashkisë Selenicë: Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me Bashkinë Fier, në lindje me Bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me Bashkinë Himarë dhe perëndim me Bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës. Bashkia e re e Selenicës shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë, i cili është tributar i Vjosës. Bashkia e re ka në territorin e saj minierën historike të bitumit në Selenicë, ku punësohen edhe banorët e fshatrave përreth, si dhe zonën naftëmbajtëse të Vllahinës ku nafta është drejt shterimit duke lënë pas një zonë të madhe të ndotur.

Bashkia përbëhet nga disa komuna të cilat nuk kanë lidhje organike me qytetin e Selenicës, si dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë rrugore me këtë qytet, duke vështirësuar në këtë mënyrë komunikimin mes tyre.

Dinamika e Popullsisë: Sipas Censurit të vitit 2011, zona e Bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezulton me 35.793 banorë. Dallimi i madh mes

shifrave të regjistrimit civil dhe të censusit flet për një shkallë të lartë emigrimi¹. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 561.24 km². Sipas të dhënave të censusit, bashkia e re ka një densitet prej 32.9 banorësh për kilometër katror ndërsa sipas regjistrimit civil, densiteti është 63.77 banorë/ km². Kjo bashki përbëhet nga 6 Njësi Administrative, të cilat janë: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra. Bujqësia dhe blegtoria është aktiviteti kryesor ekonomik i Bashkisë Selenicë, popullsia e të cilës bazohet veçanërisht shumë te remitancat nga emigracioni për të siguruar të ardhurat e saj. Si zonë bujqësore, bashkia e re është e lidhur ngushtë me Bashkinë e Vlorës, si treg i rëndësishëm për produktet e saj.

Ekonomia e Bashkisë Selenicë është një ekonomi mikse, me natyrë bujqësore dhe të shërbimit. Qyteti i Selenicës është një qytet me potencial të lartë zhvillimi duke u bazuar në pozitën gjeografike në të cilën ndodhet. Njësitë Administrative Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj kanë një ekonomi kryesisht bujqësore.

Sot Bashkia Selenicë është një qendër e rëndësishme minerare si njësi e re administrative përfshin komunitat, Brataj, Kotë, Sevaster, Vllahinë Armen. Kjo njësi e qeverisjes vendore, shtrihet në një territor të gjerë me rreth 36.000 banorë, 47 fshatra dhe qytetin e Selenicës. Shtrirja e gjerë, relievi i larmishëm, specifikat dhe veçantitë e çdo fshati, mungesa e investimeve, kanë akumuluar një sërë problematikash për komunitetin që jeton në këtë zonë.

Në qytetin e Selenicës rezulton që popullsia është e punësuar rreth 31% në shërbime, në sektorin e ndërtimit 20% dhe në sektorin e tregtisë 22%. Pjesa e banorëve të cilët janë punësuar në bujqësi arrin në 27 % kurse pjesa tjetër janë të punësuar në sektorë të tjerë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Bashkia Selenicë administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve të miratuara për vitet 2023-2025 si më poshtë:

- | | |
|--|--|
| 1. Programi i planifikimit-menaxhimit-administrimit; | 11. Programi i administrimit të pyjeve dhe kullotave; |
| 2. Programi i vështirësisë financiare dhe fiskale; | 12. Program infrastrukturës, rrugëve, kullimit, ujitjes; |
| 3. Programi i shërbimit të policisë vendore; | 13. Programi i emergjencave civile; |
| 4. Programi i mbrojtjes nga zjarri e civile; | 14. Programi fondit rezervë e kontigjenca; |
| 5. Programi i mbështes për zhvillim ekonomik; | 15. Programi i mbrojtjes së mjedisit; |
| 6. Programi shërbimeve bujqësore; | 16. Program arsimit, parauniversitar dhe edukimit; |
| 7. Programi i kujdesit social për familje dhe fëmijë; | 17. Programi i arsimit, parashkollor dhe arsimit bazë; |
| 8. Programi menaxhimit mbetjeve, shërbime publike; | 18. Programi mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave; |
| 9. Programi urban vendor dhe transporti publik; | 19. Shërbimi i kujdesit parësor; |
| 10. Programet siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit | 20. Programi për sport, argëtim dhe trashëgimia kulturore; |

Nga auditimi i procedurave të përgatitjes të PBA-së për vitet 2023-2025 u konstatua se janë zbatuar fazat e përgatitjes respektivisht, ngritja e grupit punës, marrja e kërkesave sipas nevojave për punë, mallra e shërbime, planifikimi për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj. Në mënyrë të detajuar ky dokumentacion evidentohet në vijim të materialit konkretisht:

Programimi i PBA-së për vitet 2023-2025 parashikon burimet e financimit që janë: a) të ardhurat e veta b) transferta e pakushtëzuar c) transferta pakushtëzuar sektoriale.

Tavanet e buxhetit afatmesëm për vitet 2023-2025, janë miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2022, me objekt "Për miratimin e tavaneve dhe pasqyrave të PBA-së për vitet 2023-2025",

konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë me shkresën nr. 24/1 prot., datë 17.01.2023, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2014, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Në VKB-në e sipërpërmendur është miratuar edhe vlerësimi dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Selenicë si dhe kalendarik për përgatitjen e PBA-së për vitet 2023-2025, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2014, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 33-34.

Në mënyrë elektronike nëpërmjet email-it zyrtar të institucionit, Bashkia Selenicë i ka dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë së Financave Vendore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dokumentin e PBA-së për vitet 2023-2025.

Është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025.

Disponohet Plani i Masave dhe i Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për vitin 2023, ku janë të përcaktuara aktivitetet që do të zhvillohen, afati dhe personat përgjegjës.

Ka mbledhje të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve tjera menaxhimit financiar e kontrollit.

Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA e viteve të mëparshme dhe mbi një analizë të mirëfilltë. Bashkia Selenicë është mbështetur në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2014, “Për financat e qeverisjes vendore”, konkretisht sipas neneve, 33-37, dhe në Udhëzimin nr. 7, datë 27.02.2022, dhe nr. 23, datë 08.08.2022, “Për procedurat standarde përgatitjes PBA njësisive vendore”. Gjithashtu është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore gjatë vitit 2023.

Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, si dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të Shtojcës 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” dhe Shtojcës 5 “Treguesit monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiare”, të Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vetëqeverisjes vendore”.

Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2014, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vendore”, pikat 10, 12, 28, 29, 48. Disponohet dokumentacioni për dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit. Të dhënat mbi programimin e PBA-së për vitet 2023-2025 dhe buxhetit vjetor të institucionit për vitin 2023 paraqiten sipas tabelave në vijim:

Lekë

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	135,201,438			143,949,404
601	Sigurime Shoqërore	22,657,800			30,394,090
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	67,480,241			174,343,494
605	Transferata Korente të Huaja				
606	Transferime për buxhete familjare dhe individë	7,252,525			
I	Shpenzime Korrente	232,592,004			291,379,679
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,093,276			7,000,000
231	Kapitale të Trupëzuara	127,863,218			216,900,595
	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	128,956,494			223,900,595
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim të huaj				
II	Shpenzime Kapitale				
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limitit				
	I+II +III Totali i Shpenzimeve	361,548,498			515,280,274

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA-në për vitet 2023-2025:

000/Lekë

Nr .	Emërtimi	Plan përfundimtare 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar dhe specifik	174,343	174,343	
2	Shpenzime (602 + 604 + 609) nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar dhe specifik	117,036	117036	
3	Investime Bashkia (nga të ardhurat e grantit të pakushtëzuar)	223,901	223,901	
4	Investime nga FZSH			
	Total i planit fillestar			
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)			
7	Shpenzime (602 + 604 + 609)			
	Grant i kushtëzuar (230-231)			
	Totali	515,280	515,280	

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit të VKB, ndryshimet gjatë vitit, analiza sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Për vitin 2023, buxheti i Bashkisë Selenicë është miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2022, konfirmuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë me shkresë nr. 24/1 prot., datë 17.01.2023. Miratimi i buxhetit nga njëzia vendore për vitin 2023 është kryer jashtë afateve të parashikuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 32, ku përcaktohet që:

Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njëzive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre. Këshilli brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

Bashkia Selenicë për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar buxhetin, në zbatim të kërkesave të mëposhtme:

- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjit nr. 9936, datë 08.07.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022, “Për buxhetin e vitit 2023”;
- Udhëzimit të MF nr. 1, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”;
- Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022, “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm 2023-2025”;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- VKB nr. 80, datë 27.12.2022, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Selenicë për vitin 2023”;
- VKM nr. 625, datë 28.09.2022, “Për disa shtesa në Vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, për grupimin e njëzive vendore për efekt page dhe caktim kufij page të funksionarëve të zgjedhura, të emëruar, nëpunësve civile dhe punonjësve të njëzive vendore”;
- Shkresa me nr. 2489 prot., datë 19.10.2022, “Për transfertë të përgjithshme e pakushtëzuar dhe atë sektoriale për vitin 2023”;

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nënartikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me Degën e Thesarit Vlorë.

Programimi buxhetor i vitit 2023 i Bashkisë Selenicë parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore, me qëllim përmirësimin e jetës komunitetit, përmirësimin dhe modernizimin të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, përmirësimin e pastrimit qytetit, rritjes sipërfaqeve të gjelbëruara, zhvillimin e mirëmbajtjes tregjeve, zhvillimin e turizmit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e territorit me shërbime sociale, zhvillimin e aktiviteteve kulturave e sportive, menaxhimin e situatave natyrore, etj.,.

Realizimi i buxheti të vitit paraardhës 2022 paraqitet në vlerën **361,548,498 lekë**. Buxheti i fillestar për vitin 2023 paraqitet në vlerën **515,280,274 lekë** (planifikuar mbi bazën e vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertës të pakushtëzuar të përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor) miratuar me VKB nr. 80, datë 27.12.2022.

Buxheti i rishikuar për vitin 2023 paraqitet në vlerën **549,404,299 lekë** ndërsa realizimi në vlerën **419,043,056 lekë** në masën **76%** me një diferencë mos realizimi në vlerën **130,361,234 lekë**. Të dhënat mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetore për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Njësia		Bashkia Selenicë + Ndërmarjet e vartësisë Viti 2023							Lekë
Artikulli	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	Realizimi në %	
		Fakti vitit paraardhës 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	Buxheti Plan i Rishikuar Viti 2023	Fakti i 12-mujorit	Diferenca		
600	Paga	135,201,438	143,949,404	143,949,404	163,606,514	153,709,533	9,896,981	94	
601	Sigurime Shoqërore	22,657,800	30,394,09	30,394,090	32,331,090	27,405,163	4,925,927	85	
Totali paga + sigurime		157,859,238	174,343,494	174,343,494	195,937,604	181,114,696	14,822,908	92	
602	Mallra dhe shërbime	67,480,241	0	117,036,185	156,137,954	87,939,237	68,198,717	56	
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	-	
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	400,000	400,000	0	100	
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	-	
606	Transferta për Buxhet Familje dhe individë	0	0	0	0	0	0	-	
602-606	Shpenzime operative	7,252,525	0	0	0	0	0	-	
Shpenzime Korrente		232,592,004	0	291,379,679	352,475,558	269,453,933	83,021,625	76	
230	Kapitale të Patrupëzuara	1,093,276	0	7,000,000	6,200,000	950,885	5,249,115	15	
231	Kapitale të Trupëzuara	127,863,218	0	216,900,595	190,728,741	148,638,238	42,090,503	78	
Totali Shpenzime Kapitale		128,956,494	223,900,595	223,900,595	196,928,741	149,589,123	47,339,618	76	
Totali (korrente + kapitale)		361,548,498		515,280,274	549,404,299	419,043,056	130,361,243	76	

Burimi i të dhënave: Bashkia Seleicë.

Për vitin 2023, planifikimi i burimit të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit bashkë me shtesat dhe pakësimet gjatë vitit, paraqiten:

-Planifikimi i ardhurave të veta dhe ato të kushtëzuara, specifike, trashëguara me miratim nga VKB paraqiten për vlerën 748,975,802 lekë, shtesa për 78,609,769 lekë, pakesime për 44,485,744, gjithsejtë planifikimi i të ardhurave për vlerën **783,099,827 lekë**;

-Planifikimi i shpenzimeve me miratim nga VKB paraqiten për vlerën 748,975,802 lekë, shtesa për 160,015,280 lekë, pakesime për 125,891,255 lekë, gjithsej planifikimi i shpenzimeve për vlerën **783,099,827 lekë**;

Shpenzimet planifikuara për vitin 2023 prej 783,099,827 lekë, përbëhen nga këto zëra analitik:

- 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në vlerën 163,606,514 lekë;
- 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” në vlerën 32,331,090 lekë;
- 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 156,137,954 lekë;
- 604 “Transferime korente të brendshme” në vlerën 400,000 lekë;
- 230-231 “Investime” në vlerën 196,928,741 lekë;
- Fondi Rezervë + Fondi i Kontigjencës në vlerën 15,439,467 lekë;
- Transferrat në vlerën 233,695,528 lekë;

Gjatë vitit 2023, janë marrë disa vendime të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten në pasqyrën përmbledhëse për planifikimin e të

ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit për vitin 2023, të miratuar sipas VKB-ve përkatëse që evidentohen në vijim të materialit.

Në mënyrë të përmbledhur paraqitet realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimeve të financimit dhe artikujve buxhetor si më poshtë:

Lekë

Artikulli	Plani	Fakti	Realizimi në %	Nga ardhurat veta	Nga Granti Qeveritar			
					Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar individuale
600	170,923,514	160,703,615	94	19,818,618	81,468,954	52,421,961	6,994,082	0
601	33,106,190	28,175,188	85	2,389,735	16,744,551	8,270,877	770,025	0
602+Fondin Rezervë	157,888,566	89,537,824	57	21,233,702	46,701,024	20,004,511	1,598,582	0
604	7,535,541	5,490,541	73	400,000	0	0	5,090,541	0
606	151,126,000	150,576,132	100		0	0	150,576,132	0
230-231	262,520,016	215,142,219	82	49,033,452	100,555,671	0	0	65,553,096
Totali	783,099,827	649,625,519	83	92,875,507	245,470,200	80,697,349	165,029,362	65,553,096

Burimi i të dhënave: Bashkia Seleicë.

Buxheti për vitin 2023 nga fillimi dhe gjatë vitit ka pësuar ndryshime, sipas të ardhurave të veta dhe granti i ardhur, të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme. Buxheti në total për vitin 2023 është planifikuar për vlerën **783,099,827 lekë** nga Bashkia Selenicë për të gjitha llojit e burimeve të financimit. Gjatë vitit 2023 buxheti ka pësuar ndryshime ku janë kryer shtesa në vlerën totale prej **160,015,280 lekë** në të gjithë zërat e shpenzimeve si dhe është pakësuar në vlerën prej **125,891,255 lekë**. Buxheti në total për vitin 2023 i çelur nga Dega e Thesarit Vlorë është në vlerën **649,625,519 lekë** nga **783,099,827 lekë** që ka qenë planifikimi.

Buxheti me ndryshimet për vitin 2023 (Grant & të ardhura), me analitikiisht sa vijon:

Lekë

Llogaria	Buxheti fillestar viti 2023	Shtesat gjithsej	Pakësimet gjithsej	Buxheti në total me ndryshime
Granti	321,232,726	105,929,371	45,916,511	381,245,586
600	120,410,727	18,757,110	600,000	138,567,837
601	25,927,090	2,737,000	-	28,664,090
602	88,236,185	24,874,915	3,195,000	109,916,100
230	1,200,000	-	-	1,200,000
231	85,458,724	50,311,236	32,872,401	102,897,559
604		9,249,110	9,249,110	-
Te ardhurat	194,047,548	54,085,909	79,974,744	168,158,713
600	23,538,677	1,500,000	-	25,038,677
601	4,467,000	1,400,000	2,200,000	3,667,000
602	28,800,000	22,221,854	4,800,000	46,221,854
230	5,800,000	5,000,000	5,800,000	5,000,000
231	131,441,871	23,564,055	67,174,744	87,831,182
604		400,000	-	400,000
Buxheti total me ndryshimet	515,280,274	160,015,280	125,891,255	549,404,299

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Për vitin 2023 ndryshimet e buxhetit shtesat dhe pakësimet janë miratuar sipas VKB përkatëse, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarkut Vlorë, sipas pasqyrës sa vijon:

Lekë

Numër dhe datë e VKB	Vlera	Shtesë sipas artikullit	Vlera	Pakësime sipas artikullit	Vlera
Nr. 516, datë 22.02.2023	1,500,000	60005	1,500,000	60105	1,500,000
Nr. 1077, datë 15.05.2023	2,909,400	23101	2,909,400	23101	2,909,400
Nr.1134, datë 23.05.2023	25,888,835	23101	25,888,835	23105	25,888,835
Nr.1168, datë 30.05.2023	900,000	23101	900,000	60201	900,000
Nr.1292/1, datë 15.06.2023	16,649,260	23101	12,885,205	23101	12,885,205
	0	23105	3,764,055	23105	3,764,055
Nr. 8321, datë 08.05.2023	2,975,318	60401	2,975,318		0

Nr. 9, datë 29.06.2023	14,325,318	60001	12,233,318	60401	2,975,318
	0	60101	2,092,000	23101	11,350,000
Nr. 1855, datë 28.08.2023	400,000	60405	400,000	60205	400,000
Nr. 26, datë 24.08.2023	5,800,000	60205	4,800,000	23005	5,800,000
	0	60105	1,000,000		0
Nr.15, datë 28.07.2023	48,895,826	23105	19,800,000	23105	36,621,854
	0	60205	15,821,854	60201	2,000,000
	0	23005	5,000,000	60205	4,000,000
	0	60001	6,273,972	60401	6,273,972
	0	23101	2,000,000		0
Shkres nr. 12764 prot., Shtesë page	6,273,792	60401	6,273,972		0
Shkresa nr. 1855/1 prot., datë 29.08.2023	895,000	60101	645,000	60001	600,000
	0	60001	250,000	60201	295,000
Shkresa nr. 1855/2 prot., datë 07.09.2023	400,000	60105	400,000	60205	400,000
Shkresa nr. 1855/4 prot., datë 07.09.2023	700,000	60205	700,000	60105	700,000
Shkresa nr. 1855/5 prot., datë 20.12.2023	6,627,796	60205	900,000	23105	900,000
	0	23101	5,727,796	23101	5,727,796
Shkresë nga Ministri	24,874,915	60201	24,874,915		
Totali	160,015,460		160,015,640		125,891,435

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet shtesa dhe pakësime brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit si dhe nga një artikull në tjetrin me urdhër të titullarit dhe me miratim të VKB. Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, është marrë në konsideratë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë dhe janë raportuar periodikisht pranë Degës Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar.

Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë analitike të dhënat janë paraqitur sipas pasqyrave të mësipërme.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimit financimit e krahasuar me akt rekordimin me thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për vlerësimin e programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për vitin 2023 të Bashkisë Selenice janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përballimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së viteve të kaluara dhe nevojave reale si pasojë e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor.

Ky planifikim është detajuar sipas zërave të artikujve buxhetore në nivel klasifikimi 7-shifror sipas klasifikimit buxhetor të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijim janë analizuar të gjitha shkresat e miratimit të buxhetit vjetor së bashku me ndryshimet gjatë vitit në funksion të përcaktimit të planit përfundimtar dhe në kuadër të ndryshimeve të autorizuara nga nivelet përkatëse autorizuese.

Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për të përcaktuar nivelin e planit përfundimtar dhe realizimin e tij.

Për artikujt buxhetorë të cilët kanë pasur nivel më të lartë mos realizimi është bërë dhe një analizë më e detajuar në të cilën është identifikuar dhe përcaktuar devijimi në llogaritë përkatëse, qoftë ky material nga ana cilësore apo nga ana sasiore.

Auditimi është drejtuar edhe në përcaktimin e saktësisë së klasifikimit të zërave buxhetorë sipas realizimit dhe kryerja e testeve u orientua në krahasimin e situacionit faktik të realizimit të buxhetit të konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin dhe databazës së publikuar të shpenzimeve të thesarit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nga të cilat nuk rezultuan devijime materiale.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik.

Për realizimin e shpenzimeve në total dhe në zëra analitik, Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit ka rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë në fund të vitit 2023, duke mbajtur dhe nënshkruar nga 2 palët akt-rekordimin e shpenzimeve vjetore, sa vijon:

Lekë

Artikulli	Plani	Fakti	Realizimi në %	Nga ardhurat veta	Nga Granti Qeveritar			
					Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar individ
600	170,923,514	160,703,615	94	19,818,618	81,468,954	52,421,961	6,994,082	
601	33,106,190	28,175,188	85	2,389,735	16,744,551	8,270,877	770,025	
602 + Fondi Rezervë	157,888,566	89,537,824	57	21,233,702	4,6701,024	20,004,511	1,598,582	
604	7,535,541	5,490,541	73	400,000			5,090,541	
606	151,126,000	150,576,132	100				150,576,132	
230-231	262,520,016	215,142,219	82	49,033,452	100,555,671			65,553,096
Totali	783,099,827	649,625,519	83	92,875,507	245,470,200	80,697,349	165,029,362	65,553,096

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2023 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar në gjitha zërat konkretisht me mos realizim paraqiten llogaritë si, shpenzime për paga, shpenzime operative, shpenzime për investime, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime, ç'ka tregon një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

Për vitin 2023 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën **783,099,827 lekë** dhe realizuar në vlerën **649,625,519 lekë** në masën 83 % ose me një **mos realizim në vlerën 133,474,308 lekë** përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 92,875,507 lekë + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 245,470,200 lekë + nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 80,697,349 lekë + nga transfertat

e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 165,029,362 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për investimet në vlerën 65,553,096 lekë.

➤ **Shpenzime për paga:**

Shpenzimet për paga janë realizuar në vlerën **160,703,615 lekë gjithsej** nga 170,923,514 lekë të planifikuara në masën 94%.

Fondet për **artikullin 600 “Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli”** përbëhen nga të ardhurat e veta në vlerën 19,818,618 lekë + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 81,468,954 lekë + nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 52,421,961 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 6,994,082 lekë. Mos realizimi i këtij artikulli ka ardhur si pasojë, e vendeve vakante në strukturën organizative, pasi nga 260 punonjës të planifikuar në organikën e institucionit rezultojnë që janë pakësuar 8 punonjës përgjatë vitit 2023, duke mbetur 252 punonjës në fund të viti 2023 si dhe mos përdorimit të fondit të veçantë.

Struktura organizative për 260 punonjës gjithsej është miratuar me VKB nr. 80, datë 27.12.2022, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Vlorë me shkresën nr. 24/1 prot., datë 17.01.2023. Marrëdhëniet e punës për 40 punonjësit me status nëpunësit civil të Bashkisë Selenicë rregullohen sipas Ligjit nr. 152/2013, datë 01.10.2023, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, ndërsa marrëdhëniet e punës për 220 punonjësit me kontratë pune rregullohen me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në RSH” i ndryshuar (Përfshihen dhe funksionet deleguara, Arsimi, Zjarrfikëset, Gjendja Civile etj.,).

Pagat dhe ndalesat tatimit mbi pagat personale e sigurime shoqërore e shëndetësore:

Bashkia ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2023 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar, VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e Vetëqeverisjes Vendore” dhe VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve pagave të nëpunësve Civilë” i ndryshuar, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shtesën për vjetërsi e pozicion.

Pagat dhe shtesat mbi paga etj., janë përlllogaritur drejtë, sipas tabelës pagave, në përputhje me VKM e sipërcituara.

Për ndryshimet në vitin 2023 niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 9, datë 29.06.2023, në zbatim të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njërive të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njërive të qeverisjes vendore”.

Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga përgjegjësi i administratës. Kjo listë prezencë konfirmohej nga titullari i institucionit dhe dërgohej Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit për të kryer veprimet.

Detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore janë llogaritur dhe ndaluar sistematikisht për çdo muaj.

Pagesat për shpërblimin e 21 anëtarëve të Këshillit Bashkisë janë kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 21 i Këshilltareve Bashkiak është bazuar në Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 24 “Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak” i ndryshuar me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Shpenzime për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore:

Artikulli 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 33,106,190 lekë dhe realizuar në vlerën **28,175,188 lekë** ose në masën 85% e përbërë nga

të ardhurat e veta në vlerën 2,389,735 + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 16,744,551 lekë + nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 8,270,877 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 770,025 lekë.

Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera:

Artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” + “Fondi Rezervë” është planifikuar në vlerën 157,888,566 lekë dhe realizuar në vlerën **89,537,824 lekë** ose në masën 57%, e përbërë nga këto të ardhura si burim financimi:

- Të ardhurat e veta në vlerën 21,233,702 lekë;
- Transfertat e kushtëzuar në vlerën 46,701,024 lekë;
- Transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 20,004,511 lekë;
- Transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 1,598,582 lekë;

Mos realizimi i artikullit 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” ka ardhur si pasojë e një planifikimi jo të studiuar.

Shpenzimet operative së bashku me Fondin Rezervë sipas zërave analitike të vitit 2023 për Bashkinë Selenicë paraqiten si më poshtë:

Lekë			
Nr.	Shpenzime operative	Plan	Fakt
1	Kancelari	1,000,000	356,400
2	Materiale pastrimi & dizinfektimi	800,000	447,348
3	Materiale elektrike	2,000,000	1,663,423
4	Materiale festive	200,000	139,080
5	Boje printeri	400,000	355,200
6	Blerje materiale ndërtimi	2,600,000	2,494,800
7	Materiale hidraulike	3,000,000	2,512,620
8	Shtypshkrime	2,500,000	2,423,190
9	Veshje	300,000	174,000
10	Energji	9,500,000	9,317,940
11	Ujë	3,500,000	2,876,420
12	Internet	700,000	306,819
13	Shërbim postar	1,800,000	1,752,841
14	Karburant	18,000,000	17,995,845
15	Pjesë këmbimi goma dhe bateri	1,000,000	119,400
16	Taksa automjeti	900,000	256,000
17	Shpenzime të tjera transporti	715,140	176,693
18	Udhëtim i brendshëm	200,000	148,340
19	Rehabilitimi i pastrimit të kanaleve vaditëse 2023	3,500,000	3,030,892
20	Përmirësim i banesave ekzistuese komunitetit të varfër	10,000,000	9,279,734
21	Rrethim i varreza të fshatit Amonicë	770,000	660,000
22	Mirëmbajtje të qendrave të votimi	200,000	159,600
23	Vendime gjyqësore për largime nga puna	10,200,000	9,278,076
24	Shpenzime për qiramarrje	1,800,000	1,613,300
25	Ndihmë ekonomike	3,000,000	2,600,000
26	Likuidim programi e Bill	20,000	16,788
27	Likuidim Domein	10,000	5,000
28	Furnizim vendosje aksesor zbururimi viti për vitin e ri	700,000	680,400
29	Taks kalim pronësie	9,000	8,500
30	Oponencë teknike	600,000	591,292
31	Shërbim media	100,000	80,000
32	Burës	1,383,480	1,269,897
33	Përvjetori epopeja e luftës së Drashovocës	700,000	658,560
34	Të tjera shpenzime	600,000	488,633
35	Organizim eventit	1,200,000	1,078,800
36	Furnizim vendosje pjesë këmbimi	4,000,000	3,661,200
37	Mbikëqyrje “Rruge me rërë bituminoze”	30,000	24,547
38	Mbikëqyrje “Riparim i rrjetit ujitës Bashkia Selenicë”	100,000	72,198
39	Supervizim “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin varfëra”	400,000	348,225
40	Furnizim vendosje kamera sigurie	300,000	200,400
41	Shpenzime për votime	43,320	43,320
42	Taksë pronësie	10,000	8,500
43	Shërbim vlerësimi i ndikimit në mjedis	100,000	30,000
44	Shpërblim për lajmërimin e zgjedhësve	108,672	108,672
45	Këshilltarët	3,789,060	2,780,790
46	Kryeploqët	5,000,000	4,121,500
47	Shpërblim për shpronësim	600,000	574,482
48	Ndihmë financiare nga fatkeqësitë natyrore	2,548,159	2,548,159
50	Aktivitetet për këshillin	400,000	0

51	Komunitare	2,000,000	0
52	Grant i ardhur për detyrime të prapambetura	24,874,915	0
53	Aktivite kulturore	800,000	658,560
54	Ndihme ekonomike	3,339,000	2,400,000
55	Materiale	500,000	488,633
56	Emergjencia	15,439,467	10,227,753
57	Shërbim zjarrfikëse	2,598,353	2,414,200
58	Shërbim pastrimi	5,000,000	4,991,401
59	Shërbim pyjor	2,000,000	930,000
60	Shërbime baze mirëmbajtje	0	0
Totali		157,888,566	89,537,824

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Sa më sipër:

-Shpenzimet për pastrimin e qytetit dhe 5 NjA Selenicë: Për vitin 2023 janë realizuar për vlerën 4,991,401 lekë nga 5,000,000 lekë planifikimi. Pastrimi i qytetit nga mbeturinat urbane kryhet dhe mbulohet nga vetë institucioni. Nga auditimi u konstatua se, shpenzimet e pastrimit Bashkisë Selenicë për vitin 2023 mbulohen nga tarifa e pastrimit, pasi ajo është realizuar për vlerën 8,404,612 lekë. Mbikëqyrja e pastrimit mbulohet nga Drejtoria e Shërbimeve të bashkisë.

-Shpenzimet për automjetet: Për vitin 2023, shpenzimet për karburant, pjesë këmbimi, goma, vajra e lubrifikant, taksa dhe tjera transporti për 13 automjetet e bashkisë në gjendje pune paraqiten të realizuara për vlerën 22,032,445 lekë.

Bashkia Selenicë sipas aktiveve të kontabilizuara në llogarinë 215 “Mjete transporti” paraqet 20 mjete nga të cilat 13 automjete në gjendje pune dhe 7 jo në gjendje pune.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:

Vlerat e llogaritura për këtë qëllim: Fondi rezervë dhe i kontigjencës paraqitet në shumën 15,439,467 lekë i planifikuar, miratuar me VKB nr. 80, datë 27.12.2022, dhe e mbartur nga vitet e mëparshme. Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është krijuar fondi rezervë. Në buxhetin e Bashkisë për vitin 2023, është planifikuar fond rezervë nga granti.

Nga Fondi Rezervë për periudhën nga data 01.01.2023, deri 31.12.2023, është përdorur vlera 10,227,753 lekë për ndihmën e familjeve në nevojë sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak. Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet fondi i kontigjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Përdorimi i fondit të kontigjencës për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

			Lekë
Nr.	Emër Mbiemër	Shuma	
1	Dhënie ndihme financiare për H. Kasaj		115,500
2	Dhënie ndihmë financiare për B. Licaj		106,820
3	Mbështetje financiare P. Leskaj		420,275
4	Ndihmë financiare T. Habilaj		67,906
5	Ndihmë financiare K. Metaj		169,500
6	Mbështetje financiare A. H.		1,006,966
7	Mbështetje financiare M. Lazaj		86,279
8	Dhënie ndihmë financiare V. Hoxhaj		574,913
9	Përmirësimi i banesave ekzistuese		7,487,894
10	Qira banesa sociale		191,700
Totali			10,227,753

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Subvencione: Bashkia Selenicë nuk ka pasur subvencione për vitin 2023.

Kredi të marra: Bashkia Selenicë nuk ka marrë kredi për vitin 2023.

-Artikulli 230-231 “Investime” është planifikuar në vlerën 262,520,016 lekë dhe realizuar në vlerën 215,142,219 lekë ose në masën 82% e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 49,033,452 lekë + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 100,555,671 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për investimet në vlerën 65,553,096 lekë.

-Artikulli 604 “Transferime korrente të brendshme” është planifikuar në vlerën 7,535,541 lekë dhe realizuar në vlerën **5,490,541 lekë** ose në masën 73% e përbërë nga të ardhurat e veta vlerën 400,000 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 5,090,541 lekë.

-Artikulli 606 “Transferime për buxhete familjare dhe individë” është planifikuar në vlerën 151,126,000 lekë dhe realizuar në vlerën 150,576,132 lekë ose në masën 100% e përbërë nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 150,576,132 lekë.

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësisë për 2023 në Bashkinë Selenicë mbulojnë:

- **302 familje në nevojë ekonomike** për qytetin dhe 5 Njësitë Administrative Vllahinë, Brataj, Sevaster, Kotë dhe Armen;
- **1138 persona me aftësi të kufizuara;**

Për sa trajtuar më sipër parregullsitë e konstatuar në lidhje me planifikimin e buxhetit nga Bashkia Selenicë, janë veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimin nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

2.1.4. Programimi dhe përgatitja e regjistrit prokurimeve, çelja fondeve dhe realizimi i tyre.

Peshën kryesore tek shpenzimet e zëne zëri investime për 215,142,219 lekë, pasi vend të konsiderueshëm përveç investimeve të vitit ushtrimor kanë edhe likuidimet e prapambetura të investimeve për llogari të viteve mëparshme. Për vitin 2023 paraqiten në total 7 investime me burim financimi:

- 4 investime nga të ardhurat prej 26,361,972 lekë;
- 3 investime nga granti prej 30,577,677 lekë;

Sa sipër, investimet e vitit ushtrimor 2023 me burim të ardhurat veta dhe granti, miratuar sipas VKB-ve si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Emërtimi i investimit	Numri dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)
1	Asfaltim rruge të brendshme Kocil	Nr. 80, datë 27.12.2022	Të ardhurat e veta	12,600,000	12,500,000
2	Merementim, hidroizolim shkollat 9-vjecar	Nr. 80, datë 27.12.2022	Grant + Të ardhurat e veta	5,600,000	5,300,000
3	Mremetim hidroizolim shkollat e mesme	Nr. 80, datë 27.12.2022	Grant + Të ardhurat e veta	6,800,000	6,769,832
4	Permirësim i banesave ekzistuese për komunitin e varfër	Nr. 26, datë 24.08.2023	Buxheti i Shtetit + Grant	4,800,000	1,792,140
Total ardhurat veta				25,000,000	26,361,972
5	Rreshqitje në Peshkëpi		Buxheti i Shtetit		11,913,750
6	Permirësim i banesave ekzistuese për komunitin e varfër		Buxheti i Shtetit + Grant		14,900,727
7	Blerje paisje mobileri		Buxheti i Shtetit		3,763,200
Total nga granti					30,577,677

Burimi i të ardhurave: Bashkia Selenicë.

Bashkia Selenicë ka planifikuar në buxhetin e vitit 2023 shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për investime për vlerën 18,150,626 lekë, ku janë likuiduar 24,161,754 lekë, me hollësisht pasqyra e detyrimeve të prapambetura.

Emërtimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2023	Planifikimi për likuidim në planin e buxhetit 2023 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në 2023 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit
Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore	7,799,177	6,191,557	6,318,280
Detyrime të prapambetura për shërbime	7,148,960	3,500,000	1,279,410
Detyrime të prapambetura për energji	4,693,734	3,500,000	3,338,875
Detyrime të prapambetura për investime	28,918,063	18,150,626	24,161,754
Detyrime të prapambetura për investime nga Ministria e Linjës	117,648	0	0
Detyrime të prapambetura për mallra	11,903,115	9,094,224	8,086,371
Detyrime të prapambetura për investime për mallra	1,289,301	0	400,000
Totali	61,869,998	40,436,407	43,584,690

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

2.1.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë linjës etj.,).

➤ **Detyrimet e prapambetura:**

Sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë, detyrime të prapambetura të pa likuiduara nga Bashkia Selenicë paraqiten deri më datë 31.12.2023, për vlerën 52,894,381 lekë e ndarë kjo:

- Detyrime për vendime gjyqësore për vlerën 3,181,632 lekë;
- Detyrime për investime për vlerën 36,373,846 lekë;
- Detyrime për mallra për vlerën 4,883,544 lekë;
- Detyrime për shërbime për vlerën 6,093,501 lekë;
- Detyrime për energji elektrike për vlerën 1,354,859 lekë;
- Detyrime të tjera për vlerën 889,301 lekë;
- Detyrime të tjera nga grandit për vlerën 117,648 lekë;

Vlera është raportuar nga Bashkia Selenicë në MFE me shkresën nr. 495 prot., datë 22.02.2024, për detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2023, është 52,894,381 leke, ku raportimi i përket IV-mujorit të III-të të vitit 2023.

Po kështu, vlera është raportuar nga Bashkia Selenicë në MFE me shkresën nr. 2004 prot., datë 18.09.2023, për detyrimet e prapambetura më datë 31.12.2023, është 46,361,529 leke, ku raportimi i përket IV-mujorit të II-të të vitit 2023. Për efekt të përlllogaritjes së gjendjes së vështirësive financiare vlera e detyrimeve është 52,776,683 lekë (pa përfshirë vlerën 117,698 lekë “Detyrime të tjera nga grandit”). E cila në raport me shpenzimet faktike është 416,043,056 lekë është në masën 12.59%.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, nenin 52, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Raportimi i detyrimeve të prapambetura sipas raporteve të monitorimit:

Për vitin 2023 nga Bashkia Selenicë administrohen 3 raportet të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit dhe detyrimeve të prapambetura si më poshtë:

-Me shkresën nr. 1247 prot., datë 08.06.2023, Bashkia Selenicë ka raportuar pranë MFE dhe Këshillit Bashkiak për realizimin e fondeve të buxhetit që i përkasin katër-mujorit të parë (për muajt janar-prill të vitit 2023);

-Me shkresën nr. 2458 prot., datë 07.11.2023, Bashkia Selenicë ka raportuar pranë MFE dhe KB për realizimin e fondeve të buxhetit që i përkasin katër-mujorit të dytë (për muajt janar-gusht të vitit 2023);

-Me shkresën nr. 920 prot., datë 19.04.2024, Bashkia Selenicë ka raportuar pranë MFE dhe Këshillit Bashkiak për realizimin e fondeve të buxhetit që i përkasin katër-mujorit të tretë (për muajt janar-dhjetor të vitit 2023), në përputhje me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44, me UMFE nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarte të zbatimit buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte Monitorimit Buxhetit Njësitë Qeverisjes Vendore”. Detyrime e prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE paraqiten si më poshtë:

Fatura të pa likuiduara në total sipas llojit tyre për vitin 2023 paraqiten, sipas pasqyrës:

Nr.	Emërtimi	Stokun vlerë	Totali i shpenzimeve miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)			
a	Hua afatgjatë			
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër			
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kreditë furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	13,221,205		
a	Shpenzime korrente	13,221,205		
a.1	Mallra dhe shërbime	12,331,904		
a.2	Paga dhe sigurime			
a.3	Të tjera	889,301		
B	Shpenzime kapitale (investime)	36,373,846		
b.1	Institucione buxhetore			
b.2	Subjekte private	36,373,846		
C	Vendime gjyqësore	3,181,932		
c.1	Marrëdhënie pune	2,664,668		
c.2	Mallra dhe shërbime	516,964		
c.3	Investime			
III	Totali (I+II)	52,776,983		

Sa sipër, sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit Vlorë dhe pasqyrës përmbledhëse të detyrimeve konstatohet se:

a. Disponohet rakordimi me DTHV për detyrimet gjithsej për vlerën 52,894,331 lekë, i cili nuk rakordon me pasqyrën e mësipërme për diferencën 117,648 lekë, pasi kjo vlerë përfaqëson detyrime të prapambetura për investime nga buxheti i shtetit, e pasqyruar në akt-rakordimin, bashkëngjitur.

b. Bashkia Selenicë nuk ka hua dhe provigjone afatgjata dhe afatshkurtra si dhe nuk ka fatura pa likuiduara për 2023 të paraqitura nga subjektet të paregjistruara.

c. Fatura pa likuiduara për mallra, shërbime, të tjera paraqiten 37 raste për vlerën 13,221,205 lekë (mallra e shërbime 12,331,904 lekë + tjera 889,301 lekë), të zbërthyera në mënyre analitike sipas faturave dhe vlerave respektive të tyre.

-Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për mallra e shërbime (Grant & të ardhurat) paraqiten në tabelën nr. 1, në Aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Bashkia Selenicë në 6 raste paraqet vonesa në likuidimin e faturave të subjekteve për vitin 2023, veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe me nenin 52 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, ku përcaktohet që:

Neni 52: Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

Në mënyrë analitike paraqiten faturat e likuiduara jashtë afateve të parashikuara në dispozitat ligjore përkatëse konkretisht:

-Fatura nr. 192, datë 08.05.2023, e lëshuar nga subjekti “Sh” është likuiduar me 12 ditë me vonesë sipas USH nr. 375, datë 20.06.2023, në vlerën 5,500,000 lekë;

-Fatura nr. 129, datë 06.11.2023, e lëshuar nga subjekti “B T” është likuiduar me 21 ditë me vonesë sipas USH nr. 756, datë 27.12.2023, në vlerën 944,000 lekë;

-Fatura nr. 30, datë 25.04.2023, e lëshuar nga subjekti “Y” është likuiduar me 4 ditë me vonesë sipas USH nr. 295, datë 29.05.2023, në vlerën 462,329 lekë;

-Fatura nr. 75, datë 28.04.2023, e lëshuar nga subjekti “G” është likuiduar me 16 ditë me vonesë sipas USH nr. 351, datë 13.06.2023, në vlerën 270,000 lekë;

-Fatura nr. 1363, datë 19.04.2023, e lëshuar nga subjekti “ADD P” është likuiduar me 10 ditë me vonesë sipas USH nr. 311, datë 29.05.2023, në vlerën 355,200 lekë;

-Fatura nr. 471, datë 02.05.2023, e lëshuar nga subjekti “S Rr” është likuiduar me 14 ditë me vonesë sipas USH nr. 359, datë 16.06.2023, në vlerën 660,000 lekë;

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Protokoll Arkivit dhe **znj. A M** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

d. Fatura pa likuiduara për investime paraqiten **38 raste** për vlerën **36,373,846 lekë** (117,648 lekë + 36,373,846 lekë = 36,491,494 lekë), konkretisht sipas 2 pasqyrave në mënyrë analitike dhe burimit financimit:

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (34,118,359 lekë nga Granti dhe nga të ardhurat e veta në vlerën 2,255,487 lekë), paraqiten në **tabelën nr. 2**, në Aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga granti): paraqiten në **tabelën nr. 3**, në Aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

e. Vendime gjyqësore paraqiten **13 raste** për **3,181,932 lekë** (2,664,968 lekë +516,964 lekë), më analitikisht:

-Vlera 2,664,968 lekë detyrime të vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim page, për **10 punonjësit e larguar nga puna**, ç’ka ka shkaktuar **dublim pagese për të njëjtin vend pune** dhe ka dhënë **ndikim negativ në Buxhetin e Bashkisë Selenicë për vlerën 2,664,968 lekë;**

-Vlera 516,964 lekë detyrime për 3 vendime gjyqësore për **3 subjekte detyrime kontraktore;**

Shtesa: Përveç detyrimeve gjyqësore të mbartura ndër vite, Bashkia Selenicë për vitin 2023 paraqet shtesa për vlerën 4,660,531 lekë për disa vendime gjyqësore për largim nga puna, për detyrim kontraktual, për tarifa përmbartimore, për tarifë avokati dhe diferenca tjera;

Pakësuar: Bashkia Selenicë për vitin 2023 ka likuiduar vlerën 9,278,076 lekë nga këto:

- Vlerën 6,318,280 lekë për vendime gjyqësore për llogari të viteve mëparshme para vitit 2023;
- Vlerën 2,959,796 lekë për vendimet e hyra në vitin 2023;

Nga auditimi konstatohet se vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga ish-Kryetari i Bashkisë dhe kryetari aktual nuk është kërkuar prej tyre nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto

vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare me efekt negativ në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60, me Udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011, “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe UMFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91, ç’ka ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Selenicë z. N B dhe ish-Kryetarin z. P B.

Lista e detyrimeve të vendimeve gjyqësore të Bashkisë Selenicë dhe likuidimet e kryera për dëmshpërblim page, për 10 punonjësit e larguar nga puna në vlerën 2,664,968 lekë, sipas personave, tabela:

Lekë

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë		Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit të Gjykatës	Gjendja e palikujduara	Vlera e vendimit ardhur gjatë vitit 2023	Detyrimi total	Likujduar gjatë vitit 2023	Gjendja e palikujduar më 31.12.2023
1	2	3	4	5	6	7	8=5+7	9	10=8-9
H M	1371	27.06.2007	Dëmshpërblim page	436,560	6,000	0	6,000	0	6,000
F M	1869	23.06.2016	Dëmshpërblim page	351,900	83,150	0	83,150	0	83,150
I B	4251	17.10.2017	Dëmshpërblim page	1,989,720	600	0	600	0	600
A H	1545	12.04.2018	Dëmshpërblim page	788,000	138,000	0	138,000	138,000	0
A H	211	28.03.2019	Dëmshpërblim page	819,768	219,768	0	219,768	219,768	0
A M	175	12.03.2019	Dëmshpërblim page	684,000	21,500	0	21,500		21,500
L P	495	04.07.2019	Dëmshpërblim page	750,000	150,000	162,500	312,500	312,500	0
J B	447	20.06.2019	Dëmshpërblim page	953,000	453,000	0	453,000	453,000	0
H R	640	22.10.2019	Dëmshpërblim page	1,020,000	320,000	0	320,000	320,000	0
J K	722	14.11.2019	Dëmshpërblim page	615,200	115,200	0	115,200	115,200	0
S B	675	31.10.2019	Dëmshpërblim page	740,603	290,603	0	290,603	190,000	100,603
F L	73	23.01.2020	Dëmshpërblim page	1,197,120	297,120	0	297,120	297,120	0
Dh Z	14	21.01.2020	Dëmshpërblim page	791,600	391,600	0	391,600	191,600	200,000
N V	5	17.03.2021	Dëmshpërblim page	1,089,802	1,089,802	0	1,089,802	1,089,802	0
P A	501	12.07.2022	Dëmshpërblim page	284,800	284,800	0	284,800	284,800	0
K K	235	08.04.2022	Dëmshpërblim page	684,070	684,070	0	684,070	184,070	500,000
H H	235	12.10.2022	Dëmshpërblim page	638,750	638,750	0	638,750	638,750	0
L B	1400	09.12.2020	Dëmshpërblim page	1,119,300	0	1,119,300	1,119,300	500,000	619,300
S H	3095	13.09.2018	Dëmshpërblim page	492,379	0	116,845	116,845	0	116,845
E O	36	03.03.2023	Dëmshpërblim page	0	0	148,907	148,907	148,907	0
F T	1265	16.12.2020	Dëmshpërblim page	964,590	0	964,590	964,590	0	964,590
D Z	34	18.10.2022	Dëmshpërblim page	873,224	0	873,224	873,224	873,224	0
Z P	760	26.07.2023	Tarifë përmbartimore	0	0	115,200	115,200	115,200	0
T N	183	06.03.2023	Dëmshpërblim page	545,940	0	545,940	545,940	545,940	0
D M	3921	02.11.2018	Dëmshpërblim page	327,040	0	52,960	52,960	52,960	0
K B	1	06.12.2023	Tarifë Avokati	0	0	50,000	50,000	50,000	0
A 2001	1066	20.07.2017	Tarifë Avokati	0	52,080	0	52,080	0	52,080
Totali				18,157,366	5,236,043	4,149,466	9,385,509	6,720,841	2,664,968

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Lista e detyrimeve të vendimeve gjyqësore dhe likuidimet për çështje të tjera ndryshme 2023, për 3 subjekte në vlerën 516,964 leke, sipas tabelës sa vijon:

Lekë

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit të Gjykatës	Gjendja e palikujduar	Vendime të ardhura gjatë vitit 2023	Detyrimi total	Likujduar vitin 2023	Gjendja palikujduar më 31.12.2023
					Vlera e vendimit			
1	2	3	4	5	6	7=5+6	8	9=8-7
S	Nr. 231, datë 28.10.2015	Dëmshpërblim kontraktual	1,569,592	100,000	0	100,000	100,000	0

N M	Nr. 1548, datë 15.03.2017	Dëshmshpërblim kontraktual	1,099,332	10,000	0	10,000	0	10,000
T A	Nr. 3759, datë 09.05.2011	Dëshmshpërblim kontraktual	1,306,804	606,804	0	606,804	100,000	506,804
V A	Nr.1687, datë 23.09.2015	Dëshmshpërblim kontraktual	383,540	160	0	160	0	160
F Shpk	03.07.2020	Dëshmshpërblim kontraktual	9466455	1,846,170	0	1,846,170	1,846,170	0
Sh P A	Nr. 308, datë 15.06.2020	Dëshmshpërblim kontraktual	511,065	0	511,065	511,065	511,065	0
Totali			14,336,788	2,563,134	511,065	3,074,199	2,557,235	516,964

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011, “Për zbatimin e buxhetit”, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Bashkia Selenice nuk është në vështirësi financiare, pasi detyrimet e prapambetura janë 8%, pra nën kufirin ligjor prej 25% (detyrimet = 52,894,381 lekë: 649,625,519 lekë shpenzimet gjithsej), sipas kërkesave të nenit 56, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2014, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Vendime shpronësimesh:

Për vitin 2023 në Bashkinë Selenicë janë kryer shpenzime për **shpronësime të pasurive private me interes publik**, në **1 rast** shpronësuar L Ç për **rehabilitim i fshatit Vajzë** për vlerën **574,482 lekë**, sipas Urdhër Shpenzimit nr. 171, datë 21.03.2023, bazuar në VKM nr. 89, datë 03.02.2023, dhe në VKB nr. 50, datë 30.07.2022. Nga auditimi i kësaj praktike u konstatua se:

-Nuk disponohet çertifikata e pronësisë, për numrin e pasurisë, ZK, lloji i pasurisë, sipërfaqja, të dhëna të cilat nuk përcaktohen në asnjë dokument që disponohet si VKB, shkresa nr. 699/1 prot., datë 08.08.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë;

-Për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit nuk disponohet urdhri për komision të posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit;

-Nuk disponohet Akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Selenicë;

-Nuk disponohet kërkesa për shpronësim e protokolluar e pronarit;

-Mungon përlllogaritja e shpronësimit, sipas kërkesave të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik” i ndryshuar, VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret e vlerësimit dhe përlllogaritjes të masës të shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar me VKM nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”. Lidhur me këtë shpronësim për mangësitë e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi **z. L H** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit, z. K B Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe **z. N B** Kryetar i Bashkisë Selenicë.

Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit:

Për vitin 2023 Bashkia Selenicë nuk ka pasur çelje nga fondet e FZHR, por ka pasur nga Ministria e linjë (MFE).

Investimet nga Ministria e linjës për vitin 2023, pasqyrohen sipas llojit tyre, vlera e kontratës, data e kontratës, vlera e financuar, vlera e pa financuar, operatori fitues (kontraktori), sipas tabelës sa vijon:

Lekë						
Nr.	Objekti i prokurimit	Operatori fitues	Kontrata numër dhe datë	Vlera e kontratës me Tvsh	Vlera e likuiduar	Vlera e pa likuiduar
1	Trajtim rëshqitje rruge Peshkëpi		Nr. 1812/1 prot., datë 06.09.2023	11,915,529	11,913,750	1,779
2	Permirësim i banesave të komuniteteve	Kthjello	Nr. 2107/3 prot., datë 24.10.2023	30,066,295	16,692,867	13,373,428
3	Blerje mobilje		Nr. 2472/1 prot., datë 14.11.2023	3,763,200	3,763,200	0
4	Permirësim i banesave nga fatkeqësitë natyrore	Avduli	Nr. 854/1 prot., datë 28.04.2023	10,577,054	10,577,054	0

Totali	56,322,078	42,946,871	13,375,207
--------	------------	------------	------------

Kështu për vitin 2023 paraqiten gjithsejtë 4 investime me vlerë kontraktore 56,322,078 lekë, nga kjo likuiduar vlera 42,946,871 lekë dhe mbetet pa likuiduar vlera 13,375,207 lekë.

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 1, datë 14.06.2024)

2.1.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave, qiratë e aseteve, tokave, pyje kullotave etj., në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:

Numri i përgjithshëm i punonjësve dhe struktura organizative e Bashkisë Selenicë e aplikuar për vitin 2023, është miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Selenicë”. Struktura organizative ka përsuar një ndryshim në zbatim të Urdhrit nr. 6, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Pjesë e strukturës organizative është edhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave (në vijm të materialit DAPLL) e cila përbëhet nga 9 punonjës konkretisht: 1 Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, 1 Specialist për Kontabilizimin dhe Shërbimin ndaj Taksapaguesve, 1 Specialist për Statistikat dhe Menaxhimin e Borxhit dhe 6 Inspektorë për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore. Në mënyrë të hollësishme paraqiten të dhënat mbi realizimin e strukturës organizative të DAPLL si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni
1	E F	Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave
2	S Gj	Specialist për Kontabilizimin dhe Shërbimin ndaj Taksapaguesve
3	M B	Specialist për Statistikat dhe Menaxhimin e Borxhit
4	D D	Inspektor
5	D M	Inspektor
6	E H	Inspektor
7	V T	Inspektor
8	S S	Inspektor
9	V S	Inspektor

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Nga 9 pozicionet e punës të strukturës së DAPLL vetëm 4 punonjës janë të angazhuar për administrimin, vlerësimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023 konkretisht: E F, S Gj, M B dhe D D.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Me VKB nr. 72, datë 30.11.2022, është miratuar struktura dhe niveli i taksave dhe tarifave vendore të cilat do të aplikohen në territorin e Bashkisë Selenicë për vitin 2023, konfirmuar me shkresën nr. 1179/1 prot., datë 19.12.2022, nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Mbi bazën e tarifave të miratuara, DAPLL ka dërguar njoftimet subjekteve për detyrimet e taksave që duhen paguar, duke përcaktuar këstet dhe afatet kohore, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, gërma “q”.

Në hartimin e paketës fiskale dhe aprovimin në Këshillin Bashkiak për vitin 2023 nga DAPLL nuk ka një rregullshmëri të shkruar (*Gjurma e auditimit*), nuk ka analiza të hollësishme për procedurën e ndjekur në planifikimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore. Pra nuk ka një projekt për çdo taksë të zërës në zëra analitike, në mënyrë që të saktësohet dhe argumentohet planifikimi i tyre.

Evidentimi i të dhënave për detyrimet që kanë taksapaguesit janë pasqyruar në regjistrin e detyrimeve, i cili administrohet në mënyrë elektronike. Në këtë regjistër janë pasqyruar detyrimet

për çdo subjekt (*biznesi apo dhe familje*), për çdo lloj taksë apo tarifë vendore, të ndarë sipas njësive administrative dhe për çdo fshat, si për detyrimet e prapambetura po kështu dhe detyrimet e vitit ushtrimor. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., kryhet në programin Excel.

Mungesa e një sistemi për menaxhimin e taksave e tarifave vendore ndikon në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e kësaj drejtorie, ku mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve taksave dhe kamatëvonesave. Për rrjedhojë regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet risk lartë ndaj defekteve teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DAPPLL.

DAPPLL nuk kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (*regjistra fizikë*) të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore nëpërmjet regjistrave fizik është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 4 dhe neni 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Për menaxhimin e taksave/tarifave vendore nga DAPPLL nuk ka marrëveshje bashkëpunimi për menaxhimin e taksës familjare me Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Selenicë (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë), por është menaxhuar nga vetë institucioni.

Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit ka rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë (në vijim DTHV) për realizimin ardhurave taksave vendore për periudhën **1 janar deri 31 dhjetor 2023**, sipas akt-rakordimit sa vijon:

Lekë					
Nr.	Përshkrimi	Totali i Arkëtuar 2023	Totali Përfundimtar	Pjesa e Institucionit	Pjesa e Qarkut 2%
1	Biznes i Vogël	22,320	22,320	22,320	446
2	Tatim i Thjeshtuar	35,000	35,000	35,000	700
3	Takse Toke	16,046,416	16,046,416	16,046,416	320,928
4	Takse Ndërtese	1,634,067	1,634,067	1,634,067	32,681
5	Zënie Hapësire Publike	168,200	168,200	168,200	3,364
6	Taksë Ndikimi infrastrukture	6,095,287	6,095,287	6,095,287	121,905
7	Taksë Tabele	40,050	40,050	40,050	801
8	Taksë Gjelbërimi	5,623,900	5,623,900	5,623,900	112,478
9	Taksë Ndriçimi	59,750	59,750	59,750	1,195
10	Taksë Trualli	3,169,313	3,169,313	3,169,313	63,386
11	Tarifë Uji	2,761,200	2,761,200	2,761,200	55,224
12	Tarifë Vendore për veprimtari	4,501,748	4,501,748	4,501,748	90,034
13	Shërbim Bashkie	6,700	6,700	6,700	134
14	Tarifë Vendore Ndotjeje	22,826,500	22,826,500	22,826,500	456,530
15	Qira Toke	6,362,913	6,362,913	6,362,913	127,258
16	Leje Transporti	170,750	170,750	170,750	3,415
17	Tarifë Pastrimi	8,404,612	8,404,612	8,404,612	168,092
18	Të Tjera Tarifa Administrative	162,350	162,350	162,350	3,247
19	Taksë Parkimi	12,000	12,000	12,000	240
20	Debitor	753,718	753,718	753,718	0
21	Leje Veprimtarie	901,000	901,000	901,000	18,020
22	Gjoha	1,248,471	1,248,471	1,248,471	0
23	Kamatëvonesa	14,000	14,000	14,000	0
24	Renta Minerare	3,705,314	3,705,314	3,705,314	0
25	K.Sh.A	5,402,292	5,402,292	5,402,292	0
26	T.A.P	7,523,311	7,523,311	7,523,311	0
27	5% Garanci	0	0	100,339	0
28	5% Garanci	0	0	10,823,214	0
Totali		97,651,182	97,651,182	97,651,182	1,580,081

Burimi i të dhënave: Akt-rakordimi i të ardhurave, konfirmuar nga Dega e Thesarit Vlorë.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën **114,592,854 lekë** dhe realizimi në vlerën **97,651,182 lekë** ose në masën **85.2%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **16,941,672 lekë**. Të dhënat e mbajtura nga DAPLL paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë					
Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Fakti 2023	Diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit	Realizimi në %
A	Të ardhurat nga taksat	45,563,762	44,350,211	1,213,551	97.3
1	Taksa mbi ndërtesën	6,654,010	1,654,034	4,999,976	24.8
2	Taksa mbi tokën bujqësore	22,142,232	18,014,316	4,127,916	81.3
3	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	6,510,000	4,806,631	1,703,369	73.8
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë	0	0	0	-
5	Taksa e regjistrimit të automjeteve	4,200,000	5,402,292	(1,202,292)	128.6
6	Taksë table	40,000	40,000	0	100
7	Taksa e Rentës minerale	2,450,000	3,705,314	(1,255,314)	151.2
8	Taksa e truallit	3,517,520	3,169,313	348,207	90.1
9	Tatim i thjeshtuar i biznesit të vogël	50,000	35,000	15,000	70
10	Taksë tregu	0	0	0	-
11	Taksë regjistrimi biznesi	0	0	0	-
12	Tatim mbi të ardhurat personale TAP	0	7,523,311	(7,523,311)	-
B	Të ardhurat jo tatimore	68,999,092	53,300,971	15,698,121	77.2
1	Tarifa e pastrimit	11,893,440	8,612,900	3,280,540	72.4
2	Tarifa për hapësirat publike	100,000	40,000	60,000	40
3	Tarifa e ndriçimit	89,000	50,000	39,000	56.1
4	Tarifa e gjelbërimit	3,713,000	3,719,000	(6,000)	100.1
5	Tarifa për reklamë	0	0	0	-
6	Tarifa për parkim	278,000	132,000	146,000	47.4
7	Tarifa e shërbimit veterinar	0	0	0	-
8	Tarifa për shërbime të tjera administrative	10,000	15,000	(5,000)	150
9	Tarifa për dhënie leje liçensa dhe autorizime	1,769,792	1,901,000	(131,208)	107.4
10	Tarifë ndotje mjedisi	33,898,560	25,961,500	7,937,060	76.5
11	Tarifë mirëmbajtje vaditje kullim	5,000,000	2,761,200	2,238,800	55.2
12	Qira toke	5,247,300	6,362,913	(1,115,613)	121.2
13	Qira ndërtese	0	0	0	-
14	Dhurata dhe sponsorizime	0	0	0	-
15	Të ardhura nga gjobat	50,000	0	50,000	0
16	Të ardhura nga pagesat kopsht dhe çerdhe	0	0	0	-
17	Sekuestre dhe zhëmtime	0	0	0	-
18	Të tjera jo tatimore	0	0	0	-
19	Grante nga nivele të tjera	0	0	0	-
20	Debitorë	6,500,000	3,574,708	2,925,292	54.9
21	Leje Transporti	450,000	170,750	279,250	37.9
	Totali	114,592,854	97,651,182	16,941,672	85.2

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Për sa trajtuar më sipër si dhe duke u referuar në të dhënat e dy tabelave të sipërpërmendura konstatohet se, të ardhurat nga vjelja e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore që mbahen në programin Excel rakordojnë me akt-rakordimin me Degën e Thesarit Vlorë për vlerën 97,651,182 lekë, por në disa prej zërave nuk rakordojnë ndërmjet tyre konkretisht:

- **“Taksa e tokës”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 16,046,416 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPLL paraqitet në vlerën 18,014,316 lekë;
- **“Taksa e hapësirës publike”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 168,200 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPLL paraqitet në vlerën 40,000 lekë;
- **“Taksa e ndikimit infrastrukturës”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 6,095,287 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPLL paraqitet në vlerën 4,806,631 lekë;
- **“Tarifa e ndotjes së mjedisit”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 22,826,500 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPLL paraqitet në vlerën 25,961,500 lekë;

- **“Gjoha”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 1,248,471 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPPLL paraqitet në vlerën 0 lekë;
- **“Kamatëvonesa”** në akt-rakordimin e DTHV paraqitet në vlerën 14,000 lekë ndërsa në pasqyrën e DAPPLL paraqitet në vlerën 0 lekë;

Në kushte të tilla evidenca e hartuar nga DAPPLL nuk është e saktë për disa zëra të taksave dhe tarifave vendore krahasuar me akt-rakordimin me DTHV, me pretendimin se kjo parregullsi vjen si rezultat i ngatërimit të kodeve për disa zëra të ardhurash. Për rrjedhojë, grupi i auditimit është referuar të dhënave me Degën e Thesarit Vlorë.

a. Disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- **“Taksa e ndërtesës”** është planifikuar në vlerën 6,654,010 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,654,034 lekë ose realizuar në masën 25% me një mos realizim në vlerën 4,999,976 lekë;
- **“Taksa e tokës bujqësore”** është planifikuar në vlerën 22,142,232 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 16,046,416 lekë ose realizuar në masën 72% me një mos realizim në vlerën 6,095,816 lekë;
- **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë”** është planifikuar në vlerën 6,510,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 6,095,287 lekë ose realizuar në masën 94% me një mos realizim në vlerën 414,713 lekë;
- **“Tarifa e pastrimit”** është planifikuar në vlerën 11,893,440 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,404,612 lekë ose realizuar në masën 70% me një mos realizim në vlerën 3,488,828 lekë. Nga DAPPLL nuk janë ndarë pagesat e kryera për vitin 2023, dhe arkëtimet nga vitet e mëparshme;
- **“Tarifa e ndotjes së mjedisit”** është planifikuar në vlerën 33,898,560 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 22,826,500 lekë ose realizuar në masën 70% me një mos realizim në vlerën 11,072,060 lekë;
- **“Tarifa për shërbimin veterinar”** është planifikuar në vlerën 30,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 0 lekë. Megjithëse planifikimi është kryer mbi bazën e krerëve të imta dhe të trasha të therjeve, sipas tarifave të miratuara nga Këshilli Bashkiak;

b. Disa prej zërave fiskal paraqiten me tejkalin në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

- **“Taksa e gjelbërimit”** është planifikuar në vlerën 3,713,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,623,900 lekë ose realizuar në masën 151.4% me një tejkalin në vlerën 1,910,900 lekë. Kjo taksë nuk mund të ketë tejkalin në raste se ajo planifikohet saktë mbi bazën e numrit familjeve, bizneseve dhe enteve të tjera, sipas tarifave përkatëse të miratuara për secilin grup në paketën fiskale. Kështu kanë munguar këto të dhëna në përllogaritjen dhe planifikimin e saj;
- **“Taksa e hapësirës publike”** është planifikuar në vlerën 100,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 168,200 lekë ose realizuar në masën 168.2% me një tejkalin në vlerën 68,200 lekë. Për planifikimin e kësaj takse nuk disponohen të dhëna për sipërfaqet e hapësirave publike sipas vendeve të miratuara të shoqëruara me skica e planimetri nga nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit së institucionit, mbi bazën e së cilës përllogaritet kjo taksë;

c. Për disa prej zërave fiskal nuk argumentohet mënyra e planifikimit të tyre si më poshtë:

- Për planifikimin e **“Taksës së ndërtesës”** prej 6,654,010 lekë mungon çertifikata e pronësisë nga ASHK për objektet e shërbimit, banimit, enteve, etj., e cila pasqyron sipërfaqen e ndërimit, dokument bazë për përllogaritjen e taksës pasurisë, sipas tarifës për 1 m² të paketës

fiskale të miratuar me VKB nr. 72, datë 30.11.2022. Konstatohet se dokumentacioni mbështetës mbi llogaritjen e kësaj takse nuk është i saktë, kjo pasi është bërë mbi bazën e vetë deklarimeve të subjekteve, duke mos marrë informacion nga ASHK Vlorë ose kryerjen e verifikimeve në terren me grup pune, në lidhje me sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo të mundësuar taksimin e saktë të kësaj takse dhe afër realitetit. DAPPLL për rastet e mungesës së të dhënave nga ASHK Vlorë mbi sipërfaqen e objekteve, nuk ka ngritur një grup pune me specialist të fushës dhe të verifikojë në vend sipërfaqet e objekteve për të bërë të mundur saktësinë e vetëdeklarimit të subjekteve për sipërfaqen e ndërtimit dhe për rastet e diferencave të aplikohen taksa e ndërtesës për gjithë periudhën e pataksuar. Veprime këto në kundërshtim me nenin 22, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, pikën 2.1, të VKM nr. 132, datë 07.03.2018, “Për taksën e ndërtesave, për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ detyrimit taksës”.

- Për planifikimin e **“Taksës së tabelës”** prej 40,000 lekë mungon lista përmbledhëse për numrin gjithsej të tabelave të vendosura pranë njërive tregtare, prodhuese, shërbimit, profesione lira, e tjerë, në territorin e bashkisë dhe 5 Njësitë Administrative të Bashkisë Selenicë, në mënyrë që të mos shmanget asnjë tabelë nga planifikimi, duke mos diferencuar subjektet.
- Për planifikimin e **“Taksës së ndikimit në infrastrukturë”** prej 6,510,000 lekë. Kështu kjo taksë është planifikuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për vlerën 6,510,000 lekë, nga kjo: 5,710,000 lekë ndërtimet e reja dhe 800,000 lekë nga legalizimet, por pa përcaktuar numrin e ndërtimeve me leje dhe pa leje. Kështu mungon lista e ndërtimeve të reja dhe ndërtimeve pa leje objekt legalizimi, për numrin gjithsej të tyre, ku mbi bazën e vlerave të tyre përlllogaritjet kjo takse, sipas përqindjes të miratuar nga 0.5% për ndërtimet pa leje objekt legalizimi dhe mbi 3% për ndërtimet e reja. Nga të dhënat konstatohet se bashkëpunimi midis dy drejtorive nuk ka qenë efektiv, pasi pavarësisht faktit të realizimit, planifikimi është më i ulët. Kjo çon në faktin se DPKZHT nuk njihet me kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi nga qytetarët apo subjektet. Nga Bashkia nuk është bërë njoftim periodik drejtuar ASHK, por është mjaftuar me 1 njoftim për verifikimin e subjekteve të cilat nuk kanë paguar detyrimet është marrë ose jo çertifikatë pronësie, si dhe të bllokohet procesi i dhënies deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë. DAPPLL në bashkëpunim me DPKZHT nuk ka marrë masa për një planifikim sa më të saktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë, kjo referuar zhvillimit të zonës sipas planit urbanistik;
- Për planifikimin e **“Taksës së tokës bujqësore”** prej 22,142,232 lekë konstatohet se, në planifikim nuk janë përfshirë ose ndarë veças detyrimet e fermerëve për periudhat e mëparshme, por planifikimi është në të njëjtën vlerë me vitin 2022. Kjo taksë e tokës bujqësore paraqet problem, pasi është debitorë progresive deri më 31.12.2023, për vlerën 268,483,775 lekë, pra në rritje nga viti 2022, ndërkohë që në datën 01.01.2023, debitorët progresiv të tokës bujqësore janë 264,334,156 lekë. Sipas të dhënave të Drejtorisë Bujqësisë, Bashkia Selenicë ka sipërfaqe gjithsej të tokës bujqësore 14,932 ha, nga e cila 11,648 ha ndarë me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, dhe 3,284 ha tokë bujqësore e pandarë, për këtë të fundit deri në vitin 2023 janë lidhur 23 kontrata qiraje me sipërfaqe 65,13 ha me detyrim vjetorë 6000 lekë/ha ose 390,794 lekë.

Taksa e tokës bujqësore në disa raste nuk është regjistruar sipas AMTP, por është regjistruar në emër të pjesëtarëve tjerë të familjes. Ndërsa për sa i përket kategorisë së tokës bujqësore, të dhënat

janë mbartur nga ish-komunat, duke mos marrë asnjë informacion nga Drejtoria Bujqësisë apo Ministria e linjës sipas kërkesave Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin taksave vendore” i ndryshuar.

Faturat e lëshuara nga inspektorët tatimore për taksën e tokës janë të përshtatura sipas vlerës që fermeri disponon për të shlyer në momentin e lëshimit të faturës dhe nuk përcaktohet detyrimi vjetor dhe detyrimi progresiv.

Toka bujqësore gjatë viteve ka pësuar ndryshime të konsiderueshëm në pjellori dhe në disa raste në sipërfaqe si rezultat i erozionit dhe përmytjeve. Sa i përket bonitetit të dhënat janë të trashëguara nga ish-komunat ku edhe këto nuk kanë dokumentacion bazë për bonitetin në disa raste ka pasur ndryshime të kategorisë tokës, përkatësisht nga Njësia Administrative Vllahinë.

-Bashkia Selenicë nuk disponon listën e sipërfaqeve të tokës tepër të kaluara “Shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim (teprica = pjesa zaptuar - pjesën legalizuar). Kështu, tokat “Shtet” kanë mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilat shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin, ç’ka tregon punë jo efektive, mos-menaxhim dhe administrim të tyre si dhe mungese bashkëpunimi të bashkisë me ASHK.

-Bashkia Selenicë nuk disponon listën e sipërfaqeve të tokës tepër të kaluara shtet nga ASHK, si rezultat i diferencave midis AMTP dhe LN sipërfaqes faktike në terren, sipas formularit nr. 6, dhe normës për frymë.

- Për planifikimin e **“Taksës së kullotës”** prej 5,247,300 lekë, nga kjo:
 - a. 260 kontrata për kullota gjatë vitit 2023 për vlerën 3,669,300 lekë;
 - b. 5 kontrata për antena gjatë vitit 2023 për vlerën 1,548,000 lekë;
- Për planifikimin e **“Taksës së lejes së shfrytëzimit”** prej 1,769,792 leke, për 27 leje shfrytëzimi sipas subjekteve juridike, bashkëngjitur lista;
- Për planifikimin e **“Taksës së lejes së transportit”** prej 450,000 lekë, për 11 taksi (220,000 lekë), 16 (47,000 lekë) mjete private dhe për mallra si dhe çertifikata autobusi (183,000 lekë), bashkëngjitur lista;
- Nuk është planifikuar **“Taksë e reklamës, hotelit dhe tregut”**, pasi nuk ka reklama, hotele dhe treg në territorin e Bashkisë Selenicë;
- Nuk është planifikuar saktë **“Taksa e rentës minerale”** për 2,450,000 lekë, pasi nuk disponohen dokumente për zbërthimin dhe përlloraritjen e kësaj rente sipas subjekteve, ka munguar rekordimi vjetor me agjentin tatimor. Gjithashtu në fazën e planifikimit nuk është ndarë veças vlera e rentës të paguar për vitin 2023 dhe vlera e prapambetur 2022 e paguar në vitin 2023, për llogari të viteve të mëparshme;

Ky fenomen paraqitet edhe për taksat e tarifatat tjera, **pasi nuk është ndare veças arkëtimet e vitit 2023 dhe veças arkëtimet e detyrimeve të prapambetura të paguara gjatë vitit 2023**, për rrjedhojë realizimi i paraqitur nuk është real për vitin ushtrimor.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Disa taksa dhe tarifa vendore nuk janë kontribut i DAPPLL, pasi mblidhen dhe xhirohen për llogari të bashkisë nga Institucione tjera, në rolin e Agjentit Tatimor, konkretisht sipas pasqyrës:

Lekë			
Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Realizimi 2023
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT)	50,000	35,000
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Vlorë)		7,523,311
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	0	5,402,292
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	0	0
5	Taksa e Rentës Minerale (Dogana Vlorë)	2,450,000	3,705,314

Totali	2,500,000	16,665,917
--------	-----------	------------

Referuar pasqyrës mësipërme, rezultojnë 5 agjent tatimorë, të cilët mbledhin të ardhurat nga tatimi i thjeshtë i fitimit, nga të ardhurat personale, nga taksa për regjistrimin e automjeteve, nga taksa e kalimit drejtës pronësisë, nga renta minerale, nga taksa e ndikimit të infrastrukturës. Nga auditimi u konstatua se:

-Mbledhja e **tatimit thjeshtuar mbi fitimin** bëhet me agjenti tatimor Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e kësaj takse, referuar të dhënave që subjektet deklarojnë në fund të periudhave në administratën fiskale për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. Kështu tatimi i thjeshtuar mbi fitimin është realizuar për 35,000 lekë nga 50,000 lekë planifikimi. Nuk janë mbajtur aktrakordime për tatimin e thjeshtë me Drejtorinë Rajonale Tatimeve Vlorë, për subjektet fizike për vitin 2023, sipas Udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.

-Nuk është mbledhur **taksa e kalimit drejtës pronësisë nga ASHK**, pasi nuk ka pasur regjistrime të aseteve në kadastër, ndërsa 4 taksat dhe tatimet tjera janë mbledhur dhe derdhur për llogari të Bashkisë Selenicë, sipas vlerave përkatëse në tabelën e mësipërme.

-**Nuk janë mbajtur aktrakordime** për taksën regjistrimit automjeteve me agjentin tatimor DSHTR Vlorë, për rrjedhojë nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentet tatimor dhe vlerën e parketuar prej tyre. Për këtë taksë, DAPPLL nuk ka një inventar të plotë të mjeteve në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre, tonazhit, etj.,. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët të MPVD dhe MF nr. 9, datë 04.02.2003, “Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit”.

-Për **taksën e kalimit drejtës së pronësisë nuk disponohen aktrakordime vjetore 2023** me ASHK, pasi nuk ka pasur asnjë rast regjistrimi dhe pajisje me çertifikatë pronësie të aseteve dhe pasurive të paluajtshme të Bashkisë Selenicë.

-Janë mbajtur akt-rakordime për rentën minerale për çdo muaj me agjentin tatimor Dogana dhe Ministria e Financave sipas shkresave përkatëse, por **nuk ka rekordim vjetor**. Për rentën minerale disponohen shkresa nga MF dhe Dogana si agjent tatimor, ku konstatohet se realizimi i saj në total paraqitet për vlerën 5,534,395 lekë nga kjo 3,705,314 lekë për vitin 2023, ndërsa pjesa tjetër i takon vitit 2022.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka mosrealizim dhe planifikim jo të argumentuar.

Bashkia Selenicë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të cilave të bëjë akt-rakordimet.

Bashkia nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Selenicë nuk ka marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 1172 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, ku parashikohet se: “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

Pjesa më e rëndësishme e të ardhurave si: tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, ndërtesës e tjerë që vilen nga Bashkia Selenicë dhe jo nga agjent tatimore.

Këto taksa e tarifa paraqesin një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse.

-Nuk ka për asnjë subjekt përlllogaritje të kamatëvonesave për vitin 2023, për pagesat e vonuara të taksave dhe tarifave vendore, sipas përcaktimeve në njoftimet e subjekteve dhe në paketën fiskale, në kundërshtim me nenin 5, gërma “q” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”.

Nuk janë aplikuar sanksione për shkelje afati të pagesës së kësteve tatimore për 2023 ndaj subjekteve biznesit vogël, nga inspektorët e matarimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 17, pika 1, shkronja “a”, ku përcaktohet se: “Mospagimi i taksës brenda afatit të caktuar dënohet me gjobë të barasvlershme me 25% të detyrimit dhe me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” kreu XIV “Sanksionet” neni 114 “Mospagimi në afat”.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Dinamika e subjekteve të biznesit vogël ka ardhur nga viti në vit në rënie, përkatësisht:

-Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitet 353 subjekte, nga këto: 338 subjekte të biznesit të vogël dhe 15 subjekte të biznesit të madh.

-Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitet 336 subjekte, nga këto: 301 subjekte të biznesit të vogël dhe 35 subjekte të biznesit të madh.

Për vitin 2023 regjistrime të reja nuk ka asnjë, ndërsa kanë mbyllur aktivitetin 2 subjekte.

Dinamika e lëvizjes subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit në juridiksionin e Bashkisë Selenicë bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të QKB më hollësisht sipas NjA, paraqitet sa vijon:

Emërtimi	Numri	Lloji i biznesit	Viti	Regjistrimet e reja (hyrje)	Mbyllur aktiviteti (dalje)	Gjendja në fund të vitit
Qyteti Selenicë	1	Biznesi i Madh	2023	0	0	35
Qyteti Selenicë	2	Biznesi i Vogël	2023	0		53
Total 1+2						
Njësitë administrative	3	Biznesi i Madh	2023			
NjA Armen	4	Biznesi i Vogël	2023	0	0	31
NjA Vllahinë		Biznesi i Vogël	2023	0	2	58
NjA Kotë		Biznesi i Vogël	2023	0	0	70
NjA Sevaster		Biznesi i Vogël	2023	0	0	14
NjA Brataj		Biznesi i Vogël	2023	0	0	28
Subjekte Transporti		Biznesi i Vogël	2023	0	0	47
Totali biznesi i vogël		Biznesi i Vogël				301
Totali					2	336

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Nga DAPPLL dhe Policia Bashkiake Selenicë nuk ka procesverbale në terren për subjektet e pa regjistruara në QKB për vitin 2023 veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, neni 22, nenet 48 dhe 49, **ndërsa disponohen akt-konstatime për subjektet pa NIPT**, sa vijon:

-Subjekte të pa liçencuara për vitin 2023 të Bashkisë Selenicë.

Subjekte të pa liçencuara për vitin 2023 paraqiten **103 subjekte biznes i vogël pa Nipt**, në kundërshtim me nenet 20, 22, 28, 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar. Këto subjekte në pjesën më të madhe janë dyqane, bar-kafe, ambulat, zanate përziera nëpër lagje të cilët ushtrojnë aktivitet shërbimi dhe në disa raste janë sezonale.

DAPPLL gjatë vitit 2023 ka bërë akt-konstatimet dhe ka dërguar njoftimet në çdo subjekt. Inspektorët e taksave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake kanë kryer kontrole dhe kanë mbajtur akt-konstatimi duke i lënë afat për kryerjen e liçencimit, por pa rezultat.

Në kundërshtim me pikën 1 të Ligjit nr. 10415, datë 07.04.2011, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008”, administrata tatimore për subjektet pa Nipt nuk ka mbyllur veprimtarinë ekonomiko tregtare dhe nuk ka konfiskuar materialet sipas nenit 121, të këtij ligji.

Ushtrimi i aktivitetit pa u regjistruar në DAPPLL nga 103 subjekte, përbën kundravajtje administrative.

Nga DAPPLL nuk është bllokuar veprimtaria apo sekuestrimi i pasurive në vendin e biznesit për të gjithë subjektet pa leje, sanksione këto të përcaktuara me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 41, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 17 “Kundërvajtjet dhe sanksionet”, pika 4, ku përcaktohet se: “Mos regjistrimi i taksapaguesit apo mos deklarimi i vendit të ushtrimit veprimtarisë, zbatohet neni 49 “Shkeljet dhe dënimet për regjistrimin” pika 1 e Ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se: Kryerja e veprimtarisë pa u regjistruar në organet tatimore dhe pa u pajisur më parë me çertifikatën tatimore është shkelje dhe dënohet si më poshtë:

-Me bllokim të veprimtarisë, deri në regjistrimin e tatimpaguesit dhe pajisjen e tij me çertifikatë tatimore;

-Me sekuestrim të pasurive në vendin e biznesit, kur tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë masa e bllokimit, gjendet duke ushtruar veprimtarinë;”

Për vitin 2023 subjektet pa Nipt nuk janë mbajtur nën mbikëqyrje periodike, nëse janë të mbyllura ose vazhdojnë aktivitetin apo kanë ndryshuar aktivitetet. Lista e 103 subjekteve biznes i vogël që ushtrojnë aktivitetet pa Nipt, sipas njësive administrative, paraqiten në **tabelën nr. 4**, në Aneksin nr. 1, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Subjekte biznes i madh që ushtron aktivitetet pa NIPT sekondar 2023:

U konstatuan 6 subjekte biznes i madh që kanë ushtruar aktivitetet por nuk janë të pajisur me nipt sekondar në vitin 2023 (që kanë kontrata punimesh me Bashkinë Selenicë), por 3 prej tyre kanë likuiduar taksat vendore, ndërsa **3 subjektet tjera nuk kanë likuiduar taksat vendore për vlerën 198,200 lekë**, përkatësisht:

- OE “A” Shpk vlerën 28,200 lekë;
- OE “K” Shpk në vlerën 85,000 lekë;
- OE “A” Shpk në vlerën 85,000 lekë;

Të dhënat paraqiten në mënyrë të hollësishme si më poshtë:

Lekë									
Nr.	Subjekti	Vlera e kontratës (Pa tvsh)	Afati i kontratës	Data e pagesës	Tarifë Pastrimi	Tarifë mjedis	Tatifë Gjellbërmi	Paguar	Debitor
1	A Shpk	8,600,263	60 ditë		16,600	6,600	5,000		28200
2	A C Shpk A C Shpk	9,690,048	60 ditë	29.6.23	16,600	6,600	5,000	28,200	0
3	K Shpk	25,055,246	180 ditë		50,000	20,000	15,000		85,000
4	A Shpk	8,814,212	180 ditë		50,000	20,000	15,000		85,000
5	AC Shpk A C Shpk	2,525,743	30 ditë	29.6.23	8,300	3,300	2,500	14,100	0
6	C	9,959,452	60 ditë	5.10.23	16,600	6,600	5,000	28,200	0
Totali					158,100	63,100	47,500	70,500	198,200

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Pagesat e liçencave për tregtimin e hidrokarbureve paraqitet për 5 subjekte që nuk kanë shlyer detyrimet për liçenca tregtimit hidrokarbureve për vlerën 2,850,000 lekë ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë, pasi nga 6,000,000 lekë detyrimi, kanë paguar 3,150,000 lekë në vitin 2023 dhe mbeten për t'u paguar vlera 2,850,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, Kapitulli II, Kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, Kapitulli II, pikës 1 germës "b" dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017, "Për disa ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, pika 15.1, "Për përcaktimin procedurave dhe kushteve për dhënien liçencave për tregtimin naftës bruto dhe nënprodukteve saj". Pasqyra e detyrimeve për pagesat e liçencave për tregtimin e hidrokarbureve dhe derivative të tyre për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Lekë									
Nr.	Subjekti	Nipti	Adresa	Aktivitet	Fillimi	Përfundimi	Detyrime për tu paguar	Detyrimi i paguar	Diferenca
1	T O	L....H	Peshkëpi	Karburant	28.04.2022	27.04.2027	1,000,000	400,000	600,000
2	M O	L....O	Selenicë	Karburant	04.05.2022	03.05.2027	1,000,000	250,000	750,000
3	P hpk	K....D	Kotë	Karburant	31.07.2019	30.07.2024	1,000,000	800,000	200,000
4	Xh G	L....F	Vllahinë	Karburant	08.06.2022	07.06.2027	1,000,000	300,000	700,000
5	M Shpk	J....R	Kotë	Karburant	14.10.2022	14.09.2027	1,000,000	400,000	600,000
6	D Gj Shpk	L....F	Vllahinë	Karburant	24.05.2019	23.05.2024	1,000,000	1,000,000	0
Totali							6,000,000	3,150,000	2,850,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Menaxhimi i borxhit nga taksat dhe tarifat vendore:

-**Debitorët progresiv** në fillim të vitit 2023 paraqiten 434,649,309 lekë, shtuar 29,309,297 lekë gjatë vitit 2023, arkëtuar 8,365,165 lekë gjatë vitit 2023, mbeten debitor progresiv më 31.12.2023, për **455,593,441 lekë të taksave vendore.**

-**Debitorët progresivë kanë tendencë në rritje** nga viti 2022 në vitin 2023, në vend që të uleshin, pasi nga 434,649,309 lekë janë rritur në 455,593,441 lekë, ose 20,944,132 lekë më shumë.

-Niveli i borxhit nga debitorët progresiv është përafërsisht sa buxheti vjetor i Bashkisë Selenicë.

-**Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 për vlerën 97,651,182 leke zënë 20% ndaj vlerës debitorëve progresiv** prej 455,593,441 lekë, ose vlera e debitorëve është 5 herë më madhe se ardhurat vendore 2023, raport ky i zhdrejtë.

Pasqyra përmbledhëse e debitorëve paraqitur nga DAPPLL nuk u pasqyrua në material, pasi nuk kundronte dhe gjendja e debitorëve në fillim vitit 2023 nuk është e saktë prej 412,600,981 lekë, në fakt është 434,649,309 lekë pasqyruar kjo vlerë edhe në raportin e mëparshëm 2022 të KLSH, për rrjedhojë nuk u morë parasysh kjo tabelë.

-DAPPLL në bashkëpunim me 5 NjA nuk kanë evidentuar listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 17.01.2019, "Për zbatimin e buxhetit", pika 983, të njoftojë nëpërmjet postës

familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe ndërtesave.

Vlera debitorë progresive më 31.12.2023, për 455,593,441 lekë të taksave vendore, sipas llojit taksave dhe tarifave si dhe sipas njësive administrative, zbërthehet sa vijon:

-**“Taksa e tokës bujqësore”** paraqitet debitorë për vlerën **268,483,775 lekë për 7847 familje**, sipas listave që disponohen në bashki, e ndarë sipas njësive administrative, paraqitet:

- Njësia Administrative Selenicë debitorë 6,960,495 lekë për 862 familje;
- Njësia Administrative Sevaster debitorë 31,593,132 lekë për 996 familje;
- Njësia Administrative Brataj debitorë 22,312,551 lekë për 1200 familje;
- Njësia Administrative Kotë debitorë 32,220,025 lekë për 1218 familje;
- Njësia Administrative Armen debitorë 80,992,209 lekë për 1561 familje;
- Njësia Administrative Vllahinë debitorë 94,405,363 lekë për 1698 familje;

Problematicë paraqiten me debitorët Njësive Administrative Vllahinë dhe Armen, pasi kanë vlera me peshë të madhe krahasuar me njësitë tjera.

Debitorët e taksës së tokës bujqësore në fillim të vitit paraqiten për 264,334,156 lekë për 7271 familje, shtuar 4,149,619 lekë gjatë vitit 2023, gjithsej debitorë progresivë të tokës më 31.12.2023, paraqiten 268,483,775 lekë, pra janë në rritje krahasuar me vitin e kaluar, sipas pasqyrës mëposhtme:

Lekë		
Detyrimet e Taksës së tokës bujqësore		
Periudha	Numri i familjeve	Vlera e detyrimeve
Deri më datën 31.12.2022	7271	264,334,156
Për periudhën nga 01.01.2023, deri më 31.12.2023	7535	4,149,619
Totali/Progresiv		268,483,775

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Debitorët e taksës tokës bujqësore prej 268,483,775 lekë zënë 59% ose peshën më të madhe ndaj debitorëve gjithsej prej 455,593,441 lekë, pra problem janë abonentët familjar, ku bashkia ka dështuar lidhur me mbledhjen dhe menaxhimin e kësaj takse, pasi ajo nga viti në vit rritet. Kështu aplikimi i penaliteteve është bërë i pamundur, pasi mos pagesa është masive dhe periodike për çdo vit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

-**“Taksa e ndërtesës”** paraqitet debitorë për vlerën 12,532,976 lekë për 7847 familje, sipas listave që disponohen bashki. Debitorët taksës së ndërtesës për vitin 2023 janë rritur për 3,760,863 lekë (12,532,976 lekë - 8,772,113 lekë) krahasuar me vitin e kaluar 2022, në vend që të ndodhte e kundërta, pasi nga 8,772,113 lekë në fillim të vitit është shtuar gjatë vitit vlera 3,760,863 lekë dhe në fund të vitit paraqitet për 12,532,976 lekë.

Debitorët për vlerën 12,532,976 lekë për 7847 familje ndahen sipas njësive administrative:

- Njësia Administrative Selenicë debitorë 2,350,463 lekë për 1488 familje;
- Njësia Administrative Sevaster debitorë 1,124,456 lekë për 655 familje;
- Njësia Administrative Brataj debitorë 2,052,870 lekë për 1166 familje;
- Njësia Administrative Kotë debitorë 2,773,210 lekë për 1408 familje;
- Njësia Administrative Armen debitorë 2,908,339 lekë për 1508 familje;
- Njësia Administrative Vllahinë debitorë 1,323,638 lekë për 1622 familje;

Pasqyra e debitorëve progresive abonentët familjar deri më datë 31.12.2023, debitor taksës tokës, taksës ndërtesës, pastrim, ndriçim, truall e gjelbërim, paraqitet sa vijon:

Detyrimet deri më 31.12.2023							
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit + ndriçim + truall + gjlberim	Tarifa e shërbimit komunitar	Tarifa vaditje kullim	Totali
1	Qytet Selenicë	6,960,495	2,350,463	6,066,083		0	15,377,041
2	NjA Brataj	22,312,551	2,052,870	4,185,305		0	28,550,726
3	NjA Sevaster	31,593,132	1,124,456	5,202,380		0	37,919,968
4	NjA Kotë	32,220,025	2,773,210	3,909,378		0	38,902,613
5	NjA Vllahinë	94,405,363	1,164,476	3,892,280		0	109,462,119
6	NjA Armen	80,992,209	2,908,339	8,581,300		0	92,481,848
Totali		268,483,775	12,373,814	31,836,726		0	312,694,315

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Debitorët e taksës tokës dhe taksës së ndërtesë janë të kuadruara dhe zbërthyer sipas njësive dhe në mënyrë analitike me emra konkret nga Zyra e Taksave Vendore Selenicë, bashkëngjitur.

-**“Taksa e biznesit madh”** paraqitet debitorë për vlerën 68,983,784 lekë për 43 debitor, sipas listave bashkëngjitur akt-konstatimit taksave vendore. Debitorët e biznesit të madh në fillim të vitit 2023 paraqiten për 65,605,207 lekë, përgjatë viti janë krijuar debitorë në vlerën 11,609,227 lekë për 54 subjekte si dhe është arkëtuar vlera 8,230,700 lekë ku më datë 31.12.2023, situata debitore progresive është në vlerën 68,983,784 lekë. Pra, debitorët e biznesit madh për vitin 2023 janë rritur për vlerën 3,378,577 lekë (68,983,784 lekë - 65,605,207 lekë) krahasuar me vitin e kaluar 2022, në vend që të ndodhte e kundërta.

-**“Taksa e biznesit vogël”** paraqitet debitorë për vlerën 41,608,821 lekë për 479 debitor, sipas subjekteve dhe njësive administrative listat bashkëngjitur akt-konstatimit taksave vendore. Debitorët e biznesit të vogël në fillim të vitit 2023 paraqiten për 40,006,450 lekë, përgjatë viti janë krijuar debitorë në vlerën 1,736,836 lekë si dhe është arkëtuar vlera 134,465 lekë ku më datë 31.12.2023, situata debitore progresive është në vlerën 41,608,821 lekë. Pra, debitorët e biznesit të vogël për vitin 2023 janë rritur për vlerën 1,602,371 lekë (41,608,821 lekë - 40,006,450 lekë) krahasuar me vitin e kaluar 2022, në vend që të ndodhte e kundërta.

-**“Tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, truall”** paraqitet debitorë për vlerën 34,997,739 lekë për 7964 familje, sipas listave që disponohen në bashki.

-**“Taksa e ndikimit në infrastrukturës”** paraqitet debitorë për vlerën 6,938,018 leke për 262 debitor, sipas listave bashkëngjitur akt-konstatimit taksave. Debitorët e taksës ndikimit në infrastrukturë paraqiten në total, e cila nuk është ndarë se sa janë nga legalizimet (ndërtimet informale) dhe sa janë nga ndërtimet me leje. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike ALUIZNI vënë në dispozicion të njësive qeverisjes vendore të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi. Në Bashkinë Selenicë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale për subjektet që pajisjen me çertifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë çertifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e reja bërë ndër vite, nuk kanë paguar detyrimin 262 qytetarë me vlerë totale të detyrimeve 6,938,018 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë, sipas pasqyrës bashkëlidhur. Nga Bashkia Selenicë (strukturat përgjegjëse),

nuk është marrë asnjë masë për të rritur nivelin e pagesave lidhur me këtë taksë. Gjithashtu, Drejtoria e PKZHT nuk dërgon në Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit, informacion lidhur me detyrimet që kanë ndaj bashkisë qytetarët që kanë përfituar nga procesi i legalizimit. Si rezultat këto detyrime nuk janë të kontabilizuara. Të dhëna lidhur me numrin e debitorëve nuk dërgohen as në DAPPLL i cili nuk ka informacion lidhur me numrin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë si dhe vlerën e sakte progresive të borxhit.

Bashkia Selenicë nuk ka kërkuar ASHK Drejtoria Vlorë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e çertifikatës së legalizimit, bashkia nuk ka kërkuar bllokimin ose kufizimin hipotekar te pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë. Debitorët taksës infrastrukturës dhe lëvizja e tyre gjatë vitit 2023.

Viti	Persona	Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë	Vlera e arkëtuar	Vlera e detyrimit
Deri më datë 31.12.2022	248	6,359,214		
2023	16	1,085,637	506,832	
Totali/Progresiv	264	7,444,851	506,832	6,938,019

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

DAPPLL në bashkëpunim me Policinë Bashkiake nuk ka marrë masa për të ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e taksës infrastrukturës. Veprime në kundërshtim me nenin 22, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 3, gërma “c”, “Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 % e vlerës së investimit”, VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5, si dhe VKB nr. 72, datë 25.11.2021.

-“**Taksa dhe tarifa të tjera të grupuara**” paraqitet debitorë për vlerën 22,048,328 lekë, sipas listave që disponohen në bashki.

Mbi zbatimin e legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore:

-DAPPLL nuk i ka kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Nuk është zbatuar pika 5/3.4 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”;

-DAPPLL nuk ka marrë të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e debitorëve, pasi nuk ka bërë bllokime në banka për gjithë subjektet debitor, përjashtuar disa subjekte të biznesit madh. Nuk është zbatuar pika 5/3.5, neni 90 “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, edhe në rast se ka bllokime bankare ato janë për detyrimin e vitit 2023, ndërsa detyrimi i prapambetur nuk është marrë parasysh, përjashtuar ndonjë rast.

-DAPPLL nuk ka bllokuar aktivitetin, nuk ka bërë padi dhe kallzime penale, për subjektet që nuk kanë reaguar, për efekt të shlyerjes detyrimeve taksave.

-DAPPLL në zbatim të pikës 5/3.1, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, konstatohet se është bërë njoftimi për subjektet biznes i madh, por nuk është bërë njoftimi periodik për subjektet fizikë biznes i vogël dhe abonentët familjar. DAPPLL bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, nuk ka marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

-Në këto kushte detyrimi i papaguar nga bizneset nga vitit në vit ka ardhur duke u shtuar. DAPPLL nuk ka përmbushur detyrimin e nenit 44/4, ku përcaktohet që: “Transferimi i regjistrimit tatimor nga regjistri aktiv në regjistrin pasiv nuk eliminon detyrimin tatimor ekzistues dhe nuk e ndalon

administratën tatimore për vlerësimin ose mbledhjen e detyrimit tatimor, pas transferimit në regjistrin pasiv”.

-Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se, nga DAPPLL nuk janë aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të nenit 17 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” Kreu XIV-Sanksionet neni 114.

-Nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë për arkëtimin e debitorëve të subjekteve biznesi madh.

-Nuk është dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”.

-Për rastet e bizneseve private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë që nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, nuk janë marrë masat administrative apo sekuestro, kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Kontabilizimi i debitorëve të taksave vendore:

Nga DAPPLL nuk ka shkresë protokollare në adresë të Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit (në vijim DSHFAP) për kontabilizim debitorësh, pasi nuk disponohej, pavarësisht kërkesës së vazhdueshme nga grupi i auditimit. Sipas të dhënave të DSHFAP konstatohet se, janë kontabilizuar debitorë të taksave e tarifave vendore gjithsej për vlerën **266,085,170 lekë** me qëllim pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare (Bilancin Kontabël), për ndjekjen e tyre në vazhdimësi në zbatim të procedurave ligjore, veprim ky në zbatim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kaptulli I, -Mbajtja e kontabilitetit, pika 2, gërma “c”.

-Dokumentet e kontabilitetit, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”. Bashkëngjitur shkresa e DSHFAP e nënshkruar për kontabilizimin e debitorëve të taksave vendore progresive. Sipas formatit nr. 1, të bilancit 2023 llogaria debitorë paraqitet e kontabilizuar për 306,410,435 lekë, e cila përbëhet nga këto llogari:

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 236,324,467 lekë;
- Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” në vlerën 70,005,368 lekë;
- Llogaria bileta tregu në vlerën 80,600 lekë;

Pjesë e vlerës të debitorëve prej 306,410,435 lekë është dhe vlera 266,085,170 lekë debitorë progresiv të taksave vendore. Vlera e kontabilizuar e debitorëve taksave vendore 266,085,170 lekë, sipas njësive administrative, paraqitet:

Lekë	
NjA Selenicë	118,803,165
NjA Vllahinë	142,560,485
NjA Armen	980,000
NjA Kotë	3,741,520
NjA Brataj	0
NjA Sevaster	0
Totali	266,085,170

Vlera e kontabilizuar e debitorëve prej 266,085,170 lekë, sipas llojit taksave, paraqitet:

Lekë	
Taksë e tokës bujqësore	86,930,379
Taksë e biznesit të madh	101,098,680
Qira e papaguar	1,918,506

Familjet qira e papaguar	294,887
Taksë pronësie	331,500
Transport malli	2,805,700
Qira toke	234,400
Kullota	831,200
Taksa të tjera	12,898,473
Taksë viti 2023	58,741,445
Totali	266,085,170

Si konkluzion **nuk është kontabilizuar vlera prej 189,508,271 lekë debitorë nga taksat dhe tarifatat vendore** (455,593,441 lekë - 266,085,170 lekë) si diferencë midis debitorëve gjithsej të 455,593,441 lekë me vlerën 266,085,170 lekë të kontabilizuar, ç'ka ka bërë që subjektet të diferencohen, pasi një pjesë janë regjistruar, ndërsa pjesa tjetër nuk janë regjistruar por mbahen me evidenca.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos dërgimit të shkresës protokollare për kontabilizim të debitorëve të taksave vendore që kapin shumën 189,508,271 lekë nga DAPPLL në adresë të financës bashkisë për vitin 2023.

Fenomen ky i përsëritur dhe në vitin e mëparshëm, pasi në fund të vitit 2022 kjo llogari debitorësh 468 “Debitorë të ndryshëm” është paraqitur më pak për vlerën 17,987,270 lekë, pasi nuk është pasqyruar e saktë vlera e debitorëve (nga taksat/tarifatat vendore prej 11,528,255 lekë dhe vlerës e taksës nga ndërtimet informale prej 6,459,017 lekë).

Nga DAPPLL nuk ka shkresë protokollare në adresë të financës për kontabilizim debitorësh, pasi nuk disponohej, pavarësisht kërkesës së vazhdueshme nga grupi i auditimit.

Mos kontabilizimi dhe mos arkëtimi i detyrimeve taksave vendore bie ndesh me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin” i ndryshuar, Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar dhe UMF nr. 5, datë 21.02.2022, me nenin, 17, 34 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar me Ligjin nr. 122/2020, me nenet 90, 91, 93, 111, 113 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” dhe pikat 3 dhe 5 të Udhëzimit përbashkët të MF dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003, pikat 10 të UMF nr. 655/1, datë 06.02.2007, “Për përcaktimin uniformitetit të Standardeve procedurale dhe raportimit sistemit taksës vendore”, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, germa “g”, me VKB nr. 81, datë 27.12.2023, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Sipas të dhënave Drejtorisë Taksave Vendore Debitorët me dhe pa shprese arkëtimi, ndahen:

- Me mundësi arkëtimi brenda vitit 2024 vlera 70,568,086 lekë;
- Me mundësi arkëtimi në të ardhmen vlera 363,200,599 lekë;
- Pa shpresë arkëtimi nuk ka të dhëna;

Biznesi Madh:

Njoftime për detyrimet:

Nga verifikimi me zgjedhje i dosjeve subjekteve biznesit madh për vitin 2023, konstatohet se: DAPPLL ka dërguar disa njoftime subjekteve debitorë biznesi i madh, për shlyerjen e taksave vendore prapambetura, përkatësisht:

- Subjektit “Z” Shpk për 2,700,000 lekë, sipas njoftimit nr. 2273, datë 19.10.2023;
- Subjektit “P P” Shpk për 1,900,000 lekë, sipas njoftimit nr. 2280, datë 19.10.2023;
- Subjektit “A I” për 3,372,000 lekë, sipas njoftimit nr. 2274, datë 19.10.2023;
- 62 debitorëve Armen për vlerën 5,164,623 lekë, sipas njoftimit nr. 2346/1, datë 25.10.2023;

- 122 debitorëve Vllahinë për vlerën 13,456,454 lekë, sipas njoftimit nr. 2346/1, datë 25.10.2023;
- 50 debitorëve Brataj për vlerën 3,660,952 lekë, sipas njoftimit nr. 2346/1, datë 25.10.2023;
- 25 debitorëve Sevaster për vlerën 779,343 lekë, sipas njoftimit nr. 2346/1, datë 25.10.2023;
- 105 debitorëve Kotë për vlerën 6,436,975 lekë, sipas njoftimit nr. 2346/1, datë 25.10.2023;

Dosjet e Biznesit Madh:

-Në dosjen e subjektit **“S M” Shpk** u konstatua se i është lëshuar padrejtësisht vërtetimi nr. 1443, datë 06.06.2022, se nuk është debitor për efekt dokumenti, ndërsa në fakt rezulton debitor për 1,000,000 lekë për vitin 2022, sipas shkresës nr. 1589 prot., datë 20.06.2022, nënshkruar nga Drejtori Taksave z. E F dhe Kryetari Bashkisë z. P B.

-Në dosjen e subjektit **“M P” Shpk** u konstatua se, disponohet njoftimi nr. 1332, datë 10.06.2023, për shlyerjen e 600,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023 brenda korrikut 2023, por nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave (MA), ndërsa për vitin 2020 disponohet mandati i bankës, në këto kushte ka marrë vërtetimin nr. 2568, datë 17.11.2023, se nuk është debitor.

-Në dosjen e subjektit **“B\$AD C” Shpk** u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 56, datë 12.06.2023, për shlyerjen e vlerës 1,300,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 1,370,000 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura (MA). Në këto kushte ka marrë vërtetimin nr. 892, datë 18.04.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. P B. Madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 894, datë 18.04.2023, për zhbllokim bankar BKT (2018) që ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 gjatë periudhës së auditimit, bashkëngjitur 2 shkresat fotokopje dhe lista e debitorëve prapambetur. Gjithashtu disponohet edhe vërtetimi nr. 2567, datë 17.11.2023, se nuk është debitor ndaj Bashkisë Selenicë, nënshkruar nga kryetari aktual z. N B.

-Në dosjen e subjektit **“M B” Shpk** u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 1112, datë 22.05.2023, për shlyerjen e vlerës 1,966,750 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 4,557,411 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura.

Në këto kushte ka marrë vërtetim nr. 2446, datë 06.11.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. A H, zv/kryetar bashkisë, madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 2367, datë 26.10.2023, për zhbllokim bankar, pasi subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 të periudhës së auditimit. Dosja nuk ka inventar të dokumentacionit dhe nuk janë arkivuar, fenomen dhe për rastet tjera, në kundërshtim me nenin 30, të Modelit nr. 8, “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor Republikën Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria Përgjithshme Arkivave në zbatim nenit 3 dhe 29 Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

-Në dosjen e subjektit **“S B” Sh.a** u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 1331, datë 19.06.2023, për shlyerjen e 1,800,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 5,314,702 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura (MA). Në këto kushte subjekti ka marrë vërtetimin nr. 24476, datë 06.11.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. A H, zv/kryetar bashkisë, madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 2366, datë 26.10.2023, për zhbllokim bankar, pasi subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 të periudhës auditimit. Dosja nuk ka inventar të dokumentacionit.

-Në dosjen e subjektit **“Y. S” Shpk** u konstatua se: nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave (MA), në këto kushte ka marrë vërtetim nr. 2650, datë 01.12.2023, se nuk është debitor.

-Në dosjen e subjektit “**A G E**” **Shpk** u konstatua se, disponohet njoftimi nr. 813, datë 05.04.2023, për shlyerjen e vlerës 5,214,327 lekë të taksave vendore të vitit 2023, vlerë e cila nuk është shlyer, për pasojë ka kaluar debitorë tek biznesi i madh. Sqarojmë se subjekti ka hapur padi gjyqësore me 22.06.2023, por kjo nuk e pengon ekzekutimin e detyrimit deri në daljen e vendimit formës prerë të gjykatës dhe nuk është zgjidhje garancia bankare për këtë vlerë më datë 04.05.2023. Bashkia ka bërë përsëri njoftim i datës 29.06.2023, për shlyerjen e detyrimit nga subjekti.

-Në dosjen e subjektit “**A I**” **Shpk** u konstatua se, subjekti nuk është nxjerrë debitor për vitin 2023, pasi ka pezulluar aktivitetin. Lidhur me pezullimin e aktivitetit disponohet akt-konstatimi në terren datë 01.03.2023, i komisionit të përbërë nga E F, I D dhe B D, por mungon nënshkrimi i Policisë Bashkiake dhe i palës të interesuar, madje kjo e fundit nuk ka bërë kërkesë për ndërprerje aktiviteti të protokolluar.

Mungon në dosje urdhri i Kryetarit Bashkisë nr. 559, datë 01.03.2023, për verifikimin në terren për pezullimin e aktivitetit. Për rrjedhojë akt-konstatimi nuk është i rregullt, pasi ka mungesa në formë dhe përmbajtje dhe nuk është bazuar në kërkesën zyrtare të subjektit të interesuar.

-Në dosjen e subjektit “**A**” **Shpk** u konstatua se: subjekti deri në vitin 2021 ka likuiduar detyrimet kontraktore, ndërsa për vitin 2022 dhe 2023 nuk ka shlyer detyrimet, pasi nuk ka njoftime dhe dokumente bankare MA, siç ka paraqitur MA për vitet 2018, 2019, 2020. Subjekti nuk rezulton debitorë për vitet 2022 dhe 2023, ne një kohe kur ai është me aktivitet brenda afatit 2016 deri 2026, bazuar ne kontratën nr. 1437, datë 02.07.2016. Subjektit i është lëshuar vërtetim nr. 290, datë 01.02.2024, se nuk është debitor.

-Në dosjen e subjektit “**A**” **Sh.a** u konstatua se për vitin 2023 subjekti ka paguar rentë minerale 3,625,818 lekë, ndërsa është debitor për 28,743,326 lekë (32,369,144 lekë - 3,625,819 lekë), sipas listës së debitorëve të biznesit madh për vitin 2023 dhe pagesës vitit 2023.

Dosja nuk ka inventar të dokumentacionit dhe nuk janë arkivuar, në kundërshtim me nenin 30, të Modelit nr. 8, “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor Republikën Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria Përgjithshme Arkivave në zbatim nenit 3 dhe 29, Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

-Në dosjen e subjektit “**A I**” **Shpk** u konstatua se subjekti është njoftuar për vitin 2023 disa herë për shlyerjen e detyrimeve të taksave, sipas njoftimit nr. 25, datë 01.03.2023, dhe nr. 2279, datë 19.10.2023, dhe subjekti nuk ka paguar këtë detyrim, për rrjedhojë paraqitet debitor për vlerën 370,000 lekë. Drejtoria e Taksave Vendore ka njoftuar subjektin për shlyerjen e detyrimeve të vitit 2024, ndërsa nuk ka kërkuar detyrimet debitorë të vitit 2023, sipas njoftimit nr. 30, datë 09.04.2024, pra është mjaftuar me njoftime të cinguar dhe nuk ka ndjekur hapat tjera ligjore për shlyerjen e detyrimit prapambetur 2023. Dosja e subjektit nuk është e inventarizuar dhe nuk është arkivuar.

-Në dosjen e subjektit “**N**” **Shpk** u konstatua se për vitin 2023 nuk ka dokumente për pagesën e taksave të vitit ushtrimor, përveç njoftimit nr. 2276, datë 10.10.2023, për shlyerjen e detyrimeve të taksave të prapambetura debitor për vlerën 1,820,000 lekë, e cila nuk është likuiduar nga subjekti. Drejtoria e Taksave Vendore nuk ka ndjekur hapat tjera ligjore për shlyerjen e detyrimit prapambetur. Dosja e subjektit nuk është e inventarizuar dhe nuk ka numerizim të dokumenteve si dhe nuk është arkivuar.

-Në dosjen e subjektit “**Z**” **Shpk** u konstatua se për vitin 2023 subjekti nuk ka shlyer detyrimin prej 2,700,000 lekë, për rrjedhojë rezulton debitor. Disponohet në bazë të kërkesës subjektit një marrëveshje nr. 1237/1, date 19.06.2023, (P Bj, E F dhe subjekti Z) midis 2 palëve për shtyrjen me këste prej 450,000 lekë/secili deri në fund të vitit 2024 për arsye vështirësie financiare, por nuk ka asnjë këst të derdhur nga subjekti, në kundërshtim me kushtet e aktmarrëveshjes datë

19.06.2023, pika 3 dhe nga ana e Zyrës Taksave të bashkisë nuk ka asnjë masë dhe penalitet për shkeljen e aktmarrëveshjes (paguar vetëm 30,933 lekë). Dosja e subjektit nuk është e inventarizuar, nuk ka numerizim të dokumenteve, nuk ka pasqyrim të dokumentacionit 2023, 2022, 2021, nuk ka nënshkrim të inventarit dhe pa arkivim.

-Në dosjen e subjektit “**B P**” Shpk u konstatua se për vitin 2023 subjekti nuk ka paraqitur dokument të bankës për shlyerje detyrimeve taksave prej 1,200,000 lekë, ndërsa nuk rezulton debitor dhe për këtë i është lëshuar vërtetimi nr. 1991, datë 18.09.2023. Njoftimet e Zyrës Taksave Vendore Selenicë kanë ndryshime të pa argumentuara lidhur me vlerën e taksave që do paguaj subjekti. Kështu sipas njoftimit për arkëtim taksash nr. 18, datë 20.02.2023, kërkohet vlera 1,200,000 lekë nga 1,800,000 lekë njoftimi i vitit 2022, pra nuk shpjegohet ky ndryshim me ulje vlerës taksave. Nga verifikimi i kryer rezulton se është ulur vlera e taksës mbrojtjes mjedisit nga 1,000,000 lekë në 2022 në 500,000 lekë për 2023. Dosja e subjektit nuk është e inventarizuar, nuk ka numerizim dokumenteve, nuk ka pasqyrim të dokumentacionit vitit 2023, 2022, 2021, nuk ka nënshkrim inventarit, s’ka arkivim.

Nuk u verifikuan dosjet e biznesit vogël, pasi nuk janë mbajtur nga zyra taksave vendore, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Konkluzioni:

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave Bashkia Selenicë nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit nga fillimi deri në fund që është planifikimi, faturimi, përshkrimi i masave shtrënguese, rakordimi, ndjekja ardhurave deri në arkëtimin e tyre në llogarinë e bashkisë.

Kështu, nuk janë përfshirë në gjurmën e auditimit të gjitha strukturat e ngarkuara në gjithë procesin menaxherial, mbledhja e të ardhurave vendore, vetdeklarimit nga taksa pagesit, vlerësimi tatimor, njoftimi i detyrimit, fatura për arkëtim, regjistrimi dhe rakordimi kontabël, komunikimi me agjentin tatimor, komunikimi me taksapaguesit, ankimimi i taksapaguesve. marrëveshja e pagesës me këste, monitorimi për shlyerjen e detyrimeve, dërgimi i çështjes për fillimin e procedurës së mbledhjes me masa shtrënguese, plotësimi i dosjeve subjekteve me dokumentacionin e nevojshëm ligjorë që shërben për planifikimin e saktë të detyrimeve fiskale, duke evidentuar të gjitha hapat nga regjistrimi deri në arkëtimin e tyre.

Për rrjedhojë **kemi një situatë jo të mirë të ardhurave vendore për vitin 2023**, pasi:

-Të ardhurat vendore nuk janë realizuar në total dhe në strukturë;

-Planifikimi nuk është i studiuar, i saktë dhe paraqet rezerva, pasi ka mungesë dokumentacioni, mungesë të dhënash, verifikim të pjesshëm në terren lidhur me abonentët familjar dhe subjektet;

-Debitorët e taksave dhe tarifave vendore janë problematikë, pasi vlera e tyre rezulton shumë e madhe, gati sa buxheti vjetor ose 5 herë më e lartë se të ardhurat vjetore të taksave vendore. Problem paraqet kontabilizimi i pjesshëm i debitorëve;

-Bashkia Selenicë nuk ka ndërmarrë veprime administrative ose ligjorë të plota për arkëtimin e tyre, duke i lënë këto debitorë në heshtje dhe të kalojnë në debitorë pa shpresë arkëtimi, duke kaluar afati i kërimit të tyre në rrugë gjyqësore;

Puna e pamjaftueshme e agjentëve tatimorë në arkëtimin e të ardhurat vendore, pasi nuk janë realizuar në total dhe në strukturë;

Planifikimi i taksave nuk është i studiuar, i saktë dhe paraqet rezerva, pasi ka mungesë dokumentacioni, mungesë të dhënash, verifikim të pjesshëm në terren lidhur me abonentët familjar dhe subjektet;

Puna e pamjaftueshme e agjentëve tatimorë në arkëtimin e detyrimeve taksave vendore dhe neglizhenca e strukturave Bashkisë Selenicë në menaxhimin e situatës;

-DAPPLL është mjaftuar me njoftime në adrese të subjekteve për vlerësimin tatimor për debitorët privat dhe familjar dhe në vijim nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore për: Për arkëtimin e detyrimeve progresive prej 455,593,441 lekë, të cilët nuk kanë likuiduar taksat e tarifave vendore. Nuk është kontabilizuar vlera debitorë 189,508,271 lekë (455,593,441 lekë-266,085,170 lekë), si diferencë midis debitorëve progresiv prej 455,593,441 lekë me vlerën 266,085,170 lekë të kontabilizuar.

-5 subjekte që nuk kanë shlyer detyrimet për liçenca tregtimit hidrokarbureve për vlerën 2,850,000 lekë ardhura të munguara;

-3 subjekte biznesi i madh që kanë ushtruar aktivitet por nuk janë të pajisur me nipt sekondar në vitin 2023 nuk kanë likuiduar taksat vendore për vlerën 198,200 lekë;

-103 subjekte biznesi i vogël pa Nipt, në kundërshtim me nenet 20, 22, 28, 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. **N. B.** Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 20.06.2023, deri më 31.12.2023, z. **P. B.** Ish-Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 19.06.2023, z. **E. F.** me detyrë Drejtorë i Drejtorisë së të të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, z. **D. D.** me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore, znj. **S. Gj.** me detyrë Specialiste për Kontabilizimin dhe Shërbimin ndaj Taksapaguesve dhe znj. **M. B.** me detyrë Specialiste për Statistikat dhe Menaxhimin e Borxhit.

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 14.06.2024)

2.2. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.2.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.2.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.2.4. Verifikimi i inventarëve të aktiveve afatgjata materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

Hartimi i pasqyrave financiare:

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2023 janë të nënshkruara nga z. N. B Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. L. H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Vlorë me shkresën nr. 749 prot., datë 28.03.2024, dhe konfirmuar me praktikën nr. 32 prot., datë 28.03.2024, brenda afatit ligjor.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

-Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

-Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

-Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

-Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj.,. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

-Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisve, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj.,. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.,.

-Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Selenicë për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2023, deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2023:

Bashkia Selenicë 2023, Materialiteti për shpenzimet			
Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	160,703,615	0,70	11
Sigurime Shoqërore (601)	28,175,188	0,70	2
Mallra e Shërbime (602)	89,537,824	0,70	6
Investime të brend. (230-231)	215,142,219	2,00	41
Të tjera transfer. korrente (606)	156,066,673	0,70	10

Total	649,625,519		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti në vlerë	12,992,510		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	12,992,510		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	1,299,251		
Nëntotali	11,693,259		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
Vlera e precizionit	10,523,933		
Bashkia Selenicë 2023, Materialiteti për të ardhurat			
Emërtimi i të ardhurave	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Të ardhurat nga buxheti	0	0,70	0
Të ardhurat e veta	97,651,182	0,70	43
Total	97,651,182		
Materialiteti në %	2%		
Materialiteti	1,953,024		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	1,953,024		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	195,302		
Nëntotali	1,757,721		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
Vlera e precizionit	1,581,949		

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,.

Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të institucionit për vitin 2023, ka dalë Urdhri nr. 156, datë 16.11.2023, i Kryetarit të Bashkisë z. N. B për ngritjen e komisioneve të inventarizimit me përbërje si më poshtë:

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Selenicë është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga znj. A M kryetar i komisionit dhe anëtarët M B, E K.

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Njesisë Administrative Armen është ngritur komisioni inventarizimit i përbërë nga z. E P kryetar i komisionit dhe anëtarët V S, H H.

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Njesisë Administrative Vllahinë është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga z. P Sh kryetar i komisionit dhe anëtarët D M dhe Xh M.

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Njesisë Administrative Kotë është ngritur komisioni inventarizimit i përbërë nga A K kryetar i komisionit dhe anëtarët E Xh, D Ç.

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Njesisë Administrative Brataj është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga K B kryetar i komisionit dhe anëtarët O Ll, F H.

-Për realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të Njesisë Administrative Sevaster është ngritur komisioni i inventarizimit i përbërë nga B P kryetar i komisionit dhe anëtarët Z A, V T.

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin

fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t'i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 85, gërma "c". **Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Komisionet e inventarizimit të aktiveve të institucionit të sipërpërmendura.**

Me Urdhrin nr. 154, datë 16.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë z. N B është ngritur komisioni për vlerësimin e aktiveve të propozuara për t'u nxjerrë jashtë përdorimit i përbërë nga z. L H kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. A M, znj. M B.

Nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur procesverbalet e datës 01.12.2023, 28.12.2023, dhe 23.12.2023, ku janë vlerësuar aktive që i përkasin llogarisë 32 "Inventar i imët", për Bashkinë Selenicë vlera 17,221 lekë, Njësinë Administrative Vllahinë vlera 13,836 lekë dhe Njësinë Administrative Kotë vlera 62,096 lekë për nxjerrje jashtë përdorimit të vlerës totale 93,153 lekë. Nga z. L H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit, më datë 03.01.2024, është hartuar një relacion drejtuar titullarit të institucionit në lidhje me aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit. Me Urdhrin nr. 155, datë 16.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë z. N B është ngritur komisioni për nxjerrje e aktiveve jashtë përdorimit i përbërë nga S I kryetar i komisionit dhe anëtarët D D, S Gj, M B, O M, E F, Sh Xh.

-Nga komisioni i sipërpërmendur janë mbajtur procesverbalet përkatëse të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve në vlerën 93,153 lekë. Në procesverbalet e asgjësimit të aktiveve citohet se, "Gjatë verifikimit të këtyre materialeve u konstatuan se këto materiale nuk janë në gjendje pune për t'u përdorur dhe nuk përshtaten për përdorim. Materialet që dolën jashtë përdorimit u ndryshua forma dhe një pjesë e tyre u gropos dhe pjesa tjetër u dogji". Nga sa më sipër konstatohet se nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 73-74 dhe pikat 81-110. **Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: S I, DD, SGj, MB, OM, EF, ShXh** anëtarë të komisionit për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procesin e asgjësimit të aktiveve, u konstatua se, në listë e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cila konsiderohen të dëmshme (pajisje elektrike dhe elektronike), për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga z. N B Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe propozjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike", Kreu I, pika 1 dhe pika 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 108 dhe pika 122.

-Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se nuk është kryer pakësim i vlerës 93,153 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023.

-Nga auditimi konstatohet se, më datë 31.12.2023, në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera prej 9,057,580 lekë që i përket automjeteve të dëmtuara të cilat nuk janë në gjendje pune, referuar relacionit të datës 03.01.2024, dhe procesverbaleve të vlerësimit të aktiveve të datës 01.12.2023, 23.12.2023, dhe 28.12.2023, në kushte të tilla këto aktive duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera totale e sipërpërmendur 9,057,580 lekë e cila i përket kostos historike mjeteve të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti” duhet të zbritet vlera e mjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2023, të pozicionit financiar të Bashkisë Selenicë, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

	Lekë
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	2,733,566,549
Aktivet	3,163,118,200
Pasivet	429,551,651
Aktivet Neto	2,733,566,549

	Lekë
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2023	519,390,120
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	110,537,547
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	15,114,958
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	393,737,615

Aktivet Neto më datë 01.01.2023, paraqiten në vlerën 2,626,247,791 lekë ndërsa në mbyllje më datë 31.12.2023, në vlerën 2,733,566,549 lekë. **Më datën 18.04.2024, ora 16:09 nga Dega e Thesarit Vlorë** është gjeneruar **Raporti Kuadrues** mbi pasqyrat financiare ushtrimore të Bashkisë Selenicë për vitin 2023.

Në përfundim të veprimeve të kryera në këtë raport, Aktivet Neto më datë 31.12.2023, paraqiten në vlerën 2,623,029,001 lekë me një diferencë në vlerën 110,537,548 lekë ndërmjet pasqyrave financiare dhe raportit të gjeneruar nga Dega e Thesarit Vlorë. Kjo situatë ka ndodhur për arsye se, Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, në këtë raport paraqiten me vlerën 0 lekë ndërkohë që në pasqyrat financiare kjo klasë paraqitet në vlerën 110,537,547 lekë e cila përbëhet nga llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në vlerën 110,456,947 lekë + llogaria 50 “Letra me vlerë” në vlerën 80,600 lekë.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	110,456,947	96,576,895	13,880,052
50	Letra me vlerë	80,600	80,600	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
Totali		110,537,547	96,657,495	13,880,052

-**Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2023, në vlerën 96,576,895 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 110,456,947 lekë. Kjo llogari kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 74,723,551 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 35,733,436 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 49 dhe pika 50.

-**Llogaria 50 “Letra me vlerë”** më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 80,600 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 80,600 lekë që i përkasin biletave të tregut. Përgjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime.

2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
31	Materiale	3,261,010	4,350,205	(1,089,195)
32	Inventar i imët	11,853,948	11,485,251	368,697
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
Totali		15,114,958	15,835,456	(720,498)

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2023, paraqitet në vlerën 15,114,958 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël **31 “Materiale”** në vlerën 3,261,010 lekë dhe llogaria **32 “Inventar i imët”** 11,853,948 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 720,498 lekë e cila kuadron me llogarinë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** e cila paraqitet në vlerën 720,498 lekë.

-**Llogaria 31 “Materiale”**, ka vlerën 3,261,010 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	4,350,205
Shtesa (K)	21,855,325
Pakësime (D)	22,944,520
Gjendja në 31.12.2023	3,261,010

-**Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 11,853,948 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2023	11,485,251
Shtesa (K)	544,320
Pakësime (D)	175,623
Gjendja në 31.12.2023	11,853,948

3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	70,005,368	70,005,368	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë te ndryshëm	236,324,467	180,033,022	56,291,445
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	87,407,780	75,928,024	11,479,756
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
	Totali	393,737,615	325,966,414	67,771,201
	Të tjera aktive afatshkurtra	0	0	0
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
	Totali	0	0	0

-Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 70,005,368 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 70,005,368 lekë. Në kartelën analitike evidentohet e analizuar vetëm vlera 40,244,665 lekë. Diferenca në vlerën 29,760,703 lekë është e kontabilizuar në këtë llogari me emërtimin “Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore”, e cila duhet të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 5 “Llogaritë financiar”. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Nr.	NjA	Debitor KLS	Debitor 2017	Debitor 2017	Debitorë ndihmë ekonomike	Debitorë të tjerë	Totali
1	Selenicë	118,742	1,737,420	139,502	1,112,974	1,835,737	4,944,375
2	Vllahinë	5,014,220	0	0	0	0	5,014,220
3	Armen	25,583,716	0	0	0	0	25,583,716
4	Kotë	891,760	0	0	0	614,746	1,506,506
5	Brataj	3,178,830	17,018	0	0	0	3,195,848
6	Seveaster	0	0	0	0	0	0
	Totali	34,787,268	1,754,438	139,502	1,112,974	2,450,483	40,244,665

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 180,033,022 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 236,324,467 lekë me një rritje në vlerën 56,291,445 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2023		180,033,022
Shtesa (K)		58,741,445
Pakësime (D)		2,450,000
Gjendja debitore në 31.12.2023		236,324,467

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Taksa dhe tarifa vendore për vitin 2023		58,741,445		
“Z” Shpk			900,000	
“M B” Shpk			1,550,000	
Totali	180,033,022	58,741,445	2,450,000	236,324,467

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Nr.	NjA	Tokë bujqësore	Biznes i madh	Qira e pa paguar	Familjet qira e pa paguar	Taksë pronësi	Transport mallrash	Qira toke	Kullota	Taksa	Taksa viti 2023	Totali
1	Selenicë	1,476,794	54,403,657	1,039,486	0	0	0	0	0	3,141,783	58,741,445	118,803,165
2	Vllahinë	85,453,585	46,695,023	28,800	294,887	331,500	0	0	0	9,756,690	0	142,560,485
3	Armen	0	0	0	0	0	980,000	0	0	0	0	980,000
4	Kotë	0	0	850,220	0	0	1,825,700	234,400	831,200	0	0	3,741,520
5	Brataj	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Sevaster	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali		86,930,379	101,098,680	1,918,506	294,887	331,500	2,805,700	234,400	831,200	12,898,473	58,741,445	266,085,170

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 180,033,022 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 236,324,467 lekë me një rritje në vlerën 56,291,445 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 219,268,974 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërpartit llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Të dhënat në mënyrë të përmbledhur për debitorët nga taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Debitorët	Situata debitore më datë 31.12.2023	Numri i debitorëve
1	Taksa dhe tarifa abonete familjarë	34,997,739	7,964
2	Biznesi i madh	68,983,784	43
3	Biznesi i vogël	41,608,821	479
4	Taksa e ndikimit të infrastrukturë	6,938,018	262
5	Taksë ndërtese	12,532,976	7,847
6	Taksë e tokës bujqësore	268,483,775	7,847
7	Taksa dhe tarifa vendore të grupuara	22,048,328	22,048,328
Totali		455,593,441	

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 75,928,024 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 87,407,780 lekë me një rritje në vlerën 11,479,756 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime

shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 69,043,253 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”	
Celje e vitit 2023	75,928,024
Shtesa (K)	69,043,253
Pakësime (D)	57,563,497
Gjendja debitore në 31.12.2023	87,407,780

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2023	31.12.2022	Diferenca/Ndryshimi 2023-2022
	II. Aktive Afatgjata	2,643,728,080	2,539,653,696	104,074,384
20	1. Aktive Afatgjata jo materiale	2,755,753	3,635,271	(879,518)
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	2,755,753	3,635,271	(879,518)
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
21	2. Aktive Afatgjata materiale	2,278,600,702	2,382,252,544	(103,651,842)
210	Toka, Troje, Terene	140,249,952	140,249,952	0
211	Pyje, Plantacione	0	0	0
212	Ndërtesa e konstruksione	298,479,793	313,940,758	(15,460,965)
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,765,014,313	1,857,863,786	(92,849,473)
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	7,651,813	7,430,102	221,711
215	Mjete transporti	49,806,964	51,714,282	(1,907,318)
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	17,397,867	11,053,664	6,344,203
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0
25	Huadhënie e nënhuadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	4. Investime	362,371,625	153,765,881	208,605,744
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	362,371,625	153,765,881	208,605,744

1. Aktivët Afatgjata Jomateriale.

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 3,635,271 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,094,885 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,974,403 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 2,755,753 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë				
Referenca	Nr.	Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		12,594,775
	2	Amortizim i akumuluar		8,959,504
	3	Gjendja në 01.01.2023		3,635,271
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		1,094,885
	5	Amortizim i shtesës		1,974,403

	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	13,689,660
	5	Amortizim i akumuluar	10,933,907
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	2,755,753

Lekë

Studime-Projektme (kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari				
Projekt		701,885		
Projekt		249,000		
Projekt		144,000		
Totali	12,594,775	1,094,885	0	13,689,660

2. Aktivet Afatgjata Materiale

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 140,249,952 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 58,000 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 140,249,952 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	140,307,952
	2	Amortizim i akumuluar	58,000
	3	Gjendja në 01.01.2023	140,249,952
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	140,307,952
	5	Amortizim i akumuluar	58,000
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	140,249,952

-Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” konstatohet se, për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 58,000 lekë. Bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, citohet se: “Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për grososje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Punimet e artit të marra për qëllime projektimi, si dhe veprat e muzeve dhe librat, që duhet të zëvendësohen pas një periudhe kohe të caktuar, amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme”. Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 0 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë, **ndërkohë që nuk janë kontabilizuar në total sipërfaqet prej 16,064.7 ha pyje, 26,721.5 kullotë dhe 609,312 m² karrierë natyrore**, të cilat janë transferuar Bashkisë Selenicë sipas VKM-ve respektive si më poshtë:

a) Sipërfaqja prej **26,899.51 ha** (e ndarë kjo në 16,633.1 ha kullotë, 10,062.1 ha pyll dhe 204.31 ha shkëmbore) në zbatim të VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike”;

b) Sipërfaqja e pyjeve prej **261.2 ha** në zbatim të VKM nr. 195, datë 06.03.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Selenicë, të Qarkut të Vlorës”;

c) Sipërfaqja e pyjeve prej **1,994.4 ha** dhe kullotë **4,218 ha** në zbatim të VKM nr. 739, datë 16.10.2012, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kotë, të Qarkut të Vlorës”;

d) Sipërfaqja e pyjeve prej **1,551.1 ha**, kullotë **1,229 ha** dhe karrierë natyrore **609,312 m²** në zbatim të VKM nr. 833, datë 05.12.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Sevaster, të Qarkut të Vlorës”;

e) Sipërfaqja e pyjeve prej **1,599.6 ha** dhe kullotë **4,448.4 ha** në zbatim të VKM nr. 663, datë 11.06.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Brataj, të Qarkut të Vlorës”;

f) Sipërfaqja e pyjeve prej **596.3 ha** dhe kullotë **193 ha** në zbatim të VKM nr. 1585, datë 03.12.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Armen, të Qarkut të Vlorës”.

-Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 313,940,758 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 236,074 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 150,234,482 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 298,479,793 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		448,478,201
	2	Amortizim i akumuluar		134,537,443
	3	Gjendja në 01.01.2023		313,940,758
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		236,074
	5	Amortizim i shtesës		15,697,039
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		448,714,275
	5	Amortizim i akumuluar		150,234,482
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		298,479,793

					Lekë
Ndërtesa e konstruksione (kosto historike)		Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari		01.01.2023	(D)	(K)	
Kolaudim Rikostruksion Shkolla Armen			90,582		
Supervizim Rikostruksion Shkolla Armen			145,492		
Totali		448,478,201	236,074	0	448,714,275

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 1,857,863,786 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerë 43,716 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 893,564,967 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,765,014,313 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari		
	1	Kosto historike		2,658,535,564
	2	Amortizim i akumuluar		800,671,778
	3	Gjendja në 01.01.2023		1,857,863,786

Ditari i veprimeve	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	43,716
	5	Amortizim i shtesës	92,893,189
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	2,658,579,280
	5	Amortizim i akumuluar	893,564,967
6	Gjendja më datë 31.12.2023	1,765,014,313	

Lekë

Rrugë rrjete vepra ujore (kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari				
Supervizim Ura Treblovë		43716		
Totali	2,658,535,564	43,716	0	2,658,579,280

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, në vitin 2016 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 526,501,279 lekë në Ujësjetllës Selenicë Sh.a, por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë kjo situatë e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH por rezulton e njëjta situatë, pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Selenicë dhe Ujësjetllës Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Pasqyra e aktiveve të cilat janë transferuar nga Bashkia Selenicë për Ujësjetllës Sh.a për të cilat nuk janë bërë veprimet kontabël pasqyrohet si më poshtë:

Lekë

Nr.	Emërtimi i llogarisë	Vlera kontabël	Amortizimi	Vlera neto
1	213 “Rrugë rrjete vepra ujore”	515,755,627	141,986,982	373,768,645
2	214 “Instalime makineri pajisje”	9,831,852	3,056,769	6,775,083
3	218 “Inventar ekonomikë”	757,600	481,007	276,593
	Total	526,345,079	145,524,758	380,820,321

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 7,430,102 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 598,200 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 8,144,624 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 7,651,813 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”	
		Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	15,198,237
	2	Amortizim i akumuluar	7,768,135
	3	Gjendja në 01.01.2023	7,430,102
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)	598,200
	5	Amortizim i shtesës	376,489
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	15,796,437
	5	Amortizim i akumuluar	8,144,624
	6	Gjendja më datë 31.12.2023	7,651,813

Lekë

Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune (kosto historike)	Gjendja 01.01.2023	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2023
Objekte inventari				
Blerje GPS		598,200		
Totali	15,198,237	598,200	0	15,796,437

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 51,714,282 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime por është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 38,061,287 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 49,806,964 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		87,868,251
	2	Amortizim i akumuluar		36,153,969
	3	Gjendja në 01.01.2023		51,714,282
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		0
	5	Amortizim i shtesës		1,907,318
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		87,868,251
	5	Amortizim i akumuluar		38,061,287
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		49,806,964

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” më datën 01.01.2023, ka qenë në vlerën 11,053,664 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 8,845,800 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 42,523,736 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 17,397,867 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

				Lekë
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike		51,075,803
	2	Amortizim i akumuluar		40,022,139
	3	Gjendja në 01.01.2023		11,053,664
	4	Shtesa gjatë vitit 2023 (D)		8,845,800
	5	Amortizim i shtesës		2,501,597
	6	Pakësime gjatë vitit 2023 (K)		0
	7	Amortizim nga pakësimet		0
	4	Kosto historike		59,921,603
	5	Amortizim i akumuluar		42,523,736
	6	Gjendja më datë 31.12.2023		17,397,867

					Lekë
Inventar ekonomik (kosto historike)		Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendja
Objekte inventari		01.01.2023	(D)	(K)	31.12.2023
Kompjuterat & Printera			1,688,400		
Paisje për shkollat			7,157,400		
Totali		51,075,803	8,845,800	0	59,921,603

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” është përfshirë vlera prej 31,079,786 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 15,757,820 lekë; 210 “Tokë, troje, terrene” është përfshirë vlera prej 140,307,952 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 58,000 lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” është përfshirë vlera prej 282,322,171 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 45,581,320 lekë; 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është përfshirë vlera prej 1,570,622,458 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 260,837,855 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” është përfshirë vlera prej 11,853,994 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 5,399,691 lekë; 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera prej 11,678,180 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 10,799,192 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” është përfshirë vlera prej 38,702,608 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 19,379,921 lekë të pa analizuara si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike.

Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Sevaster, Brataj, Kotë, Armen dhe Vllahinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. Të dhënat e detajuara sipas llogarive mbi aktivet e transferuara nga ish-komunat paraqitet si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Numri i llogarisë	Gjendja në fillim		Shtesa gjatë vitit		Mjetet falas		Totali i Bashkisë Selenicë	Amortizimi
			Vlera filesatare	Amortizim	Vlera filesatare	Amortizim	Vlera filesatare	Amortizim		
202	Projekte	2020100	3,610,366	2,203,183	118,200	372,856	27,351,220	13,181,781	31,079,786	15,757,820
a	Studime	2020100	3,610,366	2,203,183	118,200	372,856	27,351,220	13,181,781	31,079,786	15,757,820
Totali i Aktiveve të Trupëzuara			451,641,531	109,562,092	67,815,840	6,428,255	1,574,635,265	226,065,632	2,094,092,636	342,055,979
210	Toka troje	210	0	0	0	0	140,307,952	58,000	140,307,952	58,000
a	Sistemi trulli	2104100	0	0	0	0	140,307,952	58,000	140,307,952	58,000
212	Ndërtesa	212	73,701,618	14,568,780	5,994,835	755,532	202,625,718	30,257,008	282,322,171	45,581,320
a	Njësitë Administrative	2120101	4,886,742	867,226	0	48,867	22,651,331	0	27,538,073	916,093
b	Shkollat	2120103	62,525,876	12,426,479	0	583,827	147,402,093	0	209,927,969	13,010,306
c	Shëndetësia	2120105	0	0	0	0	29,071,964	0	29,071,964	0
d	Kultura	2120104	0	0	0	0	611,000	0	611,000	0
e	Objekte arti	2120111	1,495,000	38,972	0	14,950	515,000	0	2,010,000	399,922
f	Vareza	2120114	2,500,000	479,540	0	25,000	606,995	0	3,106,995	504,540
g	Terrene sportive	2120117	0	0	0	0	64,835	0	64,835	0
gj	Mure rrethuese	2120116	1,400,000	268,542	2,543,395	39,434	250,000	0	4,193,395	307,976
h	Rrethim vend depozitimi mbetjesh	2120116	0	0	3,451,440	34,514	0	0	3,451,440	34,514
i	Lulishte	2120113	894,000	142,021	0	8,940	1,452,500	0	2,346,500	150,961
213	Rrugë rrjete	213	364,920,421	88,793,721	61,821,005	4,267,415	1,143,881,032	167,776,719	1,570,622,458	260,837,855
a	Rikonstruksion rruge	2131100	157,861,496	37,576,240	36,006,612	1,938,681	678,581,603	0	872,449,711	39,514,921
b	Rikonstruksion ure	2131100	1,237,680	97,033	0	12,377	7,503,598	0	8,741,278	109,410
c	Rikonstruksion rrjetesh	2131100	2,727,435	779,853	1,369,080	40,965	118,680,600	0	122,777,115	820,818
d	Rikonstruksione ujore	2134100	151,863,960	32,299,061	24,445,313	1,763,093	339,115,231	0	515,424,504	34,062,154
e	Të tjera rrjete	2136100	51,229,850	18,041,534	0	512,299	0	0	51,229,850	18,553,833
214	Pajisje vegla	214	0	0	0	0	11,853,994	5,399,691	11,853,994	5,399,691
a	Pajisje dhe shpenzime	2140110	0	0	0	0	96,000	0	96,000	0
b	Pajisje që sigurojnë energji	2140130	0	0	0	0	294,000	0	294,000	0
c	Pajisje laboratorike	2140140	0	0	0	0	40,000	0	40,000	0
d	Pajisje kondicioner	2140170	0	0	0	0	86,400	0	86,400	0
e	Pajisje teknike	2140320	0	0	0	0	11,337,594	0	11,337,594	0
215	Mjete transporti	215	1,320,600	264,120	0	223,643	10,357,580	10,311,429	11,678,180	10,799,192
a	Makina	2151120	1,320,600	264,120	0	223,643	6,769,100	0	8,089,700	487,763
b	Ambulancë	2151150	0	0	0	0	3,588,480	0	3,588,480	0
218	Inventar ekonomik	218	11,698,892	5,935,471	0	1,181,665	27,003,716	12,262,785	38,702,608	19,379,921
a	Komputera	2186100	3,514,074	2,325,402	0	919,950	10,786,760	0	14,300,834	3,245,352
b	Fotokopje	2184100	653,000	361,505	0	19,590	857,350	0	1,510,350	381,095
c	Orendi zyre	2181100	6,602,389	2,719,175	0	214,242	15,359,606	0	21,961,995	2,933,417
d	Faks	2185100	9,000	5,606	0	270	0	0	9,000	5,876
e	Të tjera pajisje	2187100	920,429	523,783	0	27,613	0	0	920,429	551,396

-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 212 “Ndërtesa e kontruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” të kontabilizuara në pasqyrat financiare asnjë prej tyre nuk është pajisur me certifikatë pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërmat “a”, “b”, “c”, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare, nuk është i mbështetur me dokumentacionin e duhur ligjor.

-Nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha pasurive të cilat janë transferuar sipas VKM-ve përkatëse prej 2,391 pasuri që i përkasin

llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Bashkia/Njësitë Administrative	VKM-të	Nr. Pronave në Inventar	Prona të pa Regjistruara në pasqyrat financiare
1	Bashkia Selenicë	Nr. 195, datë 06.03.2013	90	90
2	Njësia Administrative Vllahinë	Nr. 325, datë 16.05.2012	808	808
3	Njësia Administrative Sevaster	Nr. 833, datë 05.12.2007	501	501
4	Njësia Administrative Kotë	Nr. 739, datë 16.10.2012	327	327
5	Njësia Administrative Brataj	Nr. 663, datë 11.06.2009	158	158
6	Njësia Administrative Armen	Nr. 1585, datë 03.12.2008	507	507
Totali			2,391	2391

-Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” u konstatua se, kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 530,578 lekë. Vlera e aksioneve të ShA UK Selenicë me Nipt K47127201C është 17,396,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë me Nipt M37202202E. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Selenicë është 530,578 ose 3.05% ($3.05 \cdot 17,396,000 / 100 = 530,578$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

4. Invenstimet

-Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale” më datë 01.01.2023, ka qenë në vlerën 153,765,881 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 208,605,744 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 362,371,625 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 6, Aneksi nr. 1**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

		Lekë
Llogaria 231 “Për aktive afatgjata materiale”		
Gjendje në 01.01.2023		153,765,881
Shtesa (K)		208,605,744
Pakësime (D)		0
Gjendja në 31.12.2023		362,371,625

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 362,371,625 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 362,371,625 lekë i cili kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 362,371,625 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Selenicë më datën 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor

2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,.

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 4,984,245 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 11,872,182 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 899,483 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,504,667 lekë, 436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 481,054 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 65,666,149 lekë ku totali shkon në vlerën 87,407,780 lekë e cila kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 87,407,780 lekë në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë				
Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca/Ndryshimi
1. Llogari të pagueshme		123,141,216	101,746,280	21,394,936
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	4,984,245	11,859,516	(6,875,271)
42	Detyrime ndaj personelit	11,872,182	9,989,307	1,882,875
16,17,18	Hua afat shkurtër	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	899,483	695,647	203,836
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	3,504,667	2,968,321	536,346
436	Sigurime shëndetësore	481,054	404,751	76,303
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	35,733,436	25,818,256	9,915,180
467	Kreditorë të ndryshëm	65,666,149	50,010,482	15,655,667
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
2. Të tjera pasive afatshkurtra		306,410,435	250,118,990	56,291,445
419	Kreditorë, parapagime	0	0	0
475	Të ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse	306,410,435	250,118,990	56,291,445
478	Diferenca konvertimi pasive	0	0	0
480	Të ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar	0	0	0
487	Të ardhura të arkëtuara para nxjerrjes së titullit	0	0	0

-Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 01.01.2023, është në vlerën 11,859,516 lekë e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Selenicë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,211,100 lekë dhe pakësime në vlerën 8,086,371 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,984,245 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelat si më poshtë:

Lekë	
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2023	11,859,516
Shtesa (K)	1,211,100
Pakësime (D)	8,086,371
Gjendja debitore në 31.12.2023	4,984,245

Lekë					
Nr.	Fatura	Datë	Objekti	Operatori Ekonomik	Vlera
1	97	26.11.2018	Blerje balestër kamioni	P B	20,000
2	28	13.04.2017	Blerje vaj motori	D G	5,129
3	152	13.04.2017	Blerje filtra	G BLB	17,007
4			Diferencë fature	A G	600
5	3	03.01.2019	Blerje gazoil	F Shpk	834
6	43	20.12.2023	Hartim projekti Shkolla 9-Vjecare “T. Koceli”	CEC Group	144,000

7	90	31.03.2023	Blerje gazoili	S A	860,799
8	135	30.04.2022	Blerje gazoili	S A	1,243,040
9	170	31.05.2022	Blerje gazoili	S A	1,527,336
10	57	11.09.2023	Materiale për mbrojtjen nga zjarri	B C	1,066,800
11			Blerje karburanti	V K	100
12			Blerje karburanti	T.M.E.S.A	200
13	45	24.02.2020	Studim projektim i Ujësjellësit Peshkëpi-Kocul	CEC Group	98,400
Totali					4,984,245

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” referuar pasqyrave financiare vlera 11,872,182 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2023 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2023	9,989,307
Shtesa (K)	136,308,255
Pakësime (D)	134,425,380
Gjendja debitore në 31.12.2023	11,872,182

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024, konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	08.01.2024	240,351
2	08.01.2024	1,020,677
3	08.01.2024	148,613
4	08.01.2024	581,102
5	08.01.2024	152,372
6	08.01.2024	185,479
7	08.01.2024	160,212
8	08.01.2024	9,119,091
66	05.02.2024	236432
Totali		11,844,329

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Shënim: Diferenca ndërmjet gjendjes së pasqyrave financiare dhe vlerës së likuiduar prej 27,853 lekë është vlerë e khtyer nga banka e nivelit të dytë e mbetur gjendje në këtë llogari pasi personi përfitues nuk ishte i pajisur me numër llogarie, e cila ka mbetur gjendje në këtë llogari.

-Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 899,483 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”	
Çelje e vitit 2023	695,647
Shtesa (K)	9,077,010
Pakësime (D)	8,873,174
Gjendja debitore në 31.12.2023	899,483

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
22	18.01.2024	645,164
23	18.01.2024	36,003
115	07.03.2024	43,500
189	05.04.2023	123,450
Totali		848,117

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Shënim: Diferenca në vlerën 51,366 lekë është detyrim i pa likuiduar që i përket tatimit të pagesave ndaj Kryepaqësve.

-Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 3,504,667 lekë.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2023		2,968,321
Shtesa (K)		42,693,068
Pakësime (D)		42,156,722
Gjendja debitore në 31.12.2023		3,504,667

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
9	18.01.2024		103,750
10	18.01.2024		174,253
11	18.01.2024		18,002
12	18.01.2024		82,425
13	18.01.2024		12,897
14	18.01.2024		196,433
15	18.01.2024		218,330
16	18.01.2024		75,921
17	18.01.2024		88,925
18	18.01.2024		347,781
19	18.01.2024		558,430
20	18.01.2024		180,749
21	18.01.2024		1,377,495
24	18.01.2024		69,276
Totali			3,504,667

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2023 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 481,054 lekë.

Llogaria 436 “Sigurime shoqërore”		Lekë
Çelje e vitit 2023		404,751
Shtesa (K)		5,850,966
Pakësime (D)		5,744,663
Gjendja debitore në 31.12.2023		481,054

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2024 konstatohet se:

Urdhër shpenzimi		Vlera	Lekë
Nr.	Datë		
9	18.01.2024		14,398
10	18.01.2024		24,182
11	18.01.2024		2,498
12	18.01.2024		11,440
13	18.01.2024		1,790
14	18.01.2024		22,642
15	18.01.2024		30,292
16	18.01.2024		10,536
17	18.01.2024		12,342
18	18.01.2024		48,266
19	18.01.2024		77,496
20	18.01.2024		25,084
21	18.01.2024		190,474
24	18.01.2024		9,614
Totali			481,054

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Rogozhinë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerë 35,733,436 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 7, Aneksi nr. 1**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”		Lekë
Çelje e vitit 2023		25,818,256
Shtesa (K)		10,823,214
Pakësime (D)		1,008,373
Gjendja debitore në 31.12.2023		35,733,436

-Nga auditimi i evidencave analitike të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” evidentohen vlera të kontabilizuara me emërtimin “Pa origjinë” apo “Kaluar gabim nga të ardhurat” në vlerën totale prej 764,810 lekë, për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre të cilat mbahen të mbartura dhe të trashëguara vit pas viti në kontabilitet si dhe nuk janë të verifikueshme çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë për shkak të mos përshkrimit të objektit që i përket kthimit të garancisë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3, Pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

-Për 43 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,800,834 lekë për të cilat nuk është bërë zhblokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Vlorë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 18,800,834 lekë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2023, janë në vlerën 50,010,482 lekë. Gjatë vitit 2023 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 51,153,986 lekë dhe pakësime në vlerën 35,498,319 lekë ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 65,666,149 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në **Tabelën nr. 8, Aneksi nr. 1**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”		Lekë
Çelje e vitit 2023		50,010,482
Shtesa (K)		51,153,986
Pakësime (D)		35,498,319
Gjendja kreditore në 31.12.2023		65,666,149

-Llogaria 475 “Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse”, në shumën 306,410,435 lekë, të cilat përfaqësojnë llogaritë e detyrimeve të klasës 4 të Aktivit.

		Lekë	
C	AKTIVET NETO/FONDET (A-B)	2,733,566,549	2,626,247,791
D	FONDI I KONSOLIDUAR	2,733,566,549	2,626,247,791
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,296,471,413	2,401,723,271
12	Rezultatet e mbartura	0	0

85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	74,723,511	70,758,639
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	362,371,625	153,765,881
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
E	TOTALI I PASIVEVE (B+C)	3,163,118,200	2,978,113,061

Lekë

Fondi i konoliduar	Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"		
	Mbyllje më datë 31.12.2023		Çelje më datë 01.01.2023
2,733,566,549	Debi		Kredi
		2,401,723,271	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	0	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	10,818,675
	115,350,035	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	720,498
Totali	115,350,035		2,413,262,444
		2,413,262,444-115,350,035=2,297,912,409	
		2,296,471,413-2,297,912,409=1,440,996	

-Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,401,723,271 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 10,818,675 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 720,498 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 115,350,035 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)". Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është nënvlerësuar në vlerën 1,440,996 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 17.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 49,654,554 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 62,990,451 lekë ose me një rritje në vlerën 13,335,897 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
70	I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME	62,990,451	49,654,554
700	1. Tatimi mbi të ardhurat	57,320	31,196
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	35,000	22,696
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	22,320	8,500
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
702	2. Tatimi mbi pasurinë	17,680,483	19,410,527
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	17,680,483	19,410,527

7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
703	3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit	45,252,648	30,212,831
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	45,252,648	30,212,831
704	4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare	0	0
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
705	5. Taksë e rrugës	0	0
708	6. Të tjera tatime e taksa kombëtare	0	0
709	7. Gjoha e kamatë vonesa	0	0

2. Të ardhurat jo tatimore:

Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 14,317,625 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 18,029,814 lekë ose me një rritje në vlerën 3,712,189 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
71	III. TË ARDHURA JO TATIMORE	18,029,814	14,317,625
710	1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,362,913	3,407,008
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	6,362,913	3,407,008
711	2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare	11,666,901	10,910,617
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	8,737,712	9,255,816
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	765,718	0
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	901,000	750,000
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	1,262,471	904,801
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
719	3. Të tjera të ardhura jo tatimore	0	0

3. Grante korente:

-Llogaria 72 “Grante korente”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 404,775,518 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 428,907,044 lekë ose me një rritje në vlerën 24,131,526 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
72	V. GRANTE KORENTE	428,907,044	404,775,518
720	1. Grant korent i brendshëm	428,907,044	404,775,518
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	0	387,646,567
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	343,232,874	0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme të ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	16,630,917	17,128,951
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	69,043,253	0
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	0	0
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	2. Grant korent i huaj	0	0
7211	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

SHPENZIMET

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 138,748,060 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 160,703,615 lekë ose me një rritje në vlerën 21,955,555 lekë.

-Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 23,250,085 lekë, ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 28,175,188 lekë ose me një rritje në vlerën 4,925,103 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
6001	Paga, personel i përhershëm	160,703,615	138,748,060
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	25,287,857	20,881,055
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	2,887,331	2,369,030
Totali		188,878,803	161,998,145

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

-Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”, në datë 31.12.2022, ka qenë në vlerën 70,518,742 lekë ndërsa në datën 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 94,628,365 lekë ose me një rritje në vlerën 24,109,623 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Vlorë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
602	III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME	94,628,365	70,518,742
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	10,566,061	7,404,070
6021	Materiale dhe shërbime speciale	0	0
6022	Shërbime nga të tretë	14,254,020	15,787,042
6023	Shpenzime transporti	18,547,938	13,063,562
6024	Shpenzime udhëtimi	148,340	1,017,540
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	18,220,767	9,593,690
6026	Shpenzime për qiramarrje	1,613,300	1,174,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	9,278,076	8,429,764
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	21,999,863	14,049,074

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Selenicë nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023.

4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente të brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 400,000 lekë ndërsa llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 150,576,132 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
	V. TRANSFERIME KORENTE	150,976,132	166,629,520

Llogaria	Emërtimi	31.12.2023	31.12.2022
604	1. Transferime korente të brendshme	400,000	0
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	400,000	0
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente te sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizatat jo fitimprurëse	0	0
605	2. Transferime korente me jashtë	0	0
6051	Transferime për organizatat ndërkombëtare	0	0
6052	Transferime për qeveritë e huaja	0	0
6053	Transferime për institucione jo fitimprurëse të huaja	0	0
6059	Transferime të tjera korente me jashtë shtetit	0	0
606	3. Transferime për buxhetet familjare e individë	150,576,132	166,629,520
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendore	150,576,132	166,629,520

Për vitin 2023 totali i të ardhurave në vlerë është 509,927,309 lekë dhe totali shpenzimeve është 435,203,798 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 74,723,511 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 74,723,511 lekë.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkuara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Veprimet nëpërmjet magazinës:

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletëhyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.

-Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

-Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve:

Nga Bashkia Selenicë është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartohen sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësohen pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyrohen llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkuara nga nëpunësi zbatues dhe ai autorizues.

Për periudhën e audituar janë përlloritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

1. Nga auditimi me zgjedhje i borderove, listë prezencave ditore, listë pagesave për muajt janar, mars, qershor, tetor, nëntor të vitit 2023 konstatohet se, për njëqind e njëzetë punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet kontratave individuale të punës në zbatim të Kodit të Punës nuk është përlloritur vjetërsia e punës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6, pika 2. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Nr.	Emër Mbiemër	Nr.	Emër Mbiemër	Nr.	Emër Mbiemër
1	DL	31	RS	61	Sh A	91	ND
2	EM	32	Xh K	62	L D	92	ED
3	JH	33	AE	63	NS	93	AM
4	AÇ	34	IJ	64	VM	94	AD
5	SS	35	SG	65	AM	95	AGj
6	Rli	36	PM	66	ML	96	AM
7	KH	37	AF	67	MK	97	MB
8	ES	38	AB	68	IM	98	AGj
9	EM	39	KL	69	MK	99	VD
10	KA	40	EP	70	RT	100	AB
11	RSh	41	JB	71	AM	101	VA
12	AK	42	AJ	72	ES	102	Xh B
13	AH	43	AK	73	EHj	103	KSh
14	FA	44	DM	74	DH	104	IM
15	SN	45	Xh M	75	LR	105	AR
16	D Xh	46	AL	76	ABj	106	FR
17	HV	47	MM	77	AC	107	KB
18	Sh D	48	AS	78	SC	108	HL
19	BD	49	NM	79	D Xh	109	FT
20	LB	50	JZ	80	VV	110	ZK
21	AM	51	CH	81	AR	111	MB
22	FG	52	AK	82	RI	112	KM
23	ES	53	AR	83	KA	113	ML
24	QL	54	K Xh	84	EM	114	EM
25	NB	55	MM	85	TM	115	Th M
26	MM	56	ARj	86	SL	116	MB
27	MN	57	GV	87	AK	117	TA
28	FL	58	F Xh	88	ZS	118	E Sh
29	MS	59	Sh L	89	F Sh	119	Dh H
30	KA	60	ZS	90	OL	120	E Gj

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

2. Nga auditimi me zgjedhje i 30 dosjeve të personelit të punësuar përgjatë vitit 2023 por edhe më parë kësaj periudhe konstatohet se, për punonjësin z. R M me profesion elektrikistë pranë

Drejtorisë së Shërbimeve Utilitare dhe Administrative, Sektori i Shërbimit dhe Pastrimit nuk është i pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, gërma “a”.

3. Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të aplikuar për vitin 2023 nga Bashkia Selenicë miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë konstatohet se, shtatë punonjës me detyrë Inspektor Terreni për Pyje dhe Kullota, pjesë e Sektorit të Mbrojtjes dhe Kontraktimit të Pyje/Kullotave, të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me anë të kontratave individuale të punës në zbatim të Kodit të Punës, të punësuar pranë Bashkisë Selenicë që prej vitit 2015, niveli i diplomave arsimore të tyre nuk përputhet me nivelin e arsimit të përcaktuar në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 16, pikat 3-4. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Nr.	Sektori i Mbrojtjes dhe Kontraktimit të Pyje/Kullotave	Punonjësi	Arsimi	Arsimi sipas Ligjit nr. nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”
1	Inspektor terreni pyje kullota	D L	Pedagogji, Cikli i ulët	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
2	Inspektor terreni pyje kullota	J Z	Gjuhë Lertësi	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
3	Inspektor terreni pyje kullota	D Ll	Histori-Gjeografi	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
4	Inspektor terreni pyje kullota	R Xhj	Petagogji e specializuara (Për fëmijët me aftësi të kufizuara)	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
5	Inspektor terreni pyje kullota	O Gj	Inxhinieri Navale	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
6	Inspektor terreni pyje kullota	A A	Petakogji, Cikël i ulët	Arsim profesional dhe të lartë pyjor
7	Inspektor terreni pyje kullota	J B	Kontabilitet	Arsim profesional dhe të lartë pyjor

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 20.06.2023, deri më 31.12.2023, **z. P B** Ish-Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 19.06.2023, në cilësinë e Nëpunësve Autorizues dhe **z. L H** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 3, datë 14.06.2024)

2.3. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.

2.3.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2.3.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Si çdo institucion publik edhe Bashkia Selenicë ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore.

Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Selenicë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Selenicë.

Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Selenicë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen,

personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Në zbatim të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore” si dhe në mbështetje të pikave 9-11, dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e NJQV, administrimi i aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre.

Bashkia Selenicë nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar totalisht si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, me ndarjen e re territoriale Bashkisë Selenicë i janë shtuar 6 njësi Administrative, respektivisht: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 27-28, parashikohet se, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Kjo strukturë duhet të realizonte **marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV**, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

Nga auditimi konstatohet se **Bashkia Selenicë ka në pronësi në total 2,866 pasuri, 26,899.51 ha** (Pyje, kullota dhe sipërfaqe shkëmbore) dhe **86 pasuri në përdorim** të cilat janë transferuar sipas VKM-ve si më poshtë:

➤ **Njësia Bashkia Selenicë:**

-Me VKM nr. 195, datë 06.03.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Selenicë, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 28 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 109. Sipas listave të sipërpërmendura janë transferuar në total **103 pasuri në pronësi dhe 6 pasuri në përdorim** si më poshtë:

Në pronësi:

- a. Truall + Ndërtesa 29 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 54,285 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 6,592.37 m²;
- b. Truall 19 pasuri me sipërfaqe 49,925 m²;

- c. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 6 pasuri me sipërfaqe 298.1 ha;
- d. Sisteme ujitje dhe kullimi 15 pasuri me sipërfaqe 324,780 m²;
- e. Rrugë vendore 4 pasuri me sipërfaqe 8,000 m²;
- f. Sistemi KUZ 2 pasuri;
- g. Lumenj/Përrua 1 pasuri me sipërfaqe 359,100 m²;
- h. Energjitika 13 pasuri me sipërfaqe 1,340 m²;
- i. Sheshe 1 pasuri me sipërfaqe 343.8754 m²;
- j. Pyje dhe bimësi 13 pasuri me sipërfaqe 261.2 ha;

Në përdorim:

- a. Truall 6 pasuri me sipërfaqe 101,000 m²;
- Me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” ku numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Selenicë është 485, me sipërfaqe totale **26,899.51 ha** e ndarë kjo në 16,633.1 ha kullotë, 10,062.1 ha pyll dhe 204.31 ha Shkëmbore.

➤ **Njësia Administrative Kotë:**

Me VKM nr. 739, datë 16.10.2012, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kotë, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 60 fletë e cila fillon me numër rendor 113 dhe përfundon me numër 487, dhe lista prej 15 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 112. Sipas listave të sipërpërmendura janë transferuar në total **440 pasuri në pronësi** dhe **46 pasuri në përdorim** si më poshtë:

Në pronësi:

- k. Truall + Ndërtesa 93 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 35,715 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 14,788 m²;
- l. Truall 35 pasuri me sipërfaqe 650,555 m²;
- m. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 10 pasuri me sipërfaqe 770,000 m²;
- n. Sisteme ujitje dhe kullimi 65 pasuri me sipërfaqe 331,201 m² dhe 5,928 ml;
- o. Rrugë vendore dhe nacionale 36 pasuri me sipërfaqe 581,470 m²;
- p. Mbrojtja Kombëtare 8 pasuri me sipërfaqe 18,300 m²;
- q. Sistemi për furnizimin me ujë të pijshëm 30 pasuri;
- r. Lumenj/Përrua dhe Rezervuar 14 pasuri me sipërfaqe 4,464,349 m²;
- s. Sistemi i furnizimit dhe transformimit të energjisë elektrike 18 pasuri me sipërfaqe 1,113 m²;
- t. Nxjerrje nafet 18 pasuri me sipërfaqe 110,832 m² dhe 5,150 ml;
- u. Pyje dhe bimësi 70 pasuri me sipërfaqe 1,994.4 ha;
- v. Kullotë 43 pasuri me sipërfaqe 4,218 ha;

Në përdorim:

- b. Tokë bujqësore 46 pasuri me sipërfaqe 12,754,000 m²;

➤ **Njësia Administrative Vllahinë:**

Me VKM nr. 325, datë 16.05.2012, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Vllahinë, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 112 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 826. Sipas listës të sipërpërmendur janë transferuar në total **808 pasuri në pronësi** dhe **34 pasuri në përdorim** si më poshtë:

Në pronësi:

- a. Truall + Ndërtesa 71 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 72,124 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 68,788 m²;
- b. Truall 34 pasuri me sipërfaqe 133,690 m²;
- c. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 13 pasuri me sipërfaqe 1,965,200 m²;
- d. Sisteme ujitje dhe kullimi 23 pasuri me sipërfaqe 1,164,704 m² dhe 1,070 ml;
- e. Rrugë vendore dhe nacionale 409 pasuri me sipërfaqe 2,259,990 m²;
- f. Mbrojtja Kombëtare 17 pasuri me sipërfaqe 27,000 m² dhe 100 ml;
- g. Sistemi për furnizimin me ujë të pijshëm 19 pasuri;
- h. Lumenj/Përria 37 pasuri me sipërfaqe 2,078,600 m²;
- i. Sheshe 164 pasuri me sipërfaqe 424,163 m²;
- j. Sistemi i furnizimit dhe transformimit të energjisë elektrike 21 pasuri me sipërfaqe 630 m²;

Në përdorim:

- a. Tokë bujqësore dhe inproduktive 34 pasuri me sipërfaqe 7,492,400 m²;

➤ Njësia Administrative Sevaster:

Me VKM nr. 833, datë 05.12.2007, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Sevaster, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 105 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 741. Sipas listës të sipërpërmendur janë transferuar në total **741 pasuri në pronësi** si më poshtë:

Në pronësi:

- a. Truall + Ndërtesa 25 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 28,055 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 3,468 m²;
- b. Truall 7 pasuri me sipërfaqe 38,549 m²;
- c. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 32 pasuri me sipërfaqe 11,823,763 m²;
- d. Sisteme ujitje dhe kullimi 49 pasuri me sipërfaqe 1,207,264 m²;
- e. Rrugë vendore dhe nacionale 153 pasuri me sipërfaqe 1,058,880 m²;
- f. Mbrojtja Kombëtare 4 pasuri me sipërfaqe 4,480 m²;
- g. Sistemi për furnizimin me ujë të pijshëm 10 pasuri;
- h. Lumenj/Përria 40 pasuri me sipërfaqe 1,921,824 m²;
- i. Sheshe 172 pasuri me sipërfaqe 278,483 m²;
- j. Sistemi i furnizimit dhe transformimit të energjisë elektrike 9 pasuri me sipërfaqe 92 m²;
- k. Pyje dhe bimësi 47 pasuri me sipërfaqe 1,551.1 ha;
- l. Kullotë 10 pasuri me sipërfaqe 1,299 ha;
- m. Kariera natyrore 183 pasuri me sipërfaqe 609,312 m²;

➤ Njësia Administrative Brataj:

Me VKM nr. 663, datë 11.06.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Brataj, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 42 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 240. Sipas listës të sipërpërmendur janë transferuar në total **241 pasuri në pronësi** si më poshtë:

Në pronësi:

- a. Truall + Ndërtesa 64 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 17,671 m² + 36.95 ha dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 9,029 m²;
- b. Truall 9 pasuri me sipërfaqe 44,000 m²;
- c. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 33 pasuri me sipërfaqe 440.53 m²;
- d. Rrugë vendore 10 pasuri me sipërfaqe 751,268 m²;
- e. Sistemi për furnizimin me ujë të pijshëm 25 pasuri;
- f. Lumenj/Përria 15 pasuri me sipërfaqe 2,181,529 m²;

- g. Energjia 2 pasuri me sipërfaqe 17 m²;
- h. Pyje dhe bimësi 50 pasuri me sipërfaqe 1,599.6 ha;
- i. Kullotë 33 pasuri me sipërfaqe 4,448.4 ha;

➤ **Njësia Administrative Armen:**

Me VKM nr. 1585, datë 03.12.2008, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Armen, të Qarkut të Vlorës”. Bashkëlidhur kësaj VKM-je ndodhet lista prej 79 fletë e cila fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 533. Sipas listës të sipërpërmendur janë transferuar në total **533 pasuri në pronësi** si më poshtë:

Në pronësi:

- a. Truall + Ndërtesa 35 pasuri me sipërfaqe totale të pronës 318,275.40 m² dhe sipërfaqe totale të ndërtesës 5,819 m²;
- b. Truall 24 pasuri me sipërfaqe 70,960 m²;
- c. Tokë bujqësore + tokë inproduktive 11 pasuri me sipërfaqe 246.26 m²;
- d. Sisteme ujitje dhe kullimi 57 pasuri me sipërfaqe 986,731 m²;
- e. Rrugë vendore dhe kanale 281 pasuri me sipërfaqe 1,286,700 m²;
- f. Sistemi për furnizimin me ujë të pijshëm 33 pasuri;
- g. Sistemi i furnizimit dhe transformimit të energjisë elektrike 6 pasuri me sipërfaqe 431,040 m²;
- h. Sheshe 60 pasuri me sipërfaqe 345,100 m²;
- i. Pyje 22 pasuri me sipërfaqe 596.3 ha;
- j. Kullotë 4 pasuri me sipërfaqe 193 ha;

Përmbledhësja e pronave sipas listës së inventarit si dhe VKM-ve respektive të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative:

Nr.	Bashkia/Njësiti Administrative	Nr. Pronave në Inventar	Nr. Pronave në Përdorim	Nr. i Praktikave të Çertifikuara	Prona të pa Regjistruara
1	Bashkia Selenicë	103	6	0	103
2	Njësia Administrative Vllahinë	808	34	0	808
3	Njësia Administrative Sevaster	741	0	0	741
4	Njësia Administrative Kotë	440	46	0	440
5	Njësia Administrative Brataj	241	0	0	241
6	Njësia Administrative Armen	533	0	0	533
Totali		2,866	86	0	2,866

Siç shihet nga tabela e mësipërme, Bashkia Selenicë nuk ka prona të pajisura me çertifikate pronësie, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Vlorë, si dhe nuk ka prona në proces regjistrimi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar & Arkiv Protokollit, në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk kemi raste të zaptimit të trojeve në administrim të Bashkisë Selenicë.

Në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Selenicë të miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë nuk ka drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, detyrat e të cilës i kryen Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave.

Përsa i përket këtyre pronave nga Bashkia Selenicë pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të pa trajtuara nga ana e DVASHK Vlorë, ka mbivendosje të pronave, mungesë të ardhurash për të bërë aplikim në kadastër.

Nga tabela e mësipërme sipas zërave, për 6 njësitë administrative konstatohet se nuk ka prona që janë regjistruar pranë DVASHK Vlorë, ndërsa gjatë vitit 2023 nuk kemi asnjë procedurë të nisur për regjistrim të tyre. Për periudhën e audituar nga informacionet e mara nga subjekti nuk rezultojnë

të këtë shitje të asetëve. Për më tepër në buxhetin e vitit 2023, miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2022, nuk janë parashikuar fonde për pajisjen me titull pronësie të pasurive të institucionit.

Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura:

➤ Kontratat për dhënien me qira të tokave bujqësore:

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Selenicë ka aktive 22 kontrata për dhënien me qira të tokave bujqësore, të cilat 14 kontrata me afat 1 vjeçar dhe 8 kontrata me afat 99 vjeçar. Për vitin 2023 vlera e detyrimit për këto kontrata është 258,914 lekë ku janë likuiduar sipas transaksioneve përkatëse nëpërmjet Postës Shqiptare dhe bankave të nivelit të dytë. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë						
Nr.	Emër mbiemër	Paguesa dhe numri i transaksionit	Sip ha	Pagesa	Njësia Administrative	Afati kontratës vjet
1	E Sh	Nr. 48751600, datë 17.02.2023, në Postën Shqiptare	5.3	26,000	Vlahinë/Mallkeq	1
2	A B	Nr. 50117686, datë 28.03.2023, në Postën Shqiptare	2	12,000	Armen/Trebllovë	1
3	B D	Nr. 50279791, datë 30.03.2023, në Postën Shqiptare	0.9	5,400	Kotë	1
4	S B	Nr. 51640912, datë 09.05.2023, në Postën Shqiptare	0.45	2,700	Gumenicë	1
5	S M	Nr. 52255474, datë 23.03.2023, në Postën Shqiptare	1.5	9,000	Trebllovë	1
6	Z M	Nr. 51589477, datë 08.05.2023, në Postën Shqiptare	1.5	9,000	Trebllovë	1
7	D LI	Faturë 03.10.2023	0.8	4,800	Ploçë	1
8	A H	Nr. 51631170, datë 09.05.2023, në Postën Shqiptare	0.34	2,040	Kotë	1
9	A T	Nr. 59196113, datë 04.12.2023, në Postën Shqiptare	1.45	8,700	Mesaplik	1
10	G M	Nr. 53672183, datë 05.07.2023, në Postën Shqiptare	5	30,000	Vajzë	1
11	G K	Nr. 56208914, datë 14.09.2023, në Postën Shqiptare	2.2	15,180	Shkallë/Mavrovë	1
12	L R	Nr. 58486314, datë 13.11.2023, në Postën Shqiptare	1.2	7,200	Lepenicë	1
13	A M	Nr. 50369531, datë 05.04.2023, në Postën Shqiptare	2.7	16,200	Shkallë/Mavrovë	1
14	B Z	Nr. FJB2321300630702, datë 01.08.2023, në ABI Bank	1.8	10,800	Brataj	1
15	L X	Nr. 59336853, datë 07.12.2023, në Postën Shqiptare	1.3	11,600	Kotë/Kotë	99
16	I B	Nr. FJB2334600834311, datë 12.12.2023, në ABI Bank	4	24,000	Kotë/Kotë	99
17	E O	Nr. 234670780, datë 12.12.2023, në Credins Bank	11.2	67,200	Kotë/Hysoverdh	99
18	Sh Xh	Nr. 59301916, datë 06.12.2023, në Postën Shqiptare	2	12,000	Kotë/Kotë	99
19	A K	Nr. 236035037, datë 29.12.2023, në Credins Bank	0.73	4,380	Kotë/Vajzë	99
20	Z K	Nr. 237094557, datë 09.01.2024, në Credins Bank	1.1	6,600	Kotë/Vajzë	99
21	A H	Nr. 59252423, datë 05.12.2023, në Postën Shqiptare	1.063	6,378	Sevaster/Sevaster	99
22	E M	Nr. 237094, datë 06.12.2023, në Credins Bank	1.6	13,836	Sevaster/Shkozë	99
Totali			50.133	258,914		

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

➤ Kontratat për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për vendosjen e antenave telefonike:

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Selenicë ka aktive pesë kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për vendosjen e antenave telefonike (nga të cilat vetën kontrata me subjektin “” A Sh.a”” i përket periudhës objekt auditimi). Për vitin 2023 vlera e detyrimit për këto kontrata është 1,593,833 lekë ku janë likuiduar sipas transaksioneve përkatëse në bankat e nivelit të dytë. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë							
Nr.	Subjekti	Fshati	Numër protokollit dhe data e lidhjes së kontratës	Afati Vjet	Vlera e detyrimit vjetor	Data e kalimit të pagesave të qirasë nga Dega e Thesarit Vlorë drejt Bashkisë Selenicë	Vlera e likuiduar
1	V A	Kotë	Nr. 47 prot., datë 01.01.2015	9	350,000	31.08.2023	350,000
2	V A	Kocul	Nr. 47 prot., datë 28.06.2022	10	400,000		400,000
3	V A	Armen	Nr. 47 prot., datë 14.12.2019	10	298,000	01.09.2023	298,000
4	A T Sh.a	Hadëraj	Nr. 1943 prot., datë 12.08.2016	9	400,000	09.05.2023	400,000
5	O A Sh.a	Mavrovë	Nr. 214 prot., datë 23.01.2023	1	495,833	27.03.2023	495,833
Totali					1,593,833		1,593,833

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

➤ **Kontrata për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për ushtrim veprimtarie për ndërtim Hec-i.**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nuk ka kontrata për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për ushtrimin e veprimtarisë për ndërtim Hec-i. Nga auditimi konstatohet se:

a) Ndërmjet Subjektit “H V” Shpk me Nipt L....V me përfaqësues znj. L D dhe Bashkisë Selenicë përfaqësuar nga z. P Sh është lidhur kontrata e qirasë me nr. 748 prot., datë 28.03.2017, për dhënie në përdorim sipërfaqen prej 7.1001 ha e cila është pjesë e fondit pyjor/kullor publik bashkiak, në Ekonominë Pyjore Çipin dhe Ekonominë Kullorë Kuç-Mesaplik sipas ngastrave në raportin teknik, për ushtrimin e veprimtarisë “Të mundësojë ndërtimin e Hec-eve”. Afati i kontratës është për një periudhë 2 vjeçare duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me vlerë qiraje vjetore prej 2,199,706 lekë për çdo vit.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia Selenicë i jep të drejtën subjektit “H V” Shpk të drejtën për të përdorur edhe sipërfaqen prej 0.2378 ha për ndërtimin e Hec-eve 1, 2, 3 e cila është pjesë e fondit pyjor publik e cila ndodhet në Ekonominë Pyjore Çipin në ngastrat 14, 2, 83, 80 të cilat do të hiqen nga fondi pyjor dhe do të përdoren nga ana e qiramarrësit për të gjithë kohën e zgjatjes së kësaj kontrate.

Me transaksionin e datës 27.03.2017, në San Paolo Bank është likuiduar detyrimi i vitit të parë të kontratës në vlerën 2,199,706 lekë. Ndërkohë që nga Subjekt “H V” Shpk nuk është likuiduar detyrimi që i përket vitit të dytë të kontratës duke **krijuar detyrime të pa paguara ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën 2,199,706 lekë.**

b) Ndërmjet Subjektit “H V” Shpk me Nipt L....V me përfaqësues znj. L D dhe Bashkisë Selenicë përfaqësuar nga z. P Sh është lidhur kontrata e qirasë me nr. 466 prot., datë 19.02.2019, për dhënie në përdorim sipërfaqen prej 4.7 ha e cila nuk është pjesë e fondit pyjor/kullor por është pronë e bashkisë, në Ekonominë Pyjore Çipin dhe Ekonominë Kullorë Kuç-Mesaplik sipas ngastrave në raportin teknik, për ushtrimin e veprimtarisë “Të mundësojë ndërtimin e Hec-eve”. Afati i kontratës është për një periudhë 2 vjeçare duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me vlerë qiraje vjetore prej 1,521,600 lekë për çdo vit.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia Selenicë i jep të drejtën për përdorimin e sipërfaqen e sipërpërmendur për ushtrimin e veprimtarisë “Për ndërtimin e Hec-eve 1, 2, 3, 4” vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga bashkia për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratës.

Nëpërmjet trasaksionit të Degës së Thesarit Vlorë datë 13.02.2019, është kaluar për llogari të Bashkisë Selenicë vlera 1,521,600 lekë për likuidimin e detyrimit të vitit të parë të kontratës nga Subjekt “H V” Shpk. Ndërkohë që nga Subjekt “H V” Shpk nuk është likuiduar detyrimi që i përket vitit të dytë të kontratës duke **krijuar detyrime të pa paguara ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën 1,521,600 lekë.**

Në lidhje me këtë situatë Bashkia Selenicë është drejtuar me shkresën nr. 571/1 prot., datë 02.04.2024, Subjektit “H V” Shpk për shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale prej 3,721,306 lekë në zbatim të angazhimeve të parashikuara në kontratat e sipërpërmendura.

➤ **Kontratat për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për veprimtari turistike, argoturizëm, për studim prodhimi të energjisë elektrike, shesh depozitimi të minerareve, përpunimin e ujit të pijshëm, lëndë drusore dhe agropylltari:**

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Selenicë ka aktive 19 kontrata për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për veprimtari turistike, argoturizëm, për studim prodhimi të energjisë elektrike, shesh depozitimi të minerareve, përpunimin e ujit të

pijshtëm, lëndë drusore dhe agropylltari me afat nga 1 deri në 10 vjeçar, nga të cilat 11 kontrata janë lidhur përgjatë vitit 2023 dhe 8 kontrata përpara kësaj periudhe. Për vitin 2023 vlera e detyrimit për këto kontrata është 2,353,176 lekë ku janë likuiduar sipas transaksioneve përkatëse në bankat e nivelit të dytë. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike si më poshtë:

Lekë

Nr.	Nr. arkt	Subjekti Nipt	Kontrata	Objekti i Kontratës	Nr. Parcelës	Ekonomia Pyjore/ Kullimore	Fshati	Afati/ Vite	Data e pagesës	Vlera
1	8646	E K M.....O	Nr. 1252 prot., datë 09.06.2023	Për veprimtari turistike	16 b	Gjorm-Vranisht	Brataj	10	09.06.2023	3,500
2	8553	K A E Shpk M.....G	Nr. 3319 prot., datë 11.11.2021	Për studim prodhim energji gjeneruese nga era		Shashicë-Gumenicë	Lapardha	2	04.08.2023	202,550
3	6206	B P Shpk L.....K	Nr. 3534 prot., datë 24.11.2020	Për shesh depozitimi të materialit mineral zhavorr bituminoz dhe ndërtim të çmontushëm	17 a	Selenicë	Selenicë	10	16.01.2023	154,000
4	6208	B V Shpk L.....V	Nr. 2932 prot., datë 5.10.2020	Dhënie në përdorim të sipërfaqes së pafrytshme prej 4376m ²	Nr. Kadastër 389		Drashovicë-Kotë	10	17.01.2023	3,255
5	4175	P Sh Shpk M.....P	Nr. 402 prot., datë 10.02.2023	Për veprimtari turistike	62	Kotë-Sevaster	Sevaster	10	09.02.2023	50,000
6	4176	E Z Shpk M..... A	Nr. 403 prot., datë 10.02.2023	Për veprimtari turistike	16/1	Gjorm-Vranisht	Brataj	10	09.02.2023	30,000
7	4177	F S Shpk M.....S	Nr. 393 prot., datë 10.02.2023	Për veprimtari turistike	16/2	Gjorm-Vranisht	Brataj	10	09.02.2023	50,000
8	8648	R M Shpk M.....A	Nr. 1339 prot., datë 20.06.2023	Agroturizëm	16	Gjorm-Vranisht	Brataj	10	20.06.2023	100,000
9	8649	Gj H Shpk K.....F	Nr. 1348 prot., datë 20.06.2023	Aktivitet Bujqësor, Njësi Shërbimi	115	Tokë e pafrytshme	Armen	10	20.06.2023	6,000
10	8650	Sh Shpk K.....W	Nr. 1352/2 prot., datë 20.06.2023	Shesh për depozitim të përkohshëm të matërijave të ndryshme (pika transiti)	29	Sevaster-Peshkëpi	Poçem-Vllahinë	10	20.06.2023	125,000
11	8658	I M Shpk M.....C	Nr. 1563 prot., datë 17.07.2023	Për veprimtari turistike, (Kampingje)	62	Kotë-Sevaster	Sevaster	10	17.07.2023	50,000
12	8659	M Shpk K.....H	Nr. 1656 prot., datë 22.06.2018 Nr. 1939 prot., datë 19.07.2018	Për përpunim dhe ambalazhim i ujit të pijshëm	16	Çipin		10	17.07.2023	70,081
13	8554	M M Shpk M.....V	Nr. 1586 prot., datë 19.07.2023	Për veprimtari turistike, (Kampingje)	18	Gjorm-Vranisht	Brataj	10	19.07.2023	83,000
14	8668	Sh V Shpk M.....N	Nr. 2028 prot., datë 23.08.2022	Për veprimtari turistike, bujtina pushimi dhe mbarështrim blegtorie	9	Sevastër-Peshkëpi	Vajzë	10	15.08.2023	54,200
15	8669	M F Shpk M.....D	Nr. 2027 prot., datë 23.08.2022	Për Akua -Kulturë, veprimtari turistike, dhe përpunim uji të pijshëm	26,29	Kuç-Mesaplik	Vernik	10	15.08.2023	110,850
16	8670	M K Shpk M.....O	Nr. 2029 prot., datë 23.08.2022	Për Agropylltari, pyllëzime me arrëdhe bajame	12,13a	Selenicë	Selenicë	10	15.08.2023	100,000
17	8636	B V 2013 Shpk L.....V	Nr. 2932 prot., datë 05.10.2020	Për përpunim inertesh	nr. kadastër 389		Drashovicë-Kotë	10	02.10.2023	11,815
18	8677	E Shpk L.....T		Dhënie në përdorim të fondit			Selenicë	1	14.11.2023	570,425

			Nr. 127/24 prot., datë 30.11.2023	Pyjor/Kullosor Publik	37a/1	Selenicë				
19	O 2015 Shpk L.....N	Nr. 2842 prot., datë 27.12.2023	Kontratë për shfrytëzimin e lëndës drusore në këmbë		38	Mali Bratit-Gumenicë	Gjorm	2	27.12.2023	578,500
Totali										2,353,176

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

➤ **Kontratat për dhënie me qira të pyje dhe kullotave:**

Referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, lista e inventarit fillon me numrin rendor 1 (një) dhe mbaron me numrin rendor 500 (pesëqind), ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” Bashkia Selenicë ka në pronësi 16,633.1 ha kullota.

Këto kullota administrohen nga strukturat e Bashkisë Selenicë dhe sipërfaqe të caktuara të tyre jepen me qira në përputhje me kuadrin ligjor.

Bashkia Selenicë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016, nuk është pajisur me certifikatë pronësie për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore që administrohen.

-Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Selenicë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 57, shtojca me nr. 55, në kundërshtim me pikën 64, pika 65, Ministri i Mjedisit dhe kryetarët e bashkisë përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve puna nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për transferimin e pronave nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Selenicë, si dhe pika 66 kryetarët e bashkive regjistrojnë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor të transferuar nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe nuk ka iniciuar procedura për regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore etj., që administrohen.

-Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj..) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, Bashkia Selenicë ka aktive 260 kontrata për dhënie me qira të pyje dhe kullotave me sipërfaqe prej 9,023 ha, me një total numri krerësh prej 31,102, me afat nga 1 deri në 20 vjeçar, nga të cilat 119 kontrata janë lidhur përgjatë vitit 2023 dhe 141 kontrata përpara kësaj periudhe. Për vitin 2023 vlera e detyrimit për këto kontrata është 2,810,540 lekë ku janë likuiduar sipas transaksioneve përkatëse në bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, konstatohet se Bashkia Selenicë ka lejuar edhe **47** bletore të tjerë të përdorin kullotat pa lidhur kontratat përkatëse por nga të cilët janë likuiduar detyrimet sipas sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Arsyet që Bashkia paraqet lidhur në mos nënshkrimin e këtyre kontratave është se ato nuk plotësojnë kriteret ligjore për lidhjen e kontratës sikurse janë mos pajisja me Nipt apo mos regjistrimi i bagëtive në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar “R”. Për këto bletore të cilët përdorin sipërfaqen kullosore pa shpërblim nga DZHBAPK nuk janë marr masa për eliminimin e këtij fenomeni.

-Nga Bashkisë Selenicë, nuk janë bërë sondazhe gjatë kullotjes për të mos lejuar futjen e bagëtive në kullotë jashtë kapacitetit kullor të kontraktuar, në kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike të përdorimit të fondit kullor për kullotje”, pika 7 të Udhëzimit të mësipërm.

-Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullorë, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), në referim të Ligjit 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15/2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar.

-Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara.

-Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes, sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullor”, neni 29 “Organet e kontrollit”, neni 30 “Dokumentimi”.

Në përfundim, dhënia me qira e sipërfaqeve pyll dhe kullota vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave në NJQV”, Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.

-Nga auditimi me zgjedhje i disa prej dosjeve të subjekteve për dhënien me qira të kullotave konstatohet se:

1. Për kontratën me nr. 2531 prot., datë 16.04.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. G Sh për dhënien me kullotave dhe livadheve për kullotje e kositje për 50 krerë konstatohet se, vërtetimi i lëshuar nga Kryeplaku i fshatit Gjorm nuk është në përputhje me nenin 55, 58 dhe neit 59 e pika 1, gërma “b”, të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011, “Çertifikata shëndetësore lëshohet nga veterinar zyrtar ose mjeku veteriner vulosur nga me vulën personale të tij dhe vulën e shërbimit veterinar”.

2. Për kontratën me nr. 1995, datë 11.09.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. D L në Gjoni Vranisht konstatohet se, në dokumentacionin bashkangjitur ndodhet vërtetimi i çertifikatës shëndetësore për 150 krerë pa datën e lëshimit të tyre.

3. Për kontratën nr. 2808, datë 21.12.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. A M konstatohet se, në materialet bashkangjitur ndodhet process verbali i dorëzimit në vënd të parcelës po që kontraktohet por mungon vërtetimi i çertifikatës shëndetësore të bagëtive.

4. Për kontratën me nr. 2795, datë 21.12.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. R A, me vendodhje Mali i Bratit Gumenicë konstatohet se, çertifikata shëndetsore e lëshuar nga mjeku veteriner rezulton pa numër dhe vulën personale.

5. Për kontratën me nr. 2671, datë 04.12.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. M Z, me vendodhje Brataj konstatohet se, çertifikata shëndetsore e lëshuar nga mjeku veteriner rezulton pa numër dhe vulën personale. Vërtetimi lëshuar nga Kryeplaku i fshatit Brataj është pa numër protokollit dhe pa numër krerësh. Vërtetimi i lëshuar nga DRVNB është për vitin 2020 dhe nuk pasqyron ndryshimet në krerë që mund të kenë ndodhur deri ne vitin 2023 në momentin e lidhjes së kontratës. Mugon firma dhe vula personale e veterinerit.

6. Për kontratën me nr. 1271, datë 13.06.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. A S, me vendodhje Mali i Bratit Gumenicë konstatohet se, vërtetimi i datës 10.11.2018, për 150 krerë bagëti nuk rakordon me sasinë prej 100 krerësh të lidhur në kontratë. Në dokumentacion mungon harta shoqëruese e sipërfaqes që duhet shfrytëzuar për kullota.

7. Për kontratën me nr. 2530, datë 15.11.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe z. T G. Çertifikata me nr. 37986, datë 28.08.2023, ka të regjistrua 50 krerë por mungon harta shoqëruese bashkangjitur kontrtaës.

8. Në dosje figuron vetëm mandat arkëtimi nr. 59136366, në 20,100 lekë të arkëtuar nga personi fizik z. M Z dhe nuk ka asnjë material tjetër konstatohet se, mungojnë çertifikata veterinare dhe harta shoqëruese bashkangjitur.

9. Për kontratën kolektive me nr. 2638, datë 30.11.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe 8 personave fizik përfaqësuar nga z. S A konstatohet se, në dosje mungon harta ose plani relevimi.

-Për këtë sezon nuk është shfrytëzuar e gjithë sipërfaqja kullosore e miratuar me VKM, duke mos miratuar dhe shpallur për dhënie me qira e gjithë sipërfaqja kullosore që ka në pronësi Bashkia Selenicë, gjë e cila çon në mungesë të ardhurash për këtë bashki.

Mos arritja e objektivave vjen si rezultat i disa problematikave që DZHBAPK ka, që janë:

-Mungesa e menaxhimit të zonave kadastrale,

-Vështirësi në përcaktimin e kufijve,

-Mos evidentimi i sipërfaqeve të lira të tokës si pasojë e mungesës së rakordimit me DVASHK Vlorë.

Në lidhje me zbatimin e kontratave për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor në territorin e Bashkisë Selenicë, më datë 04.06.2024, u kryer një verifikim në terren ku u konstatua se, përgjatë aksit Bashaj-Vërmik janë kryer ndërhyrje në aksin/trasënë ekzistuese si pastrime të rëshqitje të dherave apo gurëve, sistemim (sheshim) rruge dhe mbushje në segmente të caktuara të aksit me çakull. Këto punime janë kryer nga individë privatë të cilët nuk janë të pajisur me leje infrastrukturore në Bashkinë Selenicë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 11/1, pika 1 dhe 2, ku përcaktohet që:

1. *“Leje ndërtimi infrastrukturore” është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve për ngritje rrjetesh shërbimi ose sigurie publike, të rrjetit elektrik, rrjeteve të ujësjellësit, të kanalizimit, të ngrohjes, të telefonisë, të internetit, të kanaleve të kullimit apo të kanaleve të ujitjes, leje të rrjeteve rrugore dhe të sinjalistikës rrugore nga subjektet publike ose private, sipas legjislacionit në fuqi.*

2. *Dokumentet, që duhet të dorëzojë aplikuesi për t’u pajisur me leje ndërtimi infrastrukture, përcaktohen në nenin 15, të kësaj rregulloreje”.*

Të dhënat mbi likuidimin e kontratave nga dhënia me qira të pyjeve dhe Kullotave paraqiten në **Tabelën 9, Aneksi nr. 2**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Të dhënat mbi likuidimin e kontratave nga dhënia me qira të pyjeve dhe Kullotave paraqiten në **Tabelën 9, Aneksi nr. 2**, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

➤ **Kontrata për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullosor:**

Me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”, ndryshuar me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike” ku numri i pronave pyje dhe kullota që ka Bashkia Selenicë është **485**, me sipërfaqe totale prej **26,899.51 ha** e ndarë kjo në 16,633.1 ha Kullotë, 10,062.1 ha Pyll dhe 204.31 ha Shkëmbore.

Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitetet minerar **15 subjekte** private, për shfrytëzimin e sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për llojin e minerarit

bitum, zhavor bituminoz, rërë bituminoze, gëlqeror dekorativ, masiv dhe organogjeno coprizor referuar lejeve minerare të miratuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Nga Bashkia Selenicë nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private për sipërfaqen prej **699.6 ha për 10 subjekte** dhe sipërfaqen prej **297.1 ha për 5 subjekte** ëshë lidhur kontratë qiraje sipas shfrytëzimit të sipërfaqe fakive vjetore.

Për auditimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar në territorin e Bashkisë Selenicë, grupi i auditimit është referuar lejeve minerale aktive të publikuara në faqen zyrtare të AKBN-së, të cilat evidentohen në tabelën përmbledhëse si më poshtë:

Nr. Leje	Data QKB	Emri i subjektit	Nipt	Bashkia	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	S=km ²
355/1	17.06.1997	S B	K.....M	Selenicë	Selenicë	Bitum, Zhavor Bituminoz	1.543
390/1	22.01.1998	R Shpk	J.....N	Selenicë	Jorgo-Mali i Jashikut	Zhavor Bituminoz	0.099
1115/1	12.12.2007	Xh K Shpk	K.....D	Selenicë	Resulaj	Zhavor Bituminoz	1.09
1371	22.06.2009	M B Shpk	K.....E	Selenicë	Kume-Murriz	Bitum, Zhavor Bituminoz	0.324
1496/2	10.07.2013	B M I Shpk	K.....Q	Selenicë	Treblovë, Romës, Vlorë	Rërë Bituminoze	1.638
1496/3	26.11.2014	B M I Shpk	K.....Q	Selenicë	Treblovë, Romës, Vlorë	Rërë Bituminoze	1.171
1578	24.09.2013	B M I Shpk (B P Shpk NK)	K.....Q	Selenicë	Zona e dytë Resulaj	Zhavor Bituminoz	0.137
1644	02.07.2013	A-I Shpk (Z Shpk NK)	L.....B	Selenicë	Selenicë	Zhavor Bituminoz	0.36
1753	21.05.2015	B & AD C Shpk	L.....A	Selenicë	Objekti Selenicë	Zhavor Bituminoz & Bitum	0.322
1754	22.05.2015	B G	L.....I	Selenicë	Objekti Selenicë	Zhavor Bituminoz & Bitum	0.251
1789	14.01.2016	Y. S Shpk	L.....T	Selenicë	Lepenicë	Gëlqeror Dekorativ	0.198
1792/1	10.03.2016	A Shpk	L.....B	Selenicë	Lepenicë, Vlorë	Gëlqeror Dekorativ	0.268
1826	12.12.2016	M P	L.....U	Selenicë	Lepenicë, Vlorë	Gelqeror Organogjeno Coprizor	0.997
1863	17.07.2018	S M Shpk	L.....K	Selenicë	Brataj	Gëlqeror masiv	1.329
1943	17.02.2023	B S 22 Shpk	M.....E	Selenicë	Brataj	Gëlqeror Dekorativ	0.240
Totali							9.967

Burimi i të dhënave: Regjistri i lejeve minerare aktive AKBN.

Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar në territorin e Bashkisë Selenicë të administruara nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave konstatohet se:

1. Subjekti “S B” Shpk me Nipt K.....M i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 355/1, datë 17.06.1997, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit bitum dhe zhavor bituminoz me sipërfaqe 1.543 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 355/1, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **1,543,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 60/1, 59, 58, 61, 62, 63/1, 63/2, 64, 65, 66, 67, 70, 71, 72/1, 84, 85, 88, 89, 90, 91, 93, 94, 95, 97, tokë arë me sipërfaqe 785,691 m², numër 127, 228 tokë e pa frytshme me sipërfaqe 219,565 m², numër 150, 127, 129/2, 128/2, 128/1, 133, 139, 126, 130, 131, 132, 137, 140, 141, 142, 143, 151, 149 kullotë me sipërfaqe prej 452,266 m², numër 225 varreza me sipërfaqe 4,657 m², numër 2016/1, 214/1;2, 219/1;2 truell me sipërfaqe 25,351 m², numër 224 rrugë me sipërfaqe 30,981 m², numër 227 liqen me sipërfaqe 505 m², numër 226 përrua me sipërfaqe 7,500 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “S B” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “S B” Shpk që nga periudha 1997 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 239,100 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **1,211,562.8 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 1,161,562.8 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë arë + tokë e pa frytshme $137,772 \text{ m}^2 * 27,000 \text{ lekë/ha/vit} = 371,984.4 \text{ lekë/vit}$;

Kullotë $101,228 \text{ m}^2 * 78,000 \text{ lekë/ha/vit} = 789,578.4 \text{ lekë/vit}$;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 50,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $1 \text{ km} * 50,000 \text{ lekë/km} = 50,000 \text{ lekë/vit}$;

Pjesë e dosjes të subjektit “S B” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/6 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 79/18 prot., datë 25.01.2024, njoftim për mos ardhje në takimin e datës 22.01.2024, nga subjekti “S B” Shpk;

-Shkresa nr. 760/3 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1057 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes.

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 355/1, është **154.3 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 23.91 ha (13.7772 ha tokë arë + 10.128 ha kullotë) sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 1,161,562.8 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 355/1, është **130.39 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej $35.0986 \text{ kullotë} + 43.4705 \text{ ha}$ tokë arë + tokë e pafrytshme + 51.8209 ha nga privatë.

Për sipërfaqen prej **78,5691 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 3,911,394.3 lekë për vitin 2023 për subjektin “S B” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë $35.0986 \text{ ha} * 78,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 2,737,690.8 \text{ lekë/vit}$;

b. Tokë arë + tokë e pafrytshme $43.4705 \text{ ha} * 27,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 1,173,703.5 \text{ lekë/vit}$;

2. Subjekti “Rr” Shpk me Nipt J.....N i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 390/1, datë 22.01.1998, për shfrytëzimin e vendburimit Jorgo-Mali i Jashikut Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.099 km^2 .

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 390/1, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **99,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 136/1, 137, 160, 163, 137/1 tokë arë me sipërfaqe prej $91,512 \text{ m}^2$, numër 137/2 e tokë pa frytshme me sipërfaqe 385 m^2 , numër 161, 162 kullotë me sipërfaqe $4,487 \text{ m}^2$, numër 234, 240 rrugë me sipërfaqe 978 m^2 , numër 136/2 shesh me sipërfaqe $1,638 \text{ m}^2$.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë”, nga subjekti “Rr” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “Rr” Shpk që nga periudha 1998 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit,

funkcionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 16,900 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse. Sipërfaqja prej 16,900 m² bie në tokat arë e ndarë nga zbatimi i Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **150,000 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 0 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë arë 16,900 m² * 0 lekë/ha/vit = 0 lekë/vit (pasi gjurmimi faktik bie në pronë private);

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 150,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 3 km * 50,000 lekë/km = 150,000 lekë/vit;

Pjesë e dosjes të subjektit “Rr” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/7 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 79/17 prot., datë 25.01.2024, njoftim për mos ardhje në takimin e datës 22.01.2024, nga subjekti “Rr” Shpk;

-Shkresa nr. 760/5 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1060 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes;

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 390/1, është **9.9 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 1.69 ha tokë arë e cila bie në pasuri private e ndarë me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 0 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 390/1, është **8.21 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 0.4487 kullotë + 4.6 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 3.1536 ha privatë.

Për sipërfaqen prej **5.0487 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 159,198.6 lekë për vitin 2023 për subjektin “Rr” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë 0.4487 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 34,998.6 lekë/vit;

b. Tokë arë + tokë e pafrytshme 4.6 ha * 27,000 lekë tarifa/ha/vit = 124,200 lekë/vit;

3. Subjekti “Xh K” Shpk me Nipt K.....D i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1115/1, datë 12.12.2007, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 1.09 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 1115/1, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **1,090,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 33/1, 34, 35, 76, 77, 78, 80, 83, 110, 146, 149, 152, 157, 160, 190, 163 tokë arë me sipërfaqe 740,910 m², numër 150, 153, 154, 158, 228 tokë pa frytshme me sipërfaqe 11,771 m², numër 135/1, 135/2 pyll me sipërfaqe 137,641 m², numër 155, 142, 191, 192, 193, 134, 188, 189, 145, 81, 208/2, 136, 17/2, 137-73, 74, 148 kullotë me sipërfaqe 179,281 m², numër 202, 203, 204, 205 truall me sipërfaqe 3,040 m², numër 239, 246 rrugë me sipërfaqe 11,273 m², numër 82 varreza me sipërfaqe 3,680 m², numër 238 kanal me sipërfaqe 2,404 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B Dj Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M Mo Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin

tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “Xh K” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “Xh K” Shpk që nga periudha 2007 e deri në muajin mars të vitit 2024, nuk ka ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit për sipërfaqen 1,090,000 m².

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **0 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 0 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 0 lekë/vit;

Pjesë e dosjes të subjektit “Xh K” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/4 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 760/4 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1115/1, është **109 ha**;

-Sipërfaqja e pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1115/1, është **109 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 13.76 ha trung + 17.9281 ha kullotë + 8.8942 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 68.3 ha privatë.

Për sipërfaqen prej **40.5823 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 2,959,495.2 lekë për vitin 2023 për subjektin “Xh K” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung 13.76 ha * 96,000 lekë tarifa/ha/vit = 1,320,960 lekë/vit;

b. Kullotë 17.9281 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 1,398,391.8 lekë/vit;

c. Tokë arë + tokë e pafrytshme 8.8942 ha * 27,000 lekë tarifa/ha/vit = 240,143.4 lekë/vit;

4. Subjekti “M B” Shpk me Nipt K.....E i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1371, datë 22.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kume-Murriz Selenicë për llojin e mineralit bitum dhe zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.324 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 1371, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **324,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 55, 56, 57, 91 tokë arë me sipërfaqe 80,110 m², numër 228 e tokë e pa frytshme me sipërfaqe 237,671 m², numër 197, 199 truall me sipërfaqe 344 m², numër 224 rrugë me sipërfaqe 5,875 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “M B” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “M B” Shpk që nga periudha 2009 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 251,200 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse. Sipërfaqja prej 237,671 m² do t'i jepet me qira subjektit “M B” Shpk ndërsa sipërfaqja prej 13,529 m² janë në pronësi të fermerëve përfitur nga zbatimi i Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **691,711.7 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 641,711.7 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë e pa frytshme $237,671 \text{ m}^2 * 27,000 \text{ lekë/ha/vit} = 641,711.7 \text{ lekë/vit}$;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 50,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $1 \text{ km} * 50,000 \text{ lekë/km} = 50,000 \text{ lekë/vit}$;

Pjesë e dosjes të subjektit “M B” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/5 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 79/15 prot., datë 25.01.2024, njoftim për mos ardhje në takimin e datës 22.01.2024, nga subjekti “M B” Shpk;

-Shkresa nr. 760/7 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1058 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1371, është **32.4 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 25.12 ha tokë e pafrytshme sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 641,711.7 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1371, është **7.28 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 5.93 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 1.35 ha privatë. Për sipërfaqen prej **5.93 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 160,110 lekë për vitin 2023 për subjektin “M B” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Tokë arë + tokë e pafrytshme $5.93 \text{ ha} * 27,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 160,110 \text{ lekë/vit}$;

5. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë, Romës Selenicë për llojin mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.638 km^2 .

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 1496/2, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **1,638,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 107, 113, 149, 157, 163, 187, 190, 195, 197, 199, 205, 206, 209, 210, 185/1, 200 tokë arë me sipërfaqe $779,515 \text{ m}^2$, numër 196, 110, 114, 156 tokë e pa frytshme me sipërfaqe $28,213 \text{ m}^2$, rrugë me sipërfaqe $27,544 \text{ m}^2$, numër 207, 201, 192, 193, 208, 191, 198, 188, 142, 155, 148, 194 kullotë me sipërfaqe $342,359 \text{ m}^2$, numër 9, 115, 182 pyll me sipërfaqe $439,937 \text{ m}^2$, numër 242/2 përrua me sipërfaqe $20,432 \text{ m}^2$.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës i Sektorit dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “B M I” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B M I” Shpk që nga periudha 2013 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej $16,832 \text{ m}^2$, pa marrë miratimin nga organet përkatëse. Sipërfaqja prej $14,112 \text{ m}^2$ do t'i jepet me qira subjektit “B M I” Shpk ndërsa sipërfaqja prej $2,720 \text{ m}^2$ është e ndarë nga zbatimi i Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **561,024 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 381,024 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë e pa frytshme $14,112 \text{ m}^2 * 27,000 \text{ lekë/ha/vit} = 381,024 \text{ lekë/vit}$;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 180,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $3.6 \text{ km} * 50,000 \text{ lekë/km} = 180,000 \text{ lekë/vit}$;

Pjesë e dosjes të subjektit “B M I” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/3 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 760/10 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1061 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes.

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1496/2, është **163.8 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 1.6832 ha (1.4122 ha tokë e pa frytshme + 0.272 ha tokë arë) sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 381,024 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1496/2, është 162.1168 ha e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 42.0265 ha trung + 43.9945 ha kullotë + 42.458 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 33.63 ha privatë.

Për sipërfaqen prej **128.479 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 8,612,481 lekë për vitin 2023 për subjektin “B M I” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung $42.0265 \text{ ha} * 96,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 4,034,544 \text{ lekë/vit}$;

b. Kullotë $43.9945 \text{ ha} * 78,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 3,431,571 \text{ lekë/vit}$;

c. Tokë arë + tokë e pafrytshme $42.458 \text{ ha} * 27,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 1,146,366 \text{ lekë/vit}$;

6. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/3, datë 26.11.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë-Romës Selenicë për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.171 km^2 .

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 1496/3, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **1,171,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 3, 5, 33/1, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 126/1, 127, 125, 124, 130, 163, 187, 129, 128, 80 tokë arë me sipërfaqe $447,545 \text{ m}^2$, numër 31, 33/2, 133, 228 e tokë pa frytshme me sipërfaqe $26,915 \text{ m}^2$, numër 246 rrugë me sipërfaqe $2,376 \text{ m}^2$, numër 134, 145, 32, 38, 131/1, 131/2, 186 kullotë me sipërfaqe $27,003 \text{ m}^2$, numër 135/2, 135/1 pyll me sipërfaqe $651,994 \text{ m}^2$, numër 242/2 përrua me sipërfaqe $11,952 \text{ m}^2$, numër 42, 132 truall me sipërfaqe $3,215 \text{ m}^2$.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë”, nga subjekti “B M I” Shpk, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B M I” Shpk që nga periudha 2014 e deri në muajin mars të vitit 2024, nuk ka ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit për sipërfaqen 1,171,000 m².

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifatat në vlerën **0 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 0 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 0 lekë/vit;

Pjesë e dosjes të subjektit “B M I” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/3 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 760/8 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1496/3, është **117.1 ha**;

-Sipërfaqja e pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1496/3, është **117.1 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 65.1994 ha trung + 2.0003 ha kullotë + 21.28 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 28.5377 ha privatë.

Për sipërfaqen prej **88.4797 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 6,989,725.8 lekë për vitin 2023 për subjektin “B M I” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung 65.1994 ha * 96,000 lekë tarifa/ha/vit = 6,259,142.4 lekë/vit;

b. Kullotë 2.0003 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 156,023.4 lekë/vit;

c. Tokë arë + tokë e pafrytshme 21.28 ha * 27,000 lekë tarifa/ha/vit = 574,560 lekë/vit;

7. Subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1578, datë 24.09.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Zona e dytë Resulaj Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.137 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projekcioni i lejes me numër 1578, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **137,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 89, 84, 90, 136/3, 137/1, 149 tokë arë me sipërfaqe 65,474 m², numër 228 tokë e pa frytshme 25,640 m², numër 135/2, 145, 147 kullotë me sipërfaqe 44,556 m², numër 224 rrugë me sipërfaqe 1,330 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK)”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) që nga periudha 2013 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 25,876 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifatat në vlerën **219,865.2 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 69,865.2 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë arë 25,876 m² * 27,000 lekë/ha/vit = 69,865.2 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 150,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 3 km * 50,000 lekë/km = 150,000 lekë/vit;

Mbi bazën e Raportit të sipërcituar ndërmjet palëve është lidhur kontrata e qirasë me nr. 939 prot., datë 22.04.2024, nënshkruar nga z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë dhe nga znj. M N përfaqësuar ligjor i subjektit “B M I” Shpk (B P Shpk NK) me afat deri më 17.04.2034, me vlerë kontrate prej 219,865.2 lekë për vitin e parë ndërsa për vitet e tjera duke shtuar sipërfaqen faktike të gërmuar.

Me transaksionin e datës 18.04.2024, në Raiffeisen Bank subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) ka shlyer detyrimin në vlerën 219,865.20 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “B M I” Shpk (B P Shpk NK) është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 760/9 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Leje e Mjedisit e Tipit C sipas shkresës nr. 371 prot., datë 04.06.2014, lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1578, është **13.7 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 2.5876 ha tokë arë sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 69,865.2 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1578, është 11.1124 ha e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 4.4556 ha kullotë dhe 6.6558 ha tokë arë + tokë e pafrytshme. Për sipërfaqen prej **11.1124 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 527,243.4 lekë për vitin 2023 për subjektin “B M I” Shpk (B P Shpk NK) e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë 4.4556 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 347,536.8 lekë/vit;

b. Tokë arë + tokë e pafrytshme 6.6558 ha * 27,000 lekë tarifa/ha/vit = 179,706.6 lekë/vit;

8. Subjekti “A I” Shpk (Z Shpk NK) me Nipt L.....B i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1644, datë 02.07.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.36 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projekcioni i lejes me numër 1644, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **360,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 58, 65, 92 tokë arë me sipërfaqe prej 138,777 m², numër 228 tokë e pa frytshme me sipërfaqe 37,873 m², numër 56, 57, 66, 91, 141, 142, 143, 149 kullotë me sipërfaqe 177,774 m², numër 224 rrugë me sipërfaqe 5,447 m², numër 199 truall me sipërfaqe 129 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës i Sektorit dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë”, nga subjekti “A-I” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “A-I” Shpk që nga periudha 2013 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 161,647 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **1,310,846.6 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 1,260,846.6 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $161,647 \text{ m}^2 * 78,000 \text{ lekë/ha/vit} = 1,260,846.6 \text{ lekë/vit}$;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 50,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $1 \text{ km} * 50,000 \text{ lekë/km} = 50,000 \text{ lekë/vit}$;

Pjesë e dosjes të subjektit “A-I” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/9 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 79/16 prot., datë 25.01.2024, njoftim për mos ardhje në takimin e datës 22.01.2024, nga subjekti “A-I” Shpk;

-Shkresa nr. 760/2 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1056 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes.

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1644, është **36 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 16.1647 ha kullotë sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 1,260,846.6 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1644, është **19.353 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 9.314 ha arë + e pafrytshme dhe 10.039 ha privatë. Për sipërfaqen prej **9.314 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 251,478 lekë për vitin 2023 për subjektin “A-I” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Tokë arë + tokë e pafrytshme $9.314 \text{ ha} * 27,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 251,478 \text{ lekë/vit}$;

9. Subjekti “B & AD C” Shpk me Nipt L.....A i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1753, datë 21.05.2015, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz dhe bitum me sipërfaqe 0.322 km².

Mbështetur në librat kadastralë, projeksioni i lejes me numër 1753, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **322,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 136/3, 137/1, 139, 143, 146 tokë arë me sipërfaqe prej 161,968 m², numër 137/2 tokë e pa frytshme me sipërfaqe 4,116 m², numër 93, 135/2, 136/2, 138, 140, 141, 142, 151 kullotë me sipërfaqe 116,646 m², numër 224, 236 rrugë me sipërfaqe 2,750 m², numër 237 kanale me sipërfaqe 200 m².

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë”, nga subjekti “B & AD C” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B & AD C” Shpk që nga periudha 2015 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 96,627 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse. Sipërfaqja prej 79,083 m² do t’i jepet me qira subjektit “B & AD C” Shpk ndërsa sipërfaqja prej 17,544 m² është e ndarë nga zbatimi i Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **560,572.8 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 410,572.8 lekë/vit përbëhet nga:

Tokë e pa frytshme $40,446 \text{ m}^2 * 27,000 \text{ lekë/ha/vit} = 1,092,042 \text{ lekë/vit}$;

Kullotë $38,637 \text{ m}^2 * 78,000 \text{ lekë/ha/vit} = 3,013,686 \text{ lekë/vit}$

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 150,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë $3 \text{ km} * 50,000 \text{ lekë/km} = 150,000 \text{ lekë/vit}$;

Pjesë e dosjes të subjektit “B & AD C” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/2 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 760/1 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Kthim përgjigje nga subjekti “B & AD C” Shpk me shkresën e datës 24.04.2024, administruar në Bashkinë Selenicë me praktikën nr. 760/17 prot., datë 26.04.2024, me objekt “Kthim përgjigje shkresës me nr. 760/1 prot., datë 28.03.2024, Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave Bashkia Selenicë”;

-Shkresa nr. 760/18 prot., datë 09.05.2024, informacion shkresës nr. 760/17 prot., datë 26.04.2024.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1753, është **32.2 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 9.6627 ha (3.8637 ha kullotë + 4.0446 ha tokë e pa frytshme + 1.7544 ha tokë arë) sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 410,572.8 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1753, është **22.53 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 7.8 ha kullotë, 12.9756 ha tokë arë + tokë e pafrytshme + 1.7544 ha privatë. Për sipërfaqen prej **20,7756 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 958,741.2 lekë për vitin 2023 për subjektin “B & AD C” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë $7.8 \text{ ha} * 78,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 608,400 \text{ lekë/vit}$;

b. Tokë arë + tokë e pafrytshme $12.9756 \text{ ha} * 27,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 350,341.2 \text{ lekë/vit}$;

10. Subjekti “B G” Shpk me Nipt L.....I i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1754, datë 22.05.2015, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e minerarit zhavor bituminoz dhe bitum me sipërfaqe 0.251 km^2 .

Mbështetur në librat kadastralë, projekcioni i lejes me numër 1754, sipas koordinatave sipërfaqja e lejes është **251,000 m²**, me shtrirje në pasuritë me numër 136/1, 137/1, 139, 146, 152 tokë arë me sipërfaqe prej $178,252 \text{ m}^2$, numër 137/2, 150 tokë e pa frytshme me sipërfaqe $10,862 \text{ m}^2$, numër 135/2, 136/2, 142 kullotë me sipërfaqe $57,146 \text{ m}^2$, numër 235, 236 rrugë me sipërfaqe $3,171 \text{ m}^2$, numër 237 kanal me sipërfaqe $2,045 \text{ m}^2$.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. M M Inspektor Kontrolli, znj. Sh Xh Përgjegjës Sektori dhe z. V A agronom ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “B G” Shpk”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B G” Shpk që nga periudha 2015 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 27,000 m², pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **360,600 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 210,600 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 27,000 m² * 78,000 lekë/ha/vit = 210,600 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 150,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 3 km * 50,000 lekë/km = 150,000 lekë/vit;

Pjesë e dosjes të subjektit “B G” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/8 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 760/6 prot., datë 28.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa nr. 1059 prot., datë 09.05.2024, njoftim për lidhjen e akt-marrëveshjes.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1754, është **25.1 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 2.7 ha kullotë sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 210,600 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1754, është 22.4 ha e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 4.5748 ha kullotë, 3.2795 ha arë + e pafrytshme + 14.5457 ha privatë. Për sipërfaqen prej **7.8543 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 445,380.9 lekë për vitin 2023 për subjektin “B G” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë 4.5748 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 356,834.4 lekë/vit;

b. Tokë arë + tokë e pafrytshme 3.2795 ha * 27,000 lekë tarifa/ha/vit = 88,546.5 lekë/vit;

11. Subjekti “Y S” Shpk me Nipt L...T i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1789, datë 14.01.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.198 km².

Mbështetur në regjistrin kadastral pyjor/kullosor sipërfaqja e lejes minerare është **19.8 ha** e cila shtrihet në ngastrën me numër 26, (me sipërfaqe 10.536 ha) që bën pjesë në Ekonominë Pyjore Mali i Bratit-Gumenicë si dhe në ngastrën numër 13 (me sipërfaqe 9.264 ha), të Ekonomisë Kullosore Gjorm-Vranisht dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. A L Inspektor Kontrolli dhe z. J G Inspektor Zone ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “Y S” Shpk, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “Y S” Shpk që nga periudha e muajit qershor të vitit 2015 e deri në muajin mars të vitit 2024, (ku për tre vite nuk ka punuar pasi ka qenë në proces gjyqësor me subjektin “Ana-2013, për rrugën e kalimit”) kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 3.86 ha në

parcelën me numër 26 të Ekonomisë Pyjore Mali i Bratit Gumenicë pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifatat në vlerën **529,320 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 290,320 lekë/vit përbëhet nga:

Inproduktive 3.86 ha * 62,000 lekë/ha/vit = 239,320 lekë/vit;

Është llogaritur me tarifën 62,000 lekë/ha/vit si inproduktive, pasi subjekti e ka paguar vlerën prej 422,244 lekë të raportit tekniko-ekonomik;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 290,000 lekë/vit përbëhet nga:

Cungishte 1.6 km * 50,000 lekë/km/vit = 80,000 lekë/vit;

Kullotë 6 km * 35,000 lekë/km/vit = 210,000 lekë/vit;

Me transaksionin e datës 16.04.2024, në Union Bank subjekti “Y. S” Shpk ka shlyer detyrimin në vlerën 239,320 lekë dhe transaksionin e datës 15.04.2024, në Union Bank ka shlyer detyrimin në vlerën 290,000 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “Y. S” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/4 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 679 prot., datë 20.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse.

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1789, është **19.8 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 3.86 ha inproduktive sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 239,320 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1789, është 15.94 ha e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 6.676 ha trung dhe 9.264 ha kullotë. Për sipërfaqen prej **15.94 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 987,164 lekë për vitin 2023 për subjektin “Y S” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung 6.676 ha * 62,000 lekë tarifa/ha/vit = 413,912 lekë/vit;

b. Kullotë 9.246 ha * 62,000 lekë tarifa/ha/vit = 573,252 lekë/vit;

Shënim: Këto sipërfaqe janë përlllogaritur me tarifën 62,000 lekë për arsye se është paguar vlera e raportit teknik.

12. Subjekti “A” Shpk me Nipt L.....B i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.268 km².

Mbështetur në regjistrin kadastral pyjor/kullozor sipërfaqja e lejes minerare është **26.8 ha** e cila shtrihet në ngastrat me numër 19 (me sipërfaqe 0.8276 ha), 22/a (me sipërfaqe 1.89 ha), 24/a (me sipërfaqe 2.16 ha), 25 (me sipërfaqe 3.4 ha), 26/a (me sipërfaqe 3.014 ha), 26/b (me sipërfaqe 4.3974 ha) që bëjnë pjesë në Ekonominë Pyjore Mali i Bratit-Gumenicë si dhe ngastrat me numër 13 (me sipërfaqe 10.86 ha), 14 (me sipërfaqe 0.25 ha) që bëjnë pjesë në ekonominë kullozore Gjorm-Vranisht dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. A L Inspektor Kontrolli dhe z. J G Inspektor Zone ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për

shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “A” Shpk, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “A” Shpk që nga periudha e muajit shkurt të vitit 2019 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe terguesit kryesorë të grumbujve në sipërfaqen prej 4 ha, në parcelat numër 19 (me sipërfaqe 0.8276 ha), 25 (me sipërfaqe 1.4 ha), numër 26/b (me sipërfaqe 1.7724 ha) pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **399,690 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 323,740 lekë/vit përbëhet nga:

Trungishte 2.22276 ha * 96,000 lekë/ha/vit = 213,850 lekë/vit;

Inproduktive 1.7724 ha * 62,000 lekë/ha/vit = 109,890 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 75,950 lekë/vit përbëhet nga:

Shkure 1.1 km * 35,000 lekë/km/vit = 38,500 lekë/vit;

Kullotë 1.07 km * 35,000 lekë/km/vit = 37,450 lekë/vit;

Mbi bazën e Raportit të sipërcituar ndërmjet palëve është lidhur kontrata e qirasë me nr. 890 prot., datë 16.04.2024, nënshkruar nga z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë dhe nga z. P V përfaqësuar ligjor i subjektit “A” Shpk me afat deri më 15.04.2034, me vlerë kontrate prej 399,690 lekë për vitin e parë ndërsa për vitet e tjera duke shtuar sipërfaqen faktike të gërmuar.

Me transaksionin e datës 16.04.2024, në BTK subjekti “A” Shpk ka shlyer detyrimin në vlerën 399,690 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “A” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/2 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 678 prot., datë 20.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse.

Përllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1792/1, është **26.8 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 4 ha (2.2276 ha trung + 1.7724 ha tokë inproduktive) sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 323,740 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1792/1, është **22.8 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 11.69 ha trung dhe 11.11 ha kullotë. Për sipërfaqen prej **22.8 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përllogaritur detyrimi në vlerën 1,988,820 lekë për vitin 2023 për subjektin “A” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung 11.69 ha * 96,000 lekë tarifa/ha/vit = 1,122,240 lekë/vit;

b. Kullotë 11.11 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 866,580 lekë/vit;

13. Subjekti “M P” Shpk me Nipt L.....U i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1826, datë 12.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit në Lepenicë Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror organogjeno coprizor me sipërfaqe 0.997 km².

Mbështetur në regjistrin kadastral pyjor/kullor sipërfaqja e lejes minerare është **99.7 ha** e cila shtrihet në ngastrat 19, 25, 26, 28, 29, 30 që bëjnë pjesë në Ekonominë Pyjore Mali i Bratit-Gumenicë të cilat janë në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. A L Inspektor Kontrolli dhe z. J G Inspektor Zone ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “M P”, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “M P” Shpk që nga periudha e muajit mars të vitit 2019 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe terguesit kryesorë të grumbujve në sipërfaqen prej 2.82 ha në parcelat numër 26 (me sipërfaqe 1.7 ha), 28 dhe 30 (me sipërfaqe 1.12 ha) pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **406,320 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 232,640 lekë/vit përbëhet nga:

Trungishte 1.7 ha * 96,000 lekë/ha/vit = 163,200 lekë/vit;

Inproduktive 1.12 ha * 62,000 lekë/ha/vit = 69,440 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 173,700 lekë/vit përbëhet nga:

Trungishte 1 km * 70,000 lekë/km = 70,000 lekë/vit;

Kullotë 1.62 km * 35,000 lekë/km = 56,700 lekë/vit;

Inproduktive 1.88 km * 25,000 lekë/km = 47,000 lekë/vit;

Mbi bazën e Raportit të sipërcituar ndërmjet palëve është lidhur kontrata e qirasë me nr. 879 prot., datë 15.04.2024, nënshkruar nga z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë dhe nga z. E S përfaqësuar ligjor i subjektit “M P” Shpk me afat deri më 14.04.2034, me vlerë kontrate prej 406,320 lekë për vitin e parë ndërsa për vitet e tjera duke shtuar sipërfaqen faktike të gërmuar.

Me transaksionin e datës 15.04.2024, në OTP Bank subjekti “M P” Shpk ka shlyer detyrimin në vlerën 406,320 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “M P” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/10 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 675 prot., datë 20.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

-Shkresa e datës 23.03.2024, e subjektit “M P” Shpk administruar në Bashkinë Selenicë me nr. 675/1 prot., datë 25.03.2024, ku subjekti në fjalë shpreh dakordësinë mbi verifikimin e sipërfaqes faktike të gërmimit.

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1826, është **99.7 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 3.94 ha (1.7 ha trung + 1.12 tokë inproduktive) sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 232,640 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1826, është **96.88 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 36.88 ha trung dhe 60 ha tokë inproduktive. Për sipërfaqen prej **96.88 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 7,260,480 lekë për vitin 2023 për subjektin “M P” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Trung 36.88 ha * 96,000 lekë tarifa/ha/vit = 3,540,480 lekë/vit;

b. Inproduktive 60 ha * 62,000 lekë tarifa/ha/vit = 3,720,000 lekë/vit;

14. Subjekti “S M” Shpk me Nipt L.....K i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1863, datë 17.07.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror masiv me sipërfaqe 1.329 km².

Mbështetur në regjistrin kadastral pyjor/kullor sipërfaqja e lejes minerare është **132.9 ha** e cila shtrihet në ngastrën me numër 14, të ekonomisë Kullosore Gjorm-Vranisht e cila është në pronësi/administrim të Bashkisë Selenicë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. A L Inspektor Kontrolli dhe z. J G Inspektor Z ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë, nga subjekti “S M” Shpk, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “S M” Shpk që nga periudha e muajit shkurt të vitit 2019 e deri në muajin mars të vitit 2024, kanë ndryshuar kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit në sipërfaqen prej 4.68 ha në ngastrën me numër 14, të Ekonomisë Kullosore Gjorm-Vranisht pa marrë miratimin nga organet përkatëse.

Nga grupi i punës është përlogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **400,040 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 365,040 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 4.68 ha * 78,000 lekë/ha/vit = 365,040 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 35,000 lekë/vit përbëhet nga:

Kullotë 1 km * 35,000 lekë/km/vit = 35,000 lekë/vit;

Mbi bazën e Raportit të sipërcituar ndërmjet palëve është lidhur kontrata e qirasë me nr. 889 prot., datë 16.04.2024, nënshkruar nga z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë dhe nga z. M K përfaqësuar ligjor i subjektit “S M” Shpk me afat deri më 15.04.2034, me vlerë kontrate prej 400,040 lekë për vitin e parë ndërsa për vitet e tjera duke shtuar sipërfaqen faktike të gërmuar.

Me transaksionin e datës 16.04.2024, në BKT subjekti “S M” Shpk ka shlyer detyrimin në vlerën 400,040 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “S M” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Shkresa nr. 79/3 prot., datë 10.01.2024, njoftim për njohje të rekomandimeve të KLSH-së;

-Shkresa nr. 677 prot., datë 20.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse.

Përlogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1863, është **132.9 ha**;

-Sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është 4.68 ha kullotë sipas akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës pranë Bashkisë Selenicë është në vlerën 365,040 lekë;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1863, është **128.22 ha** që i përket tipologjisë kullotë.

Për sipërfaqen prej **128.22 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlogaritur detyrimi në vlerën 10,001,160 lekë për vitin 2023 për subjektin “S M” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** si më poshtë:

a. Kullotë 128.22 ha * 78,000 lekë tarifa/ha/vit = 10,001,160 lekë/vit;

15. Subjekti “B S” Shpk me Nipt M.....E i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1943, datë 17.02.2023, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.240 km².

Mbështetur në regjistrin kadastral pyjor/kullor sipërfaqja e lejes minerare është **24 ha** e cila shtrihet në ngastrat numër 12 (me sipërfaqe 18.35 ha) që bën pjesë në Ekonominë Kullorë Gjorm-Vranisht si dhe në ngastrën numër 1 (me sipërfaqe 5.65 ha) të Ekonomisë Pyjore Mali i Bratit-Gumenicë të cilat janë në pronësi/administruar të Bashkisë Selenicë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, grupi i punës i përbërë nga z. B K Drejtor i ZHBAP/K, z. B D Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullotave, z. A L Inspektor Kontrolli dhe z. J G Inspektor Zone ka hartuar Raportin “Mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktik të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkisë Selenicë”, nga subjekti “B S” Shpk, miratuar nga titullari i institucionit.

Në këtë raport evidentohet se, ndërhyrjet që janë kryer nga subjekti “B S” Shpk që nga periudha e muajit qershor të vitit 2021 e deri në muajin mars të vitit 2024, nuk ka ndryshuar kategorinë e përdorimit.

Nga grupi i punës është përlllogaritur për vitin 2023 detyrimi për tarifën në vlerën **97,519.2 lekë** si më poshtë:

a. Vlera e përdorimit = 0 lekë/vit;

b. Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km = 97,519.2 lekë/vit përbëhet nga:

Trungishte 0.55724 km * 70,000 lekë/km/vit = 53,704 lekë/vit;

Shkurre 0.20992 km * 35,000 lekë/km/vit = 7,347.2 lekë/vit;

Kullotë 1.044 km * 35,000 lekë/km/vit = 36,540 lekë/vit;

Mbi bazën e Raportit të sipërcituar ndërmjet palëve është lidhur kontrata e qirasë me nr. 880 prot., datë 15.04.2024, nënshkruar nga z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë dhe nga z. D L përfaqësuar ligjor i subjektit “B S” Shpk me afat deri më 14.04.2034, me vlerë kontrate prej 97,519.2 lekë për vitin e parë ndërsa për vitet e tjera duke shtuar sipërfaqen faktike të gërmuar.

Me transaksionin e datës 15.04.2024, në BKT subjekti “B S” Shpk ka shlyer detyrimin në vlerën 97,791.20 lekë.

Pjesë e dosjes të subjektit “B S” Shpk është edhe dokumentacioni si më poshtë:

-Urdhri nr. 209, datë 03.01.2024, i Kryetarit të Bashkisë për ngritjen e punës për verifikimin në terren të sipërfaqeve të shfrytëzuara nga subjektet minerare;

-Akt-verifikimi me nr. 108 prot., datë 11.03.2024;

-Shkresa nr. 16 prot., datë 16.02.2024, nga subjekti “Brataj Stone 22” administruar në Bashkinë Selenicë me praktikën nr. 459 prot., datë 20.02.2024, me objekt “Kërkesë për miratimin e zëvendësimit të sipërfaqes së miratuar e hequr nga fondi pyjor përcaktuar në Lejen e Shfrytëzimit nr. 1943, Bahkia Selenicë Qarku Vlorë”.

-Shkresa nr. 676 prot., datë 20.03.2024, për njoftimin për njohjen me akt-verifikimin e realizuar nga Bashkia Selenicë;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik, akt-verifikimi për lejen minerare së bashku me hartat përkatëse;

Përlllogaritja e tarifave nga grupi i auditimit:

-Sipërfaqja sipas lejes minerare nr. 1943, është **24 ha**;

-Diferenca e sipërfaqes së pa shfrytëzueshme brenda lejes nr. 1943, është **24 ha** e ndarë kjo sipas tipologjisë prej 5.65 ha trung dhe 18.35 ha kullotë. Për sipërfaqen prej **24 ha**, nga përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë **nuk është përlllogaritur detyrimi në vlerën 1,973,700 lekë për vitin 2023 për**

subjektin “B S” Shpk e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë si më poshtë:

- a. $\text{Trung } 5.65 \text{ ha} * 96,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 542,400 \text{ lekë/vit};$
- b. $\text{Kullotë } 18.35 \text{ ha} * 78,000 \text{ lekë tarifa/ha/vit} = 1,431,300 \text{ lekë/vit};$

Përlllogaritja e detyrimeve është kryer në zbatim të VKM nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari, ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, Shtojca nr. 1, “Tarifat për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond”, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si më poshtë:

9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse			
Nr.	Përdorimi i territorit	1-5	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	120,000	96,000
2	Pyll cungishte	96,000	78,000
3	Pyll shkurre	96,000	78,000
4	Kullota	96,000	78,000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	76,800	62,000
6	Inproduktive	76,800	62,000

Konkluzioni: Subjektet me objekt veprimtarinë minerare në Bashkinë Selenicë, nuk kanë zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronësisë (Bashkisë Selenicë), në përputhje me pikën 4 të nenit 4, Ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e Ligjit nr. 9/2013, dhe Ligjit nr. 134/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

-Për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare nuk është miratuar ndryshimi nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në Republikën e Shqipërisë, veprim në kundërshtim pikat 3, 5 e 8 të nenit 5 të Ligjit nr. 57/20, “Për Pyjet”, nenin 17 **“Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar”** të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

Bashkia Selenicë nuk ka lidhur kontrata qiraje me 10 subjektet që ushtrojnë veprimtari të nxjerrjes, prodhim dhe depozitim materialesh inerte në karrierë, kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, hidrokarbureve dhe të ujit, në fondin pyjor.

Sa më sipër nuk është vepruar në zbatim të pikave 3 e 4 të nenit 25 “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar” të Ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

-Nuk janë ndjekur procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për subjektet e pajisura me leje minerare nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë (dhe MMT) për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi, për pasojë nuk janë lidhur kontrata dypalëshe.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4.

-Nga Bashkia Selenicë nuk është vepruar për të lidhur kontratë qiraje për 10 subjekte private. Duke u bazuar në raportet tekniko ekonomiko-financiare të kryera nga grupi i punës të bashkisë (trajtuar më sipër në mënyrë të hollësishme) është përlllogaritur detyrimi për 15 subjekte (nga të cilat pesë prej tyre kanë lidhur kontratë qiraje) vetëm për sipërfaqen faktike të gërmimit së bashku me tarifrat për linjat gjatësore të rrugës vlerën 6,899,072.3 lekë për vitin 2023, ku është arkëtuar vlera 1,523,434.4 lekë si dhe janë krijuar debitorë ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën **52,032,890.3 lekë**. Gjithashtu nga Bashkia Selenicë për vitin 2023 nuk janë përlllogaritur detyrimet në vlerën **47,186,572.4 lekë** për pjesën tjetër të sipërfaqes së lejes minerare sipas tipologjisë përkatëse e **cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë**. Të dhënat në mënyrë analitike për përlllogaritjen e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet minerar paraqiten në **Tabelën nr. 5, Aneksi 2, të Raportit Përfundimtar të Auditimit**.

Nr. Leje	Data QKB	Emri i subjektit	Përlllogaritja nga grupi i punës nga Bashkia Selenicë	Likuiduar	Detyrimi	Përlllogaritja nga grupi i KLSH	Likuiduar	Detyrimi	Lekë
									Detyrimi Totali
355/1	17.06.1997	S B	1,211,562.8	0	1,211,562.8	3,911,394.3	0	3,911,394.3	5,122,957.1
390/1	22.01.1998	R Shpk	150,000	0	150,000	159,198.6	0	159,198.6	309,198.6
1115/1	12.12.2007	Xh K Shpk	0	0	0	2,959,495.2	0	2,959,495.2	2,959,495.2
1371	22.06.2009	M B Shpk	691,711.7	0	691,711.70	160,110	0	160,110	851,821.7
1496/2	10.07.2013	B M I Shpk	561,024	0	561,024	8,612,481	0	8,612,481	9,173,505
1496/3	26.11.2014	B M I Shpk	0	0	0	6,989,725.8	0	6,989,725.8	6,989,725.8
1578	24.09.2013	B M I Shpk (B P Shpk NK)	219,865.2	219,865.2	0	527,243.4	0	527,243.4	527,243.4
1644	02.07.2013	A-I Shpk (Z Shpk NK)	1,310,846.6	0	1,310,846.6	251,478	0	251,478	1,562,324.6
1753	21.05.2015	B & AD C Shpk	560,572.8	0	560,572.8	958,741.2	0	958,741.2	1,519,314
1754	22.05.2015	B G	360,600	0	360,600	445,380.9	0	445,380.9	805,980.9
1789	14.01.2016	Y. S Shpk	529,320	529,320	0	987,164	0	987,164	987,164
1792/1	10.03.2016	A Shpk	399,690	399,690	0	1,988,820	0	1,988,820	1,988,820
1826	12.12.2016	M P	406,320	406,320	0	7,260,480	0	7,260,480	7,260,480
1863	17.07.2018	S M Shpk	400,040	400,040	0	10,001,160	0	10,001,160	10,001,160
1943	17.02.2023	B S Shpk	97,519.2	97,519.2	0	1,973,700	0	1,973,700	1,973,700
Totali			6,899,072.3	2,052,754.4	4,846,317.9	47,186,572.4	0	47,186,572.4	52,032,890.3

➤ **Detyrimi i subjekteve për rehabilitimin e zonës së lejes minerare:**

Përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitetet minerar brenda fondit pyjor kullësor dhe në pasuritë pronë të institucionit **15 subjekte**. Referuar akt-verifikimeve të mbajtura në terren dhe raporteve tekniko-ekonomiko financiare të hartuara nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë, sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është **97.1238 ha** sipas tipologjisë tokë arë, inproduktive, e pa frytshme dhe kullotë (pjesë të fondit pyjor kullësor dhe ato privatë të përfituara në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”) që prej fillimit të lejeve dhe deri në muajin mars të vitit 2024.

Në zbatim të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në neni 37, pikat 1-7, përcaktohet që:

1. Parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare hartohen nga strukturat përgjegjëse, në këshillim me njësitë e qeverisjes vendore, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit minerar e mjedisor në fuqi, dhe miratohen nga ministri.

2. Përveç sa parashikohet më sipër në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare zotëruesi i lejes minerare ka detyrimin që gjatë veprimtarisë minerare dhe në përfundim të saj, të zbatojë planin e veprimtarisë të mbylljes së objektit minerar, **planin e rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare**, miratuar nga struktura përgjegjëse.

3. Rehabilitimi i zonë së lejuar minerare duhet të kryhet nga vetë zotëruesi i lejes apo nga subjektet e kontraktuara nga ai dhe nën përgjegjësinë e zotëruesit, **në mënyrë progresive dhe brenda afateve kohore të përcaktuara, sipas planit të veprimtarive të mbylljes së minierës e atij të rehabilitimit të mjedisit.**

4. Kontrolli i zbatimit të planeve përkatëse të mbylljes së veprimtarisë minerare e të rehabilitimit të mjedisit kryhet nga struktura përgjegjëse, e cila, pas inspektimit, i raporton ministrit. Rehabilitimi vlerësohet i përfunduar vetëm pas miratimit nga ministri të raportit përfundimtar, të hartuar nga struktura përgjegjëse, për të cilin njoftohet me shkrim zotëruesi i lejes minerare. Pas këtij miratimi zotëruesit të lejes minerare i rikthehet pjesa e garancisë financiare e pashpenzuar për realizimin e planit të veprimtarive të mbylljes së objektit minierar dhe të planit të rehabilitimit të mjedisit.

5. Në rastin kur zotëruesi i lejes minerare, që përfshin shfrytëzimin, braktis zonën e lejes minerare apo nuk përfundon zbatimin e plotë të planit të rehabilitimit, rehabilitimi kryhet nga subjekte të specializuara, të përzgjedhura nga struktura përgjegjëse, sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përballohen me fondet e garancisë financiare.

6. Nëse garancia financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit, sipas pikës 5 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme, zotëruesi i lejes minerare mbetet përgjegjës për vlerën e shpenzuar mbi fondin e garancisë së përdorur për rehabilitimin e plotë.

7. Mosrealizimi i planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes i heq të drejtën atij të përfitojë leje për një veprimtari tjetër minerare, për një periudhë 50-vjeçare, që llogaritet nga fundi i afatit të vlefshmërisë së lejes së parë dhe përbën shkak për revokimin e çdo lejeje tjetër të vlefshme të të njëjtit zotërues, të dhënë sipas këtij ligji

Si dhe

Në Urdhrin nr. 1937, datë 21.10.2014, të Ministrit të Mjedisit me objekt “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”, pika 1-3, përcaktohet që:

1. Përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre, detyrim i cili do të jetë:

A. Për fondin pyjor:

- a. E barabartë me 3 (tre) fishin e sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor për pyjet trungishte.
- b. E barabartë me sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor për pyjet me formë qeverimi cungishte dhe shkure, si dhe për sipërfaqet me bimësi pyjore.

B. Për fondin kullor:

- a. Përmirësimin kullote e barabartë me 2 (dy) fishin e sipërfaqes kullimore që hiqet nga fondi kullor.

2. Detyrimi për pyllëzimin, ripyllëzimin dhe rehabilitim kullote do të përcaktohet në dokumentin (Urdhrin e ministrit të MM-së, VKM-së apo Ligj) që vendos për heqje të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore nga fondi pyjor dhe kullor kombëtar, me qëllim për t'u kthyer në truall, zgjerim të vijës kufizuese dhe shtrirjes territoriale të qendrave të banuara, për ndërtim të strukturave turistike, për ndërtim të rrugëve automobilistike, linjave të tensionit të lartë dhe tubacioneve të gazit, veprimtaritë minerare e gjeologjike, ndërtim të hidrocentraleve etj.,.

3. Procesi i pyllëzimit apo ripyllëzimit, rehabilitimi i sipërfaqes kullimore do të realizohet nga përfituesi me fondet e saja brenda afatit kohor të përcaktuar në aktin sipas pikës 2 të këtij urdhri.

Duke u bazuar në dokumentacionin e disponueshëm në dosjet e subjeteve që ushtrojnë aktivitetet minerar konstatohet se, nga këto subjekte nuk janë masa për zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit, për rehabilitimin e sipërfaqes prej 136.5686 ha sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës në rakordim me sipërfaqen e shfrytëzueshme të karrierës, në zbatim të Urdhrit nr. 1937, datë 21.10.2014, të Ministrit të Mjedisit.

Refruar dosjeve që ushtrojnë aktivitetet minerar në territorin e Bashkisë Selenicë, institucioni disponon akt-miratimin e lejeve minerare vetëm për 8 subjekte. Gjithashtu Projekti Teknik i Rehabilitimit të Mjedisit në të cilin evidentohet skema si do të veprojë subjekti që ushtron aktivitetet minerar, mbas nxjerrjes dhe marrjes së mineralit sipas grafikut të përcaktuar nga AKBN-ja. Ky dokumentacion disponohet vetëm nga AKBN-ja.

Pas daljes së akt të miratimit për heqjen nga fondi pyjor kullosor, ndërmjet bashkisë dhe subjektit që ushtron aktivitetet minerar përcaktohet grafiku i rehabilitimit sipas tipologjisë pyll, kullotë, tokë arë, inproduktive etj., Aktualisht jemi përball faktit që ende nuk ka dal asnjë akt-miratimi për heqjen nga fondi pyjor kullosor nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në mënyrë të hollësishme paraqitet analiza si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 204/2 prot., datë 14.01.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1789, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-4900-09-2015, datë 04.09.2015, dorëzuar nga **subjekti “Y. S” Shpk** për zonën minerare nr. 70/5, të miratuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2015, për mineralin ranor silicor (mineral gëlqeror dekorativ, konstatuar sipas akt-verifikimit të AKBN, në VKT nr. 398, datë 27.10.2015), që bënë pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin “Lepenicë” Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “Y. S” Shpk për shfrytëzimin e mineralit ranor silicor brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 12 dhe 13 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit (për të cilën nuk përcaktohet sipërfaqja) miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 398, datë 27.10.2015, është **2,645,582 lekë** ndërsa ajo vjetore është **105,823 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrit nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1789, prej 19.8 ha subjekti “Y. S” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **3.86 ha Trung**. Rehabilitimi që duhet të kryeht deri në këtë fazë nga subjekti “Y. S” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **11.58 ha Trung**.

2. Me shkresën nr. 9866/1 prot., datë 16.07.2018, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1863, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-4488-10-2017, datë 20.10.2017, dorëzuar nga **subjekti “S M” Shpk** për zonën minerare nr. 70/9, të miratuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2017, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, që bënë pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin “B” Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “S M” Shpk për shfrytëzimin e mineralit të përcaktuar në leje brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 12 dhe 13 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për 13.4 ha miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 602, datë 17.11.2017, është **4,331,301 lekë** ndërsa ajo vjetore është 173,252 **lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1863, prej 132.9 ha subjekti “S M” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **4.68 ha Kullotë**. Rehabilitimi që duhet të kryeht deri në këtë fazë nga subjekti “S M” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **9.36 ha Kullotë**.

3. Me shkresën nr. 1460/1 prot., datë 17.02.2023, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1943, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-7965-12-2022, datë 19.12.2022, dorëzuar nga **subjekti “B S” Shpk** për zonën minerare nr. 270/5, për mineralin ranor silicor masiv (gëlqeror dekorativ), që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin “B”, Bashkia Selenicë, Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “B S” Shpk për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror i mermerizuar brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 12 dhe 13 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për 14.93 ha miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 44/2023, datë 23.01.2023, është **4,818,658 lekë** ndërsa ajo vjetore është **192,750 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1943, prej 24 ha subjekti “B S” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë nga sipërfaqja totale e lejes prej 24 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **0 ha**.

4. Subjekti “A” Shpk me Nipt L.....B i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.268 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 26.8 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 4 ha trung. Rehabilitimi që duhet të kryeht nga subjekti sipas gërmimit faktik është **12 ha**.

5. Me shkresën nr. 4798/2 prot., datë 12.12.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1826, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-0874-04-2016, datë 06.04.2016, dorëzuar nga **subjekti “M P” Shpk** për zonën minerare nr. 70/8, të miratuar në hartën e planit vjetor mineralar të vitit 2015, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore, për objektin “Lepenicë” Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “M P” Shpk për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror i mermerizuar brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 12 dhe 13 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për 16.4 ha miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 481, datë 11.07.2016, është **5,293,000 lekë** ndërsa ajo vjetore është **211,724 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1826, prej 99.7 ha subjekti “M P” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **2.82 ha** (1.7 ha Trung + 1.12 ha Tokë Inproduktive). Rehabilitimi që duhet të kryeht deri në këtë fazë nga subjekti “M P” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **5.1 ha Trug + 2.24 ha Tokë Inproduktive**.

6. Subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1578, datë 24.09.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Zona e dytë Resulaj Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.137 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 13.7 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 2.5876 ha tokë arë. Rehabilitimi që duhet të kryhet nga subjekti sipas gërmimit faktik është **2.5876 ha**.

7. Me shkresën nr. 3696/2 prot., datë 15.05.2015, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1753, për aplikimin në QKL për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-1928-03-2015, datë 27.03.2015, dorëzuar nga **subjekti “B & AD Co” Shpk** për zonën minerare nr. 438/7, të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2014, për mineralin zhavor bituminoz, që bënë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet, për objektin “Selenicë”, Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “B & AD C” Shpk për shfrytëzimin e mineralit sipas lejes brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 8 dhe 9 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 351, datë 23.04.2015, është **17,225,000 lekë** ndërsa ajo vjetore është **908,000 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1753, prej 32.2 ha subjekti “B & AD C” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **7.9083 ha** (3.8637 kullotë + 4.0446 tokë e pa frytshme). Rehabilitimi që duhet të kryhet deri në këtë fazë nga subjekti “B & AD C” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **7.7274 ha Kullotë + 4.0446 tokë e Pafrytshme**.

8. Subjekti “M B” Shpk me Nipt K.....E i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1371, datë 22.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kume-Murriz Selenicë për llojin e mineralit bitum dhe zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.324 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 32.4 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 25.12 tokë e pafrytshme. Rehabilitimi që duhet të kryhet nga subjekti sipas gërmimit faktik është **25.12 ha**.

9. Me shkresën nr. 3460/1 prot., datë 02.07.2013, nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës është kryer akt-miratimi nr. 1644, për aplikimin në QKL për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-8249-02-2013, datë 26.02.2013, dorëzuar nga **Subjekti “A-I” Shpk** për zonën minerare nr. 748, të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2012 për mineralin zhavor bituminoz, që bënë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet, për objektin “Selenicë”, Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “A-I” Shpk për shfrytëzimin e mineralit sipas lejes brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 5, të Vendimit nr. 152, datë 05.04.2013, të Këshillit Teknik të AKBN-së parashikohet se vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit është **9,319,983 lekë**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1644, prej 36 ha subjekti “A-I” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **16.1647 ha kullotë**. Rehabilitimi që duhet të kryhet deri në këtë fazë nga subjekti “A-I” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **32.3294 ha kullotë**.

10. Me shkresën nr. 2491/2 prot., datë 18.03.2018, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 390/1, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes

me numër LC-5460-12-2017, datë 12.12.2017, dorëzuar nga **subjekti “Rr” Shpk** për shtyrjen e afatit të Lejes Minerare nr. 390, datë 22.01.1998, për mineralin zhavor bituminoz që bën pjesë në grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet, për objektin “J-M J”, Qarku Vlorë.

Kjo shtyrje afati i jepet subjektit “Rr” Shpk për shfrytëzimin e mineralit të përcaktuar në leje, brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 10 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit së paku vetëm 1 vit përpara mbaritmit të afatit të vlefshmërisë.

Në pikën 8 dhe 9 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për 5.42 ha miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 613, datë 01.02.2018, është **1,842,225 lekë** ndërsa ajo vjetore është **184,223 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 390/1, prej 9.9 ha subjekti “Rr” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 1.69 ha tokë arë por që i përketë privatëve në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

11. Me shkresën nr. 4765/4 prot., datë 14.10.2016, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 355/1, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-2284-05-2016, datë 23.05.2016, dorëzuar nga **subjekti “S B” Shpk** për shtyrje të afatit të lejes minerare nr. 355, datë 17.06.1997, për mineralin zhavor bituminoz dhe bitum, që bën pjesë në grupin e mineraleve metalore, jo metalore, qymyret dhe bitumet, për objektin “Selenicë” në vendburimin Selenicë, Qarku Vlorë.

Kjo shtyrje afati i jepet subjektit “S B” Shpk për shfrytëzimin e mineralit të përcaktuar në leje, brenda zonës së lejuar të shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 10 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit së paku vetëm 1 vit përpara mbaritmit të afatit të vlefshmërisë.

Në pikën 8 dhe 9 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit për sipërfaqen 13.2 ha që parashikohet të dëmtohet gjatë shtesës së afatit minerar, miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 483, datë 11.07.2016, është **7,919,594 lekë** ndërsa ajo vjetore është **791,960 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes prej 154.3 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 23.91 ha (13.7772 ha tokë arë + 10.128 ha kullotë + privatë). Rehabilitimi që duhet të kryhet nga subjekti sipas gërmimit faktik është **20.256 ha**.

12. Me shkresën nr. 3668/2 prot., datë 15.05.2015, nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë është kryer akt-miratimi nr. 1754, për aplikimin në QKB për Leje Minerare Shfrytëzimi sipas çështjes me numër LC-1834-03-2015, datë 25.03.2015, dorëzuar nga **subjekti “B G” Shpk** për zonën minerare nr. 438/8, të miratuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit 2014, për mineralin zhavor bituminoz & bitum, që bënë pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin “Selenicë” Qarku Vlorë. Kjo leje i jepet subjektit “B G” Shpk për shfrytëzimin e mineralit zhavor bituminoz & bitum brenda zonës së shfrytëzimit për një periudhë vlefshmërie 25 vjet me mundësi të zgjatjes së afatit vetëm një herë të afatit për 10 vjet.

Në pikën 8 dhe 9 të akt-miratimit parashikohet se, vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit (për të cilën nuk përcaktohet sipërfaqja) miratuar me Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN-së me nr. 350, datë 23.04.2015, është **14,727,000 lekë** ndërsa ajo vjetore është **736,000 lekë/vit**.

Referuar raportit mbi studimin tekniko-ekonomik për shfrytëzimin faktit të sipërfaqeve minerare të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të z. N B Kryetar i Bashkisë, konstatohet se nga sipërfaqja totale e lejes me nr. 1754, prej 25.1 ha subjekti “B G” Shpk ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **2.7 ha Kullotë**. Rehabilitimi që duhet të kryhet deri në këtë fazë nga subjekti “B G” Shpk sipas gërmimit faktik është sipërfaqja prej **5.4 ha Kullotë**.

13. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë, Romës Selenicë për llojin mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.638 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 163.8 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 1.6832 ha (1.4112 tokë e pafrytshme + 0.272 tokë arë + privatë). Rehabilitimi që duhet të kryhet nga subjekti sipas gërmimit faktik është **1.4112 ha**.

14. Subjekti “Xh K” Shpk me Nipt K.....D i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1115/1, datë 12.12.2007, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 1.09 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 109 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë 0 ha.

15. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/3, datë 26.11.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë-Romës Selenicë për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.171 km². Nga sipërfaqja totale e lejes prej 117.1 ha ka shfrytëzuar sipërfaqen faktike sipas tipologjisë **0 ha**.

16. Me shkresën nr. 134 prot., datë 16.01.2023, dhe shkresën nr. 134/1 prot., datë 16.01.2023, Bashkia Selenicë është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për rehabilitimin e sipërfaqeve të karrierave minerare për subjektin “T E” Shpk me Nipt J.....G me administrator z. A T i cili ka marrë leje shfrytëzimi sipas çështjes LC-0023-04.2017, për zonën minerare 70/11 për mineralin gërlqeror i mermerizuar që bën pjesë në grupin e mineraleve ndërtimore me lejen minerare nr. 1844, datë 13.09.2017, me sipërfaqe 0.127 km², me sipërfaqe 1 km² dhe me kërkesë për heqje nga fondi pyjor dhe kullosor 35.59 ha, por që aktualisht nuk ushtron aktivitet.

Me shkresën nr. 313/1 prot., datë 02.02.2023, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore i ka kthyer përgjigje Bashkisë Selenicë se me anë të shkresës me nr. 861 prot., datë 11.02.2022, se nga ana e institucionit është dërguar njoftimin për rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga aktiviteti mineralar për subjektin “T E” Shpk.

Të dhënat e detajuara për detyrimin e rehabilitimit sipas sipërfaqeve paraqiten në tabelën si më poshtë:

Nr.	Subjekti	Sipërfaqja totale sipas lejes minerare ha	Sipërfaqja ha sipas shfrytëzimit faktik	Sipërfaqja sipas tipologjisë				Detyrimi për Rehabilitimin që do të kryej subjekti sipas gërmimit faktik ha	Shënime
				Trung ha	Cung, Shkurre ha	Kullotë ha	Bimësi Pyjore ha		
1	Y S Shpk Leja nr. 1789	19.8	3.86 (Trung)	10.536	0	9.264	0	11.58	Nuk ka dal urdhëri për heqje nga fondi pyjor/kullosor
2	S M Shpk Leja nr. 1863	132.9	4.68 (Kullotë)	0	0	132.9	0	9.36	Nuk ka dal urdhëri për heqje nga fondi pyjor/kullosor
3	B S 22 Shpk Leja nr. 1943	24	0	5.65	0	18.35	0	0	Nuk ka dal urdhëri për heqje nga fondi pyjor/kullosor.
4	A Shpk Leja nr. 1792/1	26.8	4 (Trung)	15.69	0	11.11	0	12	Nuk ka dal urdhëri për heqje nga fondi pyjor/kullosor

5	M P Shpk Leja nr. 1826	99.7	2.82 (1.7 Trung + 1.12 tokë inproduktive)	99.7	0	0	0	5.1 trung + 2.24 inproduktive	Nuk ka dal urdhëri për heqje nga fondi pyjor/kullosor
7	B M I Shpk Leja nr. 1578	13.7	2.5876 (Tokë arë)	0	0	0	0	0	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
8	B & AD C Shpk Leja nr. 1753	32.2	7.9083 (3.8637 kullotë + 4.0446 tokë e pa frytshme)	0	0	0	0	7.7274 kullotë + 4.0446 tokë e pafrytshme	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
9	M B Shpk Leja nr. 1371	32.4	25.12 (Tokë e pa frytshme)	0	0	0	0	25.12	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
10	A I Shpk Leja nr. 1644	36	16.1647 (Kullotë)	0	0	0	0	32.3294	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
11	Rr Shpk Leja nr. 390/1	9.9	1.69 (Tokë arë me Ligjin nr. 7501, privatë)	0	0	0	0	0	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
12	S B Shpk Leja nr. 355/1	154.3	23.91 (13.7772 tokë arë + 10.128 kullotë)	0	0	0	0	20.256	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
13	B G Shpk Leja nr. 1754	25.1	2.7 (Kullotë)	0	0	0	0	5.4	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
14	B M I Shpk Leja nr. 1496/2	163.8	1.6832 (1.4112 tokë e pafrytshme + 0.272 tokë arë)	0	0	0	0	1.4112	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
15	Xh K Shpk Leja nr. 1115/1	109	0	0	0	0	0	0	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
16	B M I Shpk Leja nr. 1496/3	117.1	0	0	0	0	0	0	Nuk janë në inventarin e VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar
Totali		996.7	97.1238	131.576	0	171.624	0	136.5686	

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga Bashkia Selenicë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1612/2 prot., datë 04.09.2024, administruar në KLSH me praktikën nr. 619/6 prot., datë 09.09.2024, nga z. N B Kryetar i Bashkisë, z. B K Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- 1. Pretendimi i subjektit:** 1. Në kreun e VI-ët "Rekomandime", të pikës "A" Masa Organizative", ku në gjetjen nga ana juaj me nr. 22, që bën fjalë për ushtrimin e aktivitetit minerar, në fondin pyjor/kullosor, por jo vetëm, pronë e Bashkisë Selenicë, të 15 subjekteve të cilët janë pajisur me licensën përkatëse për kryerjen e këtij aktiviteti, ku në total në territorin e Bashkisë janë shfrytëzuar faktikisht nga të gjitha subjektet e mësipërme një sipërfaqe prej 97.1238 ha sipas tipologjive të ndryshme të nxjerra gjatë verifikimit në terren, që nga fillimi i aktivitetit minerar e deri më 20 mars të vitit 2024. Nga këto subjekte nuk janë marrë masat për zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit, për rehabilitimin e sipërfaqes prej 136.5686 ha, sipas koeficientëve të rehabilitimit për sipërfaqen e shfrytëzuar faktikisht.
2. Mbi bazën e kësaj gjetje keni lënë në Projektraport rekomandimin me nr. 22.1: Bashkia Selenicë të marrë masa të menjëhershme që, t'u kërkojë subjekteve që ushtrojnë aktivitet minerar, në fondin pyjor/kullosor, zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit për rehabilitimin e sipërfaqes sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës, në rakordim me sipërfaqet e shfrytëzueshme të karrierës.
3. E para, në territorin e Bashkisë Selenicë, nuk ka aktivitet vetëm në fondin pyjor/kullosor, siç përmendni ju në rekomandim, por edhe prona të tjera, me gjendje juridike tjetër, të cilat janë cituar në gjetjen tuaj, por flisni vetëm në fondin pyjor/kullosor dhe, e dyta Bashkia Selenicë, ka mendim ndryshe nga ana juaj

për të zbatuar këtë rekomandim, pasi nuk ka dalë asnjë akt-miratimi për heqje nga fondi pyjor/kullosor e prona të tjera ku ushtrohet ky aktivitet, pasi aktivitete të tilla hiqen e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të tokës, me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit.

4. Këtyre subjekteve përfituese, të pajisura me lejen e shfrytëzimit përkatëse nga Ministria respektive, Bashkia u ka miratuar në organin përfaqësues, të saj, që është Këshilli Bashkiak: a) Raportin tekniko-ekonomik të sipërfaqes karrierë dhe b) Dhënien e dakordësisë përkatëse për heqjen nga fondi pyjor/kullosor e ndryshimin e kategorisë së përdorimit, të sipërfaqes karrierë dhe ja ka nisur:

-Ministrisë përkatëse për të nxjerrë akt-miratimin për sipërfaqen deri 1 ha;

-VKM-të për sipërfaqet 1 deri 10 ha;

-Ligj të veçantë për sipërfaqet mbi 10 ha, në bazë të Ligjit nr. 57/2020, “Për Pyjet”, neni 5, pika 4.

Por, deri me sot nuk ka dalë asnjë akt-miratimi për heqje e ndryshim kategorie përdorimi, për asnjë subjekt e sipërfaqe karriere dhe asnjë kontratë me subjektet minerare, të cilat lidhen pas daljes së aktit të heqjes për rehabilitimin e sipërfaqes së shfrytëzuar faktikisht.

Oëndrimi i audituesve të KLSH-së: Ju shpreheni për “.....prona të tjera, me gjendje juridike tjetër”, por nuk thoni konkretisht, cilat janë saktësisht këto prona dhe gjendjen juridike të tyre. Nëse subjektet ushtrojnë veprimtari “pa miratim për heqje nga fondi pyjor/kullosor e prona të tjera” është përgjegjësia e Bashkisë Selenicë për lejimin e veprimtarisë në terrior pa asnjë akt-miratimi për heqje e ndryshim kategorie përdorimi, siç shpreheni më lart. Referuar nenit 27 “Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, citohet se:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi;

4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor;

5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi:

6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Ju shpreheni: “...e dyta Bashkia Selenicë, ka mendim ndryshe nga ana juaj për të zbatuar këtë rekomandim, pasi nuk ka dalë asnjë akt-miratimi për heqje nga fondi pyjor/kullosor e prona të tjera ku ushtrohet ky aktivitet, pasi aktivitete të tilla hiqen e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të tokës, me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit”.

Ne kemi audituar veprimtarinë e Bashkisë Selenicë (jo mendimet) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

2. Pretendimi i subjektit: Në Ligjin nr. 57/2020, “Për Pyjet”, neni 25, pika 5, thuhet: Subjektet që marrin në shfrytëzim/përdorim pjesë të fondit pyjor kombëtar, duhet të jenë të licencuara për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin përkatës, si dhe kanë detyrimin për të depozituar planin e rehabilitimit që do të zbatohet sipas planit/grafikut të shfrytëzimit të miratuar nga ministria përgjegjëse për aktivitetin në sipërfaqet respektive dhe rehabilitimin përfundimtar në mbyllje të aktivitetit në zonën përkatëse.

...dhe në pikën 6, Kriteret, kushtet, mënyra dhe realizimi i rehabilitimit bëhet bazuar në udhëzimin e ministrit në bashkërendim me ministritë përgjegjëse për aktivitetin e miratuar. Po ashtu dhe në ligjin minerar me nr. 10304, datë 15.7.2010, “Në Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në Nenin 37 “Detyrimi i rehabilitimit të zonës së lejes minerare”

Oëndrimi i audituesve të KLSH-së: Në përgjigjen Tuaj është thelbi i trajtimit të problematikave të trajtuar në materialin e grupit të auditimit të evidentuar në Projekt Raportin e Auditimit. Në Ligjin nr.

57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", të cilit Ju i referoheni drejtë, në pikat 2, 3 e 4 të neni 25, sanksionohet:

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki identifikojnë dhe shpallin listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. **Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona.** Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.

4. Çmimet dhe tarifat për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara.

Grupi i auditimit është shprehur në lidhje "**pronësinë mbi pronën**" ku shfrytëzohet "minerali/et". Sjellim në vëmendje të Bashkisë Selenicë përcaktimet e nenit 3 dhe nenit 4, pika 4, të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet që:

Neni 3 "Mineralet në trajtë natyrore, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në sipërfaqen nënujore, shtratit dhe nënshtratit të hapësirës detare shqiptare, përtej detit territorial, të përcaktuar sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, **i përkasin shtetit dhe janë prona publike.** Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri".

Neni 4, pika 4 "E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi".

Neni 3 dhe neni 4, pika 4, janë dy përkufizime të qarta. E drejta minerare është e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës. Bashkia Selenicë është autoriteti që ka të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen së tokës, por nuk ka hartuar marrëveshje dhe nuk ka zbatuar e planin e rehabilitimit me përfituesin e të drejtës minerare sipas legjislacionit në fuqi. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit: 1. Parimet bazë për hartimin e planit të rehabilitimit të mjedisit, të planit të veprimtarive të mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare, hartohen nga strukturat përgjegjëse, në këshillim me njësitë e qeverisjes vendore, duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit minerar e mjedisor në fuqi, dhe miratohen nga ministri.

2. Përveç sa parashikohet më sipër në këtë ligj, për çdo tip lejeje minerare, zotëruesi i lejes minerare ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë minerare dhe në përfundim të saj, të zbatojë planin e veprimtarive të mbylljes së objektit minerar, planin e rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, miratuar nga struktura përgjegjëse, së bashku me lejen minerare, si pjesë të kësaj lejeje.

3. Rehabilitimi i zonës së lejuar minerare kryhet nga vetë zotëruesi i lejes apo nga subjektet e kontraktuara nga ai dhe nën përgjegjësinë e zotëruesit, në mënyrë progresive dhe brenda afateve kohore të përcaktuara, sipas planit të veprimtarive të mbylljes së minierës e atij të rehabilitimit të mjedisit.

4. Kontrolli i zbatimit të planeve përkatëse të mbylljes së veprimtarisë minerare e të rehabilitimit të mjedisit kryhet nga struktura përgjegjëse, e cila, pas inspektimit, i raporton ministrit. Rehabilitimi vlerësohet i përfunduar vetëm pas miratimit nga ministri të raportit përfundimtar, të hartuar nga struktura përgjegjëse, për të cilin njoftohet me shkrim zotëruesi i lejes minerare. Pas këtij miratimi

zotëruesit të lejes minerare i rikthehet pjesa e garancisë financiare e pashpenzuar për realizimin e planit të veprimtarive të mbylljes së objektit mineral dhe të planit të rehabilitimit të mjedisit.

5. Në rastin kur zotëruesi i lejes minerare, që përfshin shfrytëzimin, braktis zonën e lejes minerare apo nuk përfundon zbatimin e plotë të planit të rehabilitimit, rehabilitimi kryhet nga subjekte të specializuara, të përzgjedhura nga struktura përgjegjëse, sipas procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpenzimet përballohen me fondet e garancisë financiare.

6. Nëse garancia financiare për zbatimin e planit të rehabilitimit, sipas pikës 5 të këtij neni, nuk është e mjaftueshme, zotëruesi i lejes minerare mbetet përgjegjës për vlerën e shpenzuar mbi fondin e garancisë së përdorur për rehabilitimin e plotë.

7. Mosrealizimi i planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes i heq të drejtën atij të përfitojë leje për një veprimtari tjetër minerare, për një periudhë 50-vjeçare, që llogaritet nga fundi i afatit të vlefshmërisë së lejes së parë dhe përbën shkak për revokimin e çdo lejeje tjetër të vlefshme të të minerare të shfrytëzimit, Bashkia nuk ka të drejtë t'u jap urdhër subjekteve për të rehabilituar zonën e shfrytëzuar, pa patur akt-marrëveshje me ta.

Prandaj, për këtë rekomandim adresojuni, në Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë (MIE), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), si del dhe nga referencat e dy ligjeve të cituara më lart.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Grupi i auditimit në zbatim të Programit të Auditimit nr. 619/1 prot., datë 09.05.2024, i ndryshuar me shkresën nr. 619/2 prot., datë 03.06.2024, ka audituar pikën nr. 3, me objekt "Organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e Pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) në Bashkinë Selenicë". Ju bëjmë me dije se grupi i auditimit është shprehur në lidhje me pronësinë mbi pronën, në territorin administrativ të Bashkisë Selenicë. Për sa trajtuar më sipër lidhur me rehabilitimin e mjedisit, veprimtaria e mbylljes së veprimtarisë minerare, të mënyrës së përcaktimit të zonës së rrezikshme të një të drejte minerare, të planit të menaxhimit të mbetjeve minerare, hartohen nga strukturat përgjegjëse, në këshillim me njësitë e qeverisjes vendore (si përshkruhet edhe nga ana juaj me të drejtë në pikën 1). Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

4. Pretendimi i subjektit: Në pikën "C", Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash.

1. Në gjetjen nr. 4, nga auditimi i praktikave të subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Selenicë, ku keni lënë rekomandimin me nr. 4.1: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave Bashkia Selenicë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojnë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjnë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pa zbritura nga fondi pyjor t'i drejtohet subjekteve me leje minerare të bëjnë kërkesë për zbritje nga fondi pyjor, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", i ndryshuar, për zbritjet nga fondi pyjor.

2. Edhe për këtë rekomandim, Bashkia Selenicë ka mendim ndryshe nga ana juaj, pasi DZHBAP/K, si strukturë përgjegjëse ka hartuar raportet teknike për çdo subjekt, që me paraqitjen e kërkesës së subjektit në Ministri për "aplikimin e kërkesës për heqje" dhe përcjelljen nga kjo Ministri strukturës përgjegjëse të Bashkisë për hartimin e Raporteve tekniko-ekonomike për çdo subjekt, ku nga verifikimet në terren e regjistrat kadastral, të ballafaquara me hartat përkthëse të treguesëve kadastral, të fondit pyjor e kullor, është evidentuar saktësimi i sipërfaqeve sipas tipologjisë me faktin e gjendjes në terren. Për çdo subjekt këtë korespondencë që kemi patur me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, po u'a nisim përsëri bashkëlidhur këtij kundërshtimi, në mënyrë narrative e të skanuar.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Grupi i auditimit është shprehur në lidhje me procedurën ligjore të heqjes së sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar, referuar nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", Bashkia Selenicë mundet të ketë mendime ndryshe, por është e detyruar të veprojë në përputhje me legjislacionin konkret për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

5. Pretendimi i subjektit: 2.1. Për heqjen nga fondi pyjor/kullor, janë këto dokumenta: Subjekti Y S

-Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 6771/3 prot., datë 22.11.2016, i dërgon bashkisë shkresën me lëndë: “Për hartim të raportit teknik”;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Selenicë datë 09.11.2016, (paguar vlera prej 422,244 lekë);

-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 30.11.2020, për heqje nga fondi pyjor/kullosor;

-Shkresa nr. 2411 prot., datë 13.10.2022, nisur Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me Lëndë: “Dakortësi për heqje nga fondi pyjor/kullosor, për kryerjen e aktivitetit minerar për Shoqërinë “Y S” Shpk”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Ju rikujtojmë që **subjekti “Y S” Shpk** i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1789, datë 14.01.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.198 km².

Sipërfaqja prej **(19.8 ha)** në bazë të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 5 “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4, përcaktohet që: Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha. Sa më sipër nuk kemi një ligj të veçantë për sipërfaqen 0.198 km².

Për më tepër, në raport tekniko- ekonomik me nr. 88 prot, datë 15.05.2018, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: z. P H (Inspektor Kontrolli), z. B K (Përgjegjës Sektori) e z. A V (Inspektor Zone), është cituar: “Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 19.80 ha, dhe shtrihet në:

-Ngastrën nr. 26, bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe 10.536 ha.

-Ngastrën nr. 13 bën pjesë në ekonomisë kullosore Gjorëm Vranisht me sipërfaqe 9.256 ha. Referuar regjistrit kadastral prona VL3300026, parcela nr. 26, përmban ilqe.

5.1. Pretendimi i subjektit: 2.2. Për heqjen nga fondi pyjor/kullosor, janë këto dokumenta për subjektin A

-Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 7458 prot., datë 14.08.2018, i dërgon bashkisë shkresën me lëndë: “Për përgatitje të raportit teknik”;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Selenicë me nr. 38 prot., datë 13.08.2019, (paguar vlera prej 340,350 lekë);

-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 47, datë 24.05.2019, për heqje nga fondi pyjor/kullosor;

-Urdhri i Kryetarit të Bashkisë me nr. 149, datë 05.11.2018, “Për vijimësi të procedurave”;

-Shkresa nr. 1604 prot, datë 24.06.2019, nisur Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me Lëndë: “Ju dërgojmë raportin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor/kullosor, për kryerjen e aktivitetit minerar për shoqërinë “A 2013” Shpk”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Ju rikujtojmë që **subjekti “A” Shpk** i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.268 km².

Sipërfaqja prej **(26.8 ha)** në bazë të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 5, “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4, përcaktohet që: Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Sa më sipër nuk kemi një ligj të veçantë për sipërfaqen 0.268 km².

Për më tepër, në raport tekniko- ekonomik me nr. 38 prot, datë 13.02.2019, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: z. Sh D (Inxhinier Pyjesh) z. P H (Inspektor Kontrolli) , është cituar: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 14.064 ha, dhe shtrihet në:

-Ngastrat nr. 19; 25; 26 bën pjesë në ekonomisë pyjore mali Bratit-Gumenicë me sipërfaqe dhe ngastrat /nëngastart 1; 14, të ekonomisë kullimore Gjorëm Vranisht.

Përshkrimi parcelor i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1; 2; 3;4; 5 të këtij raporti. Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje; sipas tabelave 1 dhe 2.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "A" Shpk, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve në **sipërfaqe totale 14.064 ha** (sipërfaqe që hiqet nga fondi pyjor **7.739 ha** e pakëson në volume **563.80 m³ drurë zjarri**), në ngastrat nr. 19 me 69.20 m³, ngastrën nr. 25 441.70 m³ dhe ngastrën nr. 26 52.90 m³, në ekonominë pyjore mali Bratit-Gumenicë dhe sipërfaqe që hiqen nga fondi kullor 6.325 ha në ekonominë kullimore Gjorëm Vranisht në ngastrën nr. 13 me 6.075 ha dhe në ngastrën nr. 14 me 0.25 ha.

Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "tungishte".

5.2. Pretendimi i subjektit: 2.3. Për heqjen nga fondi pyjor/kullor, janë këto dokumenta, për subjektin M P

-Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 4772/4 prot., datë 03.12.2018, i dërgon bashkisë shkresën me lëndë: "Për përgatitje të raportit teknik";

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Selenicë me nr. 37 prot., datë 13.02.2019, (nuk e ka paguar vlerën prej 2,314,400 lekë)

-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 24.05.2019, për heqje nga fondi pyjor/kullor;

-Urdhri i Kryetarit të Bashkisë me nr. 165, datë 13.12.2018, "Për vijimësi të procedurave";

-Shkresa nr. 1605 prot., datë 24.06.2019, nisur Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me Lëndë: Ju dërgojmë raportin tekniko ekonomik për heqje nga fondi pyjor/kullor, për kryerjen e aktivitetit minerar për Shoqërinë "M P" Shpk;

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së për pretendimet e paraqitura nga Bashkia Selenicë për pikat 5-5.2:

Ju rikujtojmë që subjekti "M P" Shpk i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1826, datë 12.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e minerarit organogjeno coprizor me sipërfaqe 0.997 km². Sipërfaqja prej (**99.7 ha**) në bazë të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", neni 5, "Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar", pika 4, përcaktohet që: Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Sa më sipër nuk kemi një ligj të veçantë për sipërfaqen 0.997 km².

Për më tepër, në raport tekniko- ekonomik me nr. 37 prot., datë 13.02.2019, të formuluar/nënshkruar nga Grupi i punës: z. Sh D (Inxhinier Pyjesh) z. P H (Inspektor Kontrolli), z. B K (Përgjegjës Sektori), është cituar: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullor rezulton se sipërfaqja e kërkuar është 55.48 ha, dhe shtrihet në; ngastrat/nëngastrat nr. 19; 25; 26; 28; 29;30, dhe bëjë pjesë në ekonomisë pyjore/kullimore mali Bratit-Gumenicë, dhe janë në pronësi/administrim të bashkisë Selenicë. Përshkrimi parcelor i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1; 2; 3;4; 5 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje; (nuk ka ndryshime)

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria "M P" Shpk, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve (në sipërfaqe prej 55.584 pakësohet në volume **3,700.40 m³**), në ngastrat nr. 19;25; 26; 28; 29; 30; 30/1, ekonominë pyjore mali Bratit-Gumenicë.

Në raport (përveç tabelës bashkangjitur raportit ku përmbajtja e ngastrës 26 -përbërja e grumbullit është cilësuar "e thjeshtë"), nuk është përmendur statusi i veçantë i llojit të bimësisë, pasi është konsideruar si dru zjarri "trungishte".

Për të tre subjektet e sipërcituara ju rikujtojmë që:

Pika 5 e nenit 15 “Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet” e Ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” sanksionon: “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor. **Në këto raste leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.**”

Pika 10 e nenit 24 “Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore” e Ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” sanksionon: “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullor. **Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.**”

Pika 54 e nenit 3 të Ligjit nr. 57/20, datë 30.04.2020, “Për pyjet” që: “Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)” është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, **rajonat dhe vendor**, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe, volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve”. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

6. Pretendimi i subjektit: 2.4. Për heqjen nga fondi pyjor/kullor, janë këto dokumenta, për subjektin B S

-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 1397/3 prot., datë 17.05.2023, i dërgon bashkisë shkresën me lëndë: Për përgatitje të raportit teknik;

-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 23, datë 20.03.2023, për shprehjen e dakortësisë për heqjen nga fondi kullor”;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Selenicë me nr. 725/1 prot, datë 23.03.2023, (nuk ka paguar);

-Urdhri i Kryetarit të Bashkisë me nr. 36, datë 06.03.2023 “Për vijimësi të procedurave”;

-Shkresa nr. 599/1prot., datë 24.04.2023, nisur Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me Lëndë: Dokumentacion për subjektin “B S” Shpk, për heqje nga fondi kullor të sipërfaqes prej 9.87 ha.

Oëndrimi i audituesve të KLSH-së: Ju rikujtojmë që **subjekti “B S” Shpk** i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1943, datë 17.02.2023, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.240 km². Sipërfaqja prej **(24 ha)** në bazë të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 5, “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4, përcaktohet që: Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;

c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Sa më sipër nuk kemi një ligj të veçantë për sipërfaqen 0.240 km².

6.1. Pretendimi i subjektit: 2.5. Për heqjen nga fondi pyjor/kullor, janë këto dokumenta, për subjektin S M

-Kërkesë Ministrisë së Mjedisit datë 19.12.2019 për heqje nga fondi pyjor.

-Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 99, datë 21.12.2018, për miratimin e kontratës së qirasë për subjektin S M Shpk;

-Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes në pronësi publike të Bashkisë Selenicë me nr. 3313 prot., datë 19.12.2018, (nuk ka paguar).

-Urdhri i Kryetarit të Bashkisë me nr. 145, datë 13.12.2018, “Për vijimësi të procedurave”.

Këtë material po u a dërgojmë dhe në formën tabelare të skanuar.

3. Këto Raporte tekniko-ekonomike, janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është marrë dakordësia nga Këshilli për heqje dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit, për të gjitha subjektet dhe të gjitha

praktikat janë nisur Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për kompetencë, ku kjo Ministri nuk ka kthyer asnjë përgjigje për heqje dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit, në sipërfaqet karrierë të përshkuara më lartë. Prandaj pa dal akti i miratimit të “heqjes nga fondi i tokave pronë e Bashkisë”, nuk mund të bëjmë ndryshimet në kadastrën pyjore/kullosore e në toka të tjera pronë e Bashkisë, se nuk na i miraton Institucioni i ASHK DV Vlorë.

4. Për Rekomandimin 4.2, Cilësimi juaj: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave, në bashkëpunim me Drejtorinë juridike Bashkia Selenicë, të vendosin marrëdhënie kontraktuale me subjektet shfrytëzuese të sipërfaqeve pyjore, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 761,8728 ha dhe aplikuar tarifatat dysHEME minimale për të llogaritur vlerat e qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit për vlerën 52,032,890.70 lekë, për të gjithë subjektet.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Ju rikujtojmë që subjekti “S M” Shpk i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1863, datë 17.07.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e minerarit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 1.329 km². Sipërfaqja prej (132.9 ha) në bazë të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 5, “Kufijtë dhe ndryshimet në fondin pyjor kombëtar”, pika 4, përcaktohet që: Ndryshime (heqje/shtesa) të sipërfaqeve nga/në fondin pyjor kombëtar bëhen me:

- a) miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha;
- b) vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha deri në 10 ha;
- c) ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 10 ha.

Sa më sipër nuk kemi një ligj të veçantë për sipërfaqen 1.329 km².

Në të gjitha rastete e sipërcituara në zbatim të Ligji 15/2012 “Për një ndryshim dhe shtesa në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, do të trajtohet më poshtë, Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë për pikat 6-6.1.**

7. Pretendimi i subjektit: Mendimi i kundërt nga ana jonë:

4.1. Në territorin e Bashkisë, të gjitha subjektet e pajisura me leje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kanë për aktivitet “nxjerrje, prodhim dhe depozitim material inerte në karrierë”, ndërsa në VKM-në nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, në shtojcën nr. 1, tarifatat për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond, pika 9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektesh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe. Kjo tarifë referencë, nuk është e njëjta gjë me objektin e licensës së subjekteve minerare: “nxjerrje, prodhim dhe depozitim material inerte në karrierë”, sipas mendimit tonë, pasi tjetër gjë është të gërmosh në sipërfaqe, sipas lejes së shfrytëzimit të dhënë e tjetër gjë është pika 9 që përcakton tarifën e përmëndur më lartë. Të gërmosh në sipërfaqe karrierë, do të thotë të shfrytëzosh e të pajisesh me lejen përkatëse të shfrytëzimit, ashtu si janë pajisur subjektet për të cilat flasim dhe nuk kemi lidhur kontratë përdorimi, pasi duhet të hiqen nga fondi pyjor/kullosor. Dhe të kërkosh për zbulimin e vendburimeve gjeologjike e minerare, pajisesh me lejen e kërkim zbulimit, sipas pikës 9, shtojca nr. 1, dhe tarifohesh sipas sipërfaqes dhe përdorimit të territorit, me kontratë përdorimi.

4.2. Prandaj, në korespondencat që kemi patur me Ministrinë e Turizmit dhe mjedisit (MTM), për zbatimin e rekomandimeve të lëna në vite nga KLSH-ja, kemi këtë përgjigje të cilën po ua vendosim në dispozicion narrativisht dhe bashkëlidhur këtij materiali. Në shkresën me nr. 2946 prot., datë 19.12.2022, Bashkia Selenicë i drejtohet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MIE) me lëndë: “kërkojmë interpretim ligjor mbi procedurën e vlerësimit të sipërfaqeve pyjore/kullosore dhe të tarifave që aplikohen për heqjet nga ky fond, për lejet e shfrytëzimit minerar”.

Në shkresën me nr. 183 prot., datë 10.01.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MIE), na kthen përgjigjen me lëndë: përgjigje kërkesës për interpretim ligjor mbi procedurën e vlerësimit të sipërfaqeve pyjore/kullosore dhe të tarifave që aplikohen për heqjet nga ky fond, për lejet e shfrytëzimit minerar.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Po ju risqarojmë përsëri që në zbatim të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, në pikat 2 e 3 të neni 25, sanksionohet:

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki identifikojnë dhe shpallin listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. **Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona.** Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton tjetër zhvillim për sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar, objekt kontrate. Rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për këto veprimtari caktohen me udhëzim të ministrit.

Dhe në pikën 4 të nenit 4 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", sanksionohet:

4. Çmimet dhe tarifat për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me VKM, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtari që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara.

Në rastin e VKM nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", (para kësaj kohe përcaktoheshin nga VKM nr. 391, datë 21.6.2006, VKM nr .1064, datë 22.12.2010).

1. Miratimin e çmimeve dhe tarifave për veprimtari që zhvillohen në Fondin Pyjor Kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

4. Tarifat për sipërfaqet, që shfrytëzohen për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar, përcaktohen duke marrë në konsideratë: a) investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), si dhe ato gjatë periudhës së rritjes, në sipërfaqen që hiqet nga Fondi Pyjor Kombëtar; b) shpenzimet e kryera për mbrojtjen e tokës, për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe produktiv; c) shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse; ç) vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (lënda drusore, flora spontane, fauna e egër, kullota etj.), si produkt i humbur; d) investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga Fondi Pyjor Kombëtar.

7. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, **njësitë e vetëqeverisjes vendore** dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve për zbatimin e këtij vendimi. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

8. Pretendimi i subjektit: Së pari: Legjislacioni në fuqi për pyjet dhe kullotat dhe ai i aplikueshëm nga ana juaj (jonë) për rastet e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor për lejet e shfrytëzimit minerar, brenda territorit të Bashkisë Selenicë, ka të parashikuar rastet e dhënies në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor publik si dhe tarifat përkatëse të aplikueshme sipas rasteve të shfrytëzim/përdorimit.

Bashkitë janë ndër institucionet që ngarkohen për zbatimin e legjislacionit të aplikueshëm në fushën e pyjeve dhe kullotave dhe, referuar Vendimit nr. 13, datë 06.03.2014, të Gjykatës Kushtetuese, bashkitë kanë të drejtën e interpretimit të tij dhe kërkesa Juaj (jonë) për interpretim, nuk përbën detyrim ligjor nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM).

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Argumentet e paraqitura nga Ju, në lidhje me pretendimin e pikës 8, janë në thelb të njëjta me ato të pikave të sipërpërmendura në lidhje me pronësinë dhe përgjegjësinë ligjore të Bashkisë Selenicë për sa i përket veprimtarisë në territorin administrativ. Për këtë pretendim grupi i auditimit ka evidentuar dispozitat ligjore përkatëse trajtuar përgjatë observacionit. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

9. Pretendimi i subjektit: Së dyti: Ju bëjmë me dije se, në rastet e përdorimit të fondit pyjor për ushtrimin e veprimtarive minerare, legjislacioni i zbatueshëm në fushën e pyjeve është si vijon:

Ligji 15/2012 "Për një ndryshim dhe shtesa në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, ku neni 17 i Ligjit nr. 9385/2005, parashikon që "Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në

truall, për veprimtari minerare gjeologjike, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri 100 ha, me Vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë”

Për sa vijon, ligji i sipërcituar i aplikueshëm, parashikon vetëm heqjen nga fondi pyjor për veprimtari minerare dhe jo dhënien në përdorim me kontratë qiraje të këtij fondi.

Për rastet e heqjes nga fondi pyjor, për raportet teknike të hartuara para miratimit të VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondi pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, duhet të aplikohen tarifatat sipas VKM-së nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.06.2006, të Këshillit të Ministrave” Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, lidhja 4 e tij, përfundon shkresa e Ministrisë.

4.3. Në shkresën me nr. 258/8 prot., datë 08.02.2023, me lëndë: “refuzim për lejet e shfrytëzimit minerar”, Bashkia Selenicë i'u drejtua AKBN-së për rekomandimin e KLSH-së. Në shkresën me nr. 1083/1 prot., datë 15.03.2023, me lëndë: “kthim përgjigje”.

E para, AKBN-ja na dërgon statusin e zonave minerare, në formë tabelare, së bashku me sqarimet përkatëse, si i vetmi regjistër i lejeve minerare, me të cilin operon Drejtoria Minerare pranë AKBN-së, që do ta keni pjesë të këtij informacioni bashkëlidhur.

E dyta, në lidhje me bllokimin e veprimtarisë minerare, AKBN-ja vepron në bazë të Ligjit Minerar nr. 10304, datë 15.07.2010, i ndryshuar “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe pezullimi i lejeve minerare bazohet në shkeljet e përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji, ku problematikat me fondin pyjor/kullosor, nuk përbëjnë një arsye për pezullimin e lejeve minerare. Heqja e sipërfaqeve të lejeve minerare nga fondi pyjor/kullosor nuk është objekt i punës së AKBN-së.

Oëndrimi i audituesve të KLSH-së: Asnjë nga sipërfaqet e trajtuara nga grupi i auditimit nuk është deri në 1 ha, sa më sipër mungojnë VKM (për sipërfaqet mbi 1 ha e deri 100 ha) dhe ligj të veçantë (për sipërfaqe mbi 100 ha).

Në nenin 37 të Ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” përcakton që: “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit”, proces i cili duhet të përfundonte në Nëntor të vitit 2021, ky proces nuk ka përfunduar deri më sot në Bashkinë Selenicë.

Referuar nenit 27 “Funkcionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, citohet se: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

1. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirë-mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

2. Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

3. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi;

4. Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor;

5. Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi;

6. Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 5 të Ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, citohet:

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki identifikojnë dhe shpallin listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

3. Dhënia në shfrytëzim/përdorim e pjesëve të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë të kontratave të nënshkruara nga kryetari i bashkisë/organi përgjegjës për zonat e mbrojtura kur përfshihet në këto zona.

4. Çmimet dhe tarifat për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, miratohen me VKM, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për pyjet dhe ministrit përgjegjës për financat. Pronarët privatë, për veprimtaritë që zhvillohen në fondin pyjor në pronësi të tyre, kanë të drejtë të përdorin çmime dhe tarifa të vendosura në marrëveshje me subjektet e interesuara.

Grupi i auditimit është shprehur në lidhje “pronësinë mbi pronën” ku shfrytëzohet “minerali/et”. Sjellim në vëmendje të Bashkisë Selenicë përcaktimet e nenit 3 dhe nenit 4, pika 4, të Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet që:

Neni 3 “Mineralet në trajtë natyrore, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në sipërfaqen nënujore, shtratit dhe nënshtratit të hapësirës detare shqiptare, përtej detit territorial, të përcaktuar sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, i përkasin shtetit dhe janë prona publike. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, shteti, për efekt të zbatimit të këtij ligji, përfaqësohet nga ministri”.

Neni 4, pika 4 “E drejta minerare është një e drejtë e dallueshme dhe e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës, ku ato gjenden. Marrëdhëniet e subjektit përfitues të së drejtës minerare dhe titullarit të së drejtës së pronësisë mbi pronën, ku gjenden minerale, rregullohen me marrëveshje, sipas legjislacionit në fuqi”.

Neni 3 dhe neni 4, pika 4, janë dy përkufizime të qarta. E drejta minerare është e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës. Bashkia Selenicë është autoriteti që ka të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen së tokës, por nuk ka hartuar marrëveshje dhe nuk ka zbatuar e planin e rehabilitimit me përfituesin e të drejtës minerare sipas legjislacionit në fuqi. Për sa trajtuar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

(Pasi më sipër u trajtuat VKM nr. 559, datë 29.7.2022) VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, përcakton tarifat dysheme për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik për ushtrimin e veprimtarive në pikën 6 “Për nxjerrje, prodhim dhe depozitim materialesh inerte, direkt nga sipërfaqja (karrierë)” dhe pikën 9 “Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe”. Në asnjë pikë të saj, nuk përjashtohet asnjë veprimtari minerare të ushtruar në territorin e Bashkisë Selenicë nga subjektet e trajtuara nga grupi i auditimit. Ju duhej të përlllogarisnit vlerën e qirasë sipas përcaktimit të sipërcituar.

Pika 5 e nenit 15 “Leja e shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet” e Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” sanksionon: “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare, në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.”

Pika 10 e nenit 24 “Leja e shfrytëzimit me karrierë të grupit të mineraleve ndërtimore” e Ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” sanksionon: “Me miratimin e lejes minerare të shfrytëzimit të grupit të mineraleve ndërtimore, zona e lejuar e shfrytëzimit hiqet nga fondi pyjor e kullosor, pronë shtetërore, dhe kalon si pasuri minerare në varësi të ministrisë së linjës, sipas legjislacionit në fuqi për ndryshimin e zërit kadastral të fondit pyjor e kullosor. Në këto raste, leja hyn në fuqi për zbatimin e detyrimeve të saj në datën e ndryshimit të zërit kadastral.

Pika 54 e nenit 3 të Ligjit nr. 57/20, datë 30.04.2020, “Për pyjet” që: “Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor (RKFP)” është regjistri zyrtar i të dhënave kadastrale të fondit pyjor kombëtar, i organizuar në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në të cilin regjistrohen të gjitha informacionet bazë dhe ndryshimet periodike të ndodhura në pronësinë, të drejtat reale, pozicionin hartografik, sipërfaqe,

volum etj., shoqëruar me sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i nevojshëm për administrimin dhe planifikimin e pyjeve.”

Në të gjithë aktivitetin minerar në Bashkinë Selenicë ndër vite nuk është zbatuar baza ligjore përkarësë. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

10. Pretendimi i subjektit: 4.4. Në shkresën me nr .423/4 prot., datë 10.05.2024, me lëndë “Njoftim për ushtrim kontrolli”, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, nëpërmjet Drejtorisë së Menaxhimit dhe Kontrollit, ushtroi kontroll, midis të tjerave dhe “Kontrollin e kontratave të përdorimit të fondit pyjor në Bashkinë Selenicë”. Në përfundim të kontrollit pasi u vumë në dispozicion kontratat e lidhura me subjektet karrierë, që operojnë në territorin tonë, për të cilat jeni njohur dhe ju (për kontratat e shfrytëzimit faktik të lidhura me subjektet në muajin prill 2024), në Akt Konstatimin nr.1, datë 20.05.2024, Kreu i III-të” Kontrata të lidhura nga Bashkia Selenicë”, pika 10 “Për subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare, karriera guri në territorin e Bashkisë Selenicë, nga ana e bashkisë këto kontrata janë lidhur në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi, pasi jepet me qira përdorimi një sipërfaqe që shfrytëzohet me leje minerare shfrytëzimi, ku si Bashkia Selenicë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk duhej të lejonin fillimin e punimeve pa u kryer heqja e sipërfaqes së shfrytëzimit nga fondi pyjor, sipas procedurave të legjislacionit në fushën e pyjeve, si dhe parashikohet në pikën 5 të nenit 15, të Ligjit nr. 10304, datë 10.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Prandaj ne si Bashki, në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, për vitin 2023, realizuam verifikimin në terren për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Bashkisë, për shfrytëzimin faktik të tokës së pajisur me lejen përkatëse të shfrytëzimit, që nga fillimi i punimeve në karrierë deri në 20 mars të vitit 2024. Për këto sipërfaqe, me të cilat jeni njohur dhe ju në këtë kontroll, kemi lidhur kontratat e para dhe jemi në proces lidhje me disa subjekte, që po refuzojnë të lidhin, për shkak të qëndrimit të dyzuar që kemi ne si Bashki dhe nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si organ politikbërës, në fushën e Pyje/Kullotave, ashtu dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që përfaqëson qeverinë në politikbërjen e Sektorit minerar në Republikën e Shqipërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Rekomandimet e KLSH-së i janë referuar bazës ligjore për veprimtarinë minerare në RSH. Legjislacioni i sipërcituar nuk është zbatuar nga Bashkia Selenicë. Për sa trajtuar më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. **N B** Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën 20.06.2023, deri më 31.12.2023, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, z. **P B** ish-Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 19.06.2023, z. **B K** me detyrë Drejtorisë i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave, z. **E F** Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave dhe z. **L H** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit.
(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 4, datë 14.06.2024)

2.4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

2.4.1. Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Selenicë administruar në KLSH me nr. 766/19 prot., datë 21.12.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 1964/52 prot., datë 26.12.2023, ku janë lënë për zbatim **28 masa** organizative, **11 masa** për shpërblim dëmi në vlerën **8,114,599 lekë**, **5 masa** për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efience dhe efektivitet të

tyre janë rekomanduar në vlerën **198,694,475 lekë, 9 masa** për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administratimin e të ardhurave të munguara në vlerën **110,050,961 lekë, 6 masa** për uljen e borxhit tatimor në vlerën **434,649,309 lekë, 9 masa** disiplinore dhe **3 masa** administrative.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 28 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, 5 masa janë në proces zbatimi dhe 22 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 11 masa në vlerën 8,114,599 lekë të cila është janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht (ku është arkëtuar vlera 609,640 lekë) dhe 10 masa janë të pa zbatuara.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre janë rekomanduar 5 masa në vlerën 198,694,475 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë të pa zbatuara.

d. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 9 masa në vlerën 110,050,961 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 9 masa janë të pa zbatuara.

e. Për uljen e borxhit tatimor janë rekomanduar 6 masa në vlerën 434,649,309 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 6 masa janë të pa zbatuara.

f. Masa disiplinore janë rekomanduar 9 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 6 masa zbatuar plotësisht, 3 masa janë të pa zbatuara.

g. Masa administrative janë rekomanduar 3 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë të pa zbatuara.

-Gjithashtu nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 20.06.2023, deri më 31.12.2023, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, z. P B ish-Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 19.06.2023.

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Selenicë janë marrë masat e duhura për raportimin në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 114 prot., datë 12.01.2024, duke respektuar kështu edhe afatin 20 ditor në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, ku përcaktohet që: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhënave”.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Selenicë administruar në KLSH me nr. 766/19 prot., datë 21.12.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 1964/52 prot., datë 26.12.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- 28** masa organizative;
- 11** masa për shpërblim dëmi në vlerën **8,114,559 lekë**;
- 5** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën **198,694,475 lekë**;
- 9** masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në vlerën **110,050,961 lekë**;
- 6** masa për uljen e borxhit tatimorë në vlerën **434,649,309 lekë**;
- 9** masa disiplinore;
- 3** masa administrative;

IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Selenicë të Kryetarit të Bashkisë z. N B me nr. 114 prot., datë 12.01.2024, është ngritur komisioni për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të KLSH. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	28	28	0
Masa për shpërblim dëmi	11 8,114,599 lekë	11 8,114,599 lekë	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	5 198,694,475 lekë	5 198,694,475 lekë	0
Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara	9 110,050,961 lekë	9 110,050,961 lekë	0
Masa për uljen e borxhit tatimor	6 434,649,309 lekë	6 434,649,309 lekë	0
Masa disiplinore	9	9	0
Masa administrative	3	3	0
Totali	71	71	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Selenicë:

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	28	0	1	5	22
Masa për shpërblim dëmi	11 8,114,599 lekë	0	1 609,640	0	10
Masa për eliminimin e efekteve negative	5 198,694,475 lekë	0	0	0	5
Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara	9 110,050,961 lekë	0	0	0	9
Masa për uljen e borxhit tatimor	6 434,649,309 lekë	0	0	0	6
Masa disiplinore	9	6	0	0	3
Masa administrative	3	0	0	0	3
Totali	71	6	2	5	58
Totali në %	100%	8.45%	2.81%	7.04%	81.69%

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa për miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartojë rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

1.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë masa për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të bashkisë, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 1.1, nr. 1.2, dhe nr. 1.3, nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa për:

-Planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë të vlerësimit të riskut, dhe të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Plotësimin e dosjeve sipas Manualit të AB, duke plotësuar dokumentet si “planifikim angazhimi për auditim”, “letrat e punës” si dhe “vlerësimin e brendshëm të cilësisë”.

-Të rrisin cilësinë e punës audituese pasi natyra e gjetjeve dhe rekomandimeve ishte sipërfaqësore dhe nuk thellohej në çështjet objekt auditimi, si dhe të planifikojë auditimin në fushat me risk të lartë, si procedurat e prokurimit publik, për të siguruar informacionin e nevojshëm për titullarin e njësisë vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Zbatimi i këtij rekomandimi mbetet për t’u verifikuar në auditimet në vij që do të kryen nga KSLH.

Rekomandimi është në proces zbatimi.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare..., gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Planifikimi i shpenzimeve që mbulohet nga të ardhurat e veta të bëhet mbi baza reale të të ardhurave të grumbulluara në vitin ushtrimorë të mbyllur dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve buxhetore, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Për vitin 2023 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën 783,099,827 lekë dhe realizuar në vlerën 649,625,519 lekë në masën 83% ose me një mos realizim në vlerën 133,474,308 lekë. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mos realizimit të artikujve si më poshtë:

-Artikulli 600 “Shpenzime për paga” janë realizuar në vlerën 160,703,615 lekë nga 170,923,514 lekë të planifikuara ose në masën 94%.

-Artikulli 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është planifikuar në vlerën 33,106,190 lekë dhe realizuar në vlerën 28,175,188 lekë ose në masën 85%.

-Artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” + Fondi Rezervë është planifikuar në vlerën 157,888,566 lekë dhe realizuar në vlerën 89,537,824 lekë ose në masën 57%.

-Artikulli 230-231 “Investime” është planifikuar në vlerën 262,520,016 lekë dhe realizuar në vlerën 215,142,219 lekë ose në masën 82%.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare... në bashkëpunim me Drejtoritë/ Sektorët e tjerë Bashkia Selenicë, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të planifikojë fonde për investime në raport me nivelin e të ardhurave të realizuara për vitin dhe grandeve të planifikuara nga qeveris. -Të eliminohet praktika e financimeve të investimeve me afate 2 dhe 3 vjeçare, si praktikë e pabazuar në dispozitat ligjore, pasi nuk janë investime të reja dhe me kontrata shumëvjeçare.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare... në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në çdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjore, duke mos lejuar gjendje në fund të vitit ushtrimore të vlerave monetare të papërdorura.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 4.1, dhe 4.2, nuk është zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave në bashkëpunim me drejtoritë/ sektorët e tjerë të bashkisë që merren me menaxhimin e të ardhurave, të marrin masa për të bërë një analizë të saktë të të gjitha detyrimeve që vijnë nga taksat/tarifat vendore, duke mos harruar dhe borxhin tatimorë në planifikim, në mënyrë që ky planifikim të bëhet mbi baza reale dhe në raport me mundësitë ekonomike të kësaj njësie vendore.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për kryerjen e rakordimeve mujore me Agjentët Tatimorë (për taksën e mjeteve të përdorura, rentën minerale, taksën e kalimit të pronësisë, taksën e tatimit mbi të ardhurat), për të evidentuar sa është vlera që këto agjente arkëtojnë dhe nëse ajo derdhet e gjitha në llogari të bashkisë, si dhe për të bërë një analizë të tyre, duke evidentuar numrin e mjeteve që operojnë në këtë njësi administrative, volumin e të ardhurave që subjektet minerale realizojnë në një vit ushtrimorë për llogaritjen e rentës dhe transaksionet mujore/vjetore të shitblerjes së pasurive për llogaritjen e rentës dhe transaksionet mujore/vjetore të shitblerjes së pasurive.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Mos realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore në total dhe strukturë është në masën 85% pasi nga 114,592,854 lekë të ardhura të planifikuara janë realizuar vetëm 97,651,182 lekë ose me një mos realizim në vlerën 16,941,672 lekë Gjithashtu për vitin 2023 nga Bashkia Selenicë nuk janë mbajtur akt-rakordimeve mujore me Agjentët Tatimorë (trajtuar më hollësisht në aktin nr. 2, datë 14.06.2024).

Rekomandimi nr. 5.1, dhe 5.2, nuk është zbatuar.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të marrë masa për çeljen e regjistrimit të riskut për menaxhimin e të ardhurave vendore, bazuar në analize të gjithë procesit dhe veprimtarisë menaxheriale të Drejtorisë së të Ardhurave.

Te përcaktohet në regjistër punonjësi që do të ndjek vijueshmërinë e riskut, hapat e raportimit për progresin dhe trajtimin e secilit risk.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është kontaktuar edhe në vitin 2023, pra mungon regjistri i riskut për menaxhimin e të ardhurave vendore të cilat ndikojnë në mosrealizimin e të ardhurave.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Selenicë dhe ASHK Dega Rajonale Vlorë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës/truall).

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të marrë masa për të krijuar bazën e të dhënave për subjektet fizik/juridike dhe abonentët familjarë, të cilat mbledhen nëpërmjet Agjentëve Tatimor, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse, duke bërë çdo muaj rakordimet sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

8.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave/tarifave të vjela nga Agjentët Tatimor, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura të cilat gjenerohen nëpërmjet Agjentëve Tatimor (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023, konkretisht nga Drejtoria e të Ardhurave, Liçesave dhe Lejeve nuk është krijuar baza e të dhënave për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë të cilat mbledhen nëpërmjet Agjentëve Tatimorë.

Rekomandimi nr. 8.1, dhe nr. 8.2, nuk është zbatuar.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të hartojë dhe miratojë te Kryetari i Bashkisë gjurmën e auditimit nga fillimi deri në fund që është planifikimi, faturimi, përshkrimi i masave shtrënguese dhe rakordimi apo ndjekja e të ardhurave deri sa ato të futen në llogarinë e Bashkisë.

-Të përfshihen në Gjurmën e Auditimit të gjitha strukturat përkatëse të ngarkuara të përcaktohen kush e kryen veprimin dhe çfarë bën në gjithë procesin menaxherial. Mbledhja e të ardhurave vendore me procedure normale duke filluar nga vetdeklarimit nga taksa pagesit, vlerësimi tatimor, njoftimi i detyrimit, fatura për arkëtim dhe rakordimi kontabël. Komunikimi me agjentin tatimor, komunikimi me taksapaguesit, ankimimi i taksapaguesve. Marrëveshja e pagesës me

këste, monitorimi për shlyerjen e detyrimeve, dërgimi i çështjes për fillimin e procedurës së mbledhjes me masa shtrënguese.

-Të plotësohen dosjet e subjekteve me dokumentacionin e nevojshëm ligjorë që shërben për planifikimin e saktë të detyrimeve fiskale, duke evidentuar të gjitha hapat nga regjistrimi deri në arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi nuk është zbatuar.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Policisë Bashkiake dhe punonjësit e kësaj strukture, të marrin masa në çdo rast për vendosjen e penalteteve për shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimin të detyrës funksionale që ata kryejnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Rekomandimi nuk është zbatuar.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll, Bashkia Selenicë, të marrë masa për:

-Kontabilizimin e vlerës prej 17,987,270 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore viti 2022 dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën **180,033,022 lekë.**

-Të analizojë vlerën e llogarisë 423-,429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba (debitor)*”, e pasqyruar në bilanc për vlerën 70,005,368 lekë, mbështetur në dokumentacionin kontabël që disponon për të cilat është kryer regjistrimi në kontabilitet.

-Të paraqesë saktë vlerat e llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*”, ku në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 75,928,024 lekë, e cila dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*”, sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

-Të analizojë vlerën 8,226,780 lekë nëpërmjet dokumentacionit kontabël, në shtesat e llogarisë 213 “*Rrugë rrjete dhe vepra ujore*” dhe llogarisë 231 “*Investimeve në proces*”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023, është kostatuar se nuk janë marrë masat e duhura për kontabilizimin e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore konkretisht vlerën 219,268,974 lekë. Si dhe problematikat e konstatuara për llogaritë 423,429 “*Personeli, paradhënie, deficite gjoba (debitor)*”, 4342 “*Të tjera operacione me shtetin (të drejta)*” janë edhe për vitin 2023. Ndërsa për llogaritë 213 “*Rrugë rrjete dhe vepra ujore*” dhe 231 “*Investimeve në proces*” shtesat e kryera përgjatë vitit 2023 janë të analizuara sipas objekteve përkatëse.*

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokoll, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë

regjistrin analitik te aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për vitin e hyrjes, vendodhje, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, për të pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

12.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Vlorë të llogarive 210 “*Toka, troje Terrene*” 212 “*Ndërtesa konstruksione*” dhe 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, me kosto historike në vlerën 3,247,263,717 lekë, dhe nëpërmjet Drejtorisë dhe Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në akt-konstatimin nr. 3, datë 14.06.2024.

Rekomandimi nr. 12.1, dhe nr. 12.2, nuk është zbatuar.

13.1. Rekomandimi: Drejtorisë dhe Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim, Kontroll Territorit (*Spektori i Menaxhimit të Kontratave*), Bashkia Selenicë, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (*vlera 21,403,554 lekë*), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Vlorë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023, për 43 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,800,834 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Vlorë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat e menjëhershme për të kryer procesin e plotë të inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave, si vijon:

-Në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për ngritjen e Strukturës së Menaxhimit të Pronave, për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia të transferuara me VKM, duke përcaktuar detyra konkrete dhe me përgjegjësi në Rregulloren e Brendshme të bashkisë për miradministrimin e pronave për verifikim fizik të tyre dhe ndjekjen e procedurave për regjistrim.

-Të iniciojë në komunikimin me ASHK-në Drejtorisë Vlorë, me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre të plotë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.

-Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

14.2. Rekomandimi: Drejtorisë dhe Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll, duhet të caktojë menjëherë një person ekspert që të përditësojë regjistrin kontabël duke kryer të gjithë

kontabilizimin e asetëve të bashkisë me vlerën aktuale që ato kanë dhe pasqyruar në llogarinë 212 ndërtesa e konstruksione.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në akt-konstatimin nr. 3, datë 14.06.2024 dhe nr. 4, datë 14.06.2024.

Rekomandimi nr. 14.1, dhe nr. 14.2, nuk është zbatuar.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë Bashkisë dhe Inspektoriatin Mbrojtjes Territorit (IMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e sajë të përdorin sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkisë.

Të gjitha kontratat e qirave duhet të jenë të noterizuar ku si përfaqësues i bashkisë duhet të jetë Kryetari i sajë si nëpunësi autorizues.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Selenicë, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin në ASHK Drejtoria Vlorë dhe kontabilitet të sipërfaqeve pyjore/kullosore të transferuara me VKM nr. 433, datë 8.6.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

Brenda datës 31.12.2023

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi. Kjo problematikë është trajtuar në mënyrë të hollësishme në akt-konstatimin nr. 4, datë 14.06.2024.

Rekomandimi nr. 15.1, dhe nr. 15.2, nuk është zbatuar.

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Selenicë, të marrin masa që:

-Në periudhat në vijim në lidhje me procedurat e prokurimit, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

-Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponencën teknike të investimit.

-Të bëhet inventarizimi dhe arkivimi i të gjitha dosjeve të mbyllura dhe arkivuara sipas të dhënave të sistemit të SPE.

-Të bëhen pjesë e dosjes së procedurës, DST, procesverbali i hapjes së procedurës, raporti përmbledhës dhe vendimi i titullarit të AK për shpalljen fitues.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë mbetet për t'u verifikuar në auditimet në vijim që do të zhvillohen nga KLSH me objekt "Auditim përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi.

17.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës.... dhe Sektorin e Procedurave të Prokurimit, në zhvillimin e procedurave me blerje të vogla, të marrë masat për:

-Dokumentimin e nevojave dhe kërkesave të institucionit që lidhen me nevojat për mallra dhe shërbime.

-Argumentimin me dokumentacion të llogaritjes së fondit limit.

-Shmangien e specifikimeve teknike jo në përputhje me procedurën e prokurimit, si pengesë pjesëmarrje të OE;

-Procedurat për mallra/ shërbime të cilat nuk janë të ngjashme, të mos prokurohen bashkë por të veçohen në procedura të veçanta sipas objektit të tyre.

-Vlerësimin e saktë të OE të shpallur fitues në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë mbetet për t'u verifikuar në auditimet në vijim që do të zhvillohen nga KLSH me objekt "Auditim përputhshmërie".

Rekomandimi është në proces zbatimi.

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të rekrutuar staf të kualifikuar në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, kjo jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të rritur cilësinë e inspektimit dhe të kontrollit për zbatimin e lejeve të ndërtimit. Të synohet që stafi i kualifikuar të jetë me drejtim inxhinierie.

Të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Menjëherë

18.2. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit Bashkia Selenicë, të marrë masa për:

-Mbjajtjen e akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

-Aplikimin e të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve.

-Plotësimin e dosjeve me të gjitha praktikatat për secilin konstatim, duke u dokumentuar krahas akteve të mbajtura, edhe fotografitë për situatat e konstatuara të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes përkatëse.

-Në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë e Taksave, të bashkërendojnë punën për të mundësuar arkëtimin e gjobave të nxjerra. Drejtoria Juridike, të marrë masa të menjëhershme për të përgatitur kërkesë padite drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, në rastet kur subjektet refuzojnë likuidimin e tyre në mënyrë vullnetare.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë mbetet për t'u verifikuar në auditimet në vijim që do të zhvillohen nga KLSH me objekt "Auditim përputhshmërie".

Rekomandimi nr. 18.1, dhe nr. 18.2 është në proces zbatimi.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrë masa për monitorimin e vazhdueshëm të kontratave të punimeve civile, mallra dhe shërbime, me synim kërkimin nga subjektet ndërtuese, apo mbikëqyrëse, zbatimin e dispozitave ligjore për një përdorim sa më me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve në dispozicion.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

B. PËR MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, si dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë publike në bashkëpunim me nëpunësin zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **8,114,599 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **611,160 lekë**, nga shoqëria “**I.C.C G**” shpk, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar por të pa kryer.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **1,568,000 lekë**, nga shoqëria “**SH**” SHPK, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të mos ekzekutimit të disa zërave të punimeve deri në datën 27.10.2023, datë përfundimi auditimi në terren.

Brenda datës 30.3.2024

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare... dhe Drejtorinë e PZHT (sektori i menaxhimit të kontratave), në vazhdim, të rikalkulojë penaltetin që i duhet mbajtur kontraktorit, nga data e përfundimit të auditimit në terren deri në datën e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kontratës nr. 379 Prot., datë 08.02.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe shoqërisë “**SH**” SHPK, pasi të përfundojë dhe ekzekutimin e zërave të punimeve ende të pa kryera.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **2,030,954 lekë**, nga BOE “B -B” shpk & “B- N” shpk & “MF I G” shpk, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të mos ekzekutimit të disa zërave të punimeve deri në datën 27.10.2023, datë përfundimi auditimi në terren.

Brenda datës 30.3.2024

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare... dhe Drejtorinë e PZHT (sektori i menaxhimit të kontratave), në vazhdim, të rikalkulojë penaltetin që i duhet mbajtur kontraktorit, nga data e përfundimit të auditimit në terren deri në datën e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kontratës nr. 379 Prot., datë 08.02.2023, të nënshkruar midis Bashkisë Selenicë dhe BOE “B-B” shpk & “B- N” shpk & “MF I G” shpk, pasi BOE, të përfundojë dhe ekzekutimin e zërave të punimeve ende të pa kryera.

3.3. Rekomandimi: Bashkia Selenicë, në të ardhmen, të marrë masat që përpara nënshkrimit të amendamenteve të kontratave për punime, ato, të jenë të mirë argumentuara dhe të dokumentuara lidhur me arsyet e shtyrjes së afateve të ekzekutimit të punimeve.

Në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 3.1, nr. 3.2, dhe nr. 3.3, nuk është zbatuar.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv –Protokoll dhe Sektorin e Menaxhimit të kontratave, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **110,520 lekë** në shoqëria ‘A 2A C’ shpk, për mos zbatim të kushteve të nenit 15.1 të kontratës nr. 2096/4, datë 24.11.2022.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **922,320 lekë**, nga shoqëria “Sh” shpk, për punime të certifikuara, në kundërshtim me specifikimet teknike.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **1,617,500 lekë**, nga JV “**A- 2 C + B**” shpk, për punime të certifikuara, në kundërshtim me specifikimet teknike.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhër Shpenzimin nr. 783, datë 29.12.2023, është kryer ndalesa prej 609,640 lekë ndërkohë që nuk është arkëtuar vlera prej 1,107,860 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **416,245 lekë**, nga JV “**I.C.C G& B-S & MF I G**” shpk, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

-T’i kërkohet kontraktorit riparimi i trupit të kanalit në vendet e dëmtuara, brenda periudhës së riparimit të defekteve.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit **837,900 lekë**, nga kontraktori “**Sh**” SHPK, për punime të certifikuara, në kundërshtim me specifikimet teknike.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE/BOE të cilat nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve për vlerën **193,855 mijë lekë**. Gjithashtu në vijimësi të mos lejohet shpalljen fitues të OE me kriterë të paplotësuar në zbatim të kërkesave të DST dhe të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE në mosplotësim të kriterëve të DST, përbën risk real për shpenzimet e njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë me një grup pune me specialist të fushës të analizojë dhe vlerësojë vendimin e anëtarëve të KVO për kualifikim të padrejtë të JV “I.C.C G” & “B-I” & MF “I G” shpk, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mangësitë e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit duke krijuar efekt negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën **584,246 lekë**, nga anëtarët e KVO: A J, D D dhe K B.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare ..., të marra masa për një shpërndarje të drejtë të karburantit sipas drejtorive/sectorëve të Bashkisë Selenicë, referuar nevojave që ato paraqesin, ku nga këto të fundit të argumentohet lëvizja e tyre me dokumentacion ligjorë.

Në çdo rast fletudhëtimet duhet të shoqërohen me autorizim të nëpunësit autorizues ku të specifikohen arsyeja e lëvizjes dhe sasia e karburantit. Nga personi përgjegjës të hartohen dhe bashkëlidhen fletudhëtimet PV mbi shërbimin e kryer (në rastet kur kemi shërbime me volume pune) dhe të nënshkruhen nga personi përgjegjës që merr karburantin.

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare..., në rastet e mungesës së mjeteve për kryerjen e shërbimeve të ndryshme të Bashkisë Selenicë, të parashikojë fonde dhe të miratojë në Këshillin Bashkiak marrjen me qira të mjeteve të domosdoshme sipas drejtorive, duke argumentuar dhe të eliminojë marrjen e mjeteve me qira nga punonjësit e bashkisë që kanë në përdorim mjete, për të eliminuar përdorim pa efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet (3-E), të fondeve për sasinë e karburantit të konsumuar në vlerën 4,255,229 lekë.

3.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare ..., të ngriejë një grup pune me specialist të fushës për marrjen në dorëzim të dy mjeteve të dhëna në përdorim SH.A UK Bashkia Selenicë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 3.1, nr. 3.2, dhe 3.3 nuk është zbatuar.

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRATIMIN E TË ARDHURVE TË MUNGUARA.

1.1. Rekomandimi: Drejtorinë e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Juridike, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve e shumës prej **1,756,155 lekë** për **24** subjekte, respektivisht:

- Vlera 35,000 lekë për subjektin “D” shpk
- Vlera 255,000 lekë nga subjekti “R K” shpk
- Vlera 140,000 lekë nga subjekti “SH” shpk
- Vlera 127,500 lekë nga subjekti “SH” shpk
- Vlera 141,800 lekë nga subjekti “B K” shpk
- Vlera 85,000 lekë nga subjekti “ICC G” shpk
- Vlera 85,000 lekë nga subjekti “B B” shpk
- Vlera 85,000 lekë nga subjekti “A” shpk
- Vlera 269,300 lekë nga subjekti “A2 C” shpk
- Vlera 170,000 lekë nga subjekti “I-18” shpk
- Vlera 170,000 lekë nga subjekti “M K” shpk
- Për 13 subjekte në vlerën 192,555 lekë, sipas *Aneksit 2.6.2 bashkëlidhur RPA.*

Brenda datës 30.6.2024

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë të marrin masa për informimin e Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë për indeifikimin dhe regjistrimin e 155 subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Selenicë dhe janë të regjistruar për pagesën e taksave lokale, të paisjen me numër identifikimi (NIPT), kjo për të shmangur mos pagesën e detyrimeve për sigurimet shoqërore e shëndetësore, ku vetëm për vitin 2022 përlllogaritet në shumën **22,171,200 lekë**, si ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, sipas *Aneksit 2.6.4 bashkëlidhur RPA.*

1.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit, të mos lidhë kontratë me subjektet juridike/fizik fitues të procedurave por që nuk janë me vendbanim (qendër biznesi) në këtë NJA, pa bërë më parë regjistrimin në QKB për Nipti Sekondarë për periudhën e zbatimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 1.1, nr. 1.2, dhe 1.3 nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim arkëtimin e shumës prej **4,600,000 lekë** nga 8 subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve, si vijon:

- Vlera 200,000 lekë nga subjekti “P” shpk
- Vlera 200,000 lekë nga subjekti “D Gj” shpk
- Vlera 800,000 lekë nga subjekti “T O” shpk
- Vlera 800,000 lekë nga subjekti “Xh G” shpk
- Vlera 800,000 lekë nga subjekti “M O” shpk
- Vlera 800,000 lekë nga subjekti “M” shpk
- Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L GJ” shpk

Brenda datës 30.6.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Selenicë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjorë, t'i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë.

Menjëherë

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Selenicë, të vendosen marrëdhënie kontraktuale me subjektet shfrytëzuese të sipërfaqeve pyjore, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 972.7 ha, dhe aplikuar tarifat dysHEME minimale për të llogaritur vlerat e qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit për vlerën **61,810,176 lekë**, respektivisht subjektet:

- Vlera **12,035,400 lekë** nga subjekti “S B”
- Vlera **528,800 lekë** nga subjekti “R”
- Vlera **6,758,000 lekë** nga subjekti “Xh K”
- Vlera **2,008,800 lekë** nga subjekti “M B”
- Vlera **17,145,800 lekë** nga subjekti “B M I”
- Vlera **1,556,200 lekë** nga subjekti “B G”
- Vlera **1,996,400 lekë** nga subjekti “B&AD C”
- Vlera **1,227,600 lekë** nga subjekti “Y S”
- Vlera **1,661,600 lekë** nga subjekti “A 2013”
- Vlera **849,400 lekë** nga subjekti “B P”
- Vlera **2,232,000 lekë** nga subjekti “A-I”
- Vlera **3,443,976 lekë** nga subjekti “M P”
- Vlera **10,366,200 lekë** nga subjekti “S M”

Brenda datës 30.6.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nr. 3.1, dhe nr. 3.2, nuk është zbatuar.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim arkëtimin e shumë prej **19,250,000 lekë**, nga **9** subjekte me leje minerale, si më poshtë:

- Vlera **3,000,000 lekë** nga subjekti “R” shpk
- Vlera **3,400,000 lekë** nga subjekti “Xh K” shpk
- Vlera **1,550,000 lekë** nga subjekti “M B” shpk
- Vlera **3,800,000 lekë** nga subjekti “B M I” shpk
- Vlera **1,200,000 lekë** nga subjekti “B M I (B P NK)”
- Vlera **4,100,000 lekë** nga subjekti “A-I” shpk
- Vlera **400,000 lekë** nga subjekti “B&AD K” shpk
- Vlera **800,000 lekë** nga subjekti “A” shpk
- Vlera **1,000,000 lekë** nga subjekti “B of A” shpk

Brenda datës 30.6.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit, të marrë masa që;

-Për çdo leje ndërtimi për objekt të ri, deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Selenicë, të miratohet paraprakisht leje e zhvillimi, në të kundërt aplikimi të refuzohet.

-Të respektojë të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin sektorial për projektet ndërtimore, në të kundërt të mos miratohet asnjë leje ndërtimi nuk plotëson të gjitha kondicionet urbane.

-Të mos vijohet miratimi për leje ndërtimi, pa bashkëvepruar me institucionet kompetente, si OSHEE, AKM, ASHK, AKPT, UK.

Në vijimësi

5.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit, Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Ardhurave Vendore Bashkia Selenicë, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e shumës **463,430 lekë** ndaj subjekteve zhvillues **Ç H, A M dhe S L**, si rezultat i përlogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, respektivisht:

-vlera **115,904** për subjektin **Ç H**.

-vlera **334,550 lekë** për subjektin **A M**.

-vlera **12,976 lekë** për subjektin **S L**.

Brenda datës 30.3.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Rekomandimi nuk është zbatuar.

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR

1.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave, të marrin masa për:

- Përcaktimin e saktë të kategorisë së tokave bujqësore (bonitetit), sipas gjendjes faktike, duke kërkuar informacion dhe në Ministrinë e Bujqësisë.

- Të ngrejë një grup pune me specialit të fushës, për verifikimin në vend të tokave bujqësore të zëna nga ndërtime informale, duke bërë ndryshimin e destinacionit sipas Ligjit dhe përcaktimin e saktë të sasisë së tokës bujqësore që ka kjo NA dhe rakordimi me Drejtorinë e Bujqësisë në Qarkun Vlorë.

Brenda datës 30.6.2024

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e vlerës së detyrimit të mbetur në shumën **262,855,604 lekë**, si ardhur e munguar në buxhet.

Brenda datës 30.12.2024

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: *Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023, ku vlera e debitorëve nga taksa e tokës bujqësore progresive më datë 31.12.2023, është në vlerën 268,483,775 lekë për 7,847 familje.*

Rekomandimi nr. 1.1, dhe nr. 1.2, nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Selenicë, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative me qëllim arkëtimin e detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në shumën **7,835,091 lekë** sipas **Aneksit 2.6.3 bashkëlidhur RPA.**

Për çdo vit ushtrimorë Drejtoria e PZHT Bashkia Selenicë, duhet të raportojë dhe rakordojë me DAV Bashkia Selenicë dhe Drejtorinë e Financës për informimin dhe kontabilizimin e vlerës së detyrimit vjetor.

Brenda datës 30.6.2024

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Vlorë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

Statusi i rekomandimit: *I pranuar.*

Koment i grupit të auditimit: *Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023, ku vlera e debitorëve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë më datë 31.12.2023, është në vlerën 6,938,018 lekë për 262.*

Rekomandimi nr. 2.1, dhe nr. 2.2, nuk është zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të nxjerr aktet administrative përkatëse dhe të kërkojnë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e vlerës së debitorëve të paarkëtuar për taksat/ tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **163,958,614⁴ lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të Ligjit për arkëtimin e debitorëve.

⁴ Diferenca me totalin e debitorëve sipas tabelës prej 270,690,695 lekë nga vlera 434,649,309 lekë, është evidentuar në gjetje të vecanta për debitorët për tokën bujqësore në shumën 262,855,604 lekë dhe debitorë aluizni ë vlerën 7,835,091 lekë

g- Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuideojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit.

Brenda datës 30.12.2024

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë të bashkëpunojë me QKB Dega Vlorë dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë për evidentimin e subjekteve me status pasiv/mbyllur nëse ushtrojnë ose jo aktivitete dhe të mos lejohen të mbyllin veprime pa bërë likuidimin e detyrimeve të prapambetura, për të shmangur fenomenin e krijimit të borxhit të keq dhe pamundësinë e gjetjes së tyre për arkëtim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Statusi i rekomandimit: I pranuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë vitit 2023, ku vlera e debitorëve nga taksat dhe tarifave vendore progresive më datë 31.12.2023, është në vlerën 455,593,441 lekë.

Rekomandimi nr. 3.1, dhe nr. 3.2, nuk është zbatuar.

F. PËR MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Selenicë të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil/Largim nga puna”, për 9 (nëntë) punonjësit, si më poshtë:

1. E F, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mangësitë e konstatuara në angazhimin profesional në procesin e realizimit të të ardhurave të planifikuara, ku niveli i realizimeve paraqitet në masën 74.7% ose nga 108 milionë lekë të parashikuara është arkëtuar vlera 81 milionë lekë, si dhe uljen e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetër (2021/2022), për vlerën 13 milionë lekë.

-Mos taksim i subjekteve fizik/juridike nga njëra periudhë në tjetrën duke lënë jashtë tarifimit subjekte të cilat kanë qenë aktiv në vitin ushtrimorë të mbyllur (2021), dhe mos taksimin e tyre në periudhën në vijim (2022), duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë për vlerën 1,756 mijë lekë.

-Mos ndjekjen e procedurave për detyrimin e subjekteve fizik të regjistruhen në QKB, veprime me efekt negativ në të ardhurat e buxhetit të shtetit për vlerën 22,171 mijë lekë.

-Nuk është ngritur një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm, duke përcaktuar risqet ekzistuese që cenojnë arritjen e objektivave të planifikuara, përcaktimi i risqeve sipas llojit të tyre strategjik, rregullator menaxherial, operacional, rregullator i jashtëm.

Mos identifikimi i risqeve ka sjelle për pasoje vlerësimin e tij, matjen në terma financiare dhe me tej marrjen e masave për reduktimin dhe minimizimin e tij dhe përcaktimi i kufirit të riskut i cili pranohet si tille në rastet e mos eliminimit të tij. Ky kufi ose risk i pa shmangshëm pas miratimit

nga Koordinatorin e riskut paraqitet te Kryetari i Bashkisë si autoritet i vetëm qe vendos pranimin e tij, heqjen dore nga procesi qe gjeneron riskun apo merr masa për transferimin e tij. Konkluzioni jone është se sa i përket riskut nga ana e menaxhereve të të ardhurave ka mungesa te theksuara ne lidhje me bazën ligjore, udhëzimet dhe praktikat me te mira te menaxhimit te rriskut. Është rekomanduar vazhdimisht nga kontrollet e Brendshme dhe te Jashtme fillimi i identifikimit te risqeve dhe kryerja e gjithë veprimtarisë se përditshme mbi baze rrisku por deri tani nuk është realizuar.

-Mos marrjen e masave për kryerjen e akt-rakordimeve mujore me agjentët tatimorë mbi të ardhurat që ato arkëtojnë dhe duhet të derdhen për llogari të bashkisë Selenicë, duke krijuar mungesë informacion mbi nivelin e planifikimit dhe realizimit të tyre

-Mungesë arkëtimi të taksave vendore në vlerën **19,250,000 lekë**, për 9 subjekte që ushtrojnë aktivitetet minerar në territorin e Bashkisë Selenicë (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Me Vendimin nr. 442/2, datë 26.02.2024, Komisioni Disiplinor ka vendosur që mos të japë masë disiplinore për z. E F.

2. S Gj, me detyrë Specialiste kontabiliteti në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave.

Për znj. S Gj nga titullari i institucionit nuk janë marrë masat e duhura në lidhje me ndjekjen e procedurave, për dhënien e masës disiplinore.

3. D D, me detyrë Inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave.

Me Vendimin nr. 443/2, datë 26.02.2024, Komisioni Disiplinor ka vendosur që mos të japë masë disiplinore për z. D D.

4. Znj. M B, me detyrë Specialiste borxhi në Drejtorinë e të Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos zbatimi i dispozitave ligjore në arkëtimin e debitorëve të të gjitha llojeve (fizik/juridik/abonentë familjarë etj), të cilat zënë rreth **100%** të buxhetit të Bashkisë, bëjnë që bashkia të mund të mos realizojë projektet e investimeve dhe shërbimeve të ndryshme që bashkia planifikon në fillim të çdo vitit buxhetor, ku mungesa e mos realizimit të të ardhurave e bën të pamundur atë dhe njëkohësisht bëhet shkak për rritjen e faturave të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore (kreditorë). Kështu deri në fund të vitit 2022, si rezultat i punës së pamjaftueshëm të DAV Bashkia Selenicë dhe strukturave të tjera të ngarkuara sipas rregullores së brendshme të Bashkisë, niveli i borxhit është në vlerën 434,649 mijë lekë kjo për subjekte fizik/juridike/ abonentë familjarë (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për znj. M B nga titullari i institucionit nuk janë marrë masat e duhura në lidhje me ndjekjen e procedurave, për dhënien e masës disiplinore.

5. M H, me detyrë Specialist Jurist në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore , Ndhmës Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në cilësinë e administratorit të procedurave të prokurimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos inventarizimi i dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura.

-Mungesa bë dosjen e procedurës raporti përmbledhës si dhe nuk ka vendim titullari AK për shpallje fitues, veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 84 “Raport Përmbledhës”, pika 1 , pika 2.

-Mos mbajtja e PV i hapjes së procedurës, por është kaluar direkt në PV vlerësimit, gjë e cila nuk vërteton nëse procedura është hapur në afatin e caktuar, veprime në kundërshtim me nenet 74 dhe 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar.

-Mos bëri pjesë e dosjes të DST, por janë vetëm në sistem, si dhe nuk janë nënshkruar, veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1, pika 2, ku thuhet se: “Njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve standarte të tenderit të cilat duhet të bëhen pjesë e dosjes së tenderit dhe të nënshkruhen nga Njësia e prokurimit. Procedura e prokurimit publikohet në sistemin SPE pas nënshkrimit të dokumentacionit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 136-194 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Me Vendimin nr. 445/1, datë 26.02.2024, Komisioni Disiplinor ka vendosur që mos të japë masë disiplinore për z. M H.

6. B K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë DZHBAPK për vitin 2022

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos lidhja e kontratave të qirasë me subjektet minerare që shfrytëzojnë fondin pyjor/kullosor të Bashkisë Selenicë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **91,810,176 lekë**.

-Parregullsi në dokumentacionin e dosjeve të kontratave të qirasë sezonal dhe lejimi i shfrytëzimit të fondit pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

-Nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “Monitorimi i Kontratave”, lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës.

-Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

-Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Me Vendimin nr. 447/1, datë 26.02.2024, Komisioni Disiplinor ka vendosur që mos të japë masë disiplinore për z. B K.

7. Sh D, me detyrë Përgjegjës Sektori i Administrim / Menaxhimit të Pyje Kullotave

Për shkeljet e mëposhtme:

-Parregullsi në dokumentacionin e dosjeve të kontratave të qirasë sezonal dhe lejimi i shfrytëzimit të fondit pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

- Nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “Monitorimi i Kontratave” lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës.

- Nuk janë mbajtur aktet e kontrollit të përdorimit të sipërfaqes (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

z. Sh D nuk është më në marrëdhënie pune në Bashkinë Selenicë për arsye se ka dalë në pension.

8. K B, me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Integritimit European, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mangësitë e konstatuara në miratimin e lejeve të ndërtimit **nr. 54, datë 4.10.2022** me zhvillues z.

Ç H dhe objekt “Rikonstruksion pjesor i objektit ekzistues 1 dhe 2 kate dhe shtesë në lartësi 1 dhe 2 kate me funksion shërbimi turistik në Vajzë, Selenicë”, **leja e ndërtimit nr. 58, datë 10.6.2022**

me zhvillues z. **A M** me objekt: “Objekt Shërbimi për Turizëm Rural”, dhe **leja e ndërtimit nr. 72, datë 21.9.2022** me zhvillues z. **S L** me objekt: “Objekt banimi 1 kat në Karbunar, Selenicë”,

rezulton se:

-Personat përgjegjës që administrojnë procesin në *e-leje*, i kanë miratuar ato në mos përmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin; - Mungon mendimi i institucioneve bashkëvepruese në procesin e lejeve; - Nuk janë në kushtet për miratimin e lejes si struktura me funksion turistik, pasi zhvilluesi dhe objekti i lejes nuk kanë status investitori turistik; - Në 1 rast mungon dokumentacioni i plotë për lejen e ndërtimit, pasi aplikimi nuk përfshin projektin dhe relacionin e instalimeve të ngrohje –ftohjes; - Mungon leja e zhvillimit për ndërtim të ri si dhe preventivat nuk kanë të gjithë zërat e punimeve, duke shmangur potencialisht vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 113-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Me Vendimin nr. 446/1, datë 26.02.2024, Komisioni Disiplinor ka vendosur që mos të japë masë disiplinore për z. K B.

9. D A, me detyrë Kryeinspektor i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Mos aplikimin e masave administrative për kundërvajtjet e kryera, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje; - Mungesë të akteve të kontrollit për ndërtimet që kryhen me leje ndërtimi; - Mos administrimi i dosjeve përkatëse, si dhe nuk disponohen materiale provuese si fotografitë për evidentimin e situatave ndërtimore; - Mos hartimi i planeve të punës mujore dhe vjetore; - Mos marrja e masave ligjore në arkëtimin e gjobave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 113-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Për z. D A nga titullari i institucionit nuk janë marrë masat e duhura në lidhje me ndjekjen e procedurave, për dhënien e masës disiplinore.

G. PËR MASA ADMINISTRATIVE

G/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3-“Parimet e përzgjedhjeje”, 98- “Anulimi i një procedure”, 76- “Kriteret detyruese për skualifikim” dhe 92- “Shqyrtimi i ofertave” të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 67- “Klasifikimi i ofertave”, 82- “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” dhe 83- “Njoftimi i fituesit” të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (*pika 4 e Raportit Përfundimtar të auditimit faqen 160-247*).

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (*dënim me gjobë*) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (*për marrjen e masave disiplinore*), për **9 (nëntë) punonjës/ish- punonjës**, si më poshtë:

1. P B, me detyrë ish- Kryetar i Bashkisë Selenicë, në cilësinë e Titullarit të AK.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për miratimin e procedurave të prokurimit në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP nga personat përgjegjës të njësisë së prokurimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, duke lejuar aplikimin e kriterëve të paargumentuara dhe shpalljen fitues të OE me kriterë të paplotësuar dhe vlerësimin me dy standarte të disa prej procedurave, në kundërshtim me pikën 5 e nenit 73, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, si dhe pika 1 dhe 5 e nenit 21, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

a- Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për hartimin e DST.

2. **M H**, me detyrë Specialist jurist Burimet Njerëzore.
3. **E F** me detyrë Drejtor Drejtorja e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave.
4. **A Vi**, me detyrë Specialist Arkitekt, Sektori i Mjedisit, Projekteve, Investimeve Lejeve dhe Liçencave.
5. **R P**, me detyrë Specialist Arkitekt, Sektori i Mjedisit, Projekteve, Investimeve Lejeve dhe Liçencave.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht në praktikat:

- 1- Procedura me objekt “*Asfaltim rruge te brendshme Kocul*”, me fond limit 53,905 mijë lekë.
- 2- Procedura me objekt “*Ndërtim rruge e rrugica me beton viti 2022*” me fond limit 24,000 mijë lekë.
- 3- Procedura me objekt “*Ndërtimi i rrjetit te ujërave te zeza Astane Kote*” me fond limit 66,973 mijë lekë.
- 4- Procedura me objekt “*Rikonstruksion shkolla Hajredin Beqari Selenicë*” me fond limit 86,472 mijë lekë.
- 5- Procedura me objekt “*Rehabilitim kanale ujitëse sekondare Lubonje Picar Armen*” me fond limit 86,472 mijë lekë.
- 6- Procedura me objekt “*Rehabilitim kanali Gjorm*” me fond limit 15,416 mijë lekë.
- 7- Procedura me objekt “*Rikonstruksion KUZ Mesarak*” me fond limit 20,746 mijë lekë.
- 8- Procedura me objekt “*Rikonstruksion i Sheshit te Fshatit Vajze, Bashkia Selenicë*” me fond limit 12,400 mijë lekë.
- 9- Procedura me objekt “*Rikonstruksion KUZ Picar*” me fond limit 35,066 mijë lekë.

b- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin e procedurave të zhvilluara.

6. **A J**, me detyrë Specialist në Sektorin e Projekteve Publike në DPZHT;
7. **D D**, me detyrë Inspektor Vlerësimi në DTT;
8. **K B** me detyrë Drejtor DPZHT.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, vlerësimin me dy standarte të procedurave të ndryshme për kriteret e njëjta, për një përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar 193,855 mijë lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98,

“Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht në praktikat:

1- Procedura me objekt “Blerje karburant (naftë/benzinë)” me fond limit 18,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “V K OIL” shpk me vlerë kontrate 17,870 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “FV pjesë këmbimi” me fond limit 2,500 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A 2A CO” shpk, me vlerë kontrate 2,451 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Ndërtim rrugë me beton, viti 2022” me fond limit 24,00 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “A 2A CO” shpk, me vlerë kontrate 22,770 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Rehabilitim kanale ujitëse sekondare Lubonje Picar Armen” me fond limit 86,473 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “I.C.C B” shpk.

5- Procedura me objekt “Rehabilitim kanali Gjorm” me fond limit 15,416 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “B K” me vlerë kontrate 15,178 mijë lekë.

6- Procedura me objekt “Rikonstrukcion i Sheshit te Fshatit Vajze” me fond limit 12,400 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “R K” shpk me vlerë kontrate 12,009 mijë lekë.

7- Procedura me objekt “Rikonstrukcion KUZ Picar” me fond limit 35,066 mijë lekë, ku fitues është shoqëria “SH” shpk me vlerë kontrate 24,000 mijë lekë.

9. T H, me detyrë Inspektor Vlerësimi në DTT.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në cilësinë e anëtarit të njësishë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht procedura me objekt “Rehabilitim kanale ujitëse sekondare Lubonje Picar Armen” me fond limit 86,472 mijë lekë.

-Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, vlerësimin me dy standarte të procedurave të ndryshme për kriteret e njëjta, për një përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar 193,855 mijë lekë, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, konkretisht procedura me objekt “Rikonstrukcion i Sheshit te Fshatit Vajze” me fond limit 12,400 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “R K” shpk me vlerë kontrate 12,009 mijë lekë.

G/2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit (IMT), Bashkia Selenicë

Referuar shkeljeve të konstatuara në zbatimin e kontratave të punëve publike, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të Ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative (gjobë) për 2 (dy) mbikëqyrës:**

1. Shoqëria “M” SHPK me përfaqësues ligjor **z. P M**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Rikonstruksion K.U.Z Picar”. Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten, **si më poshtë:**

- Në librezën e masave, sipas zërit 7 “Shtresë çakull mbeturinë gur kave $t=20$ cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, është përfshirë realizim shtresë çakulli në aksin 2, me gjatësi 450 ml. Gjatësia 260 ml, nga piketa 1 deri piketë 15 e këtij aksi, i përket rrugës me shtresë asfaltobeton. Në këto kushte është certifikuar më shumë sasia 832 m^2 ($260 \text{ m} \times 3.2 \text{ m}$). Po ashtu në aksin 4, që i përket shtrimit të tubacionit $D = 600 \text{ mm}$, nga kryqëzimi deri tek gropa septike, në gjatësi 180 ml, në llogaritje është përfshirë shtresë çakulli, ndërkohë që tubacioni nuk shtrihet në rrugë, por në tokë të gjelbëruar. Sasia e certifikuar më shumë për shtrim çakulli për këtë seksion është 630 m^2 ($180 \text{ ml} \times 3.5 \text{ ml}$). Sa më sipër, vlera $657,900 \text{ lekë}$ [$(832 \text{ m}^2 + 630 \text{ m}^2) \times 450 \text{ lekë/m}^2$], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe konsiderohet dëm ekonomik.

-Sipas zërit 8 “Shtresë asfaltobeton me granil me gur kave, 3 cm, me makineri” dhe zërit 9 “Shtresë binderi me granil gur kave, 5 cm, me makineri”, është certifikuar sasia 797 m^2 [$(65.2 \text{ m} \times 3.8 \text{ m}) + (235.8 \text{ m} \times 2.33 \text{ m})$]. Nga verifikimi në objekt rezulton se në dy segmente me gjatësi 75 m dhe 65 m gjerësia e shtresave asfaltike është 3.4 m, ndërsa në gjatësi të kanalit është realizuar me shtresa asfaltike me gjerësi mesatare 1.4 m. Duke marrë në konsideratë sipërfaqen e realizuar edhe për çarje të shtresave asfaltike për lidhjen e tubacioneve përgjatë rrugës, si dhe sipërfaqet e zgjeruara për hapjen e pesetave, rezulton një diferencë në masën 120 m^2 . Vlera $180,000 \text{ lekë}$ [$120 \text{ m}^2 \times (700 + 900) \text{ lekë/m}^2$], është certifikuar më tepër dhe konsiderohet dëm ekonomik.

Nga verifikimi i punimeve të realizuara për gropën septike sipas zërit “F.V Kapak metalik $d=100$ mm me veshje dërrase nga poshtë”, rezulton se ato janë realizuar me diametër 60 mm. Çmimi i aplikuar për kapakët metalikë është $14,751 \text{ lekë/copë}$, ndërkohë referuar manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit nr. 3, analiza An-1, çmimi paraqitet $14,700 \text{ lekë/copë}$ (Trajtuar më hollësisht në nënplikën 4.4, faqe 194-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda datës 30.3.2024

2. Shoqëria “R” SHPK, me përfaqësues ligjor **znj. R N**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton”. Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten, **si më poshtë:**

Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton”, në fshatrat Peshkëpi, Kotë, Vajzë, Sevaster, u konstatua mangësi në lidhje me shtresat e betonit dhe vendosjen e zgarave metalike si më poshtë:

Spas zërit “F.V zgarë metalike $\emptyset 6 \text{ mm}$, çdo $15 \times 15 \text{ cm}$ ”, me çmim $150,000 \text{ lekë/ton}$, zgara metalike rezulton të jetë vendosur me kuadratë $15 \times 15 \text{ cm}$ sipas specifikimeve, por sa i përket

diametrit, rezultoi me diferencë. Në specifikimet teknike si dhe librezën e masave përcaktohet zgarë me diametër 6 mm, ndërkohë që sipas realizimit në fakt, është vendosur zgarë me diametër 4 mm. Pesha e llogaritur për zgarat metalike për këto segmente rrugorë është 8.4 ton. Nga përlllogaritjet rezulton se pesha faktike (rrjetë 4 mm) është 3.75 ton. **Vlera 697,500 lekë** [(8.4 ton – 3.75 ton) x 150,000 lekë/ton], përbën punime të certifikuara por të pa realizuara, përfituar padrejtësisht nga kontraktori.

-Nga auditimi u konstatuan mangësi, sa i përket shtresave të betonit të realizuara për tre rrugë në Fshatin Peshkopi, me gjatësi gjithsej 292 ml, gjerësi 3 ml dhe trashësi shtrese 15 cm. Dëmtimi i këtyre shtresave është i konsiderueshëm, ardhur kryesisht nga mos realizimi i përzierjes së betonit me elementët përbërës si çimento, por edhe materialit inertë në kundërshtim me specifikimet teknike. Degradimi i këtyre shtresave, deri në hapje të gropave, ndërkohë që periudha nga shtrimi i tyre është pak më shumë se një vit, është tregues që këto shtresa nuk do të realizojnë qëllimin për të cilin janë ndërtuar, në periudhën e parashikuar. Në periudhën e realizimit të punimeve betoni është realizuar sa i takon sasisë, por sa i takon cilësisë verifikimi nuk mund të bëhet vetëm duke u bazuar në provat laboratorike të materialeve siç është prova e mostrave të betonit. Dëmtimi i shtresave është i konsiderueshëm dhe për një kohë të shkurtër nuk do të kryejnë funksionin e parashikuar. Dëmtimi më i konsiderueshëm ishte tek rruga e varrezave me gjatësi 62 m, rruga tek kryqëzimi me gjatësi 60 ml (20 ml ishte në kushte të mira teknike), si dhe segmenti tjetër me gjatësi 130 ml (20 ml në kushte të mira teknike). Në këto kushte, vlera e ndërtimit të tyre (shtresa e betonit) në masën 115 m³, është certifikuar në kundërshtim me specifikimet teknikë. **Vlera 920,000 lekë** (115 m³ x 8,000 lekë/m³), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori (*Trajtuar më hollësisht në nënpikën 4.4, faqe 194-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Bashkimi i OE “D” shpk, përfaqësuar nga V T dhe & “G&L C” shpk përfaqësuar nga L H, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtimi i kanalit të ujërave të zeza Astane-Kotë”. Në mënyrë të përmbledhur mangësitë paraqiten, si më poshtë:

Nga auditimi në terren për segmentet midis piketave P3-P4, P4-P5, P5-P6, P6-P7, P7-P9 dhe P9-P10, në total 122,5 metra linear, u konstatuan diferenca dhe konkretisht: Shtresa e asfaltit, nga matjet për këtë distancë dhe për këto segmente, rezultoi të ishte e gjerë mesatarisht 0.85 metra. Për këtë distancë, sipërfaqja totale e shtresës së asfaltit (vetëm asfalti që korrespondon me gjurmën e tubit HDPE), është 0.85 m x 122,5 m = 104,125 m². Sipërfaqja e deklaruar në librezën e masave, është 147 m². Pra sipërfaqja e asfaltit e deklaruar më tepër në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar, është 147 m² – 104.125 m² = 42.875 m². Për këtë sipërfaqe, të deklaruar më tepër në librezën e masave, vlera e zërave “Skarifikim shtresë asfalti me makineri”, “Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, “Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri” dhe “Shtrese binder me granil gur kave, 6 cm me makineri. Shtresë stabilizanti t=10 cm”, vlerësohet si vlerë e situacionuar nga OE dhe që duhet kthyer në llogari të Bashkisë Selenicë. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer në terren, u konstatua se mungonin shkallët metalike tek të dy gropat septike. Në total, vlera e deklaruar më tepër në situacionin përfundimtar, që i përket zërave të punimeve të pa kryer dhe që duhet të dëmshpërblehet nga “I.C.C G SHPK, në total, është **611,160 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në nënpikën 4.4, faqe 194-222 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda datës 30.3.2024

Nga Bashkia Selenicë nuk është marrë asnjë masë për vendosjen e masave administrative për tre mbikëqyrës.

G/3. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete,

pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Selenicë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Shënim: Për punonjësit e larguar.

-Për **6 (gjashtë) ish- punonjësit** e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, **“Largim nga shërbimi civil/ zgjidhje të kontratës së punës”**, si më poshtë vijon:

1. **G L**, me Detyrë ish Drejtor i Drejtorisë DZHBAPK;
2. **P H**, me detyrë ish- Inspektor Pyje/Kullota;
3. **G S**, me detyrë ish- Inspektor Pyje/Kullota;
4. **A L**, me detyrë ish- Inspektor pyjesh;
5. **P A**, me detyrë ish- Përgj/ Sektori të pyjeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos lidhja e kontratave të qirasë me subjektet minerare që shfrytëzojnë fondin pyjor/kullosor të Bashkisë Selenicë, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **91,810,176 lekë**.

-Parregullsi në dokumentacionin e dosjeve të kontratave të qirasë sezonal dhe lejimi i shfrytëzimit të fondit pyjor/kullosor pa kontratë qiraje.

-Nuk janë zbatuar kriteret dhe përcaktimet ligjore të Kreut VI “*Monitorimi i Kontratave*”, lidhur me monitorimin e kontratave të qirasë dhe enfiteozës procedurë e cila drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të enfiteozës.

-Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

-Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes (*Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6. D L – ish - Kryeinspektor i IMTV.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos aplikimin e masave administrative për kundërvajtjet e kryera, duke mos aplikuar vendimet për gjoba, pezullim dhe prishje të ndërtimeve pa leje; - Mungesë të akteve të kontrollit për ndërtimet që kryhen me leje ndërtimi; - Mos administrimi i dosjeve përkatëse, si dhe nuk disponohen materiale provuese si fotografitë për evidentimin e situatave ndërtimore; - Mos hartimi i planeve të punës mujore dhe vjetore; - Mos marrja e masave ligjore në arkëtimin e gjobave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 113-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

H. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për

fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N B Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 20.06.2023, deri më 31.12.2023, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, z. P B ish-Kryetar i Bashkisë Selenicë për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 19.06.2023.

(Për sa trajtuar më sipër është mbajtur Averifikimi nr. 1, datë 14.06.2024)

2.5. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

➤ Trajtimi i ankesës të kryer nga z. S M:

Më datën 10.06.2024, në KLSH ka mbëritur një ankesë nga z. S M, administruar me praktikën nr. 773 prot., datë 10.06.2024. Në këtë ankesë nga ankimesi janë **ngritur pretendimet se:**

Ankesa i adresohet Subjektit "B G" Shpk me sipërmarrës z. D H dhe z. N-D I, i cili i ka dëmtuar sistematikisht pronën, gardhin si dhe strukturën e tokës e cila është prishur nga inertet që hedh ky subjekt. Si pasojë e hedhjes së inerteve është bllokuar rruga për hyrjen në pronë. Bashkëlidhur janë edhe disa foto dhe një video mbi dëmet që janë shkaktuar në pronë.

Kjo situatë ka prej 12 vitesh ku nga ankimesi z. S M janë kryer ankesa pranë Bashkisë Selenicë, Policisë së qytetit të Selenicës, Inspektoriatit të Zonës, Prefekturës, Deputetit të Zonës dhe emisioneve investigative por ende nuk ka marrë zgjidhje.

Bashkëlidhur ankesës është edhe dokumentacioni i trajtuar si më poshtë:

-Procesverbali i dorëzimit të pronës me shkresën nr. 34/1 prot., datë 17.04.2018, i mbajtur midis Drejtorisë së Pyje-Kullotave të Bashkisë Selenicë, përfaqësuar nga Drejtori z. G L, Përgjegjësi i Sektorit z. B D, Inspektorit të Kontrollit z. P H, Inspektori i Zonës z. T N dhe z. V K M si përfaqësues i trashgimtarëve ligjor i familjes "K M". Me shkresën nr. 35 prot., datë 16.02.2018, si dhe Vërtetimin Hipotekor me nr. 60, datë 13.07.2004, të trashgimtarëve ligjor:

-Në Ekonominë Pyjore Selenicë Parcela me nr. 15, me sipërfaqe 11.19 ha;

-Në Ekonominë Kullosore Karbunar-Beshisht Parcela me nr. 8, me sipërfaqe 7.51 ha;

Kufijt e Pronës në vendin e quajtur "Fushë Selenicë" parcela me nr. 15, Ekonomia Pyjore kufizohet Veri: Lomi

Jug: P P (Tokë bujqësore)

Lindje: V M (Tokë bujqësore)

Perëndim: K N

Kufijtë e Pronës në vendin e quajtur "Kotori" parcela me nr. 8, Ekonomia Kullosore Karbunar-Beshisht kufizohet:

Veri: M Ll

Jug: U A

Lindje: K B

Perëndim: K Ni

-Vendimi nr. 96, datë 28.08.2002, Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronarëve ish-Pronarëve i Prefekturës së Qarkut Vlorë i përbërë nga z. A Xh kryetar, z. A G nën/kryetar, z. Ll

Dh sekretar, znj. D N anëtar dhe z. M B anëtarë ka vendosur që t'i kthejë ish-pronarit z. K M (Trashigimtarëve të tij) sipas dëshmisë së trashgimisë me nr. 1402, datë 17.12.199, dhe nr. 22, datë 22.01.2002.

Kullotë 7.51 ha në Karbunarë-Beshisht parcela nr. 8/a;

Tokë pyjore 11.9 ha në Selenicë parcela nr. 15;

-Vërtetimi Hipotikor me nr. 60, datë 13.07.2004, figuron e regjistruar në pronësi të: z. V M, z. N M, znj. M M, znj. P M, znj. V M, znj. J M, znj. K M, znj. Z M dhe znj. S M. Pasuria ndodhet në zonën kadastrale me nr. 3285 me sipërfaqe 7.51 ha, 11.19 ha në adresën Selenicë (1. Kullotë 7.5 ha në Karbunarë-Beshisht 2. Tokë pyjore 11.19 ha).

Bashkëlidhur vërtetimit hipotekor të sipërpërmendur mungon elementi bazë siç është kartela shoqëruese e pasurisë. Në lidhje me mungesën e këtij dokumentacioni nga z. S M është paraqitur kërkesën për informacion mbi pasurinë të kryer në e-albania me nr. 20124, datë 12.04.2024. Aktualisht kjo çështje është në proces gjyqësor sipas kërkesë padisë së datë 14.09.2020, të kryer nga z. V M përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga z. S M dhe përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Avokati z. A Sh.

Për sa trajtuar më sipër në lidhje me trajtimin e ankesës së adresuar në KLSH nga z. S M deri në momenti kjo çështje është në proces gjyqësor nuk mund të japim një opinion apo rekomandim deri në shprehjen me vendim të Gjykatës në lidhje me këtë proces

VI. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2023 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në llogaritë e mësipërme janë në tejkallim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar. Për vitin 2023 totali i buxhetit është planifikuar në vlerën **783,099,827 lekë** dhe realizuar në vlerën **649,625,519 lekë** në masën 83 % ose me një **mos realizim në vlerën 133,474,308 lekë** përbëhet nga të ardhurat e veta në vlerën 92,875,507 lekë + nga transfertat e pakushtëzuar në vlerën 245,470,200 lekë + nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 80,697,349 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 165,029,362 lekë + nga transfertat e kushtëzuar për investimet në vlerën 65,553,096 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.3, germa “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor

afatmesëm” dhe VKB përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.1-2.1.5, faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me Drejtoritë e Bashkisë, të marrë masa hartojë plane të studiuara mbi realizimin e të ardhurave si bazë për planifikimin e investimeve të qëndrueshme e të sigurta për t’u realizuar, gjithashtu, plani i shpenzimeve të korrigjohet, brenda afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e detyrime të prapambetura progresive më datë 31.12.2023, është 52,894,381 lekë e përbërë nga:

- Detyrime për vendimet gjyqësore në vlerën 3,181,632 lekë;
- Detyrime për investime në vlerën 36,373,846 lekë;
- Detyrime për mallra në vlerën 4,883,544 lekë;
- Detyrime për shërbime në vlerën 6,093,501 lekë;
- Detyrime për energji elektrike në vlerën 1,354,859 lekë;
- Detyrime të tjera në vlerën 889,301 lekë;
- Detyrime të tjera nga grandit në vlerën 117,648 lekë;

Gjithashtu për vitin 2023, në gjashtë raste nga Bashkia Selenicë paraqiten vonesa në likuidimin e faturave të subjekteve. Për efekt të përlogaritjes së gjendjes së vështirësive financiare vlera e detyrimeve është 52,776,683 lekë (pa përfshirë vlerën 117,698 lekë “Detyrime të tjera nga grandit”). E cila në raport me shpenzimet faktike është 416,043,056 lekë është në masën 12.59%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, nenin 52, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.1-2.1.5, faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë pas analizës së zhvilluar lidhur me shkaqet për pagesat e vonuara, të miratojë masa specifike për të forcuar disiplinën buxhetore, kryesisht në drejtim të planifikimit buxhetor, kontrolleve financiare paraprake dhe rritjen efiçencës në kryerjen e shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, Bashkia Selenicë në një rast ka shpronësuar pasuri private me interes publik, në zbatim të projektit “Për rehabilitimin e fshatit Vajzë” në vlerën 574,482 lekë sipas USH nr. 171, datë 21.03.2023. Shpronësimi i kësaj pasurie është kryer në zbatim të VKM nr. 89, datë 03.02.2023, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe VKB nr. 50, datë 30.07.2022. Likuidimi i kësaj praktike është kryer në mungesë të dokumentacionit si më poshtë:

- Nuk disponohet çertifika e pronësisë, për numrin e pasurisë, ZK, lloji i pasurisë dhe Sipërfaqja;
- Nuk disponohet urdhri për komisionin e posaçëm nga Agjencia Shtetërore e Shpronësimit, për ndjekjen dhe realizimin e procedura të shpronësimit;
- Nuk disponohet akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Selenicë;
- Nuk disponohet kërkesa për shpronësim e cila duhej të administrohej pranë zyrës së protokollit pranë Bashkisë Selenicë nga pronari i kësaj pasurie;
- Nuk disponohet përlogaritja e shpronësimit, në zbatim të Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të pasurisë pronë private në interes publik” i ndryshuar

dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000, “Për kriteret e vlerësimit dhe përlllogaritjes të masës të shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtat e personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar me VKM nr. 395, datë 13.05.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ASHSH”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.1-2.1.5, faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Protokoll Arkivit të marrë masa për kompletimin e dosjes së shpronësimit me dokumentacionin e munguar, konkretisht: certifikata e pronësisë, akt-marrëveshja midis ASHSH dhe Bashkisë Selenicë, dokumenti për përlllogaritjen e shpronësimit dhe urdhri për komision të posaçëm nga ASHSH për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Deri më datë 30.04.2025

4. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Selenicë kryhet në programin Excel. DAPPLL kryhen regjistrim manual të të dhënave (*nuk disponon regjistra fizik*). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Selenicë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DAPPLL për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë për ndryshim të dhënash, edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit, të marrin masa për planifikimin e fondeve për blerjen e një programi kompjuterik ku të përfshihet Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave për mbajtjen veprimeve kontabël dhe të detyrimeve fiskale me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për hartimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentët familjarë më të gjitha detyrime vjetore që ato kanë në zbatimin të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 114,592,854 lekë dhe realizimi në vlerën 97,651,182 lekë ose në masën 85.2% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën 16,941,672 lekë. Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura të debitorëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2

dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm, arkëtimet nga detyrimet e prapambetura si dhe të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave, të ardhurat nga agjentët tatimorë (ASHK Vlorë në lidhje taksën mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, Drejtoria Rajonale e Tatime Vlorë në lidhje me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe DSHTRR Vlorë në lidhje me taksat vendore të qarkullimit për mjetet e përdorura dhe Dogana Vlorë për rentën minerale) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Selenicë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Vlorë. Bashkia Selenicë ka të dhëna vetëm për vlerën e arkëtuar nga këta agjentë, sipas vlerës së depozituar në thesar, por nuk ka bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimor dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre. Gjithashtu nuk janë mbajtur akt-rakordime me DSHTR Vlorë, DRT Vlorë dhe ASHK Vlorë për vitin 2023. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 15, Udhëzimin nr. 32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifave vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjëbajtjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Bashkia Selenicë për vitin 2023 nuk disponon listën e sipërfaqeve të tokës tepër kaluar “Shtet” nga ASHK, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të legalizuara dhe për diferencat midis AMTP dhe LN sipërfaqes faktike në terren, sipas formularit nr. 6, dhe normës për frymë. Kështu, tokat “Shtet” kanë mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilat shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin, ç’ka tregon punë jo efektive, mos-menaxhim dhe administrim të

tyre si dhe mungesë bashkëpunimi të bashkisë me ASHK. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë të kërkojë nga ASHK Vlorë listën e sipërfaqeve të tokës tepër kaluar “Shtet” nga ASHK sipas subjekteve, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të legalizuara dhe për diferencat midis AMTP dhe LN sipërfaqes faktike në terren, për efekt të menaxhimit dhe administrimit tyre nga pushteti vendor Selenicë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, nga Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave nuk janë mbajtur procesverbalet në terren për verifikimin e statusit të subjekteve të paregjistruara në QKB. Për vitin 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 103 subjekte “Biznes i vogël” të pa regjistruara në QKB. Këto subjekte në pjesën më të madhe janë dyqane, bar-kafe, ambulant, profesione përziera të cilët ushtrojnë aktivitet shërbimi dhe në disa raste sezonale. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, nenet 22, 48-49. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave (sektori i kontrollit në terren), të planifikojë inspektime në terren në lidhje me statusin e subjekteve, në qoftë se konstatohen subjekte që ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB t’u përlllogariten taksat dhe tarifatat vendore përkatëse.

Deri më datë 30.04.2025

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të biznesit të madh konstatohet se, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave për 6 subjekte ka lëshuar vërtetime për efekt dokumenti se këto subjekte nuk janë debitor ndaj Bashkisë Selenicë, ndërsa në fakt rezultojnë debitor për vlerën totale prej 8,727,411 lekë, përkatësisht:

-Në dosjen e subjektit “S M” Shpk u konstatua se, i është lëshuar padrejtësisht vërtetimi me nr. 1443, datë 06.06.2022, se nuk është debitor për efekt dokumenti ndaj Bashkisë Selenicë, ndërsa në fakt rezulton debitor për 1,000,000 lekë për vitin 2022, sipas shkresës nr. 1589 prot., datë 20.06.2022, nënshkruar nga Drejtori DAPPLL Taksave. E F dhe ish-Kryetari Bashkisë z. P B.

-Në dosjen e subjektit “M P” Shpk u konstatua se, disponohet njoftimi nr. 1332, datë 10.06.2023, për shlyerjen e 600,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023 brenda korrikut 2023, por nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave (MA), ndërsa për vitin 2020 disponohet mandati i bankës, në këto kushte ka marre vërtetimin nr. 2568, datë 17.11.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga Drejtori Taksave e Tarifave Vendore E F dhe Kryetari Bashkisë z. P B.

-Në dosjen e subjektit “BS C” Shpk u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 56, datë 12.06.2023, për shlyerjen e vlerës 1,300,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 1,370,000 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura (MA). Në këto kushte ka marre vërtetimin nr. 892, datë 18.04.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. P B. Madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 894, datë 18.04.2023, për zhblllokim bankar BKT (2018) që ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 gjatë periudhës së auditimit, bashkëngjitur 2 shkresat fotokopje dhe lista e debitorëve prapambetur. Gjithashtu disponohet edhe vërtetimi nr. 2567, datë 17.11.2023, se nuk është debitor ndaj Bashkisë Selenicë, nënshkruar nga kryetari aktual z. N B.

-Në dosjen e subjektit “**M B**” Shpk u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 1112, datë 22.05.2023, për shlyerjen e vlerës 1,966,750 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 4,557,411 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura.

Në këto kushte ka marrë vërtetim nr. 2446, datë 06.11.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. A H, zv/kryetar bashkisë, madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 2367, datë 26.10.2023, për zhbllokim bankar, pasi subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 të periudhës së auditimit. Dosja nuk ka inventar të dokumentacionit dhe nuk janë arkivuar, fenomen dhe për rastet tjera, në kundërshtim me nenin 30, të Modelit nr. 8, “*Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor Republikën Shqipërisë*” miratuar nga Drejtoria Përgjithshme Arkivave në zbatim nenit 3 dhe 29 Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “*Për Arkivat*”.

-Në dosjen e subjektit “**S B**” Sh.a u konstatua se, disponohet disa njoftime ndër ta dhe njoftimi nr. 1331, datë 19.06.2023, për shlyerjen e 1,800,000 lekë të taksave vendore të vitit 2023, por nuk njoftohet për detyrimet e prapambetura për vlerën debitorë prej 5,314,702 lekë, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave 2023 dhe të prapambetura (MA). Në këto kushte subjekti ka marrë vërtetimin nr. 24476, datë 06.11.2023, se nuk është debitor, nënshkruar nga z. A H, zv/kryetar bashkisë, madje ka lëshuar dhe shkresën nr. 2366, datë 26.10.2023, për zhbllokim bankar, pasi subjekti ka likuiduar të gjitha detyrimet, kur ai është debitor sipas të dhënave të taksave të raportuara gjatë majit 2024 të periudhës auditimit. Dosja nuk ka inventar të dokumentacionit.

-Në dosjen e subjektit “**Y. S**” Shpk u konstatua se, nuk ka dokument të bankës për shlyerjen e taksave (MA), në këto kushte ka marrë vërtetim nr. 2650 prot., datë 01.12.2023, se nuk është debitor nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë z. N B. (*Më hollësisht trajtuar në nënplikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi pune me specialist fushe (duke përjashtuar punonjësit e DAPPLL) për verifikimin dhe rakordimin e gjendjes debitore për subjektet të cilëve është lëshuar vërtetimi për mos pasje detyrimesh për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Selenicë ndërkohë që janë debitorë. Në rast se kjo problematikë evidentohet përgjatë këtij procesi të merren masa për përlllogaritjen e detyrimeve në vlerën 8,727,411 lekë si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit sipas vlerave përkatëse.

Deri më datë 31.12.2024

9.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave të marrë masa për plotësimin me dokumentacionin përkatës ligjore të dosjeve të subjekteve të biznesit të madh dhe atij të vogël, duke kryer njëkohësisht edhe inventarizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Selenicë janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

a) Pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit nuk është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej nëpunësit autorizues të institucionit.

b) Nga komisioni për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit i ngritur me Urdhrin nr. 155, datë 16.11.2023, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë janë mbajtur procesverbalet përkatëse të datës

23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve në vlerën 93,153 lekë. Nga të dhënat e evidentuara në procesverbalet e sipërpërmendura nuk vërtetohet dhe justifikohet me dokumentacion, mënyra e asgjësimit, transportit si dhe vendi në të cilën është kryer asgjësimi i aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

c) Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procesin e asgjësimit të aktiveve, u konstatua se, në listë e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit ka materiale të cila konsiderohen të dëmshme (pajisje elektrike dhe elektronike), për të cilat hedhja apo asgjësimi i tyre, duhet të kryhet me një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore. Nga Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e transportit, asgjësimit të tyre, nuk disponohet asnjë korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe groposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe impaktin që kanë në komunitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”, i ndryshuar, VKM nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, Kreu I, pika 1 dhe pika 2, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 73-74, pika 81-110 dhe pika 122. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Nga komisionet e inventarizimit të aktiveve pas përfundimit të procesit të inventarizimit të paraqitet para Nëpunësit Autorizues raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit.

10.2. Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysht kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit të rregullt dhe justifikues sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2023, konstatohet se nuk është kryer pakësim i vlerës 93,153 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023.

b) Nga auditimi konstatohet se, më datë 31.12.2023, në gjendjen e llogarisë 215 “Mjete transporti” është përfshirë vlera prej 9,057,580 lekë që i përket automjeteve të dëmtuara të cilat nuk janë në gjendje pune, referuar relacionit të datës 03.01.2024, dhe procesverbaleve të vlerësimit të aktiveve të datës 01.12.2023, 23.12.2023, dhe 28.12.2023, në kushte të tilla këto aktive duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera totale e sipërpërmendur 9,057,580 lekë e cila i përket koston historike mjeteve

të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marren masa që në pasqyrat nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe pasqyrës nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2024, të kryhet pakësimi i vlerës 93,153 lekë që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në pasqyrat financiare të vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës totale prej 9,057,580 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përket llogarisë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimin kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Deri më datë 31.03.2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të Klasës 4, konkretisht llogarive të arkëtueshme konstatohet se:

-Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 70,005,368 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 70,005,368 lekë. Në kartelën analitike evidentohet e analizuar vetëm vlera 40,244,665 lekë. Diferenca në vlerën 29,760,703 lekë është e kontabilizuar në këtë llogari me emërtimin “Debitorë nga taksat dhe tarifat vendore”, e cila duhej të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.2, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 5 “Llogaritë financiar”.

-Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 180,033,022 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 236,324,467 lekë me një rritje në vlerën 56,291,445 lekë. Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë vlera 219,268,974 lekë e cila i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe për pasojë kjo llogari nuk paraqet situatën reale debitore duke e nënvlerësuar këtë llogari me 219,268,974 lekë. Mos kontabilizimi i plotë i të gjithë debitorëve shoqërohet me rrezikun e humbjes së gjurmës së auditimit për debitorët, rrezikon humbjen e së drejtës së njësisë vendore për kërkimin e detyrimit në vazhdimësi. Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespondencë ndërmjet Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit. Gjithashtu në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë” me kundërparti llogarinë 468 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, pika 7, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

-Gjendja e llogarisë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 75,928,024 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2023, në vlerën 87,407,780 lekë me një rritje në vlerën 11,479,756 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa dhe sigurime

shoqërore dhe furnitorë e llogari të lidhura me to dhe nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 69,043,253 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë 470 “Llogari në pritje-të ardhura për t’u marrë”.

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të paraqesë saktë vlerat e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, ku në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 87,407,780 lekë, e cila nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Deri më datë 31.03.2025

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” konstatohet se, për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene” është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 58,000 lekë kur bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen. Në kushte të tilla për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi. Duke e nënvlerësuar këtë llogari në vlerën 58,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në pasqyrat financiare të vitit 2024 të bëjë sistemimin e vlerës 58,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” konstatohet se, në vitin 2016 janë transferuar inventarë në vlerën kontabël 526,501,279 lekë në Ujësjellës Selenicë Sh.a (sot pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë), por për këtë nuk janë hartuar procesverbale të marrjes në dorëzim midis dy institucioneve dhe këto aktive ekzistojnë ende në pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë kjo situatë e konstatuar edhe në auditimet e mëparshme të zhvilluara nga KLSH por rezulton e njëjta situatë, pra nuk janë marrë masa për hartimin e dokumentacionit të dorëzimit dhe marrjes së aktiveve midis Bashkisë Selenicë dhe Ujësjellësit Sh.a. Nuk janë hartuar procesverbale dorëzimi për aktivet transferuara nga dy institucionet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e

sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35-36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14. Rekomandimi: Nga Bashkia Selenicë të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjiellës Selenicë për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet i efekteve të transferimit.

Deri më datë 31.03.2025

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” është përfshirë vlera prej 31,079,786 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 15,757,820 lekë; 210 “*Tokë, troje, terrene*” është përfshirë vlera prej 140,307,952 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 58,000 lekë; 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” është përfshirë vlera prej 282,322,171 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 45,581,320 lekë; 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” është përfshirë vlera prej 1,570,622,458 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 260,837,855 lekë; 214 “*Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune*” është përfshirë vlera prej 11,853,994 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 5,399,691 lekë; 215 “*Mjete transporti*” është përfshirë vlera prej 11,678,180 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 10,799,192 lekë dhe 218 “*Inventar ekonomik*” është përfshirë vlera prej 38,702,608 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 19,379,921 lekë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Sevaster, Brataj, Kotë, Armen dhe Vllahinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” u konstatua se, kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 530,578 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Selenicë me Nipt K47127201C është 17,396,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë me Nipt M37202202E. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Selenicë është 530,578 ose 3.05% ($3.05 * 17,396,000 / 100 = 530,578$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale*” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe*

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

Deri më datë 31.03.2025

17. Gjetje nga auditimi: a) Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Selenicë në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 35,733,436 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, rakorduar me Degën e Thesarit Vlorë. Nga auditimi i evidencave analitike të llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" evidentohen vlera të kontabilizuara me emërtimin "Pa origjinë" apo "Kaluar gabim nga të ardhurat" në vlerën totale prej 764,810 lekë, për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre të cilat mbahen të mbartura dhe të trashëguara vit pas viti në kontabilitet si dhe nuk janë të verifikueshme çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë për shkak të mos përshkrimit të objektit që i përket kthimit të garancisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu 3, Pika 3.3, "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)".

b) Për 43 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë janë ngurtësuar fonde në vlerën 18,800,834 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Vlorë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 18,800,834 lekë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për vlerën 764,810 lekë të pa analizuar në kontabilitet që i përket llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", me qëllim evidentimin dhe raportin e saktë në dokumentet kontabël të Njësisë.

Deri më datë 31.03.2025

17.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 2,401,723,271 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b

“Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” në vlerën 10,818,675 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 720,498 lekë sipas llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” debitohet për pakësimin e vitit në vlerën 0 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2023 në vlerën 115,350,035 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”. Sipas informacionit kontabël llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” është nënvlerësuar në vlerën 1,440,996 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të merren masa që në pasqyrat financiare të vitit 2024 të kryej kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

Deri më datë 31.03.2025

19. Gjetje nga auditimi: a) Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative të aplikuar për vitin 2023 nga Bashkia Selenicë miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë konstatohet se, shtatë punonjës me detyrë Inspektor Terreni për Pyje dhe Kullota, pjesë e Sektorit të Mbrojtjes dhe Kontraktimit të Pyje/Kullotave, të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës me anë të kontratave individuale të punës në zbatim të Kodit të Punës, të punësuar pranë Bashkisë Selenicë që prej vitit 2015, niveli i diplomave arsimore të tyre nuk përputhet me nivelin e arsimit të përcaktuar në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, neni 16, pikat 3-4.

b) Nga auditimi me zgjedhje i 30 dosjeve të personelit të punësuar përgjatë vitit 2023 por edhe më parë kësaj periudhe konstatohet se, për një punonjës me profesion elektrikist pranë Drejtorisë së Shërbimeve Utilitare dhe Administrative, Sektori i Shërbimit dhe Pastrimit nuk është i pajisur me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, gërma “a”.

c) Nga auditimi me zgjedhje i borderove, listë prezencave ditore, listë pagesave për muajt janar, mars, qershor, tetor, nëntor të vitit 2023 konstatohet se, për njëqind e njëzetë punonjës që rregullojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet kontratave individuale të punës në zbatim të Kodit të Punës nuk është përlllogaritur vjetërsia e punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 53-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa që, emërimet e Inspektorëve të Terrenit për Pyje dhe Kullota të kryhen në përputhje me kriteret e parashikuara në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, duke synuar mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.

19.2. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Selenicë të merren masa për pajisjen e punonjësit që punon në pozicionin e punës elektrikist pranë Drejtorisë së Shërbimeve Utilitare dhe Administrative, me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të parandaluar çdo ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së tij.

19.3. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të merren masa që në buxhetin e vitit të ardhshëm, të parashikohen fonde për

shlyerjen e detyrimeve si rezultat i mos përllogaritjes së vjetërsisë së punës për 120 punonjës (sipas të dhënave të evidentuara në pikën nr. 2.2), që i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Selenicë për periudhën objekt auditimit konstatohet se, sipas VKM-ve përkatëse janë transferuar **2,866 pasuri** nga të cilat **86 në përdorim**.

-Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*", neni 37, pika 1, ku përcaktohet që: "*Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji*".

Në zbatim të Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001, "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore*" si dhe në mbështetje të pikave 9-11, dhe 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore*", nuk janë ngritur grupet e punës, kjo e përcaktuar në misionin dhe detyrat e NJQV, administrimi i aseteve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre.

-Bashkia Selenicë nuk ka një regjistër kontabël në nivel bashkie për të gjitha asetet që ajo zotëron. Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar totalisht si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, me ndarjen e re territoriale Bashkisë Selenicë i janë shtuar 6 njësi Administrative, respektivisht: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevaster dhe Brataj.

-Nga auditimi konstatohet se nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (*toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.*), dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", nenet 27-28, parashikohet se, funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, funksionet e bashkisë në fushën e zhvillimit ekonomik vendor.

Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave të transferimit në NJQV, vënien në evidence të ndërtesave me sipërfaqe dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive të përcaktuara në listat e inventarëve, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira.

-Bashkia Selenicë nuk ka prona të pajisura me certifikatë pronësie, nuk ka nisur asnjë procedurë për aplikimin dhe regjistrimin e pronave pranë DVASHK Vlorë, si dhe nuk ka prona në proces regjistrimi.

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve Financiar & Arkiv Protokollit, në lidhje me trojet, ndërtesat dhe sheshet publike, nuk kemi raste të zaptimit të trojeve në administrim të Bashkisë Selenicë.

-Në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Selenicë të miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë nuk ka drejtori të Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve,

detyrat e të cilës i kryen Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave.

-Përsa i përket këtyre pronave nga Bashkia Selenicë pretendohet se problematikat e mos regjistrimit janë të natyrave të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre praktikave janë të pa trajtuara nga ana e DVASHK Vlorë, ka mbivendosje të pronave, mungesë të ardhurash për të bërë aplikim në kadastër.

-Për 6 njësitë administrative konstatohet se nuk ka prona që janë regjistruar pranë DVASHK Vlorë, ndërsa gjatë vitit 2023 nuk kemi asnjë procedurë të nisur për regjistrim të tyre. Për periudhën e audituar nga informacionet e mara nga subjekti nuk rezulton të këtë shitje të asetëve. Për më tepër në buxhetin e vitit 2023, miratuar me VKB-në nr. 80, datë 27.12.2022, nuk janë parashikuar fonde për pajisjen me titull pronësie të pasurive të institucionit.

-Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 212 “*Ndërtesa e kontruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” të kontabilizuara në pasqyrat financiare asnjë prej tyre nuk është pajisur me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pika 35, gërmat “a”, “b”, “c”, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare, nuk është i mbështetur me dokumentacionin e duhur ligjor.

-Nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjitha pasurive të cilat janë transferuar sipas VKM-ve përkatëse prej 2,391 pasuri që i përkasin llogarisë 210 “*Toka, troje, terrene*”, 212 “*Ndërtesa e kontruksione*” dhe 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për ngritjen e Strukturës së Menaxhimit të Pronave, për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia të transferuara me VKM, duke përcaktuar detyra konkrete dhe me përgjegjësi në Rregulloren e Brendshme të bashkisë për miradministrimin e pronave për verifikim fizik të tyre dhe ndjekjen e procedurave për regjistrim me asistencën e DVASHK-së Vlorë. Gjithashtu Drejtoria e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit, të përditësojë regjistrin kontabël duke kryer të gjithë kontabilizimin e asteve të bashkisë me vlerën aktuale që ato kanë.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, referuar VKM-së nr. 433, datë 08.06.2016, “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive*”, ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020 “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike*” Bashkia Selenicë ka në pronësi 16,633.1 ha kullota.

-Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Selenicë që nga transferimi i këtyre sipërfaqeve nuk ka iniciuar procedura për regjistrimin e kësaj sipërfaqe dhe më pas kalimin në fazën tjetër atë të pajisjes me certifikatën e pronësisë për sipërfaqet pyjore, kullosore dhe shkëmbore etj., që administrojnë në kundërshtim me VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016, “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, pika 57, shtojca me nr. 55, pika 64, pika 65, ku Ministri i Mjedisit dhe kryetarët e bashkisë duhet të përcaktojnë personat përgjegjës si anëtarë komisioni të përbashkët brenda 20 ditëve puna nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për transferimin e pronave nga Ministria e Mjedisit pranë Bashkisë Selenicë...

-Nuk janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (*toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.*) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

-Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), në referim të Ligjit 5 “Planet e Mbarështimit”, nenin 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, nenin 15/2 “*Pronësia e Fondit Pyjor*” të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar.

-Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “*Pyjet, kullotat dhe plantacione*”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara.

-Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes, sipas Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “*Për fondin kullor*”, neni 29 “*Organet e kontrollit*”, neni 30 “*Dokumentimi*”.

Në përfundim, dhënia me qira e sipërfaqeve pyll dhe kullota vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV*”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “*Për inventarizimin e pronave në NJQV*”, Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota, të kufizuara.

-Për këtë sezon nuk është shfrytëzuar e gjithë sipërfaqja kullimore e miratuar me VKM, duke mos miratuar dhe shpallur për dhënie me qira e gjithë sipërfaqja kullimore që ka në pronësi Bashkia Selenicë, gjë e cila çon në mungesë të ardhurash për këtë bashki. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave, të marrë masa për përdorimin e sipërfaqeve pyjore/kullimore me kontratë dhe monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces në kohë. Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit dhe Drejtorinë Juridike Bashkia Selenicë, të marrin masa për evidentimin dhe regjistrimin në DVASHK Vlorë dhe kontabilitet të sipërfaqeve pyjore/kullimore të transferuara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me zbatimin e kontratave për dhënie me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor në territorin e Bashkisë Selenicë, më datë 04.06.2024, u kryer një verifikim në terren ku u konstatua se, përgjatë aksit Bashaj-Vërmik janë kryer ndërhyrje në aksin/trasënë ekzistuese si pastrime të rëshqitje të dherave apo gurëve, sistemim (sheshim) rruge dhe mbushje në segmente të caktuara të aksit me çakull. Këto punime janë kryer nga individë privatë të cilët nuk janë të pajisur me leje infrastrukturore në Bashkinë Selenicë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 11/1, pika 1 dhe 2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Selenicë të merren masa për verifikimin e situatës së konstatuar nga grupi i auditimit, të mbahet process-verbali i konstatimit të kundërvajtjes, nëse konstatohen shkelje, si dhe të ndiqen të gjitha hapat e parashikuar në dispozitat ligjore, sipas rastit, siç janë nxjerrja e vendimit të dënimit me masë administrative gjobë, vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, kallëzim penal për kundërvajtësin, etj. Nga ana e IMTV të merren të gjitha masat për të bashkëpunuar me autoritetet e tjera vendore dhe qendrore, për identifikimin e kundërvajtësit.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitetet minerar brenda fondit pyjor kullësor dhe në pasuritë pronë të institucionit **15 subjekte**. Referuar akt-verifikimeve të mbajtura në terren dhe raporteve tekniko-ekonomiko financiare të hartuara nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 209, datë 23.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë, sipërfaqja e shfrytëzimit faktik është **97.1238 ha** sipas tipologjisë tokë arë, inproduktive, e pa frytshme dhe kullotë (pjesë të fondit pyjor kullësor dhe ato privatë të përfituara në zbatim të Ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”) që prej fillimit të lejeve dhe deri në muajin mars të vitit 2024. Nga këto subjekte nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit, për rehabilitimin e sipërfaqes prej **136.5686 ha** sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës në rakordim me sipërfaqen e shfrytëzueshme të karrierës. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në neni 37, pikat 2-3, dhe Urdhrin nr. 1937, datë 21.10.2014, të Ministrit të Mjedisit me objekt “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullësore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullësor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre”, pika 1-3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë të marrë masa të menjëhershme që, t’u kërkojë subjekteve që ushtrojnë aktivitetet minerar në fondin pyjor kullësor, zbatimin e kushteve të akt-miratimit të lejes së shfrytëzimit për rehabilitimin e sipërfaqes sipas koeficientit të rehabilitimit dhe tipologjisë së tokës në rakordim me sipërfaqen e shfrytëzueshme të karrierës.

Menjëherë dhe në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Selenicë administruar në KLSH me nr. 766/19 prot., datë 21.12.2023, dhe protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 1964/52 prot., datë 26.12.2023, ku janë lënë për zbatim **28 masa** organizative, **11 masa** për shpërblim dëmi në vlerën **8,114,599 lekë**, **5 masa** për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të tyre janë rekomanduar në vlerën **198,694,475 lekë**, **9 masa** për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në vlerën **110,050,961 lekë**, **6 masa** për uljen e borxhit tatimor në vlerën **434,649,309 lekë**, **9 masa** disiplinore dhe **3 masa** administrative.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 28 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, 5 masa janë në proces zbatimi dhe 22 masa janë të pa zbatuara.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 11 masa në vlerën 8,114,599 lekë të cila është janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht (ku është arkëtuar vlera 609,640 lekë) dhe 10 masa janë të pa zbatuara.

c. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të tyre janë rekomanduar 5 masa në vlerën 198,694,475 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë të pa zbatuara.

d. Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara janë rekomanduar 9 masa në vlerën 110,050,961 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 9 masa janë të pa zbatuara.

e. Për uljen e borxhit tatimor janë rekomanduar 6 masa në vlerën 434,649,309 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 6 masa janë të pa zbatuara.

f. Masa disiplinore janë rekomanduar 9 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 6 masa zbatuar plotësisht, 3 masa janë të pa zbatuara.

g. Masa administrative janë rekomanduar 3 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 3 masa janë të pa zbatuara.

-Gjithashtu nga Bashkia Selenicë nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në KLSH duke mos respektuar kështu edhe afatin 6 mujor.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 125-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përshpejtimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

a. Për 1 masë organizative të zbatuar pjesërisht, dhe 22 masa të pa zbatuara: nr. 1.1, 1.2, 1.3, 3.1, 4.1, 4.2, 5.1, 5.2, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 12.1, 12.2, 13.1, 14.1, 14.2, 15.1, 15.2, 19.1, dhe 11.1.

b. Për dhe 10 masa shpërblim dëmi të pa zbatuara nr. 1.1, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2, 3.3, 4.1, 5.1, 7.1, 8.1.

c. Për 5 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të tyre të pa zbatuara nr. 1.1, 2.1, 3.1, 3.2, 3.3.

d. Për 9 masa të pa zbatuara, për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara në vlerën 110,050,961 lekë nr. 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 3.1, 3.2, 4.1, 5.1, 5.2.

e. Për 6 masa të pa zbatuara për uljen e borxhit tatimor nr. 1.1, 1.2, 2.1, 2.2, 3.1, 3.2.

f. Për 3 masa disiplinore nr. 2, 4, 9.

g. Për 3 masa administrative nr. 1, 2, 3.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENTË DHE EFTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, deri më 31.12.2023, vlera e detyrimeve për 13 vendime gjyqësore është 3,181,932 lekë e përbërë nga:

-Vlera 2,664,968 lekë detyrime nga vendimet gjyqësore për dëmshpërblim page, për 10 punonjës të larguar nga puna, ç’ka ka shkaktuar dublim pagese për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë **ndikim negativ në Buxhetin e Bashkisë Selenicë për vlerën 2,664,968 lekë;**

-Vlera 516,964 lekë detyrime për 3 vendime gjyqësore për tre subjekte detyrime kontraktore; Përveç detyrimeve gjyqësore të mbartura ndër vite, Bashkia Selenicë për vitin 2023 paraqet shtesa për vlerën 4,660,531 lekë për disa vendime gjyqësore për largim nga puna, për detyrim kontraktual, për tarifa përmbartimore, për tarifë avokati dhe diferenca tjera, si dhe ka likuiduar detyrimin në vlerën **9,278,076 lekë e cila konsiderohet efekt negativ financiar për Buxhetin e Bashkisë Selenicë** e përbërë nga:

-Vlerën 6,318,280 lekë për vendime gjyqësore për llogari të viteve mëparshme para vitit 2023;

-Vlerën 2,959,796 lekë për vendimet e hyra në vitin 2023;

Nga auditimi konstatohet se vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga ish-Kryetari i Bashkisë dhe kryetari aktual nuk është kërkuar prej tyre nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive

administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare me efekt negativ në buxhet. Këto janë veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60, me Udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011, “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe UMFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.1-2.1.5, faqe 19-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023 në territorin e Bashkisë Selenicë kanë ushtruar aktivitet 6 subjekte “Biznes i madh” por pa u pajisur me Nipt sekondar ku 2 prej tyre nuk kanë likuiduar taksat vendore për **vlerën 198,200 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Selenicë** përkatësisht: OE “A” Shpk në vlerën 113,200 lekë dhe OE “K” Shpk në vlerën 85,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, nenet 22. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Selenicë të pa pajisur me nipt sekondar në shumën **198,200 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë me pakicë hidrokarburet dhe nënproduktet e tyre në territorin e Bashkisë Selenicë konstatohet se për vitin 2023, pesë subjekte nuk kanë shlyer detyrimet për licencat e tregtimit të hidrokarbure në vlerën **2,850,000 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Selenicë**, pasi nga 6,000,000 lekë detyrimi i kontabilizuar, kanë paguar 3,150,000 lekë dhe mbeten për t’u paguar vlera 2,850,000 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 35, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, Kapitulli II, Kapitulli III, pika 4, me VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II/1/b, me VKM nr. 344, datë

19.04.2017, për disa ndryshime në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, pika 15.1 “Për përcaktimin procedurave dhe kushteve për dhënien licencave për tregtimin naftës bruto dhe nënprodukteve saj”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e **vlerës prej 2,850,000 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit ndaj debitorëve:

- Subjekti “T O” për vlerën 600,000 lekë;
- Subjekti “M O” për vlerën 750,000 lekë;
- Subjekti “P” Shpk për vlerën 200,000 lekë;
- Subjekti “Xh G” për vlerën 700,000 lekë;
- Subjekti “M” Shpk për vlerën 600,000 lekë;

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Selenicë në mënyrë progresive më datë 31.12.2023, janë në vlerën **455,593,441 lekë** të përbëra nga:

- Taksa tokës bujqësore 268,483,775 lekë për 7,847 familje;
- Taksa e ndërtesës 12,532,976 lekë për 7,847 familje;
- Tarifë pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, 34,997,739 lekë për 7,964 familje;
- Taksa ndikimit infrastrukturës 6,938,018 lekë për 262 debitor;
- Taksa e biznesit madh 68,983,784 lekë për 43 debitor;
- Taksa e biznesit vogël 41,608,821 lekë për 479 debitor;
- Taksa dhe tarifa tjera të grupuara 22,048,328 lekë;

Bashkia Selenicë nuk ka ndërmarrë veprime administrative ose ligjore për arkëtimin e tyre, duke i lënë këto debitorë në heshtje dhe të kalojnë në debitorë pa shpresë arkëtimi, duke kaluar afati i kërimit të tyre në rrugë gjyqësore.

Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave nuk i ka kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake dhe strukturave të tjera, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja “ç” nënpika “iii”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”. Nuk është zbatuar pika 5/3.4 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”.

DAPPLL nuk ka aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të nenit 17, pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Kreu XIV, neni 114.

- Nuk është bashkëpunuar me DRT Vlorë për arkëtimin e debitorëve të subjekteve biznes i madh.
- Për rastet e bizneseve private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë që nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, nuk janë marre masat administrative apo sekuestro, kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.1.6 faqe 35-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën totale **455,593,441 lekë**, e përbërë nga:

- 268,483,775 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7,847 familje;
- 12,532,976 lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 7,847 familje;
- 34,997,739 lekë detyrime për tarifën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit për 7,964 familje;
- 34,997,739 lekë detyrime për tarifën e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit për 7,964 familje;
- 6,938,018 lekë detyrime për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 262 persona;
- 68,983,784 lekë detyrime nga biznesi i madh për 43 subjekte;
- 41,608,821 lekë detyrime nga biznesi i vogël për 479 subjekte;
- 22,048,328 lekë detyrime nga taksa dhe tarifa të tjera të grupuara;

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.01.2023, deri më 31.12.2023, nuk ka kontrata aktive për dhënien me qira të sipërfaqeve të fondit pyjor kullor për ushtrimin e veprimtarisë për ndërtim Hec-i. Nga auditimi konstatohet se:

a) Ndërmjet Subjektit “H V” Shpk me Nipt L.....V me përfaqësues znj. L D dhe Bashkisë Selenicë përfaqësuar nga z. P Sh është lidhur kontrata e qirasë me nr. 748 prot., datë 28.03.2017, për dhënien në përdorim sipërfaqen prej 7.1001 ha e cila është pjesë e fondit pyjor/kullor publik bashkiak, në Ekonominë Pyjore Çipin dhe Ekonominë Kullorë Kuç-Mesaplik sipas ngastrave në raportin teknik, për ushtrimin e veprimtarisë “Të mundësojë ndërtimin e Hec-eve”. Afati i kontratës është për një periudhë 2 vjeçare duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me vlerë qiraje vjetore prej 2,199,706 lekë për çdo vit.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia Selenicë i jep të drejtën subjektit “H V” Shpk të drejtën për të përdorur edhe sipërfaqen prej 0.2378 ha për ndërtimin e Hec-eve 1, 2, 3 e cila është pjesë e fondit pyjor publik e cila ndodhet në Ekonominë Pyjore Çipin në ngastrat 14, 2, 83, 80 të cilat do të hiqen nga fondi pyjor dhe do të përdoren nga ana e qiramarrësit për të gjithë kohën e zgjatjes së kësaj kontrate.

Me transaksionin e datës 27.03.2017, në San Paolo Bank është likuiduar detyrimi i vitit të parë të kontratës në vlerën 2,199,706 lekë. Ndërkohë që nga Subjekt “H V” Shpk nuk është likuiduar detyrimi që i përket vitit të dytë të kontratës duke **krijuar detyrime të pa paguara ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën 2,199,706 lekë.**

b) Ndërmjet Subjektit “H V” Shpk me Nipt L.....V me përfaqësues znj. L D dhe Bashkisë Selenicë përfaqësuar nga z. P Sh është lidhur kontrata e qirasë me nr. 466 prot., datë 19.02.2019, për dhënien në përdorim sipërfaqen prej 4.7 ha e cila nuk është pjesë e fondit pyjor/kullor por është pronë e bashkisë, në Ekonominë Pyjore Çipin dhe Ekonominë Kullorë Kuç-Mesaplik sipas ngastrave në raportin teknik, për ushtrimin e veprimtarisë “Të mundësojë ndërtimin e Hec-eve”. Afati i kontratës është për një periudhë 2 vjeçare duke filluar nga data e lidhjes së kontratës me vlerë qiraje vjetore prej 1,521,600 lekë për çdo vit.

Nëpërmjet kësaj kontrate Bashkia Selenicë i jep të drejtën për përdorimin e sipërfaqen e sipërpërmendur për ushtrimin e veprimtarisë “Për ndërtimin e Hec-eve 1, 2, 3, 4” vetëm sipas qëllimit dhe sipërfaqes të miratuar nga bashkia për ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesave të përcaktuara në kontratës.

Nëpërmjet trasaksionit të Degës së Thesarit Vlorë datë 13.02.2019, është kaluar për llogari të Bashkisë Selenicë vlera 1,521,600 lekë për likuidimin e detyrimit të vitit të parë të kontratës nga Subjekt “H V” Shpk. Ndërkohë që nga Subjekt “H V” Shpk nuk është likuiduar detyrimi që i përket vitit të dytë të kontratës duke **krijuar detyrime të pa paguara ndaj Bashkisë Selenicë në vlerën 1,521,600 lekë.** Në lidhje me këtë situatë Bashkia Selenicë është drejtuar me shkresën nr. 571/1 prot., datë 02.04.2024, Subjektit “H V” Shpk për shlyerjen e detyrimeve në vlerën totale

prej 3,721,306 lekë në zbatim të angazhimeve të parashikuara në kontratat e sipërpërmendura. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës së detyrimit sipas kontratave të qirasë të sipërfaqeve të fondit pyjor kullosor për ushtrimin e veprimtarisë për ndërtim Hec-i në shumën **3,721,306 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të subjekteve që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Selenicë të administruara nga Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave (DZHBAPK), konstatohet se këto leje nuk përputhen plotësisht me kontratat e paraqitura nga subjekti Bashkia Selenicë.

Për periudhën objekt auditimi nga Bashkia Selenice nuk është shpallur lista për dhënien në përdorim e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, për punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër e për gjueti, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, në referencë të Ligjit nr 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar, neni 19, pika 1.

Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Selenicë, për periudhën objekt auditimi për subjektet të cilat nga MIE kanë marrë leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore nuk ka hapur dosje të veçantë, **ku në to të administrohen kërkesa nga subjekti për zbritjen nga fondi pyjor** në referencë të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

Kërkesa për zbritjen nga fondi pyjorë në referencë të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimin të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar, sipas pikës 5, gërmat “c” dhe “ç”, duhet të shoqërohet me planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si dhe kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit dhe miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore, e cila do t'u nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor, dokumente të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes, pika 7.

Në zonën Pyjore e Kullosore pronë e Bashkisë Selenicë janë aktive leje minerare që kryejnë aktivitetin shfrytëzim Bitum, Rërë Bituminoze, Zhavorr bituminoz, Gur gëlqeror, e Gëlqeror i mermerizuar **15 subjekte** si më poshtë:

1. Subjekti “S B” Shpk me Nipt K.....M i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 355/1, datë 17.06.1997, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit bitum dhe zhavor bituminoz me sipërfaqe 1.543 km² (154.3 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “S B” Shpk për sipërfaqen 102.4791 ha është **5,072,957.10 lekë** (për diferencën prej 51.8209 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 1 km është **50,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

2. Subjekti “Rr” Shpk me Nipt J.....N i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 390/1, datë 22.01.1998, për shfrytëzimin e vendburimit Jorgo-Mali i Jashikut Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.099 km² (9.9 ha)

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “Rr” Shpk për sipërfaqen 5.0487 ha është **159,198.6 lekë** (për diferencën prej 4.8436 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 3 km është **150,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë, përbën të ardhura të munguara.

3. Subjekti “Xh K” Shpk me Nipt K.....D i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1115/1, datë 12.12.2007, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 1.09 km² (109 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “Xh K” Shpk për sipërfaqen 40.5823 ha është **2,959,495.2 lekë** (për diferencën prej 68.3 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) ndaj Bashkisë Selenicë, përbën të ardhura të munguara.

4. Subjekti “M B” Shpk me Nipt K.....E i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1371, datë 22.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kume-Murriz Selenicë për llojin e mineralit bitum dhe zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.324 km² (32.4 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “M B” Shpk për sipërfaqen 29.6971 ha është **801,821.70 lekë** (për diferencën prej 2.7 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 1 km është **50,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

5. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/2, datë 10.07.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë, Romës Selenicë për llojin mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.638 km² (163.8 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B M I” Shpk për sipërfaqen 130.1622 ha është **8,993,505 lekë** (për diferencën prej 33.63 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 3.6 km është **180,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

6. Subjekti “B M I” Shpk me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1496/3, datë 26.11.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Treblovë-Romës Selenicë për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 1.171 km² (117.1 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B M I” Shpk për sipërfaqen 88.4797 ha është **6,989,725.8 lekë** (për diferencën prej 28.5377 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë), ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

7. Subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) me Nipt K.....Q i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1578, datë 24.09.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Zona e dytë Resulaj Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.137 km² (13.7 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK) për sipërfaqen 11.1124 ha është **527,243.4 lekë** (për diferencën prej 2.59 ha + 3 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 219,865.2 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

8. Subjekti “A-I” Shpk (Z Shpk NK) me Nipt L.....B i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1644, datë 02.07.2013, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz me sipërfaqe 0.36 km² (36 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “A-I” Shpk (Z Shpk NK) për sipërfaqen 25.4787 ha është **1,512,324.60 lekë** (për diferencën prej 10.039 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 1 km është **50,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

9. Subjekti “B & AD C” Shpk me Nipt L.....A i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1753, datë 21.05.2015, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz dhe bitum me sipërfaqe 0.322 km² (32.2 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B & AD C” Shpk për sipërfaqen 30.4383 ha është **1,369,314 lekë** (për diferencën prej 1.7544 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 3 km është **150,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

10. Subjekti “B G” Shpk me Nipt L.....I i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1754, datë 22.05.2015, për shfrytëzimin e vendburimit Selenicë për llojin e mineralit zhavor bituminoz dhe bitum me sipërfaqe 0.251 km² (25.1 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B G” Shpk për sipërfaqen 10.5543 ha është **805,980.9 lekë** (për diferencën prej 14.5457 ha është pasuri private referuar akt-verifikimit të mbajtur nga grupi i punës dhe raportit mbi studimin tekniko-ekonomik dhe nuk është përlllogaritur tarifë) dhe përdorimit faktik të linjave gjatësore prej 3 km është **150,000 lekë**, ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

11. Subjekti “Y S” Shpk me Nipt L.....T i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1789, datë 14.01.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.198 km² (19.8 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “Y S” Shpk për sipërfaqen 15.94 ha është **987,164 lekë** (për diferencën prej 3.86 ha + 7.6 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 529,320 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

12. Subjekti “A” Shpk me Nipt L.....B i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1792/1, datë 10.03.2016, për shfrytëzimin e vendburimit Lepenicë Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.268 km² (26.8 ha);

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “A” Shpk për sipërfaqen 22.8 ha është **1,988,820 lekë** (për diferencën prej 4 ha + 2.17 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 399,690 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

13. Subjekti “M P” Shpk me Nipt L.....U i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1826, datë 12.12.2016, për shfrytëzimin e vendburimit në Lepenicë Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror organogjeno coprizor me sipërfaqe 0.997 km² (99.7 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “M P” Shpk për sipërfaqen 96.88 ha është **7,260,480** (për diferencën prej 3.94 ha + 2.72 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 399,690 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

14. Subjekti “S M” Shpk me Nipt L.....K i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1863, datë 17.07.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror masiv me sipërfaqe 1.329 km² (132.9 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “S M” Shpk për sipërfaqen 128.22 ha është **10,001,160 lekë** (për diferencën prej 4.86 ha + 1 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 400,040 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara.

15. Subjekti “B S” Shpk me Nipt M.....E i regjistruar në AKBN, i pajisur me lejen minerare nr. 1943, datë 17.02.2023, për shfrytëzimin e vendburimit Brataj Selenicë për llojin e mineralit gëlqeror dekorativ me sipërfaqe 0.240 km² (24 ha).

Vlera e qirasë vjetore për vitin 2023 që duhet të paguajë subjekti “B S” Shpk për sipërfaqen 24 ha është **1,973,700 lekë** (për 1.81 km përdorimit faktik të linjave gjatësore është likuiduar detyrimi në vlerën totale 97,519.2 lekë) ndaj Bashkisë Selenicë përbën të ardhura të munguara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 78-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Selenicë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjorë, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjorë, në referencë të nenit 17, të Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjorë”, i ndryshuar, për zbritjen nga fondi pyjorë.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Selenicë, të vendosen marrëdhënie kontraktuale me subjektet shfrytëzuese të sipërfaqeve pyjore, duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 761.8728 ha, dhe aplikuar tarifin minimale për të llogaritur vlerat e qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit për vlerën **52,032,890.70 lekë**, respektivisht subjektet:

- Vlera **5,122,957.1 lekë** nga subjekti “S B” Shpk
- Vlera **309,199 lekë** nga subjekti “Rr” Shpk
- Vlera **2,959,495.2 lekë** nga subjekti “Xh K” Shpk
- Vlera **851,821.7 lekë** nga subjekti “M B” Shpk
- Vlera **16,163,230.80 lekë** nga subjekti “B M I” Shpk
- Vlera **527,243.4 lekë** nga subjekti “B M I” Shpk (B P Shpk NK)
- Vlera **1,562,324.60 lekë** nga subjekti “A-I” Shpk (Z Shpk NK)
- Vlera **1,519,314 lekë** nga subjekti “B & AD C” Shpk
- Vlera **805,980.9 lekë** nga subjekti “B G” Shpk
- Vlera **987,164 lekë** nga subjekti “Y Sa” Shpk

- Vlera 1,988,820 lekë nga subjekti “A” Shpk
- Vlera 7,260,480 lekë nga subjekti “M P” Shpk
- Vlera 10,001,160 lekë nga subjekti “S M” Shpk
- Vlera 1,973,700 lekë nga subjekti “B S” Shpk

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën shkeljes, për 7 punonjës, respektivisht:**

1. z. E. F, me detyrë Drejtorë Drejtorisë Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçencave;
2. z. D. D, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. znj. S. Gj, me detyrë Specialiste për Kontabilizimin dhe Shërbimin ndaj Taksapaguesve;
4. znj. M. B, me detyrë Specialiste për Statistikat dhe Menaxhimin e Borxhit.

Për shkeljet e përbashkëta, përkatësisht:

- Për planifikimin me rezerva dhe të paargumentuar, pa projekt për çdo takse vendore, pa të dhëna dhe dokumente;
- Për mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në total dhe strukturë, pasi nga 114,592,854 lekë planifikimi janë realizuar 97,651,182 lekë ose diferenca 16,941,672 mungesë të ardhurash;
- Për rritjen e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për vlerën 455,593,441 lekë, ku vlera e debitorëve është 5 herë më madhe se ardhurat vendore vjetore 2023, raport ky i zhdrejtë, në vend që të ndodhte e kundërta;
- Për mosndërmarrje të veprimeve administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre, duke i lënë këto debitorë në heshtje dhe të kalojnë në debitorë pa shpresë arkëtimi, duke kaluar afati i kërkimit të tyre në rrugë gjyqësore;
- Për mos aplikim të sanksioneve për mos likuidim në afat të detyrimeve në zbatim të nenit 17/1/a, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” dhe Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Kreu XIV, neni 114;
- Për mospërputhje të vlerës së kontabilizuar të debitorëve prej 266,085,170 lekë me vlerën progresive sipas taksave vendore prej 455,593,441, pra për mos kontabilizimin e vlerës debitorë 189,508,271 lekë (455,593,441-266,085,170), ç’ka bie ndesh me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin” i ndryshuar me Ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018, me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme” i ndryshuar dhe me UMF nr. 5, datë 21.02.2022, me nenin, 17, 34 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar me Ligjin nr. 122/2020, me nenet 90, 91, 93, 111, 113 etj.,;
- Për mos disponim të dokumenteve në dosjet e subjekteve, për zbërthimin dhe përlllogaritjen e rentës minerale si dhe nuk ka rekordim vjetor me agjentin tatimor, për efekt te pagesës saj dhe sa subjekte nuk kanë kryer pagesën ose e kanë kryer të pjesshme;

-Për mungesë dokumentacioni në dosjet e subjekteve biznesit madh dhe mos inventarizimin e tyre, në kundërshtim me nenin 30 të Modelit nr. 8, “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjike Shërbimit Arkivor RSH”, në zbatim nenit 3 dhe 29 Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.
-Për lëshimin në disa raste të vërtetimeve për subjektet për efekt dokumenti, se ato nuk janë debitorë, ku ne fakt rezultojnë debitorë, përkatësisht: për “B\$AD C” Shpk, “M P” Shpk, “M B” Shpk, “S B Sha, “B P” Shpk e tjerë.

5. z. L. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare & Arkiv Protokollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, nënshkruesi i pasqyrave financiare, për shkeljet:

-Për mos pakësimin e vlerës 93,153 lekë në Pasqyrën e Pozicionit Financiar nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)” dhe nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” që i përket aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit sipas procesverbaleve të datës 23.12.2023, 28.12.2023, dhe 01.12.2023;

-Për nënvlerësimin në vlerën 9,057,580 lekë të llogarisë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”, për arsye të mos kontabilizimit të aktiveve të vlerësuara si të dëmtuara nga procesi i inventarizimit sipas procesverbaleve të datës 01.12.2023, 23.12.2023, dhe 28.12.2023;

-Për aplikimin e normës së amortizimit në vlerën 58,000 lekë për llogarinë 210 “Troje, toka, terrene”, ndërkohë që duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pika 30, për këtë llogari nuk mund të aplikohet normë amortizimi;

-Për kontabilizimin e vlerës 526,501,279 lekë në llogarinë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” që i përkasin asetëve të transferuara në Shoqërinë Ujësjiellës Selenicë;

-Për kontabilizimin në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” vlerën prej 31,079,786 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 15,757,820 lekë; 210 “Tokë, troje, terrene” vlerën prej 140,307,952 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 58,000 lekë; 212 “Ndërtesa e konstruksione” vlerën prej 282,322,171 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 45,581,320 lekë; 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” vlerën prej 1,570,622,458 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 260,837,855 lekë; 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” vlerën prej 11,853,994 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 5,399,691 lekë; 215 “Mjete transporti” vlerën prej 11,678,180 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 10,799,192 lekë dhe 218 “Inventar ekonomik” vlerën prej 38,702,608 lekë kosto historike dhe amortizim në vlerën 19,379,921 lekë të pa analizuar si në kontabilitet ashtu edhe në gjendjen fizike. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave Sevaster, Brataj, Kotë, Armen dhe Vllahinë (në formë tabelore në programin Excel) e paanalizuar ndikon në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

-Për nënvlerësimin në vlerën 530,578 lekë llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, konkretisht, vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Selenicë me Nipt K47127201C është 17,396,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë me Nipt M37202202E. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Selenicë është 530,578 ose 3.05% ($3.05 \cdot 17,396,000 / 100 = 530,578$ lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë.

-Për kontabilizimin në gjendjen e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” vlerën 764,810 lekë me emërtimin “Pa origjinë” apo “Kaluar gabim nga të ardhurat” për të cilat nuk disponohet asnjë dokumentacion kontabël, mbi origjinën e tyre të cilat mbahen të mbartura dhe të trashëguara vit pas viti në kontabilitet si dhe nuk janë të verifikueshme çfarë pasqyrojnë këto vlera në kontabilitetin e njësisë për shkak të mos përshkrimit të objektit që i përket kthimit të garancisë.

-Për nënvlerësimin e llogarisë 101 “Teprica (Fondi i akumuluar)/Defiçiti i akumuluar” në vlerën 1,440,996 lekë.

6. z. B. K., me detyrë Drejtorisë i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyje/Kullotave, për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e aktiviteteve të zhvilluara në fondin pyjor dhe kullosor.

7. A. H. me detyrë Zëvendës Kryetar i Bashkisë për lëshimin e vërtetimeve që nuk janë debitorë për subjektet që janë debitorë ndaj Bashkisë Selenicë.

D. 1. Për të gjithë punonjësit e tjerë, të cilët janë trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të cilët nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i të auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Selenicë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

D.2. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, pas përfundimeve të afateve ankimore, Bashkia Selenicë, *të ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

E. TË TJERA

Në auditimin e radhës me Programin nr. 1427/1, datë 06.12.2024, do të trajtohet më tej Pika nr. 1.6, e Programit të Auditimit trajtuar edhe në Raportin e Auditimit si më poshtë:

-Burimi i krijimit të të ardhurave për vitin 2023.

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, qiratë e asetëve, tokave, pyje kullotave etj., në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT